



Republika e Kosovës

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

# **Plani i Menaxhimit të Pellgut të Lumit Ibër, Kosovë**

## **Raporti Final**

**Prill 2026**

Plani i Menaxhimit të Pellgut të Lumit Ibër është zhvilluar përmes një procesi gjithëpërfshirës, mbështetur nga Programi Zviceran dhe i Qeverisë së Kosovës për 'Menaxhimin e Integruar të Resurseve Ujore të Kosovës' (MIRU-K). Ky Program lehtësohet nga Konsorciumi i Skat Consulting Ltd., Zvicër, dhe Agjencia e Mjedisit e Austrisë (AMA). Si pjesë e këtij bashkëpunimi, autoritetet përgjegjëse – Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës së Kosovës (MMPHI) dhe Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore (ARPL) – u asistuan në aspektin teknik nga një ekip ekspertësh nga Konsorciumi i Deltares, Holandë dhe Abkons, Shqipëri, të kontraktuar nga Programi.

## Përmbajtja

Kapitulli 1.....	14
Hyrje.....	14
1.1 Direktiva Kornizë e Ujërave e BE (DKU BE) .....	14
1.1.1 Pasqyrë e përgjithshme .....	14
1.1.2 Objektivat dhe Ligjet .....	15
1.1.3 Strategjia e Përbashkët e Zbatimit (SPZ), Grupet e Punës dhe Dokumentet Udhëzuese .....	16
1.2 Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore në Kosovë.....	16
1.2.1 Baza ligjore .....	16
1.2.2 Sfidat kryesore lidhur me Menaxhimin e Resurseve Ujore në Kosovë.....	19
1.2.3 Veçoritë gjeografike të pellgjeve lumore të Kosovës .....	19
1.3 Çështjet e Rëndësishme të Menaxhimit të Ujit dhe struktura e PMPL Ibër.....	24
Kapitulli 2.....	25
Karakterizimi i Pellgut të Lumit Ibër .....	25
2.1 Hyrje rreth Pellgut të Lumit Ibër .....	25
2.2 Karakterizimi natyror themelor .....	27
2.2.1 Topografia.....	27
2.2.2 Përvijimi (delineimi) i trupave ujorë sipërfaqësorë .....	29
2.2.3 Ujërat nëntokësore.....	26
2.2.4 Demografia .....	30
2.2.5 Ekonomia.....	32
2.2.6 Gjeologjia.....	33
2.2.7 Përdorimi i tokës në Pellgun e Lumit Ibër.....	35
2.2.8 Ekoregjionet dhe biodiversiteti .....	40
2.2.9 Zonat e mbrojtura ujore.....	41
2.2.10 Klima.....	43
2.2.11 Ndryshimet klimatike në Kosovë .....	46
2.3 Karakterizimet themelore hidrologjike .....	50
2.3.1 Gjendja hidrologjike e Pellgut të Lumit Ibër.....	50
2.3.2 Përmbytjet.....	53

2.3.3 Thatësiirat.....	53
2.4 Përdorimi i ujit dhe infrastruktura e ujit.....	55
2.4.1 Prapavija.....	55
2.4.2 Sistemi uJOR Ibër-Lepenc .....	57
2.4.3 Përdorimi industrial i ujit nga ujërat sipërfaqësore .....	58
2.4.4 Përdorimi bujqësor i ujit nga ujërat sipërfaqësore.....	59
2.4.5 Furnizimi me ujë të pijshëm nga ujërat sipërfaqësore .....	59
2.4.6 Furnizimi me ujë të pijshëm nga ujërat nëntokësore .....	60
2.4.7 HidroenergJia .....	61
2.4.8 Impiantet e trajtimit të ujërave të zeza (ITUZ).....	61
Kapitulli 3.....	63
Qëllimet, Shtytësit dhe Presionet e Pellgut Lumor .....	63
3.1 Qëllimet e përgjithshme dhe Çështjet e Rëndësishme të Menaxhimit të Ujit në Pellgun e Lumit Ibër .....	63
3.1.1 Qëllimet e përgjithshme për pellgun e Lumit Ibër .....	63
3.1.2 Çështjet e Rëndësishme të Menaxhimit të Ujit, vizioni dhe objektivat menaxhuese për Pellgun e Lumit Ibër.....	63
3.2 ÇRMU 1: Ndotja nga Vendbanimet Urbane dhe Industritë (burimet e palëvizshme) ...	64
3.2.1 Përshkrimi i problemit.....	64
3.2.2 Shtytës të rëndësishëm dhe presione të lidhura me ndotjen nga burimet e palëvizshme.....	65
3.2.3 Vizioni dhe objektivat e menaxhimit për ÇRMU 1.....	75
3.3 ÇRMU 2: Ndotja nga burime të lëvizshme nga bujqësia dhe burime tjera (ndotja nga burime difuzive) .....	76
3.3.1 Përshkrimi i problemit.....	76
3.3.2 Shtytës të rëndësishëm dhe presione të ndërlidhura nga burimet difuzive .....	76
3.3.3 Vizioni dhe objektivat e menaxhimit për ÇRMU 2.....	78
3.4 ÇRMU 3: Presionet në sasinë e ujërave sipërfaqësore .....	79
3.4.1 Përshkrimi i problemit.....	79
3.4.2 Shtytësit e rëndësishëm dhe presionet e ndërlidhura me sasinë e ujërave sipërfaqësore .....	79
3.4.3 Vizioni dhe objektivat e menaxhimit për ÇRMU 3.....	87
3.5 ÇRMU 4: Presionet në hidro-morfologjinë e ujërave sipërfaqësore .....	87

3.5.1 Përshkrimi i problemit.....	87
3.5.2 Shtytës të rëndësishëm dhe presione të ndërlidhura me hidro-morfologjinë e ujërave sipërfaqësore .....	88
3.5.3 Vizioni dhe objektivat e menaxhimit për ÇRMU 4.....	89
3.6 ÇRMU 5: Presione tjera në ujërat sipërfaqësore (presione tjera: akuakultura) .....	89
3.6.1 Përshkrimi i problemit.....	89
3.6.2 Shtytës të rëndësishëm dhe presione të ndërlidhura në ujërat sipërfaqësore (presione tjera: akuakultura) .....	90
3.6.3 Vizioni dhe objektivat e menaxhimit për ÇRMU 5.....	90
3.7 ÇRMU 6: Presionet në sasinë dhe cilësinë e ujërave nëntokësore .....	90
3.7.1 Përshkrimi i problemit.....	90
3.7.2 Shtytësit kryesorë dhe presionet e ndërlidhura në sasinë dhe cilësinë e ujërave nëntokësore.....	91
3.7.3 Vizioni dhe objektivat e menaxhimit për ÇRMU 6.....	92
3.8 Pasqyrë e presioneve në sistemin e ujit në Pellgun e Lumit Ibër.....	92
Kapitulli 4.....	93
Monitorimi dhe Vlerësimi i Statusit.....	93
4.1 Hyrje.....	93
4.2 Metodologjia .....	93
4.2.1 Ujërat sipërfaqësore.....	93
4.2.2 Ujërat nëntokësore.....	96
4.3 Vlerësimi i statusit të Ujërave Sipërfaqësore.....	96
4.3.1 Çasje e përgjithshme .....	96
4.3.2 Statusi ekologjik.....	97
4.3.3 Statusi kimik.....	104
4.3.4 Statusi hidromorfologjik.....	106
4.4 Vlerësimi i statusit të ujërave nëntokësore .....	107
4.5 Zonat e mbrojtura .....	110
4.6 Rekomandimet për monitorim .....	110
4.6.1 Ujërat sipërfaqësore.....	110
4.6.2 Ujërat nëntokësore.....	112
4.6.3 Zonat e mbrojtura.....	112

4.6.4 Implementimi .....	113
4.7 Sistemi informativ ujqor.....	113
Kapitulli 5.....	115
Analiza Ekonomike e Përdorimeve të Ujqit, Analiza e të Ardhurave dhe Kthimi i Kostos .....	115
5.1 Hyrje rreth çasjes së përdorur.....	115
5.2 Analiza ekonomike e përdoruesve të ujqit.....	115
5.3 Përdorimet dhe shkarkimet aktuale dhe ato të ardhshme të ujqit.....	116
5.3.1 Nxjerrjet aktuale të ujqit për furnizim të amvisërive dhe shkarkimet.....	116
5.3.2 Nxjerrjet e ardhshme të ujqit për furnizimin të amvisërive dhe shkarkimet .....	117
5.3.3 Nxjerrjet aktuale të ujqit për përdorim të ujqit të pijshëm (të ambalazhuar) .....	118
5.3.4 Nxjerrjet e ardhshme të ujqit për përdorim si ujë i pijshëm .....	118
5.3.5 Nxjerrjet aktuale të ujqit për ujqitje .....	118
5.3.6 Nxjerrjet e ardhshme të ujqit për ujqitje .....	119
5.3.7 Nxjerrjet aktuale të ujqit për sektorin e industrisë dhe prodhimin e energjisë dhe shkarkimet e ujqit.....	119
5.3.8 Nxjerrjet e ardhshme të ujqit për sektorin e industrisë dhe prodhimin e energjisë dhe shkarkimet e ujqit.....	120
5.4 Analiza e kostos dhe e të ardhurave .....	120
5.4.1 Mekanizmat e kostos së ujqit .....	120
5.4.2 Të ardhurat nga tarifat e furnizimit me ujë dhe tarifat për ujqërat e zeza .....	121
5.4.3 Tarifat e ujqit për shërbimet e ujqitjes.....	121
5.4.4 Tarifat e ujqit për industrinë dhe prodhuesit e energjisë .....	122
5.5 Kthimi i kostos .....	123
5.6 Rekomandime .....	124
Kapitulli 6.....	126
Programi i Masave.....	126
6.1 Hyrje .....	126
6.2 Arsyetimi për zhvillimin e Programit të Masave (PM) .....	126
6.3 Afati kohor për PM të lbrit dhe prioritizimi i masave .....	127
6.4 Zbatimi i planit të veprimit dhe monitorimi .....	128
6.5 Struktura e programit të masave.....	128
6.6 Masat themelore për Pellgun e Lumit Ibër.....	129

6.7 Masa plotësuese për Pellgun e Lumit Ibër .....	130
6.7.1 Hyrje .....	130
6.7.2 Lista e prioritizuar e masave plotësuese për Pellgun e Lumit Ibër .....	131
6.7.3 Masat plotësuese të klasës 1 të prioritetit për Pellgun e Lumit Ibër .....	133
6.8 Vlerësimi paraprak i kostos së masave shtesë me prioritet .....	144
Kapitulli 7 .....	146
Regjistri i Zonave të Mbrojtura në Pellgun e Lumit Ibër .....	146
7.1 Hyrje .....	146
7.2 Qasja dhe statusi i regjistrit të zonave të mbrojtura në Pellgun e Lumit Ibër .....	147
Kapitulli 8 .....	152
Procesi i përfshirjes së palëve të interesit dhe konsultimi publik .....	152
8.1 Hyrje .....	152
8.2 Kërkesat e DKU për përfshirjen e palëve të interesit dhe pjesëmarrjen e publikut .....	152
8.3 Identifikimi i palëve të interesit .....	152
Kapitulli 9 .....	154
Konteksti institucional në menaxhimin e resurseve ujore .....	154
9.1 Hyrje .....	154
9.2 Autoritetet përgjegjëse të ujit dhe palët kryesore të interesit në menaxhimin e resurseve ujore në Kosovë .....	154
Kapitulli 10 .....	158
MIRU në nivelin e pellgut lumor: mësimet e nxjerra nga zbatimi i DKU në Evropë .....	158
Kapitulli 11 .....	160
Referencat .....	160

## Lista e figurave

Figura 1: Ngarkesa e vlerësuar për cSHBO nga amvisëritë dhe industrinë.....	68
Figura 2: Aplikimi i vlerësuar i azotit (N) për trup ujor sipërfaqësor. ....	77
Figura 3: Procedura e përgjithshme për përcaktimin e statusit të trupit ujor sipërfaqësor (L- i lartë; MR – i mirë; M – mesatar; D – i dobët; K – i keq; nd – nuk ka të dhëna; DSH - dështon).	97
Figura 4: Klasifikimi i statusit ekologjik.....	98
Figura 5: Vlerësimi i përgjithshëm i statusit ekologjik.....	103
Figura 6: Vlerësimi i përgjithshëm i statusit kimik TUS.....	105
Figura 7: Vlerësimi i përgjithshëm i statusit kimik TUN. ....	109
Figura 8: Struktura e Programit të Masave (PM) për Pellgun e Lumit Ibër .....	129
Figura 9: Korniza e organizatave institucionale për menaxhimin e resurseve ujore në Kosovë .....	154

## Lista e hartave

Harta 1: Pellgjet lumore në Kosovë. ....	21
Harta 2: Pellgu i lumit Ibër. ....	23
Harta 3: Pellgu i Lumit Ibër me nënpellgjet .....	26
Harta 4: Harta e lartësive të terrenit – Pellgu i Lumit Ibër.....	28
Harta 5: Përvijimi (delineimi) i trupave ujqorë sipërfaqësorë - Pellgu i Ibrit, të gjitha kategoritë... 30	
Harta 6: Nivelet mesatare të ujërave nëntokësore në Pellgun e Lumit Ibër (NUN).....	26
Harta 7: TUN në Pellgun e Lumit Ibër.....	29
Harta 8: Zonat administrative, dendësia dhe qendrat e popullsisë – Pellgu i Ibrit.....	31
Harta 9: Gjeologjia e pellgut të lumit Ibër.....	34
Harta 10: Përdorimi i tokës në Pellgun e Lumit Ibër.....	39
Harta 11: Pellgu i Lumit Ibër dhe ekoregjonet.....	40
Harta 12: Rrjeti hidrometrik në Pellgun e Lumit Ibër. ....	44
Harta 13: Shpërndarja e reshjeve në Pellgun e Lumit Ibër.....	45
Harta 14: Ndryshimi mesatar vjetor i temperaturës.....	48
Harta 15: Reshjet. ....	49
Harta 16: Harta hidrogjeologjike e Pellgut të Lumit Ibër - 1:200.000, ICMM, 2006.....	52
Harta 17: Indeksi i Standardizuar i Reshjeve (ISR) për periudhën gjashtëmujore hidrologjike, tetor 2019 - mars 2020 (Burimi: Raporti i gjendjes së ujit në Kosovë, 2020). E gjelbra tregon mungesë thatësire, e verdha thatësirë të vogël dhe e kuqja thatësirë të madhe.....	54
Harta 18: Infrastruktura kryesore ujore në Pellgun e Lumit Ibër.....	56
Harta 19: Sistemi Ibër-Lepenc në Pellgun e Lumit Ibër (Burimi: Ndërmarrja Ibër-Lepenci, <a href="http://www.lbër-lepenc.org/">http://www.lbër-lepenc.org/</a> ).....	57
Harta 20: Pikat e shkarkimit të ujërave të zeza në Pellgun e Lumit Ibër.....	67
Harta 21: Pasqyrë e presioneve në sistemin e ujit në Pellgun e Lumit Ibër.....	92
Harta 22: Monitorimi aktual i ujërave sipërfaqësore në Pellgun e Lumit Ibër.....	95
Harta 23: Nota e vlerësimit të rrezikut kimik për trupat nëntokësorë.....	108
Harta 24: Monitorimi i propozuar për ujërat sipërfaqësore.....	111
Harta 25: Pasqyrë e të gjitha zonave të mbrojtura – Pellgu i Lumit Ibër.....	151

## Lista e tabelave

Tabela 1: Legjislacioni kyç i Kosovës për ujin dhe mjedisin .....	18
Tabela 2: NënPELLGJET dhe trupat UJORË sipërfaqësorë (TUS) në Pellgun e Lumit Ibër (Kategoria: Lumenjtë) .....	31
Tabela 3: NënPELLGJET dhe Trupat UJORË Sipërfaqësorë (TUS) në Pellgun e Lumit Ibër (Kategoria: Liqenet) .....	33
Tabela 4: Të dhënat për trupat uJORË nëntokësorë në Pellgun e Lumit Ibër .....	27
Tabela 5: Përmbledhje e të dhënave të popullatës për secilën komunë në Pellgun e Lumit Ibër. ....	30
Tabela 6: Bujqësia në Pellgun e Lumit Ibër. ....	32
Tabela 7: Përdorimi i tokës në Pellgun e Lumit Ibër .....	36
Tabela 8: Informatat rreth ndryshimeve klimatike (Burimi: Studimi mbi ndryshimet klimatike në rajonin e Ballkanit Perëndimor në v.2018) (vjë=vjetor; qkg = qershor, korrik, gusht) .....	47
Tabela 9: Disponueshmëria e ujit në Pellgun e Lumit Ibër / Skenari: Kushtet aktuale (Burimi: Studimi i Bilancit Ujor, 2018) .....	50
Tabela 10: Disponueshmëria e ujit në Pellgun e Lumit Ibër / Skenari: Kushtet e ardhshme (Burimi: Studimi i Bilancit Ujor, 2018). ....	50
Tabela 11: Njoftimet zyrtare për përmblytje në vitin 2016 në Pellgun e Lumit Ibër .....	53
Tabela 12: Përdorimi industrial i ujit .....	59
Tabela 13: Përdorimi bujqësor i ujit në Pellgun e Lumit Ibër në vitin 2019. ....	59
Tabela 14: Sipërfaqet e ujitura në Pellgun e Lumit Ibër për komunë për 2019, 2020 dhe 2021. ....	59
Tabela 15: Furnizimi me ujë të pijshëm nga ujërat sipërfësore në Pellgun e Lumit Ibër. ....	60
Tabela 16: Furnizimi me ujë të pijshëm nga ujërat nëntokësore në Pellgun e Lumit Ibër .....	60
Tabela 17: Shtytës të rëndësishëm dhe presione të lidhura me ndotjen nga burime të palëvizshme. ....	65
Tabela 18: Kuantifikimi i burimeve të palëvizshme për Pellgun e Ibrit .....	69
Tabela 19: Regjistri i shtytësve dhe presioneve: shkarkimi i ujërave të zeza urbane dhe industriale në Pellgun e Ibrit. ....	70
Tabela 20: Regjistri i shtytësve dhe presioneve: aktivitetet industriale në Pellgun e Lumit Ibër. ....	71
Tabela 21: Regjistri i shtytësve dhe presioneve: Deponitë e mbeturinave në Pellgun e Lumit Ibër .....	72
Tabela 22: Regjistri i shtytësve dhe presioneve: Aktivitetet e minierave dhe guroreve në Pellgun e Lumit Ibër. ....	72
Tabela 23: Deponite ilegale pranë lumenjeve të Pellgut Ibër .....	73
Tabela 24: Shtytës të rëndësishëm dhe presione të ndërlidhura nga burimet difuzive .....	76
Tabela 25: Regjistri i shtytësve dhe presioneve: Bujqësia në Pellgun e Lumit Ibër .....	78
Tabela 26: Shtytësit e rëndësishëm dhe presionet e ndërlidhura me sasinë e ujërave sipërfaqësore. ....	79

Tabela 27: Regjistri i shtytësve dhe presioneve: Nxjerrja e ujit nga ujërat sipërfaqësore në Pellgun e Lumit Ibër. ....	81
Tabela 28: Shtytës të rëndësishëm dhe presione të ndërlidhura me hidro-morfologjisë e ujërave sipërfaqësore. ....	88
Tabela 29: Regjistri i shtytësve dhe presioneve: Hidrocentralet në Pellgun e Lumit Ibër.....	88
Tabela 30: Shtytës të rëndësishëm dhe presione të ndërlidhura në ujërat sipërfaqësore (presione tjera: akuakultura). ....	90
Tabela 31: Regjistri i shtytësve dhe presioneve: Akuakultura në Pellgun e Lumit Ibër.....	90
Tabela 32: Klasifikimi i elementeve të cilësisë biologjike (L- i lartë; MR – i mire; M – mesatar; D – i dobët; K – i keq; nd – nuk ka të dhëna).....	98
Tabela 33: Klasifikimi i elementeve të përgjithshme kimike (L- i lartë; MR – i mire; M – mesatar; D – i dobët; K – i keq; nd – nuk ka të dhëna). ....	100
Tabela 34: Klasifikimi i ndotësve specifike të pellgut lumor (metalet).....	102
Tabela 35: Klasifikimi i substancave prioritare (Cd, Ni dhe Pb) (Dsh – Dështon). ....	104
Tabela 36: Vlerësimi i statusit hidromorfologjik bazuar në regjimin e rrjedhjes. ....	106
Tabela 37: Klasët e rrezikut të përdorura për tipin e përdorimit të tokës. ....	107
Tabela 38: Vlerësimi i statusit për trupat ujqorë nëntokësore në Pellgun e Ibrit. ....	109
Tabela 39: Përputhshmëria e rezultateve të nitrateve dhe pesticideve me standardet e përgjithshme të BE për ujërat nëntokësore.....	109
Tabela 40: Orari për implementim. ....	113
Tabela 41: Burimi dhe lloji i të dhënave. ....	114
Tabela 42: Rritja e popullsisë për pellg lumor: viti 2021 krahasuar me vitin 2026. ....	116
Tabela 43: Nxjerrjet aktuale të ujit për pellg – KRU. ....	117
Tabela 44: Shkarkimet e amvisërive në trupat ujqorë. ....	117
Tabela 45: Skenarët e ardhshëm të nxjerrjes së ujit. ....	118
Tabela 46: Skenarët e ardhshëm të shkarkimit nga amvisëritë.....	118
Tabela 47: Nxjerrja vjetore për ujë të pijshëm.....	118
Tabela 48: Nxjerrjet e ardhshme të ujit për përdorim si ujë i pijshëm i ambalazhuar.....	118
Tabela 49: Mesatarja vjetore e ujit të nxjerrë për ujitje për pellg lumi.....	119
Tabela 50: Përmbledhje e ujit të përdorur për ujitje nga ujërat sipërfaqësore dhe ato nëntokësore (mil m <sup>3</sup> /vit). ....	119
Tabela 51: Nxjerrjet e ardhshme të ujit për ujitje.....	119
Tabela 52: Konsumi i ardhshëm neto i ujit për përdorim në ujitje.....	119
Tabela 53: Sasia mesatare vjetore e ujit të nxjerrë për përdorim në industri.....	120
Tabela 54: Shkarkimet industriale. ....	120
Tabela 55: Nxjerrjet e ardhshme të ujit për përdorim industrial.....	120
Tabela 56: Shkarkime te ardhshme industriale.....	120

Tabela 57: Tarifat e përdorimit të ujit nga KRU. ....	121
Tabela 58: Të hyrat e KRU për periudhën 2020-2021. ....	121
Tabela 59: Tarifat e ujit për përdorimin e ujit për ujitje varësisht nga resursi ujqor. ....	122
Tabela 60: Vlerësimi i të ardhurave nga uji sipërfaqësor dhe nëntokësor i përdorur për ujitje, skenari 2, Ibër. ....	122
Tabela 61: Tarifat e ujit dhe ujërave të zeza si dhe të ardhurat e vlerësuara nga përdorimi dhe shkarkimet e ujit në sektorin e industrisë. ....	123
Tabela 62: Tarifat e ujit për sektorin e energjisë në vitin 2021. ....	123
Tabela 63: Të ardhurat e parashikuara nga hidrocentralet. ....	123
Tabela 64: Kthimi i kostos në Pellgun e Lumit Ibër. ....	123
Tabela 65: Kthimi financiar i kostos për sektor. ....	124
Tabela 66: Gjetjet kryesore për gjashtë ÇRMU.....	126
Tabela 67: Lista prioritare e masave plotësuese për Pellgun e Lumit Ibër. ....	131
Tabela 68: Masat plotësuese të klasës 1 të prioritetit për Pellgun e Lumit Ibër. ....	133
Tabela 69: Krahasimi ndërmjet kërkesave të DKU për krijimin e zonave të mbrojtura dhe gjendjes aktuale me zonat e mbrojtura në Kosovë. ....	146
Tabela 70: Regjistri i zonave të mbrojtura – Kategoria Zonat e Mbrojtura Sanitare (ZMS) në Pellgun e Lumit Ibër. ....	148
Tabela 71: Zonat e mbrojtura natyrore në Pellgun e Lumit Ibër. ....	149

## Akronimet/Shkurtesat

AMA	Agjencia e Mjedisit e Austrisë
AMMK	Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
ARPL	Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore
ARRSHU	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
AZZH	Agjencia Zvicerane për Zhvillim
BE	Bashkimi Evropian
ÇRMU	Çështjet e Rëndësishme të Menaxhimit të Ujit
DEI	Direktiva e Emisioneve Industriale
DKU	Direktiva Kornizë e Ujërave
DSCM	Direktiva e Standardeve të Cilësisë Mjedisore
DTUNU	Direktiva për trajtimin e ujërave të ndotura urbane
DUN	Direktiva e ujërave nëntokësore
EJL	Evropa Juglindore
FPGJNP	Forcat shtytëse, presioniet, gjendja, ndikimi dhe përgjigjet
GS	Gazrat serrë
IHMK	Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
IKSHP	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike
ISR	Indeksi i Standardizuar i Reshjeve
ITUZ	Impiantet e trajtimit të ujërave të zeza
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KKRR	Kurba e kohëzgjatjes së rrjedhës
KNU	Këshilli ndërministror për ujërat
KOT	Karbon organik total
KPMM	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
KR	Kushtet referente
KRU	Kompani Rajonale e Ujësullësit
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MIRU-K	Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore të Kosovës
MMK	Milionë metra kub
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MPUK	Master Plani i Ujitjes së Kosovës
MRU	Menaxhimi i Resurseve të Ujit

NN	Nivelet Natyrore
OBEZH	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
OM	Operim dhe mirëmbajtje
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OT	Oksigjeni i tretur
PLD	Pellgu Lumor i Danubit
PLDR	Pellgu Lumor i Drinit
PMLP	Plani i Menaxhimit të Pellgut Lumor
PNNK	Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike
PVM	Plani i Veprimit në Mjedis
RELTN	Regjistri Evropian i Lirimit dhe Transferit të Ndotësve
RPP	Rrugët e Përfaqësimit të Përfaqësuesit
SCM	Standarde e Cilësisë Mjedisore
SHBO	Shpenzimi Biologjik i Oksigjenit
SHKO	Shpenzimi Kimik i Oksigjenit
SHPEKA	Shpenzime Kapitale
SHPOP	Shpenzimet operative
SIDA	Swedish International Development Cooperation Agency
SMMK	Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
SPI	Strategjia e Përbashkët Implementuese
TEC	Termocentrali
TUA	Trupa Ujorë Artificialë
TUMR	Trupa Ujorë të Modifikuar Rëndë
TUN	Trupa Ujorë Nëntokësorë
TUNA	Trupa Ujorë Natyrorë
TUS	Trupa Ujorë Sipërfaqësorë
UA	Udhëzimi Administrativ
UNDP	United Nations Development Programme
UNMIK	United Nations Mission in Kosovo
UPA	Uji i pafaturuar
VP	Vlerat e pragut
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
ZMS	Zonat e Mbrojtura Sanitare
ZMUP	Zonat e Mbrojtura të Ujit të Pijshëm
ZMUPN	Zonat e mbrojtura të ujit të pijshëm nëntokësor

ZNN

Zonat e ndjeshme të nitrateve

ZRRUM

Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina

# Kapitulli 1

## Hyrje

### 1.1 Direktiva Kornizë e Ujërave e BE (DKU BE)

#### 1.1.1 Pasqyrë e përgjithshme

Direktiva Kornizë e Ujërave<sup>1</sup> e BE përcakton rregulla për të ndalur përkeqësimin e statusit të trupave ujorë sipërfaqësorë dhe nëntokësorë në BE dhe për të arritur status të mirë të lumenjve, liqeneve dhe ujërave nëntokësore të Evropës.

Qytetarët, natyra dhe industria kanë nevojë për gjendje të shëndetshme të lumenjve, liqeneve, ujërave nëntokësore dhe ujërave për larje. Direktiva Kornizë e Ujërave (DKU) fokusohet në sigurimin e shëndetit të mirë cilësor dhe sasior, d.m.th., në reduktimin dhe largimin e ndotjes, si dhe në sigurimin që ka ujë të mjaftueshëm për të mbështetur qëndrueshmërinë e ekosistemeve karshi nevojave njerëzore për to.

Që nga viti 2000, DKU ka qenë ligji kryesor për mbrojtjen e ujit në Evropë. Ky ligj zbatohet për ujërat sipërfaqësore të brendshme, tranzitore dhe bregdetare, si dhe për ujërat nëntokësore. Kjo Direktivë siguron një qasje të integruar në menaxhimin e ujit, duke respektuar integritetin e ekosistemeve si tërësi, duke rregulluar ndotësit individualë dhe duke caktuar standardet përkatëse rregullatore. Ky ligj bazohet në një qasje rajonale të pellgut lumor duke u siguruar që vendet fqinje janë duke bashkëpunuar në menaxhimin e lumenjve dhe trupave të tjerë ujorë që ato ndajnë së bashku.

Shumë pellgje lumenjsh evropianë janë me karakter ndërkombëtar, që do të thotë se i kalojnë kufijtë administrativë dhe territorialë. Prandaj, është thelbësore të arrihet një kuptim dhe një qasje e përbashkët në zbatimin e suksesshëm dhe efektiv të Direktivës.

Planet e Menaxhimit të Pellgjeve Lumore (PMPL) janë mjetet kryesore për zbatimin e DKU. Ato përpilohen pas konsultimit me palët e interesit dhe konsultimit publik dhe janë të vlefshme për një periudhë gjashtëvjeçare. Këto plane ofrojnë një qasje gjithëpërfshirëse në menaxhimin e ujërave, duke përfshirë aspekte të ndryshme si cilësia, sasia, statusi ekologjik, parandalimi i ndotjes dhe aspektet ekonomike. PMPL kanë për qëllim arritjen dhe ruajtjen e statusit të mirë të ujit në të gjithë trupat ujorë, duke përfshirë lumenjtë, liqenet, ujërat nëntokësore dhe zonat bregdetare. Në thelb, PMPL shërbejnë si zbatim praktik i DKU në nivelin e pellgut lumor, duke siguruar menaxhim të koordinuar dhe të integruar të resurseve ujore drejt arritjes së rezultateve të qëndrueshme që kanë të bëjnë me ujërat.

**Për zhvillimin e planit të MPL Ibër dhe raporteve teknike të tij, u përdorën dokumentet udhëzuese të Strategjisë së Përbashkët të Zhvillimit (SPZH) në vijim <sup>2</sup>:**

- Udhëzuesi nr 01 - Ekonomia- WATECO (WG 2.6)
- Udhëzuesi nr 02 - Identifikimi i trupave ujorë
- Udhëzuesi nr 03 - Presionet dhe ndikimet - IMPRESS (WG 2.1)
- Udhëzuesi nr 04 - Trupa ujorë të modifikuar rëndë - HMWB (WG 2.2)
- Udhëzuesi nr 07 - Monitorimi (GP 2.7)
- Udhëzuesi nr 09 - GIS (WG 3.1)
- Udhëzuesi nr 10 - Kushtet referente për ujërat e brendshme - REFCOND (WG 2.3)

<sup>1</sup> EUR-Lex - 32000L0060 - EN - EUR-Lex (europa.eu)

<sup>2</sup> wfd — Bibliothek (europa.eu)

- Udhëzuesi nr 13 - Klasifikimi i statusit ekologjik (WG A)
- Udhëzuesi nr 15 - Udhëzuesi për monitorimin e ujërave nëntokësore, nëntor-2006\_FINAL-2
- Udhëzuesi nr 16 - Ujërat nëntokësore në Zonat e Mbrojtura të Ujit të Pijshëm (ZMUP)
- Udhëzuesi nr 18 - Vlerësimi i gjendjes së ujërave nëntokësore
- Udhëzuesi nr 19 - Monitorimi kimik i ujërave sipërfaqësore
- Udhëzuesi nr 26 - Vlerësimi i rrezikut të ujërave nëntokësore dhe modelet konceptuale
- Udhëzuesi nr 27 - Nxjerrja e Standardeve të Cilësisë Mjedisore - versioni 2018-1

Struktura institucionale dhe mekanizmi për zhvillimin e PMPL Ibër ndjek praktikën e mirë të Organizatave Ndërkombëtare të Pellgjeve Lumore dhe integron tre nivele për të mundësuar planifikim dhe menaxhim efektiv midis autoriteteve të përfshira dhe palëve të interesit. Shkëmbimi i shpeshtë i informacionit dhe bashkërendimi ndërmjet tre niveleve ka qenë thelbësor për të siguruar një proces angazhimi gjithëpërfshirës dhe funksional drejt Planit të parë të Menaxhimit të Pellgut të Lumit Ibër. Tre nivelet janë:

- **Niveli A:** Niveli i gjerë i Pellgut të Ibër dhe niveli ndërkombëtar në të cilin kontribuon PMPL Ibër, duke përfshirë nivelin shtetëror të Kosovës me shtetet e saj ripariane përmes një mekanizmi të bashkëpunimit ndërkombëtar në nivelin e pellgut ndërkufitar (ky nivel është në proces zhvillimi).
- **Niveli B:** Niveli Shtetëror dhe Ndërministror është autoriteti përgjegjës i ujit në nivel pellgu dhe nënpellgu.
- **Niveli C:** Komunat, Kompanitë Rajonale të Ujit (KRU) dhe Kompanitë Rajonale të Ujitjes janë autoritetet përgjegjëse të ujit brenda nënpellgjeve.

### 1.1.2 Objektivat dhe Ligjet

Objektivat kryesorë të DKU janë përcaktuar në Nenin 4 të Direktivës. Ky nen kërkon që Shtetet Anëtare të përdorin Planet e tyre të Menaxhimit të Pellgjeve Lumore (PMPL) dhe Programet e Masave (PM) për të mbrojtur dhe, kur është e nevojshme, për të ristauruar trupat ujqorë në mënyrë që të arrihet statusi i mirë dhe kështu të parandalohet përkeqësimi i gjendjes. Statusi i mirë nënkupton status të mirë kimik, ekologjik dhe hidromorfologjik.

Direktiva Kornizë e Ujërave (DKU) është legjislacioni primar. Kjo Direktivë mbështetet nga dy direktiva simotër që kanë të bëjnë me cilësinë dhe sasinë e ujërave nëntokësore<sup>3</sup> dhe me cilësinë e ujërave sipërfaqësore<sup>4</sup>. DKU përmban dispozita rreth afateve të përbushjes së objektivave të saj, si dhe dispozita për përjashtimet. **Shtojcat** e DKU përmbajnë detaje për kërkesat e monitorimit, kriteret e vlerësimit të statusit të trupit ujqor, si dhe përmbajtjen e PMPL.

Aktualisht, DKU përfshin në **Shtojcat** e saj listën e substancave prioritare që Shtetet Anëtare duhet të monitorojnë në ujërat sipërfaqësore, por standardet për to janë përcaktuar në Direktivën e Standardeve të Cilësisë Mjedisore (DSCM)<sup>5</sup> dhe duhet të përbushen për të arritur status të mirë kimik të ujërave sipërfaqësore, në përputhje me Nenin 4 të DKU dhe pikën 1.4.3 të **Shtojcës V**. DKU gjithashtu kërkon që Shtetet Anëtare të vendosin dhe të përbushin Standardet e Cilësisë Mjedisore (SCM) për substancat me interes shtetëror, d.m.th. për ndotësit specifikë të pellgjeve lumore, monitorimi i të cilëve aktualisht kontribuon në vlerësimin e gjendjes ekologjike. Kjo listë e substancave prioritare duhet të rishikohet dhe të përditësohet nëse është e nevojshme, çdo 6 vjet.

<sup>3</sup> Groundwater (europa.eu)

<sup>4</sup> Surface water (europa.eu)

<sup>5</sup> EUR-Lex - 02008L0105-20130913 - EN - EUR-Lex (europa.eu)

Në mënyrë të ngjashme, lista e ndotësve dhe standardeve me interes për mbarë BE nga **Shtojca I** e Direktivës së Ujërave Nëntokësore (DUN)<sup>6</sup> duhet gjithashtu të rishikohet çdo 6 vjet. Kjo kontribuon në vlerësimin e gjendjes kimike të ujërave nëntokësore. Kjo direktivë e plotëson DKU duke përfshirë kërkesat që kanë të bëjnë me trendet e ndotësve dhe statusin sasior.

DKU integron në vetvete direktiva më specifike, d.m.th., Direktivën për Ujërat Nëntokësore, Direktivën e Ujit të Pijshëm, Direktivën e Ujërave për Larje, Direktivën e Nitrateve, Direktivën për Trajtimin e Ujërave të Zeza Urbane, Direktivën e Standardeve të Cilësisë Mjedisore dhe Direktivën e Përmbytjeve, dhe njëkohësisht mbështetet nga këto direktiva.

### **1.1.3 Strategjia e Përbashkët e Zbatimit (SPZ), Grupet e Punës dhe Dokumentet Udhëzuese**

Zbatimi i DKU paraqet disa sfida të përbashkëta teknike për Shtetet Anëtare, Komisionin, Vendet Kandidate dhe vendet e ZEE (Zonës Ekonomike Evropiane), si dhe palët e interesit dhe OJQ. Për të adresuar këto sfida në një mënyrë bashkëpunuese dhe të koordinuar, Komisioni u pajtua për një Strategji të Përbashkët Zbatimi (SPZ) për Direktivën Kornizë të Ujërave vetëm pesë muaj pas hyrjes në fuqi të direktivës. SPZ synon të sigurojë një zbatim të qëndrueshëm të DKU dhe në harmoni me direktivat simotra të saj.

Brenda këtij kuadri, funksionojnë disa Grupe Punuese teknike që përgatisin dokumente udhëzuese për aspektet teknike dhe temat kryesore. Këto grupe gjithashtu krijojnë edhe dokumente tematike shtesë<sup>7</sup>.

## **1.2 Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore në Kosovë**

### **1.2.1 Baza ligjore**

Disponueshmëria e sasive të mjaftueshme të ujit me cilësi të përshtatshme në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore është parakusht për furnizimin me ujë të pijshëm, prodhimin bujqësor, aktivitetet industriale, mbrojtjen e shëndetit publik dhe ruajtjen e ekosistemeve ujore.

Rritja e kërkesës për ujë, së bashku me ndikimet e ndryshimeve klimatike dhe presionet antropogjene, ka intensifikuar konkurrencën ndërmjet sektorëve të ndryshëm të përdorimit, veçanërisht në pellgjet me burime të kufizuara ujore. Në këto kushte, menaxhimi efektiv i burimeve ujore kërkon balancim të qëndrueshëm ndërmjet nevojave socio-ekonomike dhe mbrojtjes së integritetit hidrologjik dhe ekologjik të pellgjeve lumore.

Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore (MIRU) ofron një kornizë të përshtatshme për planifikimin, shpërndarjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të ujit në nivel pellgu. Ky qasje zbatohet përmes Planeve të Menaxhimit të Pellgjeve Lumore, të cilat përcaktojnë objektivat, masat dhe mekanizmat institucionalë për përmirësimin e statusit sasior dhe cilësor të ujërave.

Planet e menaxhimit përfshijnë masa strukturore dhe jo-strukturore, instrumente ligjore dhe politike, si dhe sisteme monitorimi dhe raportimi, të mbështetura në të dhëna shkencore dhe analiza teknike. Zbatimi efektiv i këtyre planeve kontribuon në përmbushjen e angazhimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, përfshirë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, si dhe në rritjen e qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike.

Republika e Kosovës ka bërë progres në krijimin e legjisllacionit që ka të bëjë me resurset ujore. Këto ligje kanë për qëllim trajtimin e aspekteve të ndryshme të menaxhimit dhe rregullimit të

<sup>6</sup> EUR-Lex - 32006L0118 - EN - EUR-Lex (europa.eu)

<sup>7</sup> wfd — Bibliothek (europa.eu)

ujërave në nivel vendi. Disa nga ligjet kryesore që kanë të bëjnë me menaxhimin e ujërave në Kosovë janë si në vijim:

- Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës;
- Ligji Nr. 02/L-9 për Ujitjen e Tokave Bujqësore;
- Ligji Nr. 02/I-79 për Veprimtaritë Hidrometeorologjike;
- Ligji Nr. 02/L-78 për Shëndetësi Publike;
- Ligji Nr. 03/L-086 për Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetës, Kanalizimit dhe Mbeturinave.
- LIGJI Nr. 04/L-060 PËR MBETURINA

Përveç këtyre ligjeve, rregullimi i aspekteve që kanë të bëjnë me resurset ujore në Kosovë përfshin edhe një sërë Udhëzimesh Administrative (UA). Këto UA shërbejnë si rregullore plotësuese që ofrojnë udhëzime dhe detaje të mëtejshme për zbatimin e legjislacionit më të gjerë të ujit. Disa nga UA më të rëndësishme janë si më poshtë:

- UA Nr. 15/2017 për Kriteret e Përcaktimit të Zonave të Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit;
- UA Nr. 16/2017 për Klasifikimin e Trupave Ujorë Sipërfaqësorë;
- UA Nr.17/2017 për Klasifikimin e Trupave Ujorë Nëntokësorë. Ky UA është në përputhje me DKU;
- UA Nr. 20/2015 për Kriteret për Zonat për Larje.
- Udhëzim Administrativ Mmph Nr. 04 /2016 për Kriteret dhe Procedurat për Mbrojtjen e Brigjeve të Ujërredhave dhe Akumulacioneve
- Udhëzim Administrativ Mmph - Nr. 20/2015 për Kriteret për Zonat për Larje

Më shumë hollësi për ligjet kryesore relevante për menaxhimin e resurseve ujore janë prezantuar në vijim.

#### **Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës** - Qëllimi i këtij ligji është:

- Të sigurojë zhvillim dhe shfrytëzim të qëndrueshëm të resurseve ujore, të cilat janë thelbësore për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin socio-ekonomik të Kosovës;
- Të vendosë procedura dhe parime udhëzuese për shpërndarjen optimale të resurseve ujore në bazë të përdorimit dhe qëllimit;
- Të sigurojë mbrojtjen e resurseve ujore nga ndotja, mbipërdorimi dhe keqpërdorimi; dhe
- Të përcaktojë kuadrin institucional për administrimin e resurseve ujore.

Pjesë e zbatimit të këtij ligji është edhe zhvillimi i planeve të MPL (Ligji Nr. 04/L-147, Shtojca 1). Ligji përcakton elementët që duhet të mbulohen në Planin e Menaxhimit të Pellgut Lumor.

**Ligji Nr. 02/I-79 për Veprimtaritë Hidrometeorologjike** - Ky është një tjetër ligj i rëndësishëm për sektorin e ujërave, i cili synon të rregullojë aktivitetet hidro-meteorologjike dhe mënyrën e zhvillimit të tyre.

**Ligji Nr. 02/L-78 për Shëndetësi Publike** - Ky ligj përcakton institucionet përgjegjëse për zbatimin e politikave shëndetësore dhe përcaktimin e detyrave të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, duke përfshirë monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm.

**Ligji Nr. 03/L-086 për Aktivitetet e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit, Ujërave të Zeza dhe Mbeturinave**- Është një ligj i rëndësishëm që themelon Zyrën Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM) dhe përbën kornizën ligjore për rregullimin ekonomik të kompanive publike që ofrojnë ujë. dhe shërbimet e ujërave të zeza.

**Ligji Nr. 02/L-9 për Ujitjen e Tokave Bujqësore** - Ky ligj rregullon organizimin dhe administrimin e ujitjes dhe kullimit të tokës bujqësore në Kosovë, kompetencat dhe përcaktimin e përgjegjësive të subjekteve të ujitjes dhe kullimit, themelimin dhe regjistrimin e kompanive të ujitjes, federatat, organizimi i tyre, tarifatat e ujit për ujitje, biznesi i shoqatave dhe çështje të tjera që lidhen me ujitjen dhe kullimin.

**Strategjia Kombëtare e Kosovës për Ujërat** - Është gjithashtu një nga dokumentet kryesore të planifikimit të resurseve ujore në Republikën e Kosovës. Ky dokument paraqet obligim ligjor në bazë të nenit 31 të Ligjit Nr.04/L-147. Nëpërmjet këtij dokumenti, Qeveria synon të trajtojë dhe drejtojë zhvillimet e politikave, operacioneve dhe investimeve në sektorin e ujit për një hark kohor 20-vjeçar. Qëllimi i strategjisë është të sigurojë një zhvillim të integruar dhe të qëndrueshëm të sektorit të ujit duke përmbushur nevojat e mëposhtme:

- Furnizimi me ujë të pijshëm
- Ujë për prodhimin e ushqimit
- Ujë për ujitjen e tokës bujqësore
- Ujë për industri
- Sporti dhe rekreacioni, dhe
- Prodhimi i energjisë elektrike

**Tabela 1: Legjislacioni kyç i Kosovës për ujin dhe mjedisin**

Legjislacioni	Pasqyrë
Ligji Nr. 03/L-025 (19.03.2009) I ndryshuar	"Për Mbrojtjen e Mjedisit" <sup>8</sup> (i ndryshuar)
UA Nr. 01/2021 <sup>9</sup> (28.01.2021)	"Për Autorizim Mjedisor"
Strategjia 2019 - 2028 (2018)	"Për ndryshimet klimatike"
Ligji Nr. 04/L-147 (05.04.2013) i ndryshuar	"Për Ujërat e Kosovës" (i ndryshuar)
Rregullorja nr. 02/2016 (11.08.2016)	"Për mënyrën e përcaktimit të prurjes së pranueshme ekologjike"
UA Nr. 03/2018 (24.08.2018)	"Për procedurat e lejes ujore"
UA Nr. 15/2017 (08.12.2017)	"Për kriteret e përcaktimit të zonave të mbrojtjes sanitare të burimeve ujore"
UA Nr. 16/2017 (08.12.2017)	"Për klasifikimin e trupave ujqorë sipërfaqësore"
UA Nr. 17/2017 (08.12.2017)	"Për klasifikimin e trupave ujqorë nëntokësore". Ky UA është në përputhje me DKU.
UA Nr. 12/2015 (12.11.2015)	"Për përcaktimin e kriterëve për zonat e mbrojtura për qëllime strategjike"
UA Nr. 05/2016	"Për rregullimin e statusit të pasurive ujore"

<sup>8</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2631>

<sup>9</sup> All Laws and Administrative Instructions can be found at <https://gzk.rks-gov.net/default.aspx?index=1>

Legjislacioni	Pasqyrë
(20.09.2016)	
UA Nr. 04/2016 (06.09.2016)	"Për kriteret dhe procedurat e mbrojtjes së brigjeve të ujërrjedhave dhe akumulacioneve"
UA Nr. 19/2015 (15.12.2015)	"Për mbrojtjen nga veprimet e dëmshme të ujit". Ky UA është në përputhje me Direktivën 2008/60/EC për Vlerësimin dhe Menaxhimin e Rrezikut nga Përmbytjet.
UA Nr. 20/2015 (15.12.2015)	"Për kriteret e zonave për larje". Ky UA është në përputhje me Direktivën 2006/7/EC për Menaxhimin e cilësisë së ujit për larje.
UA Nr. 12/2013 (17.06.2013)	"Për sistemin e informacionit të ujit"
Ligji Nr. 06/L-088 (21.06.2019)	"Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-042 për Rregulloren e Shërbimeve të Ujit"
UA Nr. 10/2021 (13.12.2021)	"Për cilësinë e ujit të destinuar për konsum njerëzor". Ky UA është pjesërisht në përputhje me direktivat e BE 98/83/KE dhe 2013/51/EURATOM.
UA Nr. 13/2008 (18.07.2008)	"Për vlerat e kufizuara të efluentëve që shkarkojnë në trupat ujorë dhe në sistemin e kanalizimit publik"
Ligji Nr. 03/L-214 (14.10.2010) i ndryshuar	"Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor" (i ndryshuar)
Ligji Nr. 03/L-214 (14.10.2010) i ndryshuar	"Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" (i ndryshuar)
UA Nr. 07/2017 (09.06.2017) i ndryshuar	"Për Lejet Mjedisore" (i ndryshuar)
UA Nr. 16/2015 (01.12.2015)	"Për informimin, pjesëmarrjen e publikut dhe palëve të interesuara në procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis"
UA Nr. 08/2015 (31.07.2015)	"Për përcaktimin e vlerës tarifore të shërbimeve në lidhje me procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis"
UA Nr. 09/2016 (23.12.2016)	"Për strukturën organizative dhe detyrat përcjellëse të Autoritetit të Qarkut të Pellgut Lumor"
Ligji Nr. 04/L-174 (19.08.2013)	"Për planifikimin hapësinor"

### 1.2.2 Sfidat kryesore lidhur me Menaxhimin e Resurseve Ujore në Kosovë

Uji është pjesë integrale e zhvillimit socio-ekonomik të Kosovës, dhe resurset ujore janë nën presion në aspektin e sasisë dhe cilësisë së tyre. Gjatë viteve të fundit, Kosova po përballet me një sërë sfidash në sektorin e ujit, si mungesa e burimeve financiare për operim dhe mirëmbajtje (O&M), mbishfrytëzimi i resurseve ekzistuese ujore (atyre nëntokësore dhe sipërfaqësore) për shkak të shtimit të popullsisë dhe urbanizimit, ndotja e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore, shfrytëzimi i rërës dhe zhavorrit, përmbytjet, rritja e nivelit të shpyllëzimeve, si dhe sedimentimi dhe erozioni përgjatë lumenjve.

Ujërat sipërfaqësore në Kosovë janë shumë të ndotura, veçanërisht përreth qendrave urbane dhe kryeqytetit Prishtinës, pastaj Mitrovicës, Ferizajit, Fushë-Kosovës dhe Obiliqit për shkak të shkarkimit të ujërave të zeza të patrajuara nga amvisëritë në sistemin e ujit. Për shkak të rritjes së aktiviteteve industriale, shumë impiante industriale po shkarkojnë ujërat e zeza industriale në ujërat sipërfaqësore pa trajtimin e duhur.

Vlerësimi ekonomik i menaxhimit të resurseve ujore (shih gjithashtu **Shtojcën 6**) solli në pah faktin se uji shpërndahet në mënyrë të pabarabartë në të gjithë vendin dhe se lumenjtë konsiderohen me prurje të parregullta. Përveç kësaj, reshjet janë të parregullta dhe vendi ka përdorim të lartë të ujit nga sektori i bujqësisë për ujitje, duke rritur stresin ujor të pellgjeve lumore. Për më tepër, për shkak të ndryshimeve klimatike, kryesisht pellgjet e Iberit dhe Moravës së Binçës mund të kthehen në zona me mungesë uji (PointPro, 2022).


### 1.2.3 Veçoritë gjeografike të pellgjeve lumore të Kosovës

Republika e Kosovës ndodhet në Evropën Juglindore, në pjesën qendrore të Gadishullit Ballkanik. Në jugperëndim kufizohet me Shqipërinë, në veriperëndim me Malin e Zi, në verilindje

me Serbinë dhe në jug me Maqedoninë e Veriut. Territori shtrihet brenda gjatësive gjeografike 41° 51' dhe 43° 16' dhe brenda gjerësive gjeografike 19° 59' dhe 21° 47'. Lartësia mesatare është 800 m mbi nivelin e detit, por Kosova ka lartësi të ndryshme. Pika më e ulët e Kosovës ndodhet në luginën e Lumit Drini i Bardhë, në kufi me Shqipërinë dhe arrin një lartësi prej 270 m. Pika më e lartë është në perëndim të Kosovës - në Malin e Gjeravicës - 2656 m e lartë.

Nga pikëpamja gjeografike Kosova është e ndarë në dy rrafsh të mëdha. Fusha verilindore quhet "Rrafshi i Kosovës", kurse ajo jugperëndimore njihet si "Rrafshi i Dukagjinit". Kufiri midis Rrafshit të Dukagjinit dhe Rrafshit të Kosovës i ndanë ujërat sipërfaqësore që i përkasin Detit Adriatik në njërin anë me ato që i përkasin Detit të Zi (pellgjet e Ibri dhe Moravës së Binçës) dhe Detit Egje (pellgu i Lepencit) në anën tjetër. Pellgu ujëmbledhës i Detit të Zi përfshin 50.7% të territorit të vendit, lumenjtë kryesorë të të cilit janë Ibri dhe Sitnica. 43.5% e territorit të vendit i përket pellgut ujëmbledhës të Detit Adriatik, i cili përfshin lumin më të madh të vendit, Lumin Drini i Bardhë. 5.8% i përket pellgut ujëmbledhës të Detit Egje, ku lumi më i madh është Lumi Lepenc.

Harta 1: Pellgjet lumore në Kosovë.




Kosova ka një sipërfaqe të përgjithshme ujëmbledhëse prej më shumë se 11,000 km<sup>2</sup> të ndarë në katër pellgje lumore: Drini i Bardhë, Ibri, Morava e Binçës dhe Lepenci. Të 4 lumenjtë kryesorë në Kosovë janë pjesë e pellgut lumor ndërkufitar (shih Hartën 1):

- Pellgu i Lumit Drini i Bardhë i përket pellgut të zgjeruar ndërkufitar të Lumit Drin (PLDR) që ndodhet në pjesën jugperëndimore të Gadishullit Ballkanik. Sipërfaqja e përgjithshme gjeografike e PLDR është 20,311 km<sup>2</sup> dhe ndahet midis Shqipërisë, Kosovës, Greqisë, Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi. Pellgu i Lumit Drini i Bardhë, është më i madhi nga katër pellgjet në Kosovë (rreth 4,567 km<sup>2</sup> në Kosovë) dhe derdhet përmes Shqipërisë në Detin Adriatik, pasi bashkohet me Drinin e Zi.
- Pellgu i Lumit Ibër ndodhet në veri dhe verilindje të Kosovës. Madhësia e pellgut të lumit është rreth 4,400 km<sup>2</sup>. Lumi Ibër buron nga Mali i Zi, rrjedh nëpër Serbi para se të hyjë në Kosovë, pastaj kalon përsëri në Serbi dhe në fund derdhet në Danub dhe për këtë arsye përfundon në Detin e Zi. Rezervuari i Ujmanit në këtë pellg e ka një rëndësi të madhe për furnizimin me ujë dhe prodhimin e energjisë elektrike në Kosovë.
- Pellgu i Lumit Morava e Binçës në lindje është më i vogël, rreth 1600 km<sup>2</sup>, dhe ky lumë kalon gjithashtu në Serbi dhe në fund në Danub. Shtete të tjera në këtë pellg lumor janë Maqedonia e Veriut dhe Bullgaria.
- Pellgu i Lumit Lepenc (rreth 700 km<sup>2</sup>) ndodhet në jug/juglindje të Kosovës; lumi derdhet në Vardar në Maqedoninë e Veriut. Nga atje derdhet në Detin Egje në veri të Greqisë.

Ky është Plani i parë i Menaxhimit të Pellgut të Lumit Ibër (shih Hartën 2).

Harta 2: Pellgu i lumit Ibër.



### 1.3 Çështjet e Rëndësishme të Menaxhimit të Ujit dhe struktura e PMPL Ibër

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore (ARPL) i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) u pajtua për 6 Çështje të Rëndësishme të Menaxhimit të Ujit (ÇRMU) që janë të një rëndësie të konsiderueshme në Pellgun e Lumit Ibër:

1. ÇRMU 1: Ndotja nga Vendbanimet Urbane dhe Industrinë (burimet e palëvizshme);
2. ÇRMU 2: Ndotja nga burime të lëvizshme nga bujqësia dhe burime të tjera (ndotja nga burimet difuzive);
3. ÇRMU 3: Presionet në Sasinë e Ujërave Sipërfaqësore;
4. ÇRMU 4: Presionet në Hidro-Morfologjinë e Ujërave Sipërfaqësore;
5. ÇRMU 5: Presione tjera në Ujërat Sipërfaqësore (peshkimi);
6. ÇRMU 6: Presionet në Sasinë dhe Cilësinë e Ujërave Nëntokësore.

Struktura e PMLP Ibër ndjek logjikën e Ciklit të MPL. Megjithatë, 6 ÇRMU përcaktojnë strukturën e PMPL Ibër (**Kapitujt 3, 4 dhe 6** i dedikohen plotësisht ÇRMU).

Karakterizimi i Pellgut të Lumit Ibër (**Kapitulli 2**) është baza për të gjitha vlerësimet.

**Kapitulli 3** paraqet qëllimet e përgjithshme të pellgut lumor, si dhe Shtytësit dhe Presionet në Pellgun e Lumit Ibër. Përveç kësaj, vizioni dhe objektivat e menaxhimit janë të përshkruara për çdo ÇRMU për të mbështetur një mënyrë strategjike të arritjes së qëllimeve të përgjithshme të Pellgut të Lumit Ibër.

Monitorimi dhe Vlerësimi i Statusit të Pellgut të Lumit Ibër përshkruhen në **Kapitullin 4** dhe do të shërbejnë si bazë për të vërtetuar gjetjet e Vlerësimit të Riskut/Rrezikut në ciklin e ardhshëm të zhvillimit të planit të MPL.

Analiza ekonomike dhe zhvillimet e pritshme përkatëse socio-ekonomike janë paraqitur në **Kapitullin 5**.

Programi i Masave (PM) në **Kapitullin 6** lidhet drejtpërdrejt me gjetjet e Vlerësimit të Statusit duke marrë parasysh zhvillimet socio-ekonomike dhe duke sugjeruar masa zbutëse për çdo ÇRMU. Zbatimi i tyre do të mbështesë përmirësimin e gjendjes së ujërave në Pellgun e Ibrit dhe arritjen e qëllimeve të përgjithshme që kanë të bëjnë me afatin kohor të Ciklit të MPL Ibër.

Më tej, Plani i MPL Ibër paraqet një regjistër të zonave të mbrojtura (**Kapitulli 7**) dhe procesin e përfshirjes më të gjerë të palëve të interesit dhe konsultimit publik (**Kapitulli 8**).

**Kapitulli 9** përmban një përmbledhje të kontekstit ekzistues institucional dhe kornizën e akteve ligjore dhe politikave të cilat janë relevante për implementimin e menaxhimit të resurseve ujore dhe pellgut lumor në Pellgun e Lumit Ibër.

Në **Kapitullin 10** renditen të gjitha referencat përkatëse.

Plani i MPL Ibër ilustron gjetjet nëpërmjet hartave që janë pjesë e **Shtojcës** së veçantë të Atlasit të Planit të MPL Ibër.

## Kapitulli 2

### Karakterizimi i Pellgut të Lumit Ibër

#### 2.1 Hyrje rreth Pellgut të Lumit Ibër

Pellgu i Lumit Ibër ndodhet në rajonin e Drenicës dhe në Luginën e Kosovës, duke u shërbyer rreth 1.053.000 banorëve. Ai është një nga katër pellgjet lumore në Kosovë dhe konsiderohet një nënpellg, pjesë e Pellgut më të madh ndërkuftar të Lumit Danub (PLD). Lumi Ibër buron nga gjashtë burime në malet e Malit të Zi lindor, rrjedh nëpër territorin e Malit të Zi dhe Serbisë dhe hyn në territorin e Kosovës afër vendbanimit të Banjës. Më pas rrjedh në juglindje, merr një kthesë të fortë në të majtë dhe kthehet në Mitrovicë. Prej aty rrjedh në veri përmes Zveçanit, Leposaviqit dhe Leshakut. Pranë Rudnicës, rrëzë maleve të Kopaonikut, kalon nga territori i Kosovës në Serbi, ku bashkohet me Lumin Morava Perëndimore dhe përfundimisht derdhet në Danub dhe bashkë me të në Detin e Zi. Lumi Ibër ka një gjatësi prej më shumë se 270 km nga burimi deri në derdhjen e tij në Moravën Perëndimore, me 90 km të asaj gjatësie të vendosur brenda territorit të Kosovës. Sipërfaqja e përgjithshme ujëmbledhëse në Kosovë mbulon 4,044 km<sup>2</sup>, që përbën 37% të territorit të vendit.


Ka disa degë lumenjsh, të cilët janë Sitnica (Graçanica, Prishtevka (Lumi i Prishtinës), Sllakovaqa, Studimja, Sazlia, Caraleva, Llapi, Drenica, Trepça, Smrekovnica, Gojbula, Dumnica) pastaj Lushta, Kozareva, Bajaska, Kamenica, Vuça, Gërkaja, Jashanica, Borogllava, Vraqeva, Trebiçka, Bistrica, Ceraja, Mushnica, Dubrava, Jagnjeniq, Brusovaqa, Bërnjaka, Çeçeva, Zubodolli (Albaniku), Zubqana, Drena, Tverdani, Leposaviqi dhe Sllatina. Lumenjtë më të gjatë dhe më të rëndësishëm janë Ibri dhe Sitnica<sup>10</sup>.

Pellgu i Lumit Ibër përbëhet nga 16 nënpellgje (shih 3 dhe **Error! Reference source not found.**2)

---

<sup>10</sup> Kosovo Environmental Protection Agency, 2020

Harta 3: Pellgu i Lumit Ibër me nënpellgjet



**Legend/Shpjegues**

Rivers / Rrjet ujqor

- large river / lumë i madh
- small river / lumë i vogël
- stream / përrua
- channel / kanal

Lake&Reservoir / Liqen&Rezervuar

Administrative boundary of basin - Kufi administrativ i pellgut

Hydrological boundary of basin - Kufi hidrologjik i pellgut

National Border - Kufi kombëtar

Surface water body unit / Nën - njësi të nën - pellgjeve

Tributary / Degëzim lumi

Sub basin / Nën pellg

XK-02-01	XK-02-06	XK-02-11
XK-02-02	XK-02-07	XK-02-12
XK-02-03	XK-02-08	XK-02-13
XK-02-04	XK-02-09	XK-02-14
XK-02-05	XK-02-10	XK-02-15
		XK-02-16

**River Basin of Ibër**  
**Pellgu Ujqor Ibër**  
 Sub - basin Map  
 Harta e Nën - pellgjeve



**Republika e Kosovës**  
 Republika Kosova - Republic of Kosovo  
**Qeveria – Vlada – Government**

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*  
 Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
 Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Pellgu i Lumit Ibër është zona që përfshinë pjesën më të madhe të popullsisë së vendit, duke përfshirë kryeqytetin Prishtinën, si dhe shumicën e aktiviteteve minerare, bujqësinë e konsiderueshme dhe pjesën më të madhe të industrisë. E rëndësishme është se dy termocentralet kryesore (termike) të vendit ndodhen gjithashtu afër Prishtinës në Obiliq, pranë deponitave të mëdha të linjtit.

Në kuadër të pellgut ndodhet edhe aeroporti kryesor (komercial) i Kosovës, Aeroporti "Adem Jashari", afër kryeqytetit të Kosovës, Prishtinës. Infrastruktura rrugore në Pellgun e Lumit Ibër është e zhvilluar mirë. Ekziston edhe një sistem hekurudhor që mbulon territorin e Pellgut të Lumit Ibër, duke lidhur veriun me jugun dhe lindjen me perëndimin.

Pellgu i Lumit Ibër është i pasur me minerale. Kjo është për shkak të diversitetit të madh përbërës, aktiviteteve intrusive dhe efuzive, efekteve të sedimentit dhe tektonikës që kanë ndikuar në formimin e llojeve dhe burimeve të shumta minerare të rëndësishme, metalike dhe jometalike.

Pellgu i Lumit Ibër ka burime të rëndësishme të ujërave termale që përdoren për qëllime rekreative dhe shëndetësore. Ekzistojnë disa banja të tilla: Banjska afër Zveqanit, Gojbula-Vushtrri, Banja e Lluzhanit - Besianë, Banja e Runikut, Burimi i Nxehtë i Runikut-Skenderaj dhe Pokleku-Drenas.


## **2.2 Karakterizimi natyror themelor**

### **2.2.1 Topografia**

Pellgu i Lumit Ibër karakterizohet nga një strukturë relievoe e larmishme, e cila përfshin luginat përgjatë Lumit Ibër afër Zveqanit dhe Leposaviqit. Përgjatë degëve të lumit gjenden fusha, si ajo e Llapit; pastaj lugina, siç është lugina e Kosovës, e cila është lugina më e madhe në pellg me lartësi mbidetare prej 510-570 m; zona kodrinore, që shërbejnë edhe si toka bujqësore, si Drenica; dhe zona malore, si malet e Kopaonikut, Gollakut dhe Carralevës.

Zona e ngushtë e Pellgut të Lumit Ibër përbëhet nga malet e Kopaonikut në anën e djathtë të Lumit Ibër, i cili gjendet në pjesën veriore të linjës: Mitrovicë-Stantërg- Maja 'Bajraku' (1789 m), pastaj Mali i Thatë (pjesa veriore), dhe rajoni malor në pjesën veriperëndimore të Mitrovicës. Ka karakter të theksuar malor, me prerje të thella të luginës së Lumit Ibër dhe degëve të tij (përrenj me rrjedhje të përhershme dhe të përkohshme).

Harta 4: Harta e lartësive të terrenit – Pellgu i Lumit Ibër



## 2.2.2 Përvijimi (delineimi) i trupave ujqorë sipërfaqësorë

Përvijimi (delineimi) i nënpellgjeve, identifikimi i Trupave Ujqorë Sipërfaqësorë (TUS) dhe procedura për karakterizimin e trupave ujqorë sipërfaqësorë është përcaktuar në DKU të BE<sup>11</sup>. Ky proces mund të rregullohet dhe përmirësohet në ciklin e dytë të Planit të Menaxhimit të Pellgut Lumor. Një trup ujqor sipërfaqësor është një njësi e menaxhueshme e ujit sipërfaqësor, duke qenë si e tërë (ose pjesë) e një përroi, lumi ose kanali, liqeni ose rezervuari. Një trup ujqor sipërfaqësor mund të kategorizohet si *Natyror (TUN)*, *i Modifikuar Rëndë (TUMR)* ose *Artificial (TUA)*.

Trupat ujqorë artificialë dhe të modifikuar rëndë përcaktohen sipas Nenit 2 (8) dhe (9) të DKU. Nën kushte të caktuara, DKU u lejon Shteteve Anëtare të identifikojnë dhe caktojnë trupat ujqorë artificialë (TUA) dhe trupat ujqorë të modifikuar rëndë (TUMR) sipas nenit 4(3) të DKU. Një **Trup Ujqor Artificial** nënkupton një trup ujqor sipërfaqësor të krijuar nga aktiviteti njerëzor. **Trupi Ujqor i Modifikuar Rëndë** nënkupton një trup ujqor sipërfaqësor i cili për shkak të ndryshimeve fizike nga aktiviteti njerëzor ka ndryshuar në mënyrë thelbësore në karakter, siç përcaktohet nga Shteti Anëtar në përputhje me dispozitat e **Shtojcës II** të DKU. Një **Trup Ujqor Natyror** nuk është artificial dhe nuk është i modifikuar rëndë.


Në Pellgun e Lumit Ibër janë identifikuar gjithsej 16 nënpellgje, të përbëra nga 33 trupa ujqorë sipërfaqësorë (kategoria: lumenjtë); *26 Trupa Ujqorë Natyrorë*, *6 TUMR* dhe *1 Trup Ujqor Artificial*. I vetmi trup ujqor artificial sipërfaqësor është kanali kryesor për ujitje: Kanali Ibër – Lepenc.

Nuk ka liqene natyrore në Pellgun e Ibrit, por ka 4 liqene/rezervuarë që përdoren për ujë të pijshëm, ujitje, prodhim hidroenergjetik dhe rekreacion (të kategorizuar si TUMR). Këto janë: diga e Ujmanit në Lumin Ibër, diga e Batllavës në Lumin Batllava dhe diga e Badovcit në Lumin e Graçanicës. Diga e Ujmanit është më e madhja në Pellgun e Ibrit me një kapacitet prej rreth 370 milionë m<sup>3</sup>.

---

<sup>11</sup> European Commission – Directive 2000/60/EC – Annex II

Harta 5: Përvijimi (delineimi) i trupave ujorë sipërfaqësorë - Pellgu i Ibrit, të gjitha kategoritë.



**Tabela 2: NënPELLGJET dhe trupat UJORË sipërfaqësorë (TUS) në Pellgun e Lumit Ibër (Kategoria: Lumenjtë).**

Emri i nënpellgut	Kodi i nënpellgut	Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )	Emri i TUS	Kodi i TUS	Forma e TUS	Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )	Gjatësia (km)	Tipi (sistemi A-Shtojca II)	Përshkrimi i shkurtër i nënpellgut
Sitnica	XK-02-01	1.072,44	Shtimje – 01	XK-02-01-01	Natyrall	102,05	15,03	Tipi 3	Lumi Sitnica rrjedh në pjesën qendrore të Rrafshit të Kosovës dhe është dega më e madhe e Lumit Ibër, por gjithashtu është lumi më i gjatë që rrjedh tërësisht brenda Kosovës. Në pjesën perëndimore nënpellgu i Sitnicës kufizohet me Rrafshin e Dukagjinit. Në pjesën lindore kufizohet me Serbinë, ndërsa në pjesën juglindore dhe jugore me Pellgun e Lumit Morava e Binçës dhe Pellgun e Lumit Lepenc. Në veri derdhet nëLumin Ibër. Burimi i Lumit Sitnica është në pellgun e Sazlisë, në veri të Ferizajt dhe rrjedh përgjatë Rrafshit të Kosovës
			Shtimje – 02	XK-02-01-02	Natyrall	147,56	11,73	Tipi 6	
			Sitnica – 01	XK-02-01-03	Natyrall	228,02	9,88	Tipi 6	
			Sitnica – 02	XK-02-01-04	TUMR	66,09	15		
			Sitnica – 03	XK-02-01-05	Natyrall	11,97	2,51	Tipi 6	
			Sitnica – 04	XK-02-01-06	TUMR	122,69	20		
			Sitnica – 05	XK-02-01-07	Natyrall	203,01	10,22	Tipi 6	
			Sitnica – 06	XK-02-01-08	TUMR	191,04	18		
Gadimja	XK-02-02	65,11	Lumi i Gadimes	XK-02-02-01	Natyrall	65	25,08	Tipi 4	Lumi Gadime është degë e Lumit Sitnica. Ai buron nga kodra e Gadimes dhe kalon nëpër fshatrat Gadime dhe Rubovc.
Versheci	XK-02-03	64,89	Vershec	XK-02-03-01	Natyrall	65	16,86	Tipi 4	Lumi Vershec buron pranë Blinajës (Rezervati i Gjetisë). Ai kalon nga Versheci, Qylaga, Dobraja e Madhe dhe Lluga para se t'i bashkohet Lumit Sitnica.
Klisura	XK-02-04	154,32	Klisura	XK-02-04-01	Natyrall	74,68	11,7	Tipi 1	Lumi Graçanka është dega e djathtë e Sitnicës. Fillon në majën e Zllashit (1210m.l.m) dhe derdhet në Sitnicë afër fshatit Vragoli. Nga burimi deri te derdhja, gjatësia e tij është 34 km. Rrjedha e epërme karakterizohet nga pjerrësia dhe shpejtësia e rrjedhës, ndërsa vendi i prurjes merr tiparet e një lumi fushor.
			Graçanka – 01	XK-02-04-02	TUMR	29,69	0,2		
			Graçanka – 02	XK-02-04-03	Natyrall	49,94	18,67	Tipi 4	
Magura	XK-02-05	32,29	Lumi i Magures	XK-02-05-01	Natyrall	32	12,46	Tipi 4	Lumi Magure buron në malet e Minierës së Gllavicës. Ai kalon nëpër fshatrat Magure e Dobrajë e Vogël dhe afër aeroportit "Adem Jashari" përpara se të derdhet në Ligatinën e Hencit/Radevës, prej nga bashkohet me Lumin Sitnica.
Prishtevka	XK-02-06	98,84	Prishtevka	XK-02-06-01	Natyrall	99	26,97	Tipi 2	Lumi Prishtevka është një përrua malor me një shtrat të ngushtë dhe të thellë në pjesën e epërme të rrjedhës, ndërsa pjesa e poshtme në fshatin Llukur karakterizohet me një shtrat më të gjerë dhe një rrjedhë më të qetë. Ky lumë ka një gjatësi prej 26,5 km.
Drenica	XK-02-07	431,77	Drenica – 01	XK-02-07-01	Natyrall	359,02	32,53	Tipi 6	Lumi Drenica buron në Bretenc (1.046 m) nga mali i Caralevës. Mbulon një sipërfaqe prej 477 m <sup>2</sup> dhe ka një gjatësi prej 50,5 km. Ky lumë derdhet në Lumin Sitnica. Shkarkimi mesatar i Lumit Drenica në Sitnicë është 2,0 m <sup>3</sup> /s.
			Drenica – 02	XK-02-07-02	Natyrall	72,75	20,64	Tipi 6	

Emri i nënpellgut	Kodi i nënpellgut	Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )	Emri i TUS	Kodi i TUS	Forma e TUS	Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )	Gjatësi (km)	Tipi (sistemi A-Shtojca II)	Përshkrimi i shkurtër i nënpellgut
Kalatica	XK-02-08	263,05	Keqekolla	XK-02-08-01	Natyrall	93,48	18,68	Tipi 1	Lumi i Kalaticës është një përrua në Podujevë. Kalatica ndodhet në afërsi të fshatit Orllan; nga burimi deri në derdhje, gjatësia e lumit është 12,76 km.
			Lumi Kalatica	XK-02-08-02	Natyrall	117,26	12,76	Tipi 2	Lumi Batllava furnizon Liqenin e Batllavës dhe është degë e Llapit. Lumi kalon nëpër fshatrat Orllan dhe Batllavë.
			Batllava	XK-02-08-03	TUMR	52,31	20		
Dumnica	XK-02-09	98,61	Lumi i Dumnices	XK-02-09-02	Natyrall	99	31,33	Tipi 3	
Llapi	XK-02-10	580,22	Llapi – 01	XK-02-10-01	Natyrall	106,48	25,63	Tipi 1	Fillon në lartësinë rreth 750 m në kodrat e Dumnices së Epërme. Ai kalon nëpër fshatrat Shtedim, Sibovc dhe Llugë para se t'i bashkohet Lumit Llap.
			Llapi – 02	XK-02-10-02	Natyrall	179,04	33,02	Tipi 6	Lumi Llap është dega më e rëndësishme dhe më e gjatë (79 km) e Lumit Sitnica, duke përfshirë 33% të pellgut ujëmbledhës dhe 33% të ujëmarrësit të Sitnicës. Shtrihet në shpatet juglindore të Kopaonikut. Në fillim rrjedhat janë shumë të rrëmbyeshme dhe në hyrje të fushës së Kosovës qetësohen duke marrë tiparet e lumit fushor. I karakterizuar nga përdorimet e shumta të ujit gjatë vitit, maksimumi shënohet në pranverë dhe dimër, ndërsa minimumi në verë. Rrjedhat kryesore të këtij lumi (Llap) janë Kaqandolli, Dumnica dhe Batllava.
			Llapi – 03	XK-02-10-03	Natyrall	294,71	32,45	Tipi 6	
Lushta	XK-02-11	48,47	Lushta	XK-02-11-01	Natyrall	48	18,64	Tipi 1	Lumi i Lushtës ka një gjatësi prej rreth 19 km dhe është dega e djathtë e Lumit Ibër. Lumi i Lushtës buron në kodrën e Lubovecit (800 m) dhe kalon nëpër grykën e saj të prerë në gur gëlqeror midis kodrave të Bajrit dhe Shipolit. Lumi i Lushtës derdhet në Lumin Ibër.
Brosova	XK-02-12	43,58	Lumi i Brosovës	XK-02-12-01	Natyrall	44	9	Tipi 3	Lumi i Brosovës është përrua në Pellgun e Lumit Ibër. Ndodhet afër Vërnices.
Kozareva	XK-02-13	27,62	Lumi i Kozareves	XK-02-13-01	Natyrall	28	14,32	Tipi 1	
Banja	XK-02-14	75,79	Lumi i Banjës	XK-02-14-01	Natyrall	76	20,95	Tipi 1	Lumi i Banjës gjendet në veri të Kosovës me një gjatësi prej rreth 21 km.
Bistrica	XK-02-15	171,13	Bistrica	XK-02-15-01	Natyrall	171	30,47	Tipi 2	Lumbardhi i Shalës (Bistrica) është një lumë që gjendet në rajonin verior të Shalës së Bajgorës. Vendbanimi më i madh i pellgut të tij nëpër të cilin kalon lumi në fjalë është fshati Bistrica e Shalës në komunën e Albanikut, prandaj lumi ndonjëherë quhet edhe Lumi i Bisticës së Shalës.
Pellgu i Lumit Ibër	XK-02-16	931,17	Ibër – 01	XK-02-16-01	TUMR	196,06	22		

Emri i nënpellgut	Kodi i nënpellgut	Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )	Emri i TUS	Kodi i TUS	Forma e TUS	Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )	Gjatësi (km)	Tipi (sistemi A-Shtojca II)	Përshkrimi i shkurtër i nënpellgut
			Ibër - 02	XK-02-16-02	Natyrall	88,61	15,95	Tipi 5	Lumi Ibër rrjedh përmes pjesës lindore të Malit të Zi, Kosovës veriore dhe Serbisë qendrore, me një gjatësi totale prej 272 km. Lumi fillon në malin Hajla, në Rozhajë, në pjesën lindore të Malit të Zi, dhe kalon nëpër Serbinë jugperëndimore dhe Kosovën veriore, ku kthehet në Serbi për tu derdhur në Lumin Morava Perëndimore afër Kralevës, në Serbinë qendrore.
			Ibër - 03	XK-02-16-04	TUA	10,74	4		
			Ibër - 04	XK-02-16-05	Natyrall	635,76	65,15	Type 6	

**Tabela 3: Nënpellgjet dhe Trupat Ujorë Sipërfaqësorë (TUS) në Pellgun e Lumit Ibër (Kategoria: Liqenet).**


Emri Nënpellgu	Kodi i nënpellgut	Emri i TUS	Kodi i TUS	Forma e TUS	Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )	Lartësia m mnd	Përshkrim i shkurtër i nënpellgut
Sitnica	XK-02-01	Liqeni i Radevës	XKLWB-3003	TUMR	0,7	535	Liqeni i Radevës shtrihet në qendër të vendit dhe zë një sipërfaqe prej 110 hektarësh. Ky akumulim është krijuar nga lumenjtë Vrella dhe Magura, të cilët janë degë të Lumit Sitnica.
Kalatica	XK-02-08	Liqeni i Batllavës	XKLWB-3002	TUMR	2,8	639	Liqeni i Batllavës shtrihet në pjesën verilindore të vendit, 30 kilometra nga Prishtina dhe 13 kilometra nga komuna e Podujevës. Liqeni shtrihet nga perëndimi në lindje pasi që diga ndodhet në pjesën perëndimore dhe furnizohet nga Lumi Batllava. Përveç furnizimit me ujë të pijshëm për komunat dhe fshatrat e shumta, liqeni përdoret edhe për not dhe peshkim.
Klisura	XK-02-04	Liqeni i Badovcit	XKLWB-3007	TUMR	1,8	654	Liqeni i Badovcit ndodhet 5 km nga Prishtina dhe paraqet burimin kryesor të furnizimit me ujë të pijshëm për këtë komunë. Furnizohet kryesisht nga Lumi Graçanka dhe tri degë të tjera (Mramor, Slivovë dhe Androvinë).
Ibri	XK-02-16	Liqeni i Ujmanit	XKLWB-3001	TUMR	5,4	696	Ujmani është liqeni më i madh në Kosovë dhe ndodhet në pjesën veriperëndimore të vendit me një sipërfaqe prej 12 km <sup>2</sup> , prej të cilave 9.1 km <sup>2</sup> shtrihen brenda territorit të Kosovës. Furnizohet nga Lumi Ibër dhe ka një vëllim mesatar prej 370 milion m <sup>3</sup> .

### 2.2.3 Ujërat nëntokësore

Ujërat nëntokësore në Kosovë gjenden në shkëmbinj të formacioneve të ndryshme, në sedimente nga paleozoiku deri në kuaternar. Këto rezerva ujore nëntokësore janë burim i rëndësishëm për furnizimin me ujë të pijshëm, industrinë dhe bujqësinë. Territori i Kosovës ka një formacion të ndërlikuar gjeologjik dhe karakterizohet me terrene me akuiferë porozë granularë dhe ndërgranularë (aluvione dhe sedimente të periudhës së neogjenit dhe pliocenit); akuiferë me porozitet çarjesh, akuiferë karstikë (gëlqerorë, mermer) si dhe me insulatorë e terrene, flish, rreshpore, etj.

Një studim i kryer në vitet 2000-2001 me titullin 'Anketa e Furnizimit me Ujë në Zonat Rurale në Kosovë'<sup>12</sup> pohon se niveli i ujërave nëntokësore është matur në mbi 2000 puse të hapura dhe të shpuara në të gjithë territorin e Kosovës. Niveli mesatar i ujërave nëntokësore në Pellgun e Lumit Ibër është paraqitur nga këto të dhëna në Harta 6. Bazuar në këto të dhëna dhe interpolimin e tyre, rezulton se thellësia mesatare e nivelit të ujërave nëntokësore varion nga 4 m në më shumë se 22 m. Nga koha e realizimit të këtij studimi 20 vite më parë, gjendja mund të ketë ndryshuar. Monitorimi i vazhdueshëm i ujërave nëntokësore që nisi në fillim të vitit 2023 do të japë informacione të reja.

Harta 6: Nivelet mesatare të ujërave nëntokësore në Pellgun e Lumit Ibër (NUN).



<sup>12</sup> Water Supply Server in Rural Areas, Kosovo, 2000/01 Premiere Urgence, Aide Humanitarian Internationale.

Përvijimi (delineimi) i trupave ujqorë sipërfaqësorë është bazuar në rezultatet e vitit 2012<sup>13</sup> të Studimit të Binjakëzimit dhe Studimit të Bilancit Ujqor të MIRU-K.

Gjashtë trupa ujqorë nëntokësorë janë të përvijuar (delineuar) në Pellgun e Lumit Ibër. Të dhënat për këta trupa ujqorë nëntokësorë janë paraqitur në Tabelën 4. Trupat ujqorë nëntokësorë janë përshkruar më poshtë.

**Tabela 4: Të dhënat për trupat ujqorë nëntokësorë në Pellgun e Lumit Ibër.**

Emri	ID (Kodi)	Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )	Sipërfaqja (%)	Perimetri (km)
Drenica	XKUN0018	279,51	6,94	129,97
Reqica	XKUN0022	95,52	2,37	61,47
Qyqavica	XKUN0023	640,17	15,89	409,85
Vicianumi	XKUN0024	1.075,41	26,69	482,95
Trepça	XKUN0025a	1.322,78	32,83	320,84
Badovci	XKUN0025b	615,60	15,28	254,55

### **TUN XKUN0018- Drenica**

Akuiferi i Lumit Drenica është një akuifer i pakonsoliduar, freatik, i përbërë nga sedimente aluviale (Lumi Drenica) me përçueshmëri të mirë hidraulike, porozitet ndërgranular të lartë deri mesatar, karst lokal dhe vlerë të ulët të K<sub>r</sub>. Ky trup ujqor nëntokësor është ndër dy trupat me mundësinë e potencialit më të madh të ujërave nëntokësore në Pellgun e Ibrit. Nivelet e ujërave nëntokësore zakonisht janë afër sipërfaqes.

### **TUN XKUN0022- Reqica**

TUN Reqica është një akuifer me porozitet të çarjes të përbërë nga gur gëlqeror, mermer, shkëmb metamorfik, konglomerat dhe shkëmb plutonik nga cenozoiku në neoproterozoik. Ka një përshkueshmëri mesatare-të ulët në thyerje dhe furnizon një rezervuar që përdoret si burim kryesor i ujit të pijshëm për Prishtinën.

### **TUN XKUN0023- Qyqavica**

TUN i Qyqavicës është një lloj akuiferi shkëmbor sedimentar (shkëmbi sedimentar Drin-Ivanicki), me sedimente ujqore si gur ranor, gëlqeror dhe flish si shumicë dhe pakicë të baltës, gur gëlqeror 'cherty' dhe shkëmb magmatik nga kretaku i sipërm. Në veriperëndim, ka disa metasedimente nga paleozoiku, triasi dhe jurasiku. Në zonën jugore, akuiferi është një gur metaranor, shkëmb metamorfik, me dominim të shkëmbit silikat metasedimentar dhe me sasi minimale të shkëmbit magmatik. Sedimentet e lumenjve kanë krijuar praninë e një akuiferi lokal aluvial brenda TUN XKUN0023

### **TUN XKUN0024- Vicianum**

Ky është një akuifer i pakonsoliduar i përbërë kryesisht nga sedimente aluviale të moshës kuaternare që ndodhen pranë kanaleve të lumenjve me zhavorr, rërë, baltë dhe argjilë. Në nivel minimal paraqitet me gur ranor dhe konglomerat në Lumin Sitnica dhe Lumin Llap. Sedimentet e vjetra të vjetërsisë terciare janë të vendosura në tarracat fqinje. Gjithashtu, shumë rrallë, në zhvillimin e pellgut të ngushtë të Lumit Ibër janë përfshirë masa gëlqerore, sedimente pliocenike dhe kuaternare si dhe tarraca kuaternare. Me porozitet ndërgranular dhe përshkueshmëri të lartë deri në mesatare, karsti lokal është karakteristik për trupin ujqor nëntokësor përgjatë Lumit Sitnica; megjithatë, sedimentet më të vjetra mund të kenë

<sup>13</sup> EU Twinning Project KS 09 IB EN 01-Draft Report on Groundwater Monitoring "Support to the Environment Sector" in Kosovo, 2011

përçueshmëri hidraulike më të ulët dhe përshkueshmëri të dyfishtë. Nga ana tjetër, poroziteti dhe përshkueshmëria ndërgranulare e lartë deri në të ulët janë karakteristike për pjesën lindore të TUN të Vicianumit (Lumi Llap). Pjesa qendrore e akuiferit aluvial të TUN Vicianum (Lumi Sitnica) është e pasigurt nga seritë sedimentare vullkanike të vjetërsisë triasike në thellësi. Në pjesën më qendrore të këtij TUN vihet re një akuifer artezian. Prandaj, me mjedisin gjeologjik përreth pjesës lindore të TUN XKUN0024, mund të supozojmë se ai mbështetet mbi shkëmbin sedimentar të kretakut të poshtëm.

Së bashku me TUN XKUN0018-Drenica këta trupa ujqorë nëntokësorë ka të ngjarë të kenë potencialin më të madh të ujërave nëntokësore në Pellgun e Lumit Ibër. Nivelet e ujërave nëntokësore zakonisht janë afër sipërfaqes.


#### **TUN XKUN0025a- Trepça**

TUN Trepça është më i madhi në Pellgun e Lumit Ibër (32,83 % e pellgut). Zona lindore është një lloj shkëmbi sedimentar i akuiferit, me litologjinë kryesore nga kretaku i poshtëm dhe një intrusion magmatik jurasik. Drejtimi jug-veri ka litologjinë kryesore të përbërë nga andeziti, shkëmbi piroklastik dhe bazalti nga periudha e pliocenit deri në periudhën oligocene. Zona veriore përbëhet nga shtresat vullkanike jurasike (peridotit, serpentinit dhe dunit) dhe nga aluvione përgjatë kanalit lumor të Pellgut të Lumit Ibër (K mesatar-i lartë).

#### **TUN XKUN0025b- Badovci**

Badovci është akuifer shkëmbor sedimentar me litologji kryesore nga kretaku i poshtëm, i përbërë nga gur ranor dhe konglomerat me një zhytje të shtratit rreth 50° dhe në sasi minimale nga kombinimi konglomerat, gur ranor, gëlqeror, gur merl, shkëmb silikat meta-sedimentar, shkëmb magmatik, serpentinite dhe mermer. Ky është një akuifer me akuitard rajonal me vlera të ulëta K, me sipërfaqe totale prej 615,6 km<sup>2</sup>, perimetër 254,55 km dhe një përqindje prej 15,28 % të Pellgut të Lumit Ibër.

Harta 7: TUN në Pellgun e Lumit Ibër.



## 2.2.4 Demografia

Pellgu i Lumit Ibër përfshin komunat e Leposaviqit, Zubin Potokut, Zveçanit, Mitrovicës, Podujevës, Lipjanit, Shtimes, Vushtrisë, Graçanicës, Fushë Kosovës, Obiliqit, Drenasit/Glllogocit dhe pjesërisht përfshin komunat e Prishtinës, Skenderajt, Gjilanit dhe Ferizajt. Të dhëna më të detajuara janë paraqitur në Tabela 5 më poshtë.

**Tabela 5: Përmbledhje e të dhënave të popullatës për secilën komunë në Pellgun e Lumit Ibër.**


Pellgu	Komuna	Zona e komunës [km <sup>2</sup> ]	Popullata e komunës	Dendësia e popullatës [banorë/km <sup>2</sup> ]
Ibër	Leposaviq	539,00	13.202	24,5
	Zubin Potok	334,85	6.664	19,9
	Zveçan	123,01	7.290	59,3
	Mitrovicë	336,18	81.325	241,9
	Podujevë	632,59	82.023	129,7
	Lipjan	338,41	57.928	171,2
	Shtime	134,42	27.450	204,2
	Vushtri	344,85	62.926	182,5
	Graçanicë	122,41	12.229	99,9
	Fushë Kosovë	84,09	39.948	475,1
	Obiliq	104,84	18.218	173,8
	Drenas/Glllogoc	275,63	61.145	221,8
	Prishtinë	523,13	218.782	418,2
	Skenderaj	374,37	52.714	140,8
Gjilan	391,84	77.145	196,9	
Ferizaj	344,61	34.672	100,6	

Pellgu i Lumit Ibër është një zonë me popullsi shumë të dendur, ku vetëm komunat Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok kanë më pak se 100 banorë/km<sup>2</sup>. Komunat me dendësinë më të madhe janë Prishtina dhe Fushë Kosova me më shumë se 400 banorë/km<sup>2</sup>. Pellgu i Lumit Ibër është me dendësi më të vogël se Pellgu i Lumit Lepenc, por me dendësi më të madhe se Pellgu i Lumit Morava e Binçës.

Një analizë krahasuese e statistikave të popullsisë nga viti 2011 deri në vitin 2020<sup>14</sup> tregon se, në përgjithësi, ka pasur një rritje të lehtë të numrit të banorëve që jetojnë në Pellgun e Lumit Ibër, për afërsisht 1.4%. Komunat që tregojnë rritje të popullsisë janë Skenderaj, Zubin Potoku, Graçanica, Fushë Kosova, Drenasi dhe Prishtina përkatësisht me 3.5%, 0.7%, 12.7%, 12.8%, 4.3% dhe 9.1%. Komunat e Leposaviqit, Zveçanit, Podujevës, Vushtrisë, Ferizajt, Gjilanit dhe Obiliqit kanë rënie të numrit të popullsisë përkatësisht me 2.6%, 4.2%, 2.5%, 7.3%, 9.9%, 2.2%, 14.5% dhe 15.5%. Komunat e Mitrovicës, Lipjanit dhe Shtimes nuk kanë trend të dukshëm pasi që popullsia duket të ketë luhaje, duke u rritur dhe duke u zvogëluar varësisht nga viti.

<sup>14</sup> <https://ask.rks-gov.net/media/6390/vjetari-statistikor-2021f.pdf>

Harta 8: Zonat administrative, dendësia dhe qendrat e popullsisë – Pellgu i Ibrit.



## 2.2.5 Ekonomia

### Minierat

Pellgu i Lumit Ibër është i pasur me minerale për shkak të diversitetit të tij të rëndësishëm formues, aktiviteteve ndërhyrëse dhe efuzive, efekteve sedimentare dhe ndikimeve tektonike. Këta faktorë kanë kontribuar në formimin e resurseve të shumta të vlefshme minerale, duke përfshirë mineralet metalike dhe jometalike, si dhe burimet energjetike. Janë të pranishme mineralet metalike si plumbi, zinku, mangani, nikeli, argjendi dhe hekuri. Ndër mineralet jometalike, thëngjilli dhe linjiti janë më të përhapurit. Pellgu i Lumit Ibër karakterizohet me rezerva të mëdha të dëshmuara të linjtit, duke e renditur Kosovën si të pestën në botë. Resurset më të rëndësishme të plumbit dhe zinkut gjenden në 'brezin metalogjenik të Trepçës', i cili shtrihet në Pellgun e Ibrit dhe në një pjesë të Pellgut të Moravës së Binçës. Për shkak të kësaj, në ujëmbledhësin e Pellgut të Lumit Ibër është e zhvilluar mirë industria minerare. Një përmbledhje e industrisë minerare është dhënë në **Kapitullin 3**.

### Industria

Në territorin e pellgut ndodhen disa objekte industriale që mbulojnë shumë aktivitete industriale, si industritë e përpunimit bujqësor, industritë kimike, kompanitë e ndërtimit dhe termocentralet. Lista e përgjithshme e operatorëve industrialë është dhënë në **Kapitullin 3**.

### Bujqësia dhe fermat e peshkut

Spektori i bujqësisë në përgjithësi është ende i organizuar në mënyrë modeste në këtë pjesë të Kosovës. Sipërfaqja e përgjithshme bujqësore në Pellgun e Lumit Ibër vlerësohet të jetë 45.067 ha, që është 11,2% e sipërfaqes totale të pellgut ujëmbledhës. Kulturat dominuese janë gruri dhe misri që zënë përkatësisht 27.170 ha dhe 13.192 ha, ose 89,5% të totalit të tokës bujqësore. Një nga karakteristikat e përdorimit të tokës në këtë ujëmbledhës është kultivimi tradicional i sipërfaqeve të konsiderueshme me patate përgjatë Lumit Sitnica. Patatet kultivohen në më shumë se 1.900 ha, duke e bërë atë kulturën e dytë më të kultivuar pas drithërave për sa i përket sipërfaqes së kultivuar<sup>15</sup>.

Ka një sasi të madhe toke të punueshme pa ujitje. Një pjesë e infrastrukturës së ujitjes është ende duke funksionuar, por në një shkallë të vogël në rreth 1000 ha në vit. Kompania e Kanalit Ibër-Lepenc u ofron fermerëve kontrata për ujitje me çmim të ulët të ujit për shërbimet e ujitjes. Pjesa më e madhe e sipërfaqes së ujitur i kushtohet kultivimit të patates, që është traditë në fushën e Sitnicës. Spektori i bujqësisë ende është i orientuar drejt mbijetesës, për shkak të madhësisë mesatarisht të vogël të fermave (1,52 ha për familje). Në përgjithësi, prodhimi blegtoral shihet si shtylla kryesore e bujqësisë së Kosovës.

**Tabela 6: Bujqësia në Pellgun e Lumit Ibër.**

Kultura	Zona totale (ha)	Nga zona bujqësore (%)	Nga zona e ujëmbledhësit (%)
Grurë	27.171	60,3 %	6,74 %
Misër	13.193	29,3 %	3,27 %
Patate	1.906	4,2 %	0,47 %
Mollë	670	1,5 %	0,17 %
Mjedër	601	1,3 %	0,15 %
Arra	496	1,1 %	0,12 %
Speca	448	0,1 %	0,11 %
Kumbull	434	0,1 %	0,11 %

<sup>15</sup> INTEGRATED WATER RESOURCES MANAGEMENT IN KOSOVO (IWRM-K). Phase 1- May 2020 – April 2024. Technical Support to Agriculture in Kosovo in the Context of Integrated Water Resources Management. STUDY ON ASSESSMENT OF PRESSURES AND RISKS FROM DIFFUSE POLLUTION.

Kultura	Zona totale (ha)	Nga zona bujqësore (%)	Nga zona e ujëmbledhësit (%)
Luleshtrydhe	91	0,2 %	0,02 %
Vreshta	21	0,05 %	0,01 %
Shalqi	21	0,05 %	0,01 %
Domate	11	0,02 %	0,00 %
Tranguj	4	0,01 %	0,00 %

Në Pellgun e Lumit Ibër zhvillohen edhe disa aktivitete të kultivimit të peshkut. Një listë totale e aktiviteteve të kultivimit të peshkut është dhënë në **Kapitullin 3**.

### 2.2.6 Gjeologjia

Në Pellgun e Lumit Ibër është e pranishme gjeologjia e larmishme që varion në moshë nga neo-proterozoiku deri në holocen. Gjeologjia karakterizohet nga veçori të konsiderueshme strukturore në shkallë rajonale, duke përfshirë thyerjen normale dhe shtytjen. Shkëmbinj të vjetër formojnë bazamentin neo-proterozoik, i cili është i përbërë nga rreshpe kristalore dhe granite, që përfaqesojnë produktet e metamorfizmit rajonal të shkallës së lartë. Këta shkëmbinj gjenden kryesisht në pjesën verilindore të pellgut ujëmbledhës të Ibrit. Pjesët qendrore, juglindore dhe jugperëndimore të Pellgut të Lumit Ibër karakterizohen nga sedimente paleogjene-neogjene, sedimente mezozoike dhe shkëmbinj pak metamorfikë dhe migmatit mezozoik.


Në aspektin gjeologjik, ujëmbledhësi i Pellgut të Lumit Ibër kryesisht i përket Zonës së Vardarit (Nënzonat e Vardarit: e jashtme, qendrore dhe e brendshme). Megjithatë, elementi Drin-Ivanicki është i pranishëm në pjesën perëndimore dhe veriore të Pellgut të Lumit Ibër.

#### **Pellgu i Lumit Ibër është i krijuar nga disa formacione gjeologjike:**

- Formacionet e Serisë Trepça (ranore, rreshpe kuarci me metamorfizim të ulët, konglomerate kuarci dhe gëlqerje);
- Formacionet shkëmbore ultrabazike dhe themelore (serpentine, amfibol, diabaz, gabro);
- Sedimentet terciare (konglomerate dhe gur ranor, tuf, andezit, piroksenit);
- Sedimentet jurasike (serpentin, gabro-amfibolit, breçe, gëlqeror);
- Sedimentet lumore/liqenore kuarternare;
- Formacionet nga kontakti i dyshemesë terciare të shkëmbinjve vullkanogjenë me gëlqerorët.

Sedimentet e aluvioneve kuaternare dhe terciare janë të vendosura pranë lumenjve më të mëdhenj (Ibër, Sitnicë, Llap dhe Drenicë). Sedimentet aluviale në Lumin Ibër shtrihen në një sipërfaqe të vogël dhe trashësia e tyre vlerësohet të jetë e vogël. Megjithatë, përgjatë lumenjve Sitnica, Llap dhe Drenica, këto sedimente aluvionale janë më të thella. Sedimentet e aluvioneve të epokës kuaternare gjenden pranë kanalit të lumit, kurse sedimente më të vjetra të moshës terciare gjenden në tarracat fqinje.

Harta 9: Gjeologjia e pellgut te lumit Ibër.



### 2.2.7 Përdorimi i tokës në Pellgun e Lumit Ibër

Kategoritë e përdorimit të tokës mund të grupohen në 5 klasa kryesore:

- sipërfaqe artificiale / sipërfaqe të ndërtuara (rreth 33,3 %);
- zona pyjore dhe gjysmënatyrore (rreth 33,3 %);
- sipërfaqe bujqësore (rreth 20 %);
- ligatina (6,7 %);
- trupa ujqorë (6,7 %).

Sipërfaqet artificiale përfshijnë zonat urbane dhe vendbanimet, zonat industriale dhe tregtare, rrugët, kantieret e minierave, vendgrumbullimet, kantieret e ndërtimit si dhe zonat me vegjetacion artificial, jo bujqësor. Këto sipërfaqe janë të vendosura kryesisht në luginë, ku ndodhen vendbanimet më të mëdha të pellgut.

Përdorimi i tokës në pellg është në bazë të të dhënave të mbulesës tokësore në Kosovë të CORINE 2018. Të dhënat janë skematizuar në Tabela 7 dhe Harta 10.


Tabela 7: Përdorimi i tokës në Pellgun e Lumit Ibër.

Nënpelgu	KodITUS	Aeroporte	Pyje gjethëgjera	Zona të djegjura	Kultivim kompleks	Pyje halore	Drujt frutorë dhe plantacione të manaferrave	Zona ndërtimi	Zonë e vazhdueshme urbane me ndërtesa dhe rrugë	Zonë e pavazhdueshme me ndërtesa dhe rrugë	Lokacione mbeturinash	Njësi industriale ose komerciale	Mocale të brendshme	Tokë e zënë kryesisht nga bujqësia, me sipërfaqe të konsiderueshme të vegetacionit natyror	Vendndërtimet të mineraleve	Pyje të përziera	Toka të lagështa dhe shkurre	Kullosa natyrore	Tokë e punueshme pa ujë	Kullota	Lokacione sporti dhe rekreacioni	Torfe	Rrëzimet rrugore dhe hekurudhore dhe toka shodhëse	Zona me bimësi të rralle	Shkurre kalimtare pyjore	Trupa ujorë	Zona (km <sup>2</sup> )
XK-02-01	XK-02-01-01		7186		832	1				112				1119				284	2					0	670		102
	XK-02-01-02		1880	9	1301	189	215		3	1624		346		537	54	362		115	7280	647					196		148
	XK-02-01-03		6084		1493	49					1678		129		2466	26	141		9528		577			50	582		228
	XK-02-01-04				210						399		21	16						5247	248		36		87	0	66
	XK-02-01-05		147		49	9					172		59	74			0			659				27	0		12
	XK-02-01-06		1036		1844			25			1416	304		638	59	816	200		74	4313	1024	23			495		123
	XK-02-01-07		7215		2880	0					747		49		2560				444	5498	163			45	699		203
	XK-02-01-08		6415	70	1700	32					1350	62	66		2954		64		304	4526	411					1152	
XK-02-02	XK-02-02-01		3297	148	1769	45				258				219	46	29		132	365	8					194		65
XK-02-03	XK-02-03-01	10	2675		309					424				150	15	164			2283	122					338		65
XK-02-04	XK-02-04-01		4318		196	13								2425		28		289							199		75
	XK-02-04-02		2330	8	1									241				71		0					121	196	30
	XK-02-04-03		464		222			24		1158	52	195		251	70	101		64	1923	101			15	6	349	0	50
XK-02-05	XK-02-05-01	346	302		74					223		98	16	7	164			582	1185	68					107	56	32
XK-02-06	XK-02-06-01		4098		163	15		3		2237				1450		144		42	889	1			53		533		99
XK-02-07	XK-02-07-01		12710		7903	61		53		1499	44	246		3008	117	832		7129	943				7	329	993	26	359
	XK-02-07-02		2544		1239	64				275				525	633	43		292	1182	245					233		73

Nënpelgu	Kod/ITUS	Aerporte	Pyje gjethegjera	Zona të djegura	Kultivim kompleks	Pyje habore	Druri frutorë dhe plantacione të manaferrave	Zona ndërtimi	Zonë e vazhdueshme urbane me ndërtesa dhe rrugë	Zonë e pavazhdueshme me ndërtesa dhe rrugë	Lokacione mbeturinash	Njësi industriale ose komerciale	Mogële të brendshme	Tokë e zënë kryesisht nga bujqësia, me sipërfaqe të konsiderueshme të veçelacionit natyror	Vendndërtje të mineraleve	Pyje të përziera	Toka të lagështa dhe shkurre	Kullësia natyrore	Tokë e punueshme pa ujë	Kullota	Lokacione sporti dhe rekreacioni	Torfe	Rrjetet rrugore dhe hekurudhore dhe toka shodëruese	Zona me bimësi të rralë	Shkurre kalimtare pyjore	Trupa ujorë	Zona (km <sup>2</sup> )
XK-02-08	XK-02-08-01		7142		59									1657				66							376	46	93
	XK-02-08-02		6030	47	326				25					3006	0			180		100					1886	34	117
	XK-02-08-03		2409		116					204					377	41			1541	1						304	238
XK-02-09	XK-02-09-02		1964		1541	0			555					851				180	4177	274			27		266		99
XK-02-10	XK-02-10-01		6462		377									196				2491		55				487	551	106	
	XK-02-10-02		6522		2883	146				1263				1107	120			586	4278	181				112	696	179	
	XK-02-10-03		13795		1051	41				1414	25	45		3200	151			1501	6749	72	10		38	236	1145	295	
XK-02-11	XK-02-11-01		2456		661					246				792				7	248	119			72	247		48	
XK-02-12	XK-02-12-01		3247		30									276				188		54				323		44	
XK-02-13	XK-02-13-01		1953		24						24			471				43					104	144		28	
XK-02-14	XK-02-14-01		4477		7					25				727				241					328	756		76	

Nënpelgu	Kod/ITUS	Aerporte	Pyje gjethegjera	Zona të djegura	Kultivim kompleks	Pyje halore	Druri frutues dhe plantacione të manaferrave	Zona ndërtimi	Zonë e vazhdueshme urbane me ndërtesa dhe rrugë	Zonë e pavazhdueshme me ndërtesa dhe rrugë	Lokacione mbeturinash	Njësi industriale ose komerciale	Mreçatë të brendshme	Tokë e zënë kryesisht nga bujqësia, me sipërfaqe të konsiderueshme të veçelimit natyror	Vendndërtje të mineraleve	Pyje të përziera	Toka të lagështa dhe shkurre	Kullosa natyrore	Tokë e punueshme pa ujë	Kullota	Lokacione sporti dhe rekreacioni	Torfe	Rrjetet rrugore dhe hekurudhore dhe toka shodëruese	Zona me bimësi të rralle	Shkurre kalimtare pyjore	Trupa ujorë	Zona (km <sup>2</sup> )	
																												Zona (ha)
XK-02-15	XK-02-15-01		6987		126									1595		42		4023		110					885	3346		171
XK-02-16	XK-02-16-01		8165		240	586				20				1741		514	61	517		14					28	1296	778	196
	XK-02-16-02		6011		855	36				162				956				50	48	19					294	431		89
	XK-02-16-04		2		78					543				146					230							74		11
	XK-02-16-05		30501	1909	29					340	125	58		10471	19	582	1	3204	52	58					2668	5735	28	636


Harta 10: Përdorimi i tokës në Pellgun e Lumit Ibër.



## 2.2.8 Ekoregjionet dhe biodiversiteti

Pellgu i Ibrit është pjesë e ekoregjioneve 5 (Ballkani Perëndimor Dinarik, pjesa veriore) dhe 6 (Ballkani Perëndimor Helen) bazuar në sistemin e klasifikimit të ekosistemeve sipas DKU, **Shtojca XI**), siç tregohet në Harta 11.

Harta 11: Pellgu i Lumit Ibër dhe ekoregjionet



Biodiversiteti i Kosovës<sup>16</sup> është jashtëzakonisht i pasur me lloje të bimëve duke marrë parasysh sipërfaqen relativisht të vogël të vendit. Janë gjetur 13 lloje bimore që rriten vetëm në Kosovë dhe afërsisht 200 lloje që rriten vetëm në Ballkan. Diversiteti bimor i Kosovës është rezultat i ndërveprimit kompleks të faktorëve fizikë që krijojnë një shumëllojshmëri të gjerë të kushteve të habitatit për rritjen e bimëve. Diversiteti bimor i Kosovës pasurohet më tej nga prania e llojeve të shtyra nga jugu gjatë periudhave të akullnajave. Pyjet mbulojnë rreth 40% të Kosovës, por vetëm rreth një e treta e kësaj zone konsiderohet ekologjikisht e shëndetshme dhe ekonomikisht produktive. Pjesa më e madhe e dy të tretave të mbetura përbëhet nga pemë të reja dhe pyje të ulëta me shkurre që priten periodikisht për dru zjarri. Ritmi i prerjes për dru zjarri u rrit gjatë dhe pas luftës, por Kosova ende duhet të importojë më shumë se gjysmën e drurit të përdorur si karburant dhe pjesën më të madhe të lëndës drusore për ndërtim. Pyjet e rritura të dushkut tani janë shumë të kërcënuara. Disa lloje të bimëve dihet se janë në prag të zhdukjes në Kosovë ose tashmë janë zhdukur në nivel lokal - kryesisht për shkak të veprimeve njerëzore.

Pyjet e Pellgut të Lumit Ibër janë kryesisht gjethegjera, me një përqindje të vogël të pyjeve halore dhe të përziara. Në pjesën veriore të Pellgut të Ibrit ka kullota natyrore. Një pjesë e

<sup>16</sup> Biodiversity and Forestry Indefinite Quantity Contract, USAID, Kosovo, May 2003.

vogël e tyre gjendet edhe në jug të pellgut. I gjithë Pellgu i lbrit ka zona të vogla shkurresh pyjore kalimtare.

Faktorët që krijojnë kushte të favorshme për diversitetin bimor në Kosovë shpjegojnë gjithashtu nivelin e dalluar të diversitetit të shtazëve në këtë zonë relativisht të vogël. Vlerësohet se në Kosovë ekzistojnë rreth 46 lloje gjitarësh, shumë prej tyre me rëndësi konservimi në nivel rajonal ose global. Viset kufitare malore të Kosovës ofrojnë habitate për një numër të llojeve të gjitarëve duke përfshirë ariun e murrmë, rrëqebullin, macen e egër, ujkun, dhelprën, dhinë e egër, kaprollin dhe drerin. Pritet që 225 lloje shpendësh të jenë ose rezidentë në Kosovë ose si migrues sezonalë – duke përfshirë disa lloje shpendësh grabitqarë. Shumica e llojeve shtazore në vend kërcënohen nga shkatërrimi i habitateve pyjore. Disa lloje të shpendëve të ujit tashmë janë zhdukur në Kosovë, ndoshta për shkak të shkatërrimit të ligatinave. Gjuetia dyshohet se ka qenë intensive gjatë viteve 1990, por aktualisht është e ndaluar dhe thuhet se ka pak gjueti të paligjshme. Statusi i popullatave të llojeve të përdorura në gjueti është i panjohur. Popullatat e dy llojeve të breshkave janë varfëruar seriozisht nga grumbullimi për tregtinë e kafshëve shtëpiake. Ekosistemet ujore në lumenj janë shumë të kërcënuara për shkak të ndotjes së ujit nga burimet shtëpiake dhe industriale, si dhe nxjerrjet e pakontrolluara të rërës dhe zhavorrit nga shtretërit e lumenjve.

Pjesa më e madhe e diversitetit të mbetur të bimëve dhe kafshëve tokësore gjendet në malet më të larta në rajonet jugore dhe perëndimore të Kosovës. Parku Kombëtar i Malit Sharr në jug mbulon 53,272 ha kurse Parku i Bjeshkëve të Nemuna në perëndim të Kosovës përfshin 62,488 ha. Zonat e tjera të mbrojtura përfshijnë dy peizazhe të mbrojtura dhe 38 monumente natyre.

### 2.2.9 Zonat e mbrojtura ujore

Neni 66 i Ligjit për Ujërat e Kosovës<sup>17</sup> i specifikon tri lloje të Zonave të Mbrojtura Ujore në Kosovë:

1. Zonat e Mbrojtura Sanitare (ZMS), zonat e caktuara për furnizim me ujë për konsum njerëzor;
2. Zonat e mbrojtura për qëllime strategjike;
3. Zonat ekologjike të mbrojtura (zonat e rritit Natura 2000<sup>18</sup>).

Kriteret për caktimin e zonave të mbrojtura sanitare përcaktohen nga Ministria e Mjedisit në bashkëpunim me autoritetet shëndetësore, përkatësisht me akt nënligjor, konkretisht Udhëzimi Administrativ (UA) nr. 15/2017 për Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit. Këto zona nuk aplikohen për burimet që përdoren për furnizim publik me ujë të pijshëm me kapacitet mesatar ditor më të vogël se 10 m<sup>3</sup> në ditë ose që përdoren për furnizim me ujë të vendbanimeve me më pak se 50 banorë<sup>19</sup>.

Ministria përkatëse e Mjedisit, me akt nënligjor, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Shëndetësisë, në të ardhmen do të përcaktojë kriteret për zonat e mbrojtura për qëllime strategjike. Zonat e mbrojtura ekologjike ujore përcaktohen me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës.

<sup>17</sup> Ligji nr. 04/L-147 Ligji për Ujërat e Kosovës

<sup>18</sup> The Natura 2000 protected areas network — European Environment Agency (europa.eu)

<sup>19</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15796>

## **Zonat e Mbrojtura Sanitare ZMS**

Janë tre ZMS të caktuara për ujë për konsum njerëzor brenda kufijve të Pellgut të Lumit Ibër, siç është paraqitur më detajisht në **Kapitullin 7**. Nuk ka monitorim të vazhdueshëm aktiv të kushteve të këtyre ZMS, megjithatë sipas MMPHI ato mirëmbahen në mënyrë të kënaqshme.

Legjislacioni shtetëror përcakton masat e mbrojtjes dhe ndalimet së pari për secilën zonë në varësi të burimit të ujit dhe së dyti për secilën kategori të asaj zone.

Regjistri i zonave të mbrojtura gjendet në **Kapitullin 7** të këtij plani.

## **Zonat e mbrojtura për qëllime strategjike**

Nuk ka zona specifike të mbrojtura të përcaktuara ende në pellg për: (i) Speciet ujore me rëndësi ekonomike; (ii) Ujë për rekreacion dhe larje dhe (iii) Zonat e ndjeshme nutritive. Megjithatë, janë bërë përpjekje për përcaktimin e këtyre zonave specifike të mbrojtura. Ka projektvendime të Qeverisë së Kosovës, të pa miratuara ende që përcaktojnë zona të veçanta të mbrojtura brenda pellgut.

## **Zonat e përcaktuara për mbrojtjen e habitateve dhe specieve**

Këtu përfshihen zonat ku mirëmbajtja ose përmirësimi i statusit të ujit është një faktor kyç në mbrojtjen e tyre, duke përfshirë zonat përkatëse të Natura 2000 të përcaktuara sipas Direktivës 92/43/EEC dhe Direktivës 79/409/EEC.

Legjislacioni shtetëror (me Ligjin Nr. 04/L-147 “Për Ujërat e Kosovës”) përcakton Zonat e Mbrojtura Ekologjike (Natura 2000) që është pjesërisht ekuivalente me Zonat e përcaktuara për Mbrojtjen e Habitaveve ose Specieve. Këto zona janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 03/L-233 “Për Mbrojtjen e Natyrës”. Sipas këtij ligji, zonat për mbrojtjen e habitateve dhe specieve ose të njohura në vend si zona të mbrojtura ekologjike, klasifikohen më tej si:

- Rezervat strikt i natyrës;
- Park Kombëtar;
- Zonë e veçantë (ZVM dhe ZVR);
- Park natyre;
- Monument natyre;
- Peizazh i mbrojtur;
- Monument i arkitekturës së parkut.

Aktualisht, Kosova ka vetëm një zonë të caktuar për mbrojtjen e Habitaveve dhe Specieve sipas legjislacionit të Natura 2000. Kjo zonë është Ligatina e Hencit, e vendosur në Pellgun e Lumit Ibër dhe në nënpellgun e Sitnicës. Kjo zonë është krijuar si zonë e mbrojtur në vitin 2014 sipas legjislacionit shtetëror, Ligjit Nr. 03/L-233 “Për Mbrojtjen e Natyrës” dhe e ka statusin si “Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve”.

Përveç kësaj, ka disa zona të përcaktuara si “Zona të Mbrojtura Ekologjike” sipas legjislacionit shtetëror<sup>20</sup>. Këto zona dhe karakteristikat e tyre janë renditur në **Kapitullin 7**.

<sup>20</sup> [https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Biodiversiteti%20IK/Zonat%20e%20mbrojtura/Zonat\\_e\\_Mbrojtura.pdf](https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Biodiversiteti%20IK/Zonat%20e%20mbrojtura/Zonat_e_Mbrojtura.pdf)

## 2.2.10 Klima

Në përgjithësi, reshjet vjetore dhe sezonale të përbëra nga bora dhe/ose shirat janë faktori kryesor i të gjitha ndërveprimeve lidhur me ujin në pellgun e lumit. Në bazë të kushteve klimatike, Kosova mund të ndahet në tri zona klimatike:

1. Zona Klimatike e Kosovës (Rrafshi i Kosovës);
2. Zona Klimatike e Dukagjinit (Rrafshi i Dukagjinit);
3. Zona klimatike e maleve dhe pjesëve pyjore.

Klima e Pellgut të Lumit Ibër hyn në kategorinë e parë të zonës klimatike të Kosovës (Rrafshi i Kosovës). Klima në Pellgun e Lumit Ibër është kryesisht e tipit e mesme-kontinentale. Kjo do të thotë se dimrat janë më të ftohtë me temperatura mesatare mbi  $-10\text{ }^{\circ}\text{C}$ , por ndonjëherë deri në  $-26\text{ }^{\circ}\text{C}$ . Vera është e nxehtë me temperatura mesatare prej  $20\text{ }^{\circ}\text{C}$ , ndonjëherë edhe deri në  $37\text{ }^{\circ}\text{C}$ .


Në Pellgun e Lumit Ibër, ka dy lloje të reshjeve, kryesisht reshje *relievore ose orografike*, si dhe reshje *konvektive*. Reshjet orografike ose relievore shkaktohen kur masat e ajrit shtyhen në anën e formacioneve të ngritura të tokës, të tilla si malet ose pllajtat (ky shpesh njihet si efekt i shpatit). Ngritja e ajrit në anën e malit rezulton në ftohje me rritjen e lartësisë mbidetare, dhe përfundimisht kjo qon në kondensim dhe reshje. Reshjet konvektive ndodhin kur ajri ngritet vertikalisht përmes mekanizmit (përkohësisht) të vetë-qëndrueshëm të konvektionit. Prandaj, pjesët më të larta të pellgut përfshihen me më shumë reshje sesa pjesët e ulëta.

Të dhënat e reshjeve janë mbledhur nga burime të ndryshme. Në vitin 1999, Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës ka kryer një studim ku janë llogaritur mesataret mujore për një periudhë 25-vjeçare. Kjo bazë e të dhënave është zgjeruar gjithashtu për të mbuluar një periudhë 25-vjeçare (1979-2004) përveç vlerave për vitet 2001-2004.


Ky pellg karakterizohet nga një klimë e thatë dhe me reshje mesatare vjetore prej 782 mm në vit. Reshjet mesatare vjetore në rajon variojnë nga nën 600 mm në lugina deri në rreth 800 mm në zona malore. Por ka dallime lokale. Për shembull, stacionet matëse të vendosura në dhe rreth nënpellgut të Sitnicës kanë regjistruar reshje vjetore deri në 1.200 mm, ndërsa ato në pjesët e poshtme kanë regjistruar 400 mm deri në 500 mm.

Lumi Ibër karakterizohet me prurje maksimale në pranverë dhe prurje minimale në periudhën e fundit të verës. Shkarkimi mesatar është  $25,3\text{ m}^3/\text{s}$ . Ndërsa prurja maksimale lidhet me shkriren e borës në fillim të pranverës, prurjet e ulëta janë për shkak jo vetëm të mungesës së reshjeve, por edhe të avullimit intensiv dhe infiltrimit të ujit në zonat gëlqerore.

Harta 12: Rrjeti hidrometrik në Pellgun e Lumit Ibër.



Harta 13: Shpërndarja e reshjeve në Pellgun e Lumit Ibër.



### 2.2.11 Ndryshimet klimatike në Kosovë

Në Strategjinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (SMMK) dhe në Planin e Veprimit në Mjedis (PVM), ndryshimet klimatike janë identifikuar si prioritet në procesin e përafrimit të Kosovës me BE dhe në përmbushjen e obligimeve që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit.

Komponenti i Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike është thelbësor për adresimin dhe parashikimin e ndikimeve të ndryshimeve klimatike në Kosovë. Këto ndikime aktuale dhe të pritshme përfshijnë pikat në vijim (Burimet: IPCC, 2007, 2013, UN-Habitat 2009, OSBE 2008 dhe UNDP/WMO 2009)<sup>21</sup>:

- Ekspozimi ndaj rreziqeve si thatësitrat, përmbytjet dhe zjarret në pyje do të rritet me ndryshimet klimatike. Ndryshueshmëria e klimës tashmë është rritur në Kosovë;
- Rritja e intensitetit dhe frekuencës së ekstremeve të reshjeve si shirat e dendur, gjithashtu edhe thatësitrat më ekstreme, veçanërisht që nga vitet 1980. Përmbytjet e shpejta po shtohen në zonat malore, ndërsa vërshimet e lumenjve ndodhin më shpesh në fusha dhe ultësira;
- Temperaturat më të larta do të bëjnë më të mundshme valët e të nxehtit dhe zjarret në pyje. Që nga viti 2000, ka pasur një numër në rritje të zjarreve në pyje në Kosovë; Kosova është goditur nga thatësira disa herë në dy dekadat e fundit (1993, 2000, 2007 dhe 2008);
- Rritja e temperaturave, reshjet më të pasigurta dhe zvogëlimi i rrjedhave të lumenjve, kombinuar me zhvillimet socio-ekonomike dhe rritjen e përdorimit të resurseve ujore do të rrisin ekspozimin ndaj thatësirës;
- Që nga viti 2004, 80% e komunave të Kosovës kanë pësuar nga mungesa e ujit për shkak të thatësirave hidrologjike dhe keqpërdorimi i resurseve ujore (OSBE, 2008);
- Degradimi dhe reduktimi i shërbimeve të ekosistemeve;
- Rritja e ndotjes dhe format e reja të saj, si dhe rritja e numrit të sëmundjeve të lidhura me ujin.

Ndryshimet klimatike mund të ndikojnë drejtpërdrejt në ciklin hidrologjik dhe, nëpërmjet tij, në sasinë dhe cilësinë e resurseve ujore. Rritja e temperaturës së sipërfaqes së ujit dhe ndryshimet në ciklin hidrologjik mund të rezultojnë në ndryshimin e modeleve të reshjeve në rajon. Disa zona mund të përjetojnë reshje intensive që rezultojnë në përmbytje të mëdha, ndërsa disa zona tjera mund të kenë më pak reshje shiu dhe gjithashtu të përjetojnë thatësira të shpeshta (IPCC, 2013; IARU, 2009; Raporti Botëror i Zhvillimit të Ujit, 2009). Ndryshimet klimatike mund të shkaktojnë uljen e nivelit minimal të ujit në lumenj, duke ndikuar në disponueshmërinë dhe cilësinë e ujit për florën dhe faunën dhe në disponueshmërinë e ujit të pijshëm, prodhimin e energjisë (hidroenergjisë), ftohjen e termocentraleve dhe transportin nëpërmjet lumenjve, kanaleve dhe liqeneve. Si rezultat i drejtpërdrejtë, shumë sektorë janë jashtëzakonisht të prekshëm ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike, në veçanti bujqësia, peshkimi, industria, lundrimi, turizmi, shëndeti i njerëzve, siguria publike, biodiversiteti dhe shërbimet mjedisore nga ekosistemet. Përveç dëmit mjedisor dhe ekonomik, ndikimi përfundimtar i ndryshimeve klimatike është një taksë për burimin tonë më të çmuar - jetën dhe shëndetin e njerëzve. Ndikimet shëndetësore janë ndër dëmet më të rëndësishme nga ndryshimet klimatike - dhe shëndeti mund të jetë një forcë shtytëse për angazhimin publik në zgjidhjet lidhur me klimën.

<sup>21</sup> Strategjia Kombëtare për ndryshimet Klimatike 2018- 2017/ Plani i Veprimit për Ndryshimet Klimatike 2018- 2020

Prandaj, pranohet gjerësisht nga autoritetet përgjegjëse se Kosova duhet të planifikojë për t'u përshtatur me sfidat dhe mundësitë që do të sjellin ndryshimet klimatike. Institucionet përgjegjëse për ujin, bujqësinë, pylltarinë, lundrimin, industrinë, shëndetin publik, planifikimin e përdorimit të tokës dhe çështjet e lidhura me mjedisin janë nën presion për t'iu përgjigjur ndikimeve të paprecedenta të ndryshimeve klimatike si përmbytjet më të mëdha, thatësitat më të rënda, degradimi dhe reduktimi i shërbimeve të ekosistemeve, mungesat e furnizimit me ujë, rritja e nivelit të ndotjes dhe paraqitja e formave të reja të saj, si dhe sëmundjet e lidhura me ujin<sup>22</sup>.

**Tabela 8: Informatat rreth ndryshimeve klimatike (Burimi: Studimi mbi ndryshimet klimatike në rajonin e Ballkanit Perëndimor në v.2018) (vjt=vjetor; qkg = qershor, korrik, gusht).**

	$\Delta T$ (°C) VJT		$\Delta T$ (°C) QKG		$\Delta P$ (%) VJT		$\Delta P$ (%) QKG	
	RPP4.5	RPP8.5	RPP4.5	RPP8.5	RPP4.5	RPP8.5	RPP4.5	RPP8.5
<b>E ardhmja e afërt (2016-2035)</b>	0,5 – 1,0	0,5 – 1,5	1,0 – 1,5	1,0 – 1,5	-5	-5	-30	-30
<b>Meshekulli (2046-2065)</b>	1,5 – 2,0	2,0 – 3,0	2,0 – 3,0	2,0 – 3,0	-5	0	-30	-30
<b>Fundshekulli (2081-2100)</b>	2,0 – 3,0	4,0 – 5,0	2,0 – 3,0	> 5,0	0	-30	-40	-50


Informacionet bazë për ndryshimet klimatike në Kosovë tregojnë një rritje alarmante të temperaturës në të gjithë territorin e vendit:

- Gjatë periudhës të së ardhmes së afërt (2016-2035), që tashmë po ndodh, rritja mesatare vjetore e temperaturës pritet të arrijë 0,5 – 1,0 °C, por nëse ka rritje konstante globale të GS, rritja mund të shkojë edhe deri në 1,5 °C;
- Gjatë periudhës së mesit të shekullit (2046-2065), rritja mesatare vjetore e temperaturës pritet të arrijë në 1,5 – 2,0 °C dhe deri në 2,0 – 3,0 °C, me një rritje të vazhdueshme të GS globale;
- Gjatë periudhës së fundit të shekullit (2081-2100), mesatarja vjetore e rritjes së temperaturës tregon se edhe nëse emetimet globale të GS stabilizohen, temperaturat do të vazhdojnë të rriten me një shtesë prej 0 – 1,0 °C që nga periudha e mesit të shekullit (deri në 2,0 – 3,0 °C krahasuar me klimën aktuale), dhe në rast të rritjes së vazhdueshme globale të GS, rritja e temperaturës do të arrijë në 4,0 – 5,0 °C në të gjithë rajonin krahasuar me klimën aktuale.
- Rritja e temperaturave verore (qershor-korrik-gusht: QKG) është më e lartë se mesatarja vjetore deri në 0,5 – 1,0 °C, dhe në rast të rritjes së vazhdueshme globale të GS, temperatura për këtë stinë do të kalojë 5,0 °C rritje në periudhën e fundit të shekullit në krahasim me klimën aktuale.

*Në hartën më poshtë: Ndryshimi mesatar vjetor i temperaturës (°C) për periudhat e së ardhmes të afërt 2016-2035 (kolona e majtë), mesit të shekullit 2046-2065 (kolona e mesme) dhe fundit të shekullit 2081-2100 (kolona e djathtë) krahasuar me periudhën bazë (1986-2005) sipas RPP4.5 (rreshti i sipërm) dhe RPP 8.5 (rreshti i poshtëm) - Burimi: Studimi mbi ndryshimet klimatike në rajonin e Ballkanit Perëndimor në 2018.*

<sup>22</sup> Strategjia Kombëtare për ndryshimet Klimatike 2018- 2017/ Plani i Veprimit për Ndryshimet Klimatike 2018- 2020

Harta 14: Ndryshimi mesatar vjetor i temperaturës.




Ndryshimi i reshjeve të akumuluar është më kompleks për t'u analizuar, ku përfundimet më të rëndësishme janë:

- ndryshimi i dukshëm i reshjeve të akumuluar vjetore fillon nga periudha e mesit të shekullit, me një gradient ndryshimi që tregon rritje në pjesët veriore të rajonit (Serbia e Veriut) dhe rënie intensive drejt jugut, përfshirë zonat bregdetare;
- deri në fund të shekullit do të mbizotërojë thatësira në rajonin e Ballkanit Perëndimor;
- ndikimi i ndryshimeve klimatike është më i dukshëm në një ndryshim të shpërndarjes vjetore të reshjeve, gjë që është evidente nga thatësirat ekstreme të stinës së verës (QKG); ky fenomen është më i theksuar drejt jugut të rajonit dhe në zonat bregdetare.

### Harta 15: Reshjet.

(Ndryshimi i reshjeve të akumuluar (%) për periudhat e së ardhmes së afërt (rreshti i sipërm), mesit të shekullit (rreshti i mesëm) dhe fundit të shekullit (rreshti i poshtëm) krahasuar me periudhën bazë për vlerat mesatare vjetore sipas RPP4.5 (majtas), në RPP8.5 (mes) dhe verë mesatare (qershor-korrik-gusht) sipas RCP8.5 (djathtas) - Burimi: Studimi mbi ndryshimin e klimës në rajonin e Ballkanit Perëndimor në 2018.)



Për sa i përket skenarit të gjendjes në periudhën e ardhshme, projeksionet e përcaktuara nga vlerësimi i ndryshimeve klimatike sipas dy skenarëve të emetimeve, u aplikuan në modelin aktual të kushteve meteorologjike dhe rrjedhimisht u zbatuan 4 simulime<sup>23</sup>:

1. Periudha e mesit të shekullit 2046-2065 krahasuar me periudhën bazë, sipas RPP4.5;
2. Periudha e fundit të shekullit 2081-2100 krahasuar me periudhën bazë, sipas RPP4.5;
3. Periudha e mesit të shekullit 2046-2065 krahasuar me periudhën bazë, sipas RPP8.5;
4. Periudha e fundit të shekullit 2081-2100 krahasuar me periudhën bazë, sipas RPP8.5.

Më shumë detaje mbi analizën për periudhën kohore 1982-2020 (kushtet aktuale) mund të gjenden në **Shtojcën 3**, ku jepen të dhëna rreth disponueshmërinë mesatare specifike të ujit

<sup>23</sup> Study on climate change in the Western Balkans region in 2018.

për pellgun dhe vëllimin mesatar vjetor të akumuluar në daljen e pellgut. Janë paraqitur gjithashtu shkarkimet me frekuenca të ndryshme.

Tabela 9 përmbledh prurjet mesatare dhe vëllimet vjetore për Pellgun e Lumit Ibër në daljen e kufirit të Kosovës, duke përmbledhur rezultatet për skenarët e gjendjes së ardhshme (dy skenarë të emetimeve RPP4.5 dhe RPP8.5 për mesin e shekullit 2046-2065 dhe periudhat e fundit të shekullit 2081-2100).

**Tabela 9: Disponueshmëria e ujit në Pellgun e Lumit Ibër / Skenari: Kushtet aktuale (Burimi: Studimi i Bilancit Ujor, 2018).**

	<b>Ibër</b>
Prurje mesatare (m <sup>3</sup> /s)	25,30
Vëllimi mesatar vjetor (MMK)	798
Q25% (m <sup>3</sup> /s)	10,68
Q50% (m <sup>3</sup> /s)	17,00
Q75% (m <sup>3</sup> /s)	33,24

**Tabela 10: Disponueshmëria e ujit në Pellgun e Lumit Ibër / Skenari: Kushtet e ardhshme (Burimi: Studimi i Bilancit Ujor, 2018).**

<b>RPP4.5 2046-2065</b>			<b>RPP4.5 2081-2100</b>		
Prurje mesatare (m <sup>3</sup> /s)	Vëllimi mesatar vjetor (MMK)	Ndryshimi në vëllim %	Prurje mesatare (m <sup>3</sup> /s)	Vëllimi mesatar vjetor (MMK)	Ndryshimi në vëllim %
23,00	725	-9,10%	23,72	748	-6,30%
<b>RPP8.5 2046-2065</b>			<b>RPP8.5 2081-2100</b>		
Prurje mesatare (m <sup>3</sup> /s)	Vëllimi mesatar vjetor (MMK)	Ndryshimi në vëllim %	Prurje mesatare (m <sup>3</sup> /s)	Vëllimi mesatar vjetor (MMK)	Ndryshimi në vëllim %
23,66	746	-6,50%	18,44	582	-27,10%

## 2.3 Karakterizimet themelore hidrologjike

### 2.3.1 Gjendja hidrogeologjike e Pellgut të Lumit Ibër

Sedimentet aluviale të rërës dhe zhavorrit në pellg përmbajnë një akuifer me ujëra nëntokësore të cekëta freatike. Ky lloj akuiferi ka ndërveprim të mirë hidraulik me ujërat sipërfaqësore dhe për këtë fakt, ujërat nëntokësore janë mjaft të ndjeshme ndaj presioneve mjedisore, kështu që mund të ndoten lehtësisht. Gjithashtu në bazë të përvojave praktike mund të themi se thellësia e ujërave nëntokësore në puse të hapura për furnizim me ujë të pijshëm varion nga 5 deri në 15 m. Pra, kemi të bëjmë me ujëra, të cilët nga pikëpamja hidrogeologjike përfaqësojnë akuiferin e parë, i cili është mjaft i vështirë për t'u mbrojtur nga ndotja që vjen prej sipërfaqes. Balta dhe sedimentet e ngjashme të cilat janë gjithashtu të përhapura gjerësisht janë izolues hidrogeologjik dhe nuk paraqesin një mjedis hidrogeologjik të favorshëm për deponimin e ujërave nëntokësore.


Sedimentet aluviale përgjatë luginave të lumenjve Sitnicë, Llap dhe Drenicë janë të rëndësishme për Pellgun e Ibrit. Fusha aluviale e Lumit Sitnica mbulon një sipërfaqe të konsiderueshme të Rrafshit të Kosovës. Trashësia e sedimenteve aluviale varion nga 10 m deri në 15 m, ndërsa në fshatin Besi arrin deri në 33 m (lugina e Lumit Llap).








Nëse i konsiderojmë si akuiferë sedimentet aluviale, tarracat lumore dhe liqenore, si dhe masat e vogla të shkëmbinjve gëlqerorë pranë Lumit Ibër, mund të themi se hapësira e ngushtë e Lumit Ibër është formuar kryesisht nga shkëmbinj që nuk kanë natyrë akuiferi dhe vetëm pjesërisht nga të tillë që kanë natyrë akuiferë (rezistentë ndaj ujit dhe jo-rezistentë ndaj ujit). Në këto formacione, akuiferët sporadikë dhe të varfër formohen vetëm në zona tektonike të

dekompozuara dhe të varfra. Këta akuiferë plotësohen përmes reshjeve dhe infiltrimit dhe shkarkohen përmes burimeve dhe resurseve ujore.

Vlerësohet se një akuifer i formuar në këto sedimente aluviale do të ishte i rëndësishëm për furnizimin me ujë të pijshëm, industrinë dhe kërkesat e tjera për rajonin e Prishtinës. Aluvionet e Lumit Llap kanë trashësi të ndryshueshme. Ujërat nëntokësore në këto sedimente aluviale variojnë nga 3,6 m deri në 5 m (Podujevë).

Harta 16: Harta hidrogeologjike e Pellgut të Lumit Ibër - 1:200.000, ICMM, 2006.



<b>Legend – Hydrogeological Units</b>	
<b>Aquifer-Porous/intergranular porosity</b>	
	Intergranular porosity aquifer with very high-medium permeability (e.g., sand, sand + gravel, sand + gravel + mud/silt) with $K_f > 10^{-5}$ m/s.
	Intergranular porosity aquifer with medium- low permeability (e.g., clay+ sand + mud/silt) with $K_f > 10^{-5} - 10^{-9}$ m/s.
<b>Fissured porosity</b>	
	Fissured porosity aquifer with medium-low fracture permeability (e.g., limestone, limestone/marlstone, marble, metamorphic rock, sandstone + conglomerate + limestone/marlstone, plutonic rock, with $K_f = 10^{-5} - 10^{-9}$ m/s.
<b>Fissured/karstified porosity</b>	
	Fissured and karstified porosity aquifer with strongly alternating, local very high, fracture permeability (e.g., limestone, marble) with $K_f = 10^{-3} - 10^{-9}$ m/s.
<b>Mixed porosity</b>	
	Double porosity aquifer with medium-low permeability (e.g., limestone) with $K_f = 10^{-5} - 10^{-9}$ m/s.
<b>Hydrothermal/tectonic alteration zone</b>	
	Alteration zone of hard rock with medium-low permeability, with $K_f = 10^{-4} - 10^{-7}$ m/s.
<b>Aquiclude</b>	
	Aquiclude without considerable intergranular or fissured porosity (e.g., sandstone, sandstone +mudstone/siltstone, conglomerate, metamorphic rock, plutonic rock, pyroclastic rock) with $K_f < 10^{-9}$ m/s.

### 2.3.2 Përmbytjet

Kosova është një vend me 'stres ujqor'. Megjithatë, nganjëherë sasi masive të reshjeve ndodhin në periudha të shkurtra kohore, duke shkaktuar përmbytje (të shpejta) dhe erozion. Parashikohet se ndryshimet klimatike do të sjellin temperatura më të larta dhe periudha më të shpeshta të reshjeve, veçanërisht gjatë verës. Kjo do të rrisë shfaqjen dhe ndikimin e përmbytjeve dhe thatësirave në vend.

Intensiteti dhe kohëzgjatja e reshjeve janë të rëndësishme për mbushjen e rezervuarëve, por ndonjëherë mund të çojnë në përmbytje masive. Një situatë e tillë ka ndodhur gjatë muajit prill të vitit 2014, kur brenda pak ditësh tre rezervuarët (Batllava, Badovci dhe Përlepnicë) janë mbushur 100% me ujë dhe bile ata është dashur të lëshojnë ujë, gjë që ka shkaktuar vërshime në rrjedhën e poshtme.

Në vitin 2015, për shkak të një cikloni që erdhi nga pjesa veriperëndimore e kontinentit evropian, Kosova u godit nga reshje masive me intensitet të lartë, veçanërisht në datat 4, 5 dhe 6 shkurt 2015, duke çuar në një rritje të shpejtë të nivelit të ujit të lumenjve dhe vërshimeve, veçanërisht në nënpellgun e Lumit Sitnica.

Viti 2016 ka qenë një vit pak i lagësht dhe janë dhënë disa paralajmërime zyrtare për përmbytje, siç tregohet në Tabela 11 **Error! Reference source not found.**

**Tabela 11: Njoftimet zyrtare për përmbytje në vitin 2016 në Pellgun e Lumit Ibër.**

Nr.	Nga	Deri	Zona e ndikuar
1	06.1.2016	09.1.2016	Tërë Kosova
2	07.3.2016	08.3.2016	Fusha e Kosovës
3	13.3.2016	15.4.2016	Tërë Kosova
4	02.4.2016	05.4.2016	Tërë Kosova
5	21.5.2016	22.5.2016	Tërë Kosova
7	07.11.2016	09.11.2016	Tërë Kosova

Në vitin 2018, disa rajone kanë pasur reshje të dendura deri në 25 - 40 mm në 3 orë, duke shkaktuar rritje të nivelit të ujit në shumë përrenj dhe duke shkaktuar përmbytje në Pellgun e Ibrit.

Një situatë edhe më ekstreme ka ndodhur në janar të vitit 2021, ku u regjistruan rreth 200 mm në 24 orë reshje - një rekord shtetëror. Kjo situatë ndikoi në mbushjen e tre rezervuarëve pas një periudhe thatësire gjatë 3-4 viteve të mëparshme (2017 - 2020). Reshje të tilla ekstreme me 30 deri në 50 mm në 3 deri në 6 orë mund të çojnë në përmbytje të fuqishme, shpesh të shoqëruara me rrëshqitje dheu. Nëse reshjet e tilla ndodhin në një kohë kur rezervuarët e ujit janë tashmë të mbushur me kapacitetin e tyre maksimal të ruajtjes, lindin probleme të tjera; gjegjësisht duke theksuar kapacitetet e derdhjeve dhe strukturat e digave.

Zonat më të shpeshta të prekura nga vërshimet në Pellgun e Lumit Ibër janë në nënpellgun e Sitnicës nga Lipjani deri në Vushtrri (shih foton më poshtë). Infrastruktura e mbrojtjes nga përmbytjet e ndërtuar midis viteve 1970-1990 në disa segmente lumore në Pellgun e Lumit Ibër nuk është mirëmbajtur siç duhet dhe tregon shenja degradimi. Zona e cila përjeton vërshimet më të mëdha është segmenti Lipjan-Vragoli dhe fshati Nadakovc.

### 2.3.3 Thatësirat


Sasia e reshjeve brenda një viti kalendarik dhe shpërndarja e tyre e pabarabartë në kohë dhe hapësirë favorizon një situatë ku thatësirat janë më të pranishme në disa zona të Kosovës, p.sh., pjesë të fushës së Kosovës (ku bën pjesë Pellgu i Lumit Ibër) dhe lugina e Kriva Rekës

(Pellgu i Lumit Morava e Binçës). Raporti i Gjendjes së Ujit në Kosovë i vitit 2020 thekson se Kosova është një vend i prirur ndaj thatësirave.

Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK), bazuar në kushtet e monitorimit të thatësirës/lagështisë në Republikën e Kosovës për periudhën hidrologjike gjashtëmujore tetor 2019-mars 2020, ka bërë një analizë të situatës sipas Indeksit të Standardizuar të Reshjeve (ISR). Siç tregohet në Harta 17, analiza e ISR tregon se për periudhën gjashtëmujore hidrologjike, tetor 2019 - mars 2020, kushtet e lagështisë/ thatësirës në Kosovë janë afër normales në shumicën e pjesëve të Kosovës. Sektori i IHMK/Hidrologjisë vazhdimisht e matë ISR në një sërë lokacionesh në Kosovë nga ku monitorohen reshjet.

Indeksi i Standardizuar i Reshjeve (ISR) është një indeks i përdorur shpesh për të karakterizuar thatësirën meteorologjike në periudha të ndryshme kohore. Në periudha të shkurtra kohore, ISR lidhet ngushtë me lagështinë e tokës, ndërsa në periudha më të gjata kohore, ISR mund të ndikohet nga depozitimi i ujërave nëntokësore dhe rezervuarëve. ISR është përcaktuar për të ofruar informacione rreth thatësirave për publikun, kompanitë e ujit dhe politikëbërësit për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të Kosovës dhe menaxhim më të mirë të resurseve ujore.

**Harta 17: Indeksi i Standardizuar i Reshjeve (ISR) për periudhën gjashtëmujore hidrologjike, tetor 2019 - mars 2020 (Burimi: Raporti i gjendjes së ujit në Kosovë, 2020). E gjelbra tregon mungesë thatësire, e verdha thatësirë të vogël dhe e kuqja thatësirë të madhe.**




## 2.4 Përdorimi i ujit dhe infrastruktura e ujit

### 2.4.1 Prapavija

Të dy llojet e trupave ujqorë, sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, në Pellgun e Lumit Ibër përdoren për furnizimin me ujë për bujqësi, ujëjitje, ujë të pijshëm, prodhim të energjisë elektrike, qëllime industriale, kultivim peshku dhe rekreacion. Sa i përket depozitimit të ujërave sipërfaqësore, Liqeni i Ujmanit është i vetmi rezervuar shumëqëllimësh që përdoret për ujëjitje, për ujë të pijshëm dhe përdorim industrial. Batllava dhe Badovci shfrytëzohen për ujë të pijshëm dhe për qëllime industriale<sup>4</sup>. Ujërat e zeza lirohen në pellg nga impiantet e trajtimit të ujërave të zeza (ITUZ) ose pikat e shkarkimit të ujërave të zeza të patrajuara.

Në hartën 18 më poshtë, është vizualizuar infrastruktura përkatëse ujore.


Harta 18: Infrastruktura kryesore ujore në Pellgun e Lumit Ibër.



## 2.4.2 Sistemi ujqr Ibër-Lepenc

Për të adresuar problemet e furnizimit me ujë të pijshëm për pjesën veriore dhe qendrore të Kosovës në luginën e Lumit Ibër, në vitet e 80-ta u ndërtuan diga dhe rezervuari i Ujmanit dhe rezervuari Predvoricës. Ndërtimi i sistemit Ibër-Lepenc (shih Harta 19) ishte një nga punët më komplekse dhe më të mëdha inxhinierike hidroteknike në Kosovë.

Harta 19: Sistemi Ibër-Lepenc në Pellgun e Lumit Ibër (Burimi: Ndërmarrja Ibër-Lepenci, <http://www.lber-lepenc.org/>).



NPH "Ibër-Lepenc" Sh. A. me seli në Prishtinë, është një ndërmarrje shumëfunktionale që furnizon industrinë, ujësjellësit dhe bujqësinë me ujë të papërpunuar dhe prodhon energji elektrike nga hidrocentrali i Ujmanit. Kompania është themeluar në vitin 1986 si ndërmarrje shoqërore me qëllim operimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së këtij sistemi multifunksional. Ndërtimi i këtij sistemi ishte planifikuar të bëhet në dy faza. Faza e parë e ndërtimit ka përfunduar në vitin 1986, e cila i përket pjesës së Ibrit, ndërsa pjesa e dytë që i përket Lepencit, ende nuk ka përfunduar, edhe pse në dekadat e fundit ka pasur disa zhvillime të pjesshme në aspektin e studimeve të fizibilitetit të bëra nga BERZH dhe Banka Botërore<sup>24</sup>.

Kanali Ibër-Lepenc shërben si ujësjellës me shumë qëllime i cili siguron ujë për ujiitje, industri, ujësjellës për pije dhe ujë për hidrocentrale. Skema e kanalit Ibër-Lepenc përbëhet nga:

1. *Rezervuari i Ujmanit dhe hidrocentrali* - resurset ujore ruhen në rezervuar, duke u shfrytëzuar nga një hidrocentral i vendosur në rrjedhën e poshtme. Uji që del nga turbinat derdhet në rezervuarin e Predvoricës i cili është një rezervuar i dytë (bufer).
2. *Rezervuari i dytë* gjithashtu merr një prurje direkt nga liqeni (rezervuari i Ujmanit) përmes një strukture marrjeje që ndodhet në mes të liqenit.
3. *Uji nga ky bufer dytësor* lëshohet në kanal in kryesor (kanali Ibër-Lepenc) përmes një porte rregulluese për të shpërndarë ujin tek përdoruesit e ndryshëm.
4. *Një rrjedhë mjedisore* (rrjedhë-M) lëshohet gjithashtu në Lumin Ibër nga rezervuari i Predvoricës përmes një porte. Për më tepër, kur rezervuari mbushet pas funksionimit të turbinës, uji i tepërt rrjedh në Lumin Ibër përmes një shkarkimi.
5. *Kanali Ibër-Lepenc* - Nëpërmjet një sistemi ujitës të kanaleve, tubacioneve, rregullatorëve, pendës dhe sifonëve, sistemi ofron furnizim me shumicë të ujit për një numër të përdoruesve të ujit (bujqësi, industri dhe ujësjellës komunal).
6. *Rrjedha e kthimit* mbledhet në pjesën e epërme të rrjedhës së Lumit Sitnica e cila derdhet përsëri në Lumin Ibër. Kanali Ibër-Lepenc është i gjatë 49 km. Ai gjithashtu ka degë dytësore të cilat e devijojnë ujin për ta transportuar atë në vende të veçanta ku mund të përdoret.

### 2.4.3 Përdorimi industrial i ujit nga ujërat sipërfaqësore

Dy shfrytëzuesit kryesorë për qëllime industriale në pellg janë Ndërmarrja NewCo "Ferronikeli" dhe dy termocentralet TC "Kosova A" dhe TC "Kosova B". Pjesa më e madhe e ujit të përdorur nga Ndërmarrja NewCo "Ferronikeli" shkon për nevojat industriale të operatorit, ndërsa një sasi e vogël e ujit përdoret si ujë i pijshëm. Uji industrial përdoret kryesisht për prodhimin e avullit, ftohjen e furrave elektrike, granulimin e skorjeve dhe sistemet e pastrimit të pluhurit dhe gazit në furrat elektrike dhe në konverterë. Sipas të dhënave të siguruar nga NewCo "Ferronikeli", në vitin 2019 kompania ka përdorur rreth 1.5 milionë m<sup>3</sup> ujë në vit. Në termocentralet "Kosova A" dhe "Kosova B" uji përdoret për ftohje dhe prodhimin e avullit nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)<sup>25</sup>.

<sup>24</sup> EBRD, & WorldBank. (2012). Feasibility study for protection of Ibër-Lepenc canal Kosovo: Environmental and Social Impact Assessment Framework.

<sup>25</sup> IWRM-K. (2022). Economic Assessment of Water Resources Management.

Tabela 12: Përdorimi industrial i ujit <sup>26</sup>.

Muaji	TC Kosova A m <sup>3</sup> /muaj	TC Kosova B m <sup>3</sup> /muaj	NewCo Feronikeli m <sup>3</sup> /muaj
I	-	1,041,600	267,840
II	-	940,800	241,920
III	-	1,041,600	267,840
IV	-	1,008,000	259,200
V	-	1,041,600	267,840
VI	518,400	1,008,000	259,200
VII	803,520	1,041,600	267,840
VIII	803,520	672,000	267,840
IX	777,600	1,008,000	259,200
X	803,520	1,041,600	267,840
XI	-	1,008,000	259,200
XII	-	1,041,000	267,840
<b>Totali</b>	<b>3,706,560</b>	<b>11,893,800</b>	<b>3,153,600</b>

#### 2.4.4 Përdorimi bujqësor i ujit nga ujërat sipërafqësore

Tabela 13 tregon sasinë e ujit të përdorur në bujqësi, duke përfshirë ujitjen, përdorimin në blegtori etj. Tabela është përfaqësuese për tërë Pellgun e Ibrit.

Tabela 13: Përdorimi bujqësor i ujit në Pellgun e Lumit Ibër në vitin 2019.

Përdorimi bujqësor i ujit (Milion m <sup>3</sup> /vit)					
Pellgu lumor	Konsumi i ujit për ujitje	Uji i pafaturuar	Konsumi i ujit të gjelbër	Konsumi i ujit për blegtorinë	Përdorimi total i ujit nga KRU
Ibër	19,98	39,97	184,17	1,90	246,03

Tabela 14 më poshtë paraqet sipërfaqen e ujitur për secilën komunë brenda Pellgut të Lumit Ibër për vitet 2019, 2020 dhe 2021. Këto të dhëna janë siguruar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Tabela 14: Sipërfaqet e ujitura në Pellgun e Lumit Ibër për komunë për 2019, 2020 dhe 2021.

Komuna	Burimi i ujitjes	Sipërfaqja e ujitur / ha - 2019	Sipërfaqja e ujitur/ ha - 2020	Sipërfaqja e ujitur/ ha - 2021
Prishtinë	Ibër-Lepenci	220	207	152
Vushtrri	Ibër-Lepenci	487	532	488
Zveçan	Burime	-	68	76
Graçanicë	Lumenj, burime	462	438	442
Obiliq	Ibër-Lepenci	526	564	622
Podujevë	Lumenj, burime	781	816	988
Mitrovicë	Ibër-Lepenci	437	387	387
Mitrovicë e Veriut	-	-	-	-
Leposaviq	-	-	1.000	-
Lipjan	Lumenj, burime	149	31	26
Fushë.Kosovë	Lumenj, burime	135	160	137
Drenas	Ibër-Lepenci	78	132	144
Shtime	Lumenj, burime	100	182	260
Skenderaj	Lumenj, burime	-	-	150
Zubin Potok	-	-	-	-
<b>Totali</b>	<b>-</b>	<b>3.375</b>	<b>4.517</b>	<b>3.782</b>

#### 2.4.5 Furnizimi me ujë të pijshëm nga ujërat sipërafqësore

Shërbimet e furnizimit me ujë në Pellgun e Lumit Ibër ofrohen nga Kompania Publike Hidroekonomike “Ibër-Lepenci” dhe dy Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit (KRU), KRU “Prishtina” dhe KRU “Mitrovica”. Ndërmarrja Publike Hidroekonomike “Ibër-Lepenci”, në

<sup>26</sup> Burimi: World Bank, 2014. Feasibility Study for Protection of Iber-Canal.

kuadër të fushëveprimit të saj, përmes kanalit Ibër-Lepenc, furnizon me ujë të papërpunuar dy KRU si dhe aktivitetet industriale e bujqësore në pellg. Kanali Ibër-Lepenc e merr ujin nga rezervuari i Ujmanit, i cili është rezervuari më i rëndësishëm në Kosovë<sup>27</sup>.

**Tabela 15: Furnizimi me ujë të pijshëm nga ujërat sipërfësore në Pellgun e Lumit Ibër.**

Pellgu	KRU	Komunitat	Nevojat e përmbushura nga KRU Rezidencialë			Nevojat e përmbushura nga KRU Industria	Nevojat e papërmbushura nga KRU Rezidencialë		
			Popullata e furnizuar	Konsumi (l/ditë/ind)	Total (Mm <sup>3</sup> /vit)	Total (Mm <sup>3</sup> /vit)	Popullata	Konsumi (l/ditë/ind)	Total (Mm <sup>3</sup> /vit)
Ibër	KRU Pristina	Prishtinë	195.246	92	6,58	18,43	12.462	92	0,42
		Podujevë	58.269	92	197		24.973	92	0,84
		Fushe Kosovë	36.723	92	1,24		1.136	92	0,04
		Obiliq/Kastriot	18.804	92	0,63		190	92	0,01
		Lipjan	31.403	92	1,06		25.693	92	0,87
		Shtime	25.564	92	0,86		1.924	92	0,06
		Glllogoc	26.646	92	0,90		33.192	92	1,14
		Gracanicë	10.317	92	0,35		1.680	92	0,06
	KRU Ujeshellesi Rajonal	Mitrovicë	62.996	194	4,47	0,19	5.478	194	0,39
		Vushtrri	48,686	194	3,46		16.229	194	1,15
		Skenderaj	19.260	194	1,37		32.793	194	2,33
	Sisteme të tjera publike të ujit	Mitrovicë e V.	12250	194	0,87	-	-	-	-
		Zubin Potok	6.584	194	0,47		-	-	-
Zveqan		7.360	194	0,52	-		-	-	
Leposaviq		13.576	194	0,96	-		-	-	

## 2.4.6 Furnizimi me ujë të pijshëm nga ujërat nëntokësore

Sipas të dhënave të përdorimit të ujërave nëntokësore, ekzistojnë dy tipe të ndryshme akuiferësh që përdoren për furnizimin me ujë të pijshëm. Aluvionet sasiore dhe akuiferët e karsteve shfrytëzohen pothuajse në mënyrë të barabartë, ndërsa për nga numri i resurseve, përdorimi i sedimenteve aluviale përfshinë një numër shumë më të madh. Ujërat nëntokësore në lokalitetet Podujevë, Kuzmin dhe Lipjan shfrytëzohen edhe për furnizim me ujë të pijshëm në Pellgun e Ibrit.

Një pjesë e fshatrave që nuk përfshihen në rrjetin publik për ofrimin e shërbimeve të ujit të pijshëm, furnizohen me ujë nga pusët e hapura dhe të shpuara, si dhe një pjesë e vogël e tyre nga burimet natyrore të ujit.

**Tabela 16: Furnizimi me ujë të pijshëm nga ujërat nëntokësore në Pellgun e Lumit Ibër<sup>28</sup>.**

Rajoni	Përdorimi i ujërave nëntokësore (milion m <sup>3</sup> / vit)				
	Akuiferët aluvialë	Akuiferët neogjenë	Akuiferët karstikë	Akuiferët e fragmentuar	Total
I Kosovës	185	60			245
I Mitrovicës	86		30		116

<sup>27</sup> EBRD, & WorldBank. (2012). Feasibility study for protection of Ibër-Lepenc canal Kosovo: Environmental and Social Impact Assessment Framework.

<sup>28</sup> Burimi: SAFEGE-EpTisa-Seureca-Beoinzenjering 2000-Safege Doo. MPS for Sewerage & Wastewater in the West Morava River Basin, R3: Environmental Impact Assessment, 2012)

## 2.4.7 Hidroenergija

Hidrocentralet (HEC) ndikojnë në masë të madhe në hidromorfologjinë dhe ekologjinë e lumenjve, duke përfshirë konektivitetin për migrimin e peshqve dhe transportin e sedimenteve. Është e kuptueshme që regjimi i rrjedhës së poshtme është tërësisht i ndërprerë (pa rrjedhje-M) nga operacionet e hidrocentraleve, qoftë në aspektin e sasisë së ujit të nxjerrur në raport me rrjedhën mesatare në pikën e nxjerrjes qoftë në aspektin e kohëzgjatjes së nxjerrjes së ujit nga rrjedha lumore. Kjo ndërprerje e regjimit të rrjedhës është efekt shtesë ndaj ndikimeve kryesore morfologjike (fizike) në lumë. Kjo është kryesisht për shkak se operatorët kanë objektiva ligjërisht të detyrueshme të pajtueshmërisë së prodhimit të energjisë ndaj Ministrisë së Ekonomisë dhe periudha e lejes për koncesion (fikse) zakonisht zgjat 20-30 vjet. Regjimet e rrjedhës mjedisore në rrjedhën e poshtme të instalimeve të HEC rrallë janë përcaktuar ose monitoruar.

Në Pellgun e Lumit Ibër ekzistojnë tri diga kryesore me qëllime hidroenergjetike<sup>29</sup>:

1. Diga e Ujmanit është një digë argjinatore e zonës me mbushje shkëmbore me një bërthamë qendrore. Ajo ka një lartësi prej 101 metrash dhe një gjatësi të kreshtës 519 metra. Kjo digë mban një vëllim prej 370 milionë m<sup>3</sup> ujë. Diga furnizon një hidrocentral i cili ndodhet në bazën e saj. Ka një kapacitet të instaluar prej 35 MW.
2. Batllava është gjithashtu një digë shkëmbore e zonuar me bërthamë qendrore argjilore. Lartësia e digës është 46 metra, dhe gjatësia e kreshtës së saj është 288 metra. Ka një kapacitet prej 40 milion m<sup>3</sup> ujë.
3. Diga e Badovcit është më e vogla nga të tria me kapacitet prej 32 milionë m<sup>3</sup> ujë. Është një digë shkëmbore e zonuar me lartësi 45 metra dhe gjatësi kreshtë 289 metra.

Pellgu i Lumit Ibër ka 8 hidrocentrale sipas raportit të ZRRE të vitit 2021 dhe regjistrin të lejeve të ARPL. Hidrocentralet aktuale në Pellgun e Ibrit janë dhënë në **Kapitullin 3**.

Sugjerohet një analizë e ndikimit të sedimentimit në funksionimin afatgjatë të infrastrukturës ujore si rezervuari i Ujmanit dhe nevoja për masa parandaluese.

## 2.4.8 Impiantet e trajtimit të ujërave të zeza (ITUZ)

Në Kosovë, KRU shërbejnë gjithashtu si ofrues të shërbimeve të menaxhimit të ujërave të zeza, duke përfshirë funksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të kanalizimit dhe trajtimit të ujërave të zeza. Mesatarisht, në Kosovë, KRU ofrojnë shërbime të grumbullimit të ujërave të zeza për 63% të popullsisë. Dy KRU janë pjesë e Pellgut të Lumit Ibër, KRU "Prishtina" dhe KRU "Mitrovica". KRU "Prishtina" ofron shërbime të kanalizimit për 78% të popullsisë, që në të njëjtën kohë është përqindja më e lartë e të gjitha KRU në Kosovë. KRU "Mitrovica" mbulon 60% të popullsisë me shërbime të kanalizimit. Brenda Pellgut të Lumit Ibër, 72% e popullsisë ka qasje në sistemin e kanalizimit<sup>30</sup>.

Për sa i përket trajtimit të ujërave të zeza, situata në pellg është e dobët. Kosova në përgjithësi ka mungesë të vazhdueshme të impianteve për trajtimin e ujërave të zeza. Aktualisht, në Pellgun e Ibrit ekzistojnë pesë impiante funksionale për trajtimin e ujërave të zeza. ITUZ në Skenderaj menaxhohet nga KRU "Mitrovica" me kapacitet mesatar vjetor prej 735,000 m<sup>3</sup>. KRU "Prishtina" menaxhon katër impiante të vogla për trajtimin e ujërave të zeza: ITUZ "Harilaq" i cili pas grumbullimit të ujërave të zeza nga KRU "Prishtina" i shkarkon ato në Lumin Drenica, ITUZ "Badovc" (ose Mramor) i cili shkarkon ujërat e zeza në Lumin Graçanka, ITUZ "Medvec-

<sup>29</sup> KEPA (2020). *The state of water in Kosovo*.

<sup>30</sup> IWRM-K. (2022). *Economic Assessment of Water Resources Management*.

Vrellë” që më tej shkarkon ujërat e zeza në Lumin Klina dhe ITUZ “Orllan” që shkarkon efluentin e saj në Lumin Sitnica.

Sasia e ujërave të zeza të grumbulluara të trajtuara është e vogël dhe pothuajse e papërfillshme. KRU “Mitrovica” ofron shërbime të trajtimit të ujërave të zeza vetëm për 14% të amvisërive, ndërsa KRU “Prishtina” ofron një sasi të vogël të trajtimit të ujërave të zeza (më pak se 1%) për rajonin e saj<sup>31</sup>.

Përveç kësaj, ekzistojnë edhe dy ITUZ të menaxhuara nga UNMIK, njëri në Komunën e Prishtinës dhe tjetri në Komunën e Mitrovicës. Të dy impiantet janë të lidhura me sistemet e ujërave të zeza pasi janë në zona urbane. Ujërat e zeza së pari trajtohen në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza përpara se të shkarkohen në sistemin lumor<sup>32</sup>.

ITUZ prezente në Pellgun e Lumit Ibër janë të listuara në **Kapitullin 3**.

---

<sup>31</sup> KEPA. (2020). Annual report on the state of the environment

<sup>32</sup> UNMIK. (2016). UNMIK Waste Management Plan.

## Kapitulli 3

### Qëllimet, Shtytësit dhe Presionet e Pellgut Lumor

#### 3.1 Qëllimet e përgjithshme dhe Çështjet e Rëndësishme të Menaxhimit të Ujit në Pellgun e Lumit Ibër

##### 3.1.1 Qëllimet e përgjithshme për pellgun e Lumit Ibër

Përcaktimi i qëllimeve dhe objektivave për arritjet afatmesme dhe/ose afatgjata në një pellg lumor është një hap vendimtar në kuadër të procesit të planifikimit të menaxhimit të pellgut lumor (MPL). Qëllimet e dakorduara i orientojnë vazhdimisht të gjitha autoritetet përgjegjëse të përfshira të ujit dhe palët përkatëse të interesit drejt qëllimeve qartë të përcaktuara. Qëllimet e përgjithshme të pellgut lumor janë qëllimet e konsoliduara, të cilat janë rënë dakord të arrihen në pellgun lumor, në përputhje me afatin kohor të Ciklit të Menaxhimit të Pellgut Lumor. Qëllimet e përgjithshme të pellgjeve lumore janë baza e të gjitha vlerësimeve në këtë Plan të Menaxhimit të Pellgut Lumor. Njësoj janë edhe veprimet në Programin e Masave (PM) që synojnë arritjen e qëllimeve.

##### **Qëllimet e përgjithshme për Pellgun Lumor**

Të sigurohet menaxhim i qëndrueshëm i resurseve ujore në Pellgun Lumor duke mundësuar mbrojtjen e mjedisit ujor, zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik dhe sigurinë e furnizimit me ujë nëpërmjet masave të duhura. Në mënyrë të detajuar, synohet:

- sigurimi i cilësisë së mirë të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nëpërmjet reduktimit të ndotjes dhe të gjitha presioneve tjera përkatëse.
- sigurimi i sasisë së mirë/mjaftueshme të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nëpërmjet përdorimit efikas të ujit dhe të gjitha masave tjera të nevojshme.

##### 3.1.2 Çështjet e Rëndësishme të Menaxhimit të Ujit, vizioni dhe objektivat menaxhuese për Pellgun e Lumit Ibër

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) dhe Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore (ARPL) u pajtuan për 6 Çështje specifike të Rëndësishme të Menaxhimit të Ujit (ÇRMU) që janë të një rëndësie të konsiderueshme për Pellgun e Lumit Ibër:

1. **ÇRMU 1:** Ndotja nga Vendbanimet Urbane dhe Industrinë (burimet e palëvizshme);
2. **ÇRMU 2:** Ndotja nga burime të lëvizshme nga bujqësia dhe burime tjera (ndotja nga burime difuzive);
3. **ÇRMU 3:** Presionet në Sasinë e Ujërave Sipërfaqësore;
4. **ÇRMU 4:** Presionet në Hidro-Morfologjinë e Ujërave Sipërfaqësore;
5. **ÇRMU 5:** Presione tjera në Ujërat Sipërfaqësore (peshkimi);
6. **ÇRMU 6:** Presionet në Sasinë dhe Cilësinë e Ujërave Nëntokësore.

6 ÇRMU rezultojnë kryesisht nga veprimet njerëzore dhe veprimet e ndërlidhura me ujin. Ato pasqyrojnë sfidat kryesore në Pellgun e Lumit Ibër, të cilat mund të ndikojnë në cilësinë dhe/ose sasinë e ujit, duke e bërë të nevojshëm kështu një menaxhim efektiv. Për të përcaktuar qëllimet dhe hapat menaxherialë për secilën ÇRMU, si dhe për të mundësuar një vlerësim specifik në Planin e Menaxhimit të Pellgut të Lumit Ibër, vizionet dhe objektivat e menaxhimit

janë dakorduar për secilën ÇRMU. Parimet themelore të tyre mund të përshkruhen si më poshtë:

- Vizionet e ÇRMU pasqyrojnë vlera të përbashkëta në lidhje me ÇRMU të identifikuara së bashku, të cilat ndahen pastaj nga MMPHI/ARPL dhe Platforma e Pellgut të Lumit Ibër me të gjithë akterët e përfshirë. Vizionet për 6 ÇRMU përshkruajnë objektivat kryesore për Pellgun e Lumit Ibër me një perspektivë afatgjatë (20+ vjet).
- Objektivat e menaxhimit të ÇRMU bazohen në vizionet dhe përshkruajnë hapat konkretë të zbatimit drejt qëllimeve të përgjithshme të dakorduara të Pellgut të Lumit Ibër. Objektivat e menaxhimit e mbështesin rrugën drejt qëllimeve të përbashkëta dhe të përgjithshme në Pellgun e Lumit Ibër. Ato mundësojnë mbledhjen specifike të të dhënave dhe Analizën e Presionit/Ndikimit. Objektivat e menaxhimit e ndjekin afatin kohor të Ciklit të Menaxhimit të Pellgut Lumor në lidhje me arritjet dhe janë të natyrës cilësore dhe/ose sasiore, si dhe të matshme. Ato synohet të arrihen përmes masave për të reduktuar ose eliminuar presionet.

Paragrafët e mëposhtëm përmbajnë një përshkrim të problemit për secilën ÇRMU, duke përshkruar gjithashtu shtytësit dhe presionet që rezultojnë negativisht në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore në Pellgun e Lumit Ibër. Bazuar në këtë, **vizioni** dhe **objektivat e menaxhimit** përshkruhen për çdo ÇRMU.

Është zhvilluar një *Regjistër i Shtytësve dhe Presioneve* për të gjithë pellgun që përmban të gjitha të dhënat e disponueshme për të kuantifikuar presionet sa më shumë që të jetë e mundur. Në Regjistër përmenden referencat për burimet origjinale të të dhënave dhe ato gjithashtu përfshihen në **Kapitullin 11**. Në tabelat në paragrafin e mëposhtëm është identifikuar mungesa e të dhënave ose prania e kufizuar e tyre. Në raundin tjetër të përmirësimit të Planit të Menaxhimit të Pellgut Lumor, theksi do të jetë në plotësimin e Regjistrit të Shtytësve dhe Presioneve.

## 3.2 ÇRMU 1: Ndotja nga Vendbanimet Urbane dhe Industrinë (burimet e palëvizshme)

### 3.2.1 Përshkrimi i problemit

Ndotja nga burimet e palëvizshme shkaktohet kryesisht nga shkarkimi i ujërave të zeza pjesërisht të trajtuara ose të patrajtuara nga vendbanimet urbane, industria dhe bujqësia. Shumica e vendbanimeve urbane në Pellgun e Lumit Ibër nuk kanë trajtim të mjaftueshëm të ujërave të zeza dhe për këtë arsye janë kontribuesit kryesorë të ndotjes organike dhe nutritive. Shkarkimet direkte dhe indirekte të ujërave të zeza industriale janë gjithashtu të rëndësishme. Në kuadër të legjislacionit të BE, impiantet e mëdha industriale rregullohen sipas Direktivës së Emetimeve Industriale (2010/75/BE). Kjo Direktivë kërkon që këto impiante të përdorin teknologjinë më të mirë të disponueshme gjatë funksionimit të tyre, duke përfshirë konsumin e ujit, si dhe prodhimin dhe trajtimin e ujërave të zeza. Megjithatë, shumë shpesh ujërat e zeza industriale trajtohen në mënyrë të pamjaftueshme ose nuk trajtohen fare përpara se të shkarkohen në ujërat sipërfaqësore (emetim direkt) ose në sistemet e kanalizimeve publike (emetim indirekt). Shkarkimet e pakontrolluara industriale në rrjetet komunale përbëjnë një sfidë shtesë për Impiantet e Trajtimit të Ujërave të Zeza (ITUZ). Ndotja nga burimet e palëvizshme të kategorive si: aktivitetet industriale, deponitë (legale si dhe ato ilegale) të mbeturinave, aktivitetet e minierave dhe guroreve, si dhe akuakultura janë presione të mëdha si në ujërat sipërfaqësore ashtu edhe ato nëntokësore.

Ndotja organike mund të shkaktojë ndryshime të rëndësishme në ekuilibrin e oksigjenit të ujërave sipërfaqësore. Prandaj, mund të ndikojë në përbërjen e specieve/popullatave ujore

dhe rrjedhimisht në statusin e ujit. Emetimet organike dhe ndikimi i tyre mund të maten dhe shprehen me parametra si SHKO (shpenzimi kimik i oksigjenit), SHBO (shpenzimi biologjik i oksigjenit) dhe KTO (karboni total organik). Ndotja nga lëndët ushqyese nga burimet e palëvizshme, veçanërisht azoti dhe/ose fosfori, mund të kontribuojë në eutrofikimin e ujërave. Eutrofikimi është rritja e tepërt e algave, dhe kjo dukuri mund të ndikojë ndjeshëm në cilësinë e ujit. Substancat e rrezikshme nga aktivitetet industriale dhe ekonomike paraqesin rreziqe shtesë si eutrofikimi dhe lulëzimi i algave, shoku biologjik ose akumulimi i metaleve të rënda në sediment.

Si përmbledhje, mungesa e trajtimit adekuat të ujërave të zeza nga amvisëritë dhe industria rrezikon shëndetin e popullatës dhe e vë në pikëpyetje përshtatshmërinë e ujërave për pije, larje, peshkim dhe aktivitete tjera njerëzore. Burimet e palëvizshme të ndotjes nga aktivitetet industriale, deponitë (legale si dhe ato ilegale) të mbeturinave, aktivitetet minerare dhe guroret, si dhe fermat e peshkut shkaktojnë kërcënime direkte dhe indirekte si për ujërat sipërfaqësore ashtu edhe ato nëntokësore. Shkarkimet e ndotura e dëmtojnë cilësinë e ekosistemeve ujore.

### 3.2.2 Shtytës të rëndësishëm dhe presione të lidhura me ndotjen nga burimet e palëvizshme

Tabela 17: Shtytës të rëndësishëm dhe presione të lidhura me ndotjen nga burime të palëvizshme.

Presionet	Shtytësit kryesorë	Përshkrimi
<b>Presionet e palëvizshme cilësore</b>		
1.1 Burimi i palëvizshëm – Ujërat e Zeza Urbane	Zhvillimi urban	Përfshin shkarkimet nga zonat tregtare jo-prodhuese të cilat mund të përzihen kryesisht me ujërat e zeza urbane. Përfshin shkarkimet e ujërave të zeza urbane të papërpunuara ose të trajtuara pjesërisht të cilat identifikohen si burime të palëvizshme.
1.2 Burimi i palëvizshëm - Përmbytjet e stuhisë	Zhvillimi urban	Përmbytje nga kanalizime të ndara ose të kombinuara, të identifikuar si burime të palëvizshme (për ato difuzive shih 'Difuzive - Rrjedhje urbane' më poshtë).
1.3 Burimi i palëvizshëm - Impiante DEI (në pajtim me Direktivën e Emisioneve Industriale)	Industria	Burime të palëvizshme industriale nga impiantet e përfshira në RELTN (Regjistri Evropian i Lirimit dhe Transferit të Ndotësve)
1.4 Burimi i palëvizshëm - Impiante jo DEI	Industria	Çdo burim i palëvizshëm industrial që nuk përfshihet në RELTN
1.5 Burimi i palëvizshëm - Lokacione të Kontaminuara/Lokacione industriale të braktisura	Industria	Ndotja që rezulton nga një zonë industriale e braktisur, ose një zonë e kontaminuar për shkak të aktiviteteve industriale të së kaluarës, hedhjes së paligjshme të mbetjeve industriale ose një aksidenti ndotjeje dhe që identifikohet si burim i palëvizshëm (për ato difuzive, shih më poshtë 'Difuzive – Lokacione të kontaminuara/Lokacione industriale të braktisura'). Kjo kategori nuk mbulon aktivitetet industriale ekzistuese.
1.6 Burimi i palëvizshëm - Vendet e deponimit të mbeturinave	Zhvillimi urban	Burimet e palëvizshme për shkak të lokacioneve të deponimit të mbetjeve urbane ose industriale.
1.7 Burimi i palëvizshëm - Ujërat e minierës	Industria	Burimet e palëvizshme për shkak të grumbullimit dhe pompimit të ujit në një gropë të hapur ose minierë nëntokësore. Nuk përfshin ujërat e zeza nga proceset industriale.
1.8 Burimi i palëvizshëm – Akuakultura	Akuakultura	Shihni gjithashtu ÇRMU 5.


Ndotja nga burime të palëvizshme që vjen nga vendbanimet dhe industrinë në fund të fundit nxitet nga rritja e përgjithshme e popullsisë së bashku me proceset e urbanizimit dhe industrializimit. Për më tepër, kjo ndihmohet edhe nga shpërndarja e popullsisë rurale, për

arsye se trajtimi konvencional i ujërave të zeza është i shtrenjtë, si në aspektin e investimeve ashtu edhe në aspektin e mirëmbajtjes. Së fundi, zhvillimi ekonomik në kombinim me ndikimin e ndryshimeve klimatike do të shkaktojë një rritje të furnizimit me ujë dhe rrjedhimisht edhe të prodhimit të ujërave të zeza.

Tabelat në vijim përmbledhin shtytësit kryesorë të rëndësishëm dhe presionet e lidhura me ndotjen nga burimet e palëvizshme në Pellgun e Lumit Ibër (më shumë detaje dhe informacion bazë mund të gjenden në **Shtojcën 3**).

Në raportin Kadastr i Ndotjes së Ujërave (AMMK, 2012), është identifikuar një numër i përgjithshëm prej 126 lokacionesh ku ujërat e zeza derdhen në sistemin ujqor në Pellgun e Lumit Ibër (presionet 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4, në Tabela 17). Koordinatat e secilës pikë shkarkimi janë nxjerrë nga një hartë prej raportit të AMMK (shih gjithashtu Harta 20). Një presion i rëndësishëm lidhet me shkarkimin e ujërave të ndotura urbane dhe industriale, të renditura në Tabela 19 që bazohet në lejet ekzistuese (qoftë leje ujore ose mjedisore). Disa lokacione të shkarkimit kanë ITUZ të vogla të cilat trajtojnë sasi të vogla uji në krahasim me shkarkimin e përgjithshëm të ujërave të zeza.

Harta 20: Pikat e shkarkimit të ujërave të zeza në Pellgun e Lumit Ibër.



Aktualisht, në Pellgun e Ibrit ekzistojnë pesë impiante funksionale për trajtimin e ujërave të zeza. ITUZ në Skenderaj menaxhohet nga KRU “Mitrovica” me kapacitet mesatar vjetor prej 735,000 m<sup>3</sup> dhe është projektuar për 10,000 banorë. KRU “Prishtina” menaxhon katër impiante të vogla për trajtimin e ujërave të zeza: ITUZ “Harilaq” i cili pas grumbullimit të ujërave të zeza nga KRU “Prishtina” i shkarkon në Lumin Drenicë, ITUZ “Badovc” (ose Mramor) i cili shkarkon ujërat e zeza në Lumin Graçankë, ITUZ “Medvec-Vrellë” që më tej shkarkon ujërat e zeza në Lumin Klina dhe ITUZ “Orllan” që e shkarkon efluentin e saj në Lumin Sitnicë.

Megjithatë, duke krahasuar numrin e banorëve që kanë çasje në sistemet e kanalizimeve me kapacitetet e këtyre impianteve të trajtimit të ujërave të zeza, mund të konkludojmë se sasia e ujërave të ndotura të trajtuara është e vogël dhe pothuajse e papërfillshme. KRU “Mitrovica” ofron shërbime të trajtimit të ujërave të zeza vetëm për 14% të amvisërive, ndërsa KRU “Prishtina” ofron një sasi të vogël të trajtimit të ujërave të zeza (më pak se 1%) për rajonin e saj.

Krahas ITUZ të përmendura, ekzistojnë edhe dy ITUZ të menaxhuara nga UNMIK; njëra në Komunën e Prishtinës dhe tjetra në Komunën e Mitrovicës. Të dy impiantet janë të lidhura me sistemet e ujërave të zeza pasi janë në zona urbane. Ujërat e zeza së pari trajtohen në impiantet e ujërave të zeza përpara se të shkarkohen në sistemet e tyre përkatëse të ujërave të zeza.

Një kuantifikim fillestar i ngarkesës nga burimet e palëvizshme është bërë në Studimin e Modelimit të Cilësisë së Ujërave Sipërfaqësore në kuadër të Studimit të Bilancit të Ujit. Ngarkesa totale nga amvisëritë dhe industritë është vlerësuar për çdo trup uhor sipërfaqësor. Figura 1 paraqet ngarkesat për SHBO. Aty paraqiten ngarkesat në pikën kryesore të shkarkimit, duke përfshirë ngarkesat e grumbulluara nga trupat uhorë në rrjedhën e epërme.




Figura 1: Ngarkesa e vlerësuar për cSHBO nga amvisëritë dhe industritë.

**Tabela 18: Kuantifikimi i burimeve të palëvizshme për Pellgun e Ibrit.**

<b>Ngarkesa totale në ton/vit</b>		
	<b>Amvisëritë</b>	<b>Industria</b>
cSHBO	13,200	140
Total N	2,901	53
Total P	371	7

**Tabela 19: Regjistri i shtytësve dhe presioneve: shkarkimi i ujërave të zeza urbane dhe industriale në Pellgun e Ibrit.**

No.	Agjencia/Operatori	Komuna/Rajoni	Lloji i lejes	Lumi në kuadër të Pellgut të Ibrit	Burimi	Komente
1	Beton-plus Sh.p.k	Fushë Kosovë	Leje Ujore/ 4210-2/20	Sitnica	MMPHI/ARPL	Shkarkim i ujërave industriale/Fabrikë e përpunimit të çimentos
2	Burimi Sh.p.k	Obiliq	Leje Ujore/5563-2/20	Sitnica	MMPHI/ARPL	Shkarkim i ujërave industriale/Fabrikë e përpunimit të çimentos
3	Burimi Sh.p.k	Mitrovicë	Leje Ujore/ 5566-2/20	Sitnica	MMPHI/ARPL	Shkarkim i ujërave industriale/Fabrikë e përpunimit të çimentos
4	Tehno Burimi d.d.sh.a	Mitrovicë	Leje Ujore/5564-2/20	Sitnica	MMPHI/ARPL	Shkarkim i ujërave industriale/Fabrikë e përpunimit të çimentos
5	Renelual Tahiri Sh.p.k	Graçanicë	Leje Ujore/ 5729-2/20	Sitnica	MMPHI/ARPL	Shkarkim i ujërave industriale/Fabrikë e përpunimit të çimentos
6	N.T.P Iliria	Mitrovicë	Leje Ujore/ 4474/20	Sitnica	MMPHI/ARPL	Shkarkim i ujërave industriale/Fabrikë e përpunimit të çimentos dhe Shkarkim i Ujërave të Zeza nga rezervuari septik (X-7489999; Y-4748607)
7	TT Kosova A	Prishtinë	Leje e integruar mjedisore	Sitnica	MMPHI	Shkarkim i ujërave industriale/Termocentral me Thëngjill
8	TT Kosova B	Prishtinë	Leje e integruar mjedisore	Sitnica	MMPHI	Shkarkim i ujërave industriale
9	ITUZ Harilaq	Fushë Kosovë	Leje Ujore	Drenica	ARPL	ITUZ
10	ITUZ Mramor	Prishtinë	Leje Ujore	Graçanka	ARPL	ITUZ
11	ITUZ Skenderaj	Skenderaj	Leje Ujore	Klina	ARPL	ITUZ
12	ITUZ Medvec-Vrelle	Lipjan	Leje Ujore	Sitnica	KRU Prishtina	ITUZ
13	ITUZ Orllan	Podujevë	Leje Ujore	Bervenica	KRU Prishtina	ITUZ
14	UNMIK MHQ Prishtina	Prishtinë	Desk Study	Sitnica	KRU Prishtina	ITUZ
15	UNMIK RHQ Mitrovica	Mitrovicë	Desk Study	Sitnica	KRU Prishtina	ITUZ

Ndotja nga burime të palëvizshme në Pellgun e Ibrit nga aktivitetet industriale, deponitë e mbeturinave, aktivitetet e minierave dhe gurorëve dhe akuakultura paraqitet në tabelat e mëposhtme

**Tabela 20: Regjistri i shtytësve dhe presioneve: aktivitetet industriale në Pellgun e Lumit Ibër.**

No.	Lloji i aktivitetit	Komuna/Rajoni	Lloji i lejes
1	Fabrika e riciklimit të vajit të përdorur-Industria Energjetike	Vushtrri	Leje e integruar mjedisore (B)
2	Prodhimi i ngjyrave dhe llaqeve - Industri Kimike	Fushë Kosovë	Leje e integruar mjedisore (B)
3	Prodhimi i ngjyrave dhe llaqeve - Industri Kimike	Prishtinë	Leje e integruar mjedisore (B)
4	Kompania e prodhimit të letrës	Lipjan	Nuk ka të dhëna për llojin e lejeve mjedisore
5	Prodhimi i metalit	Lipjan	Leje mjedisore MMPHI
6	Prodhimi i tekstilit	Fushë Kosovë	Leje mjedisore MMPHI
7	Prodhimi i qumështit	Fushë Kosovë	Leje mjedisore MMPHI
8	Fabrika e llamarinës	Vushtri	Nuk ka të dhëna për llojin e lejes mjedisore
9	Prodhimi i tekstilit	Prishtinë	Nuk ka të dhëna për llojin e lejes mjedisore
10	Industri kimike - Ngjyra	Vushtrri	Leje e integruar mjedisore (B)
11	Ferronikeli - Industri Minerale	Drenas	Leje e integruar mjedisore (B)
12	Prodhimi i materialeve të ndërtimit-Industri Minerale	Lipjan	Leje mjedisore
13	Prodhimi i tullave	Podujevë	Leje e integruar mjedisore (B)
14	Fabrika e riciklimit të vajit të përdorur	Mitrovicë	Leje mjedisore MMPHI
15	Prodhimi i tullave	Prishtinë	Leje mjedisore MMPHI
16	Prodhimi i ngjyrës	Prishtinë	Leje mjedisore MMPHI
17	Kompani ndërtimi	Ferizaj	Pëlqim mjedisor MMPHI
18	Prodhimi i betonit	Fushë Kosovë	Nuk ka të dhëna për llojin e lejes mjedisore
19	Kompani ndërtimi	Ferizaj	Leje mjedisore MMPHI
20	Fabrika e prodhimit/tharjes së thëngjillit	Prishtinë	Nuk ka të dhëna për llojin e lejes mjedisore
21	Prodhimi i aluminit	Ferizaj	Nuk ka të dhëna për llojin e lejes mjedisore
22	Prodhimi i energjisë elektrike (thëngjilli)	Prishtinë	Leje e integruar mjedisore (B)
23	Prodhimi i energjisë elektrike (thëngjilli)	Prishtinë	Leje e integruar mjedisore (B)
24	Prodhimi i mishit	Fushë Kosovë	Nuk ka të dhëna për llojin e lejes mjedisore
25	Ngrohtorja qendrore Termokos	Prishtinë	Nuk ka të dhëna për llojin e lejes mjedisore
26	Impianti i gazifikimit dhe plehrave azotike	Prishtinë	Joaktiv
27	Fabrika e Bllokave	Lipjan	Leje mjedisore MMPHI
28	Thertore dhe prodhim i mishit	Leshak	Nuk ka të dhëna për llojin e lejes mjedisore
29	Thertore	Mitrovicë	Nuk ka të dhëna për llojin e lejes mjedisore
30	Thertore dhe përpunim i mishit	Gllamnik	Nuk ka të dhëna për llojin e lejes mjedisore
31	Thertore	Lushtë	Nuk ka të dhëna për llojin e lejes mjedisore
32	Thertore	Banullë	Nuk ka të dhëna për llojin e lejes mjedisore
33	Thertore	Banullë	Nuk ka të dhëna për llojin e lejes mjedisore
34	Thertore	Sallabajë	Nuk ka të dhëna për llojin e lejes mjedisore
35	Thertore dhe përpunim i mishit	Llapashticë	Nuk ka të dhëna për llojin e lejes mjedisore
36	Thertore e pulave	Zhitkoc	Nuk ka të dhëna për llojin e lejes mjedisore

**Tabela 21: Regjistri i shtytësve dhe presioneve: Deponitë e mbeturinave në Pellgun e Lumit Ibër.**

No.	Instalacioni/Operatori	Lloji i aktivitetit	Lumi në kuadër të Pellgut të Ibrit	Komuna/Rajoni	Lloji i lejes	Sasia	Burimi
1	Deponia e skorjeve	Deponia (mbeturinat e ngurta urbane)	Drenica	Prishtina	Leje Mjedisore MMPHI	Nuk ka të dhëna	UNDP 2010
2	Deponia e hirit TEC A (e vjetër)	Nxjerrja e linjtit - hi	Sitnica	Prishtina	Leje Mjedisore MMPHI	43 milionë tonë	MMPHI
3	Deponia e hirit TEC B (e vjetër)	Nxjerrja e linjtit - hi	Sitnica	Prishtina	Leje Mjedisore MMPHI	20 milionë tonë	MMPHI
4	Deponia e linjtit TEC B	Minierat e linjtit	Sitnica	Prishtina	Leje Mjedisore MMPHI	Nuk ka të dhëna	MMPHI
5	Deponia e linjtit TEC A	Minierat e linjtit	Sitnica	Prishtina	Leje Mjedisore MMPHI	Nuk ka të dhëna	MMPHI
6	Deponia Komunale e Prishtinës	Deponia e mbetjeve të ngurta	Sitnica	Prishtina	Leje Mjedisore MMPHI	Nuk ka të dhëna	MMPHI
7	Deponia e hirit Mirash	Nxjerrja e linjtit - hi	Sitnica	Prishtina	Nuk ka të dhëna për llojin e lejes mjedisore	Nuk ka të dhëna	MMPHI
	Deponia e sanitare Mirash	Deponia e mbetjeve komunale	Sitnica	Prihtiina	Leje Mjedisore MMPHI	193,698.74 tonë (ne vitin 2024)	MMPHI
8	Deponia e mbetjeve të minierave	Deponia e mbetjeve të ngurta	Graçanka	Prishtina	Nuk ka të dhëna për llojin e lejes mjedisore	Nuk ka të dhëna	MMPHI
9	Deponia sanitare komunale në Podujevë	Deponia e mbetjeve komunale	Lumi i Dumnicës	Podujeva	Leje Mjedisore MMPHI	Nuk ka të dhëna	MMPHI
10	Deponia sanitare komunale në Mitrovicë	Deponia e mbetjeve komunale	Ibër	Mitrovica	Leje Mjedisore MMPHI	Nuk ka të dhëna	MMPHI

**Tabela 22: Regjistri i shtytësve dhe presioneve: Aktivitetet e minierave dhe guroveve në Pellgun e Lumit Ibër.**

No.	Instalacioni/Operatori	Lloji i aktivitetit	Lumi në kuadër të Pellgut të Ibrit	Komuna/Rajoni	Burimi
1	Minierat e magnezit "Golesh"	Minierë e magnezit	Lumi i Magurës	Lipjan	Raporti i Sigurisë së Ujit për Kosovën Qendrore
2	"Trepça - Ndërmarrja në Administrim të AKP"	Minierë	Sitnica/Ibri	Mitrovicë	Raporti i Sigurisë së Ujit për Kosovën Qendrore
3	Minierat e Linjtit-KEK	Minierë	Drenica	Obiliq	MMPHI
4	Miniera e Trepçës Stan Terg + Flotacioni (Tuneli i Parë)	Minierë	Lumi i Barës	Mitrovicë	KPMM (Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale)
5	Minierat e Kishnicës dhe Badovcit	Minierë	Graçanka	Graçanicë	KPMM (Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale)
6	Minierat e Hajvalisë	Minierë	Graçanka	Graçanicë	KPMM (Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale)

No.	Instalacioni/Operatori	Lloji i aktivitetit	Lumi në kuadër të Pellgut të Ibrit	Komuna/Rajoni	Burimi
7	Miniera e Belobërdit	Minierë	Drenas	Leposaviq	KPMM (Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale)
8	Flotacioni Leposaviq	Minierë	Ibri	Leposaviq	KPMM (Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale)
9	Miniera e Cërnacit	Minierë	Lumi i Kuq	Leposaviq	KPMM (Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale)
10	Miniera "Çuka e Batllavës".	Minierë	Batllava	Podujevë	KPMM (Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale)
11	Flotacioni i Kishnicës	Minierë	Graçanka	Graçanicë	KPMM (Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale)
12	Nxjerrja e rërës	Nxjerrje e rërës dhe zhavorrit	Ibri	Leposaviq	Plani Lokal i Veprimit Leposaviq
13	Nxjerrja e rërës	Nxjerrje e rërës dhe zhavorrit	Ibri	Leposaviq	Plani Lokal i Veprimit Leposaviq

**Tabela 23: Deponite ilegale prane lumenjeve te Pellgut Ibër.**

Nr.	Madhesia	Lloji	Latitude	Longitude	Komuna	Lumi
1	E mesme	A	42.600091	21.079581	Fushe Kosove	Graçanka
2	E madhe	N	42.598341	21.09883	Fushe Kosove	Graçanka
3	E vogël	N	42.6466676	20.9174347	Gillogoc	Drenica
4	E madhe	N	42.608791	21.21875	Gracanica	Graçanka
5	E vogël	A	43.129378	20.771206	Leposaviç	Ibër
6	E vogël	A	43.129266	20.775948	Leposaviç	Ibër
7	E vogël	N	43.164082	20.740995	Leposaviç	Ibër
8	E vogël	A N	43.159485	20.741009	Leposaviç	Ibër
9	E vogël	A N	43.141017	20.758317	Leposaviç	Ibër
10	E vogël	A	43.050245	20.804401	Leposaviç	Ibër
11	E vogël	A	43.0283624	20.8163915	Leposaviç	Ibër
12	E vogël	A	43.0435256	20.8008072	Leposaviç	Lumi i Kuq
13	E vogël	A	43.0516761	20.803588	Leposaviç	Ibër
14	E mesme	A	43.061764	20.806245	Leposaviç	Ibër
15	E mesme	A N	43.139563	20.757777	Leposaviç	Ibër
16	E mesme	A N	43.138411	20.753584	Leposaviç	Ibër
17	E mesme	A N	43.158545	20.747699	Leposaviç	Ibër
18	E mesme	A	43.0177608	20.8281654	Leposaviç	Ibër
19	E madhe	N	43.083985	20.805478	Leposaviç	Joshanicë
20	E madhe	N V	43.08575	20.806924	Leposaviç	Ibër

21	E madhe	N	43.129712	20.770798	Leposaviç	Ibër
22	E madhe	A	43.138199	20.751973	Leposaviç	Ibër
23	E madhe	A V	43.1328481	20.770118	Leposaviç	Thanës
24	E mesme	N	42.498207	21.157225	Lipjan	Badovc
25	E madhe	N	42.470099	21.151029	Lipjan	Gadimes
26	E madhe	A N	42.465163	21.143364	Lipjan	Nerodime
27	E madhe	A N R	42.507357	21.118888	Lipjan	Sitnica
28	E madhe	A N R V	42.48484	21.121199	Lipjan	Sitnica
29	E madhe	A N	42.5264064	21.0943791	Lipjan	Sitnica
30	E madhe	A N V	42.5341865	21.090422	Lipjan	Sitnica
31	E madhe	A N	42.535012	21.032055	Lipjan	Vershec
32	E madhe	N	42.5472804	21.0449271	Lipjan	Vershec
33	E mesme	A	42.886388	20.856935	Mitrovice e Jugut	Ibër
34	E mesme	N	42.870564	20.832627	Mitrovice e Jugut	Ibër
35	E mesme	N	42.8778267	20.8746076	Mitrovice e Jugut	Sitnica
36	E madhe	N	42.894252	20.883117	Mitrovice e Jugut	Sitnica
37	E madhe	N	42.903828	20.871171	Mitrovice e Jugut	Ibër
38	E madhe	N	42.9003319	20.8797544	Mitrovice e Jugut	Sitnica
39	E vogël	A	42.889147	20.857716	Mitrovica e Veriut	Ibër
40	E vogël	A	42.8924921	20.8696263	Mitrovica e Veriut	Ibër
41	E vogël	N	42.725912	21.074247	Obiliq	Llap
42	E madhe	N	42.730395	21.0908247	Obiliq	Llap
43	E madhe	A N	42.449234	20.956089	Shtime	Cernaleva
44	E madhe	A N	42.454855	21.1161655	Shtime	Shtime
45	E mesme	N	42.729911	21.01386	Vushtrri	Sitnica
46	E mesme	A N	42.7825676	20.9908511	Vushtrri	Sitnica
47	E vogël	A	42.903338	20.753929	Zubin Potok	Ibër
48	E vogël	A	42.904653	20.760185	Zubin Potok	Ibër
49	E mesme	A N V	42.910834	20.709055	Zubin Potok	Ibër
50	E mesme	A N	42.9279807	20.6831465	Zubin Potok	Ibër
51	E mesme	A N	42.937828	20.672816	Zubin Potok	Ibër
52	E madhe	A N V	42.909747	20.717668	Zubin Potok	Ibër
53	E mesme	N	42.970502	20.8115709	Zvecan	Banjës
54	E madhe	A N V	42.919092	20.835598	Zvecan	Ibër
55	E madhe	A N	42.971548	20.811793	Zvecan	Ibër
56	E madhe	A N V	42.918139	20.83396	Zvecan	Ibër
57	E madhe	A N	42.926968	20.827554	Zvecan	Ibër

### **Në mënyrë të përmbledhur, presionet që kanë të bëjnë me resurset ujore janë:**

- Shtytësit dhe presionet e sipërpërmendura janë shkarkimet e ujërave të zeza komunale, bujqësore dhe industriale pjesërisht të trajtuara ose të patrajtuara si dhe shkarkimet nga burime tjera të palëvizshme.
- Përveç ndotjes nga burime të palëvizshme, ndotja nga burime të lëvizshme kontribuon gjithashtu në mënyrë të rëndësishme në resurset ujore në Pellgun e Lumit Ibër. Ndotja nga burime të lëvizshme e ka origjinën nga bujqësia, blegtoria dhe popullsia e shpërndarë rurale, duke përfshirë nutrientët dhe substancat tjera të rrezikshme si p.sh. pesticidet. Kështu, vlerësimi i rrezikut është i lidhur ngushtë me ÇRMU 2 (Ndotja nga burime të lëvizshme prej bujqësisë dhe burimeve tjera). Kjo lidhje siguron një qasje gjithëpërfshirëse dhe kuptimin e kontributeve të ndotjes, qoftë nga burimet e palëvizshme apo ato të lëvizshme.
- Përqendrimet e vëzhguara të ndotësve janë rezultat i ngarkesave me ndotës si dhe modelimit dhe matjes së rrjedhave të ujit. Prandaj, është i nevojshëm adresimi i këtij aspekti dhe lidhja e tij me ÇRMU 3 (Presionet në sasinë e ujit sipërfaqësor).
- Gjithashtu, duhet të merret parasysh kontributi i ndotjes urbane dhe industriale në përkeqësimin e gjendjes së ujërave nëntokësore (ÇRMU 6, Presionet mbi sasinë dhe cilësinë e ujërave nëntokësore).

### **3.2.3 Vizioni dhe objektivat e menaxhimit për ÇRMU 1**

#### **Vizioni**

Vizioni për ndotjen nga burimet urbane dhe industriale është: (i) një shkarkim afër zeros i ujërave të zeza të patrajtuara (urbane dhe industriale) në ujërat sipërfaqësore të pellgut, me përdorim të teknologjive me kosto efektive dhe ripërdorim të ujërave të zeza të trajtuara; (ii) parandalimi i ndotjes në pellg nga burime tjera të lokalizuara të palëvizshme; dhe (iii) menaxhimi i qëndrueshëm i mbetjeve të ngurta brenda pellgut (grumbullimi, trajtimi, përpunimi dhe ripërdorimi).

#### **Objektivat e menaxhimit**

- Zhvillimi dhe zbatimi i politikave përkatëse shtetërore, duke përfshirë implementimin dhe monitorimin e ndikimit;
- Identifikimi dhe përditësimi i pikave të nxehta (hotspoteve) (Raporti i AMMK, 2011) të ndotjes nga vendbanimet, industria dhe deponitë e mbetjeve në pellg për të kuptuar nevojën për veprime, masa dhe investime të qëllimshme;
- Sigurimi i lidhjes së plotë të amvisërive me sistemet e kanalizimeve që çojnë në Impiantet e Trajtimit të Ujërave të Zeza (ITUZ). Inspektimi i rregullt dhe nëse është i nevojshëm rinovimi i sistemeve ekzistuese të kanalizimeve për të minimizuar rrjedhjet dhe shkarkimin e ndotësve në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore;
- Implementimi ose përmirësimi i impianteve adekuate të trajtimit të ujërave të zeza në qytete dhe qyteza dhe zgjidhje të decentralizuara me kosto efektive për vendbanimet rurale, duke siguruar kështu largimin e lëndëve nutritive dhe kimike nga ujërat e zeza komunale;
- Ofrimi i mbështetjes për industrinë në zbatimin e masave për reduktimin e konsumit të ujit;

- Implementimi i trajtimit adekuat të ujërave të ndotura industriale përmes ITUZ specifike ose të zakonshme;
- Implementimi i teknologjive për ripërdorimin e ujërave të zeza të trajtuara duke ndjekur udhëzimet e rekomanduara nga autoritetet përkatëse;
- Trajtimi dhe asgjësimi i duhur i llumit që vjen nga ITUZ dhe nga industria;
- Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave të ngurta në Kosovë duke krijuar mjedise për grumbullimin dhe përpunimin e tyre në mënyrë që të parandalohet futja e tyre në mjedis; mbështetja dhe implementimi i aktiviteteve të riciklimit;
- Përmirësimi i bazës së të dhënave/regjistrit të industrive që shkarkojnë mbetjet në mjedis (me ose pa objekte trajtimi);
- Kampanjat e vetëdijësimit dhe ngritja e kapaciteteve.

### 3.3 ÇRMU 2: Ndotja nga burime të lëvizshme nga bujqësia dhe burime tjera (ndotja nga burime difuzive)

#### 3.3.1 Përshkrimi i problemit

Bujqësia është shkaktari kryesor që i takon ndotjes nga burime të lëvizshme (ndotja difuzive) dhe që kërcënon ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore. Ndotja me nutrientë që vijnë nga bujqësia, veçanërisht azoti dhe/ose fosfori, mund të shkaktojë eutrofikimin e ujërave. Eutrofikimi është rritja e tepërt e algave që mund të ndikojë ndjeshëm në cilësinë e ujit. Gjithashtu, përdorimi i gjerë i pesticideve që rrjedhin në ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore, duke u inkorporuar në burimet e ujit të pijshëm, paraqet rrezik për shëndetin e njeriut dhe ekosistemet e aktivitetet prodhuese.

Ujërat e ndotura nga nutrientët dhe pesticidet kërkojnë një trajtim më të detajuar për t'u vënë në dispozicion për konsum njerëzor. Ndërsa ndotja me lëndë ushqyese shkakton kryesisht një rrezik për ekosistemet, helmimi me pesticide rezulton në sëmundje të konsiderueshme njerëzore. Pesticidet gjithashtu mund të prishin funksionin endokrin, duke shkaktuar potencialisht probleme riprodhuese te gjitarët, amfibët dhe peshqit që janë ekspozuar.

Shtytës tjerë të rëndësishëm të ndotjes nga burime difuzive që janë marrë në konsideratë në analizën e rrezikut janë rrjedhjet e pakontrolluara dhe të shpërndara urbane në sistemin ujqor, ndotja difuzive nga transporti dhe reshjet me përmbajtje të azotit dhe squfurit.

#### 3.3.2 Shtytës të rëndësishëm dhe presione të ndërlidhura nga burimet difuzive


Tabela 24: Shtytës të rëndësishëm dhe presione të ndërlidhura nga burimet difuzive.

Presionet	Shtytësit kryesorë	Përshkrimi
<b>Presione cilësore difuzive</b>		
2.1 Burimi difuziv - Rrjedhjet urbane	Zhvillimi Urban, Industria	Vërshimet dhe shkarkimet e ujërave të stuhisë në zona të urbanizuara që nuk janë identifikuar si burime të palëvizshme.
2.2 Burimi difuziv – Bujqësia	Bujqësia	Sasitë e plehrave artificiale të përdorura.
2.3 Burimi difuziv – Pylltaria	Pylltaria	-
2.4 Burimi difuziv – Transporti	Transporti	Ndotja nga trafiku rrugor dhe i trenave, aviacioni dhe infrastruktura.
2.5 Burimi difuziv – Lokacionet e kontaminuara/Lokacionet e braktisura industriale	Industria	Ndotja që rezulton nga një zonë industriale e braktisur, ose një zonë e kontaminuar për shkak të aktiviteteve industriale të së kaluarës, hedhjes së paligjshme të mbetjeve industriale ose një aksidenti ndotjeje dhe që identifikohet si burim difuziv (për burimet e palëvizshme)

Presionet	Shtytësit kryesorë	Përshkrimi
<b>Presione cilësore difuzive</b>		
		shih më lart "Burim i palëvizshëm - Lokacione të kontaminuara/lokacione industriale të braktisura).
2.6 Burimi difuziv - Shkarkimet jo të lidhura me rrjetin e kanalizimeve	Zhvillimi urban	Ndotja që vjen nga ujërat e zeza urbane të palidhura me kanalizime dhe të identifikuar si burime difuzive.
2.7 Burimi difuziv - Depozitimi atmosferik	Bujqësia, Energjia jo-ujore, Industria, Transporti, Zhvillimi Urban	Ndotja difuzive nga depozitimet atmosferike të çfarëdo origjine.
2.8 Burimi difuziv – Miniera	Industria	Ndotja nga aktivitetet minerare të cilat identifikohen si difuzive (për burimet e palëvizshme shih kategoritë më lart).

Ndotja difuzive nga bujqësia, vendbanimet, industria, sistemet e transportit dhe depozitimi atmosferik në fund të fundit nxitet nga rritja e përgjithshme e popullsisë së bashku me urbanizimin, industrializimin dhe rritjen e prodhimit bujqësor.

Në studimin e modelimit të cilësisë së ujit sipërfaqësor realizuar në kuadër të Studimit të Bilancit të Ujit (PointPro, 2023), për çdo trup uJOR sipërfaqësor është llogaritur ngarkesa totale e aplikuar në ujëmbledhësin e trupit uJOR (shih **Error! Reference source not found.**). Kjo përfshin si përdorimin e plehrave ashtu edhe prodhimin e plehut organik nga bagëtia. Ngarkesat e larta bujqësore gjenden në Trupin UJOR Sipërfaqësor XK-02-01-01 (Drenicë), XK-0215-01 (Bisticë) dhe XK-02-16-05 (Ibër në rrjedhën e poshtme). Ngarkesa mesatare vjetore për ha të sipërfaqes bujqësore është 180 kg N/ha për Azotin dhe 25 Kg P/ha për Fosforin (PointPro, 2023).



**Figura 2: Aplikimi i vlerësuar i azotit (N) për trup uJOR sipërfaqësor.**

Presion kryesor i rëndësishëm ndotës nga burime difuzive në Pellgun e Lumit Ibër është ndikimi i bujqësisë në sistemin uJOR (presioni 2.2), i përmbledhur në tabelën më poshtë.

Ndotja nga rrjedhjet urbane difuzive (presioni 2.1), pastaj ndotja difuzive nga transporti (presioni 2.4) dhe depozitimi atmosferik (presioni 2.7) nuk janë llogaritur më tej në nivelin e Pellgut të Ibrit dhe vlerësimi i rrezikut është kryer bazuar në një vlerësim cilësor. Më shumë detaje dhe informacion historik mund të gjenden në **Shtojcën 3**.

Presionet 2.5, 2.6 dhe 2.8 mbulohen tek ÇRMU 1.

Sasitë e plehrave artificiale të përdorura në bujqësi bazohen në mesataren vjetore prej 455 kg/ha, sipas Anketës së Ekonomive Bujqësore (Agjencia e Statistikave të Kosovës, ASK, 2021).

**Tabela 25: Regjistri i shtytësve dhe presioneve: Bujqësia në Pellgun e Lumit Ibër.**

No.	Lumi në kuadër të pellgut të Ibrit	Komuna/Rajoni	Zona bujqësore (ha)	Sasia e plehrave të përdorur (ton/vit)	Sipërfaqja bujqësore nën ujtitje (ha)	Burimi	Komente
1		Prishtinë	12.975	5.903	152	Anketa e Ekonomive Bujqësore, ASK, 2021	Plehra artificiale të përdorura
2		Obiliq	5.519	2.511	622	Anketa e Ekonomive Bujqësore, ASK, 2021	Plehra artificiale të përdorura
3		Fushe Kosovë	4.714	2.144	137	Anketa e Ekonomive Bujqësore, ASK, 2021	Plehra artificiale të përdorura
4		Podujevë	24.807	11.287	898	Anketa e Ekonomive Bujqësore, ASK, 2021	Plehra artificiale të përdorura
5		Lipjan	18.547	8.438	26	Anketa e Ekonomive Bujqësore, ASK, 2021	Plehra artificiale të përdorura
6		Drenas	15.125	6.881	144	Anketa e Ekonomive Bujqësore, ASK, 2021	Plehra artificiale të përdorura
7		Graëanicë	5.658	2.574	442	Anketa e Ekonomive Bujqësore, ASK, 2021	Plehra artificiale të përdorura
8		Shtime	6.127	2.787	260	Anketa e Ekonomive Bujqësore, ASK, 2021	Plehra artificiale të përdorura
9		Mitrovicë e jugut	10.942	4.978	387	Anketa e Ekonomive Bujqësore, ASK, 2021	Plehra artificiale të përdorura
10		Mitrovicë e Veriut	N/A	N/A	-	Anketa e Ekonomive Bujqësore, ASK, 2021	Plehra artificiale të përdorura
11		Zveçan	N/A	N/A	76	Anketa e Ekonomive Bujqësore, ASK, 2021	Plehra artificiale të përdorura
12		Leposaviq	N/A	N/A	-	Anketa e Ekonomive Bujqësore, ASK, 2021	Plehra artificiale të përdorura
13		Zubin Potok	N/A	N/A	-	Anketa e Ekonomive Bujqësore, ASK, 2021	Plehra artificiale të përdorura
14		Skënderaj	19.700	8.963	150	Anketa e Ekonomive Bujqësore, ASK, 2021	Plehra artificiale të përdorura
15		Vushtrri	17.505	7.964	488	Anketa e Ekonomive Bujqësore, ASK, 2021	Plehra artificiale të përdorura

### 3.3.3 Vizioni dhe objektivat e menaxhimit për ÇRMU 2

#### Vizioni

Vizioni për adresimin e ndotjes nga burime të lëvizshme nga bujqësia, shkaktuar nga azoti, fosfori dhe pesticidet, është parandalimi i degradimit të cilësisë së ujërave sipërfaqësore. Ky degradim paraqet rrezik dhe kërcënim për shëndetin e njeriut dhe ekosistemin ujor, duke rrezikuar gjithashtu përdorimin e drejtë të ujërave sipërfaqësore për qëllime të ndryshme.

#### Objektivat e menaxhimit

- Zhvillimi dhe zbatimi i politikave dhe strategjive shtetërore për të rregulluar përdorimin e sigurt të plehrave dhe pesticideve të regjistruara në përputhje me udhëzimet e BE.
- Mbajtja e përqendrimeve të azotit dhe fosforit (N dhe P) në të gjithë trupat ujorë në përputhje me legjislacionin shtetëror;
- Krijimi i një baze të centralizuar të dhënash për përcjelljen e përdorimit të pesticideve dhe plehrave;

- Krijimi dhe zbatimi i praktikave më të mira bujqësore për të minimizuar shkarkimin e lëndëve ushqyese dhe pesticideve në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore.
- Inkurajimi i fermerëve për të përdorur metoda bujqësore që janë miqësore ndaj mjedisit.
- Ofrimi i këshillave dhe trajnimeve për fermerët në ruajtjen, menaxhimin dhe asgjësimin e duhur të pesticideve;
- Parandalimi i ndikimit të incidenteve të ndotjes duke zbatuar masat e duhura të sigurisë;
- Kontrolli mbi importin e pesticideve përmes doganave për të menaxhuar sasinë e pesticideve të importuara dhe të përdorura.

### 3.4 ÇRMU 3: Presionet në sasinë e ujërave sipërfaqësore

#### 3.4.1 Përshkrimi i problemit

Lumenjtë dhe përrenjtë në Pellgun e Lumit Ibër janë resursi kryesor i ujit, duke siguruar furnizimin me ujë për amvisëritë, industrinë dhe zonat e ujitjes të pranishme në pellg. Për të plotësuar kërkesat për furnizim me ujë të amvisërive dhe industrisë si dhe ato për ujitje gjatë stinës së verës, uji duhet të ruhet gjatë periudhës së dimrit. Për këtë arsye janë ndërtuar infrastrukturat e lidhura me ujin përgjatë rrjetit të lumit (shih **Kapitullin 2**), të cilat e kanë transformuar Pellgun e Lumit Ibër pjesërisht në një lumë të modifikuar, duke ndikuar gjithashtu në sasinë e ujit.

Sa i përket rezervuarëve në Pellgun e Lumit Ibër, uji ose nxirret drejtpërdrejt nga rezervuarët ose devijohet në kanalet e ujitjes. Ndikimet në regjimin e rrjedhës poshtë rezervuarëve varen kryesisht nga madhësia e rezervuarëve dhe mënyra e funksionimit të tyre, duke përfshirë rregullimet për shkarkimet e ujit në rrjedhën e poshtme. Përderisa rregullat e funksionimit janë në fuqi për rezervuarët e mëdhenj, planet për shumicën e rezervuarëve mungojnë ose nuk dihen. Prandaj, shumica e seksioneve të lumenjve nuk kanë asnjë rrjedhë të rregulluar mjedisore (rrjedhje-M) në rrjedhën e poshtme të rezervuarëve. Biota e lumenjve si peshqit p.sh., ndikohet nga mungesa e ujit dhe prandaj shërbimet e ekosistemit, si peshkimi, mund të preken.

#### 3.4.2 Shtytësit e rëndësishëm dhe presionet e ndërlidhura me sasinë e ujërave sipërfaqësore

Tabela 26: Shtytësit e rëndësishëm dhe presionet e ndërlidhura me sasinë e ujërave sipërfaqësore.

Presionet	Shtytësit kryesorë	Përshkrimi
<b>Presionet e nxjerrjes</b>		
3.1 Nxjerrja / Devijimi i rrjedhës – Bujqësia	Bujqësia	Përfshin transferet dhe nxjerrjet e ujit për ujitje dhe nevoja të blegtorisë.
3.2 Nxjerrja / Devijimi i rrjedhës – Furnizimi i banorëve me ujë	Zhvillimi urban	Përfshin transferet e ujit. Ndikimi ndaj TW dhe/ose CW është i mundur vetëm në rastin e impianteve desalinuese.
3.3 Nxjerrja / Devijimi i rrjedhës – Industria	Industria	Nxjerrja për procese industriale (uji ftohës përfshihet në kategorinë "Nxjerrje - ujë ftohës").
3.4 Nxjerrja /Devijimi i rrjedhës – Uji ftohës	Industria; Energjia jo-ujore	

Shtytësit kryesorë janë: rritja e popullsisë urbane, trend që pritet të vazhdojë edhe në të ardhmen, si dhe rritja e industrive, veçanërisht në qendrat më të rëndësishme ekonomike të pellgut. Rritja e kërkesës për furnizimin me ujë për amvisëritë dhe industrinë lidhet me këto zhvillime. Përveç kësaj, nevoja e shtuar për rritjen e prodhimit të ushqimit shkaktonte një rritje të përdorimit të ujit për ujitje. Ndryshimet klimatike mund t'i shtohen sfidave të përmendura në

Pellgun e Lumit Ibër në të ardhmen dhe të çojnë në rritje të përmytjeve dhe thatësirave (shih **Kapitullin 2**).

**Presionet e lidhura me resurset ujore janë (presionet 3.1, 3.2, 3.3 dhe 3.4):**

- Presionet kryesore mbi sasinë e ujit në Pellgun e Lumit Ibër janë kërkesat në rritje për furnizim të amvisërive, industrisë dhe bujqësisë që duhet të plotësohen gjatë gjithë vitit dhe që rezultojnë në deponimin dhe/ose devijimin e sasive të mëdha të ujit nga Lumi Ibër në infrastrukturën e shumta të lidhura me ujin, si digat dhe rezervuarët (shih **Kapitullin 2**).
- Presionet mbi sasinë e ujit që lidhen me prodhimin bujqësor në pellg dhe përdorimi joefikas i ujit. Rritja e të mbjellave dhe rritja e vazhdueshme e nevojës për ujitje gjithashtu kontribuon në këtë problem.
- Një presion tjetër në këtë drejtim vjen nga fakti se rezervuarët duhet të menaxhohen në varshmëri nga nevojat për ujë. Rezervuarët duhet të jenë plot në fund të dimrit, por duhet të kenë ende kapacitet të mjaftueshëm deponues për të përballuar reshjet e shumta në periudhën para sezonit të rritjes së nivelit të ujit.
- Shkarkimi i ujit ftohës të industrisë dhe ujit nga lokacionet e prodhimit të energjisë mund të ndikojë në proceset ekologjike kur temperaturat e ujit janë në rritje.

Vendndodhjet kryesore të nxjerrjes së ujit në Pellgun e Lumit Ibër që ndikojnë në disponueshmërinë e përgjithshme të ujit në pellg janë përmbledhur në tabelën më poshtë. Më shumë detaje dhe informacion historik mund të gjenden në **Shtojcën 3**.

**Tabela 27: Regjistri i shtytësve dhe presioneve: Nxjerrja e ujit nga ujërat sipërfqësore në Pellgun e Lumit Ibër.**

Nr	Instalimi / Operimi	Lloji i aktivitetit	Lumi në kuadër të Pellgut të Ibrit	Komuna/Rajoni	Lloji i lejes	Sasia	Kapaciteti i rezervuarit	Burimi
1	Kanali Ibër - Lepenc	Furnizim me ujë për amvisëritë / Ujë Industrial / Ujitje	Ibri	Zubin Potok	Leje ujore	220,752,000 m <sup>3</sup> /vit (minimumi)	370 milionë m <sup>3</sup>	Autoriteti Rregullator i Shërbimeve të Ujit, 2021
2	KRU Mitrovica	Furnizim me ujë për amvisëritë	Sitnica	Mitrovicë	Leje ujore	21.820.226 m <sup>3</sup> /vit	Nuk ka të dhëna	Autoriteti Rregullator i Shërbimeve të Ujit, 2021
3	Trepça	Ujë Industrial	Sitnica/Trepça	Mitrovicë	Nuk ka të dhëna të disponueshme në lejen e ujit	18.921.600 m <sup>3</sup> /vit	Nuk ka të dhëna	NH "Ibër-Lepenc" sh.a.
4	Stacioni në Bivolak	Furnizim me ujë për amvisëritë / Ujë Industrial / Ujitje	Sitnica	Vushtri	Leje ujore	5.518.825 m <sup>3</sup> /vit	Nuk ka të dhëna	NH "Ibër-Lepenc" sh.a.
5	TC Kosova B	Ujë Industrial	Sitnica	Vushtri	Leje ujore	10.437.362 m <sup>3</sup> /vit	Nuk ka të dhëna	NH "Ibër-Lepenc" sh.a.
6	TC Kosova A	Ujë Industrial	Llapi	Prishtinë	Leje ujore	1,173,971 m <sup>3</sup> /vit	Nuk ka të dhëna	NH "Ibër-Lepenc" sh.a.
7	Balincë	Furnizim me ujë për amvisëritë	Sitnica	Vushtri	Leje ujore	6,711,579 m <sup>3</sup> /vit	Nuk ka të dhëna	NH "Ibër-Lepenc" sh.a.
8	Shkabaj	Furnizim me ujë për amvisëritë	Sitnica	Prishtinë	Leje ujore	16.632.124 m <sup>3</sup> /vit	Nuk ka të dhëna	NH "Ibër-Lepenc" sh.a.
9	Badovc, KRU Prishtinë	Furnizim me ujë për amvisëritë	Graçanka	Prishtinë	Leje ujore	Nuk ka të dhëna	27 milionë m <sup>3</sup>	Autoriteti Rregullator i Shërbimeve të Ujit, 2021
10	Batlave, KRU Prishtina	Furnizim me ujë për amvisëritë	Batlava	Prishtinë	Leje ujore	50,834,822 m <sup>3</sup> /vit	38 milionë m <sup>3</sup>	Autoriteti Rregullator i Shërbimeve të Ujit, 2021
11	Puset në Obiliq	Furnizim me ujë për amvisëritë	Sitnica	Prishtinë	Leje ujore	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Autoriteti Rregullator i Shërbimeve të Ujit, 2021
12	Puset në Kuzmin, Fushë.Kosovë	Furnizim me ujë për amvisëritë	Sitnica	Fushë Kosovë	Leje ujore	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Autoriteti Rregullator i Shërbimeve të Ujit, 2021
13	Puset në Lipjan	Furnizim me ujë për amvisëritë	Sitnica	Lipjan	Leje ujore	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Autoriteti Rregullator i Shërbimeve të Ujit, 2021

### 3.4.3 Vizioni dhe objektivat e menaxhimit për ÇRMU 3

#### Vizioni

Vizioni për hidrologjinë/sasinë e ujit të lumit është të sigurojë përdorim të qëndrueshëm të ujërave sipërfaqësore duke garantuar sigurinë e ujit, disponueshmërinë e ujit dhe kapacitetet e ruajtjes, si dhe duke marrë parasysh ndikimet e ndryshimeve klimatike.

#### Objektivat e menaxhimit

- Zhvillimi dhe zbatimi i politikave përkatëse shtetërore;
- Përditësimi i identifikimit të burimeve kryesore të nxjerrjes së ujit dhe ndryshimeve hidrologjike që mund të shkaktojnë ndikime;
- Rritja e disponueshmërisë së resurseve ujore duke shtuar më shumë kapacitet deponues, pasi disponueshmëria e ujit pritet të ulet me më shumë se 20%;
- Krijimi i skemave të ripërdorimit të ujit për të reduktuar nivelet aktuale të nxjerrjes të ujit;
- Kryerja e një studimi për bilansin e ujit në pellg;
- Hartimi i planeve për menaxhimin e përmbytjeve dhe thatësirave (tashmë 7 KRU kanë plane për menaxhimin e thatësirës).

### 3.5 ÇRMU 4: Presionet në hidro-morfologjinë e ujërave sipërfaqësore

#### 3.5.1 Përshkrimi i problemit

Në Kosovë, faktori njeri ka ndryshuar karakteristikat fizike të ekosistemeve ujore, si p.sh. formën e trupave ujqorë dhe rrjedhën e lumenjve për shkak të përdorimit të ujit për qëllime bujqësore, deponim të ujërave sipërfaqësore për përdorime të shumëfishta, gjenerim të energjisë elektrike, si dhe mbrojtje të vendbanimeve dhe tokës bujqësore nga përmbytjet. Për këto qëllime, disa lumenj u drejtuan, u kanalizuan dhe u shkëputën nga fushat e tyre përmbytëse. Toka është drenazhuar, janë ndërtuar diga dhe penda, brigjet e lumenjve janë përforcuar dhe nivelet e ujërave nëntokësore janë modifikuar. Këto aktivitete kanë rezultuar në ndryshim të habitateve, ndërprerje në rrjedhat e lumenjve, ndërprerje në vazhdimësinë e lumenjve dhe humbje të konektivitetit me fushat e përmbytura (Agjencia Evropiane e Mjedisit, 2020).

E gjithë kjo ka shkaktuar dëmtim të cilësisë hidro-morfologjike të trupave ujqorë, e cila e ka një rol kyç në ruajtjen e ekosistemeve ujore. Funksionimi i mirë hidro-morfologjik është një element thelbësor i shëndetit të ekosistemit dhe mbështet ofrimin e shumë shërbimeve dhe përfitimeve të ekosistemit për shoqërinë.

Karakteristikat hidro-morfologjike të trupave ujqorë luajnë një rol kyç në DKU. Analiza e presioneve hidromorfologjike, vlerësimi i statusit hidromorfologjik të trupave ujqorë si një element mbështetës për statusin ekologjik dhe përcaktimi i ndikimeve që rezultojnë nga presionet hidromorfologjike janë disa nga hapat në të cilët hidro-morfologjia merret në konsideratë në kuadër të DKU. Që një trup ujqor të arrijë një status të mirë ekologjik, kushtet e tij hidro-morfologjike duhet të jenë të tilla që ndryshojnë vetëm pak nga një gjendje e patrazuar natyrore, për të mbështetur kështu bashkësitë e elementeve të cilësisë biologjike, si peshqit dhe gjallesat e tjera ujore.

### 3.5.2 Shtytës të rëndësishëm dhe presione të ndërlidhura me hidro-morfologjinë e ujërave sipërfaqësore

Tabela 28: Shtytës të rëndësishëm dhe presione të ndërlidhura me hidro-morfologjisë e ujërave sipërfaqësore.

Presionet	Shtytësit kryesorë	Përshkrimi
<b>Morfologjia</b>		
4.1 Ndryshimi fizik i kanalit/shtratit/zonës bregore/bregut të trupit uJOR	Mbrojtja nga përmytjet Bujqësia Transporti	I referohet kryesisht ndryshimeve gjatësore të trupave uJORë.
4.2 Diga, barriera dhe pengesa	Energjia – hidrocentrale Mbrojtja nga përmytjet Zhvillimi urban Bujqësia Industria	
4.3 Ndryshimi hidrologjik	Bujqësia, Transporti	Një ndryshim në regjimin e rrjedhës (p.sh., për shkak të kullimit të tokës, transportit në ujërat e brendshme)
4.4 Humbje fizike e trupave të tërë uJORë (ose një pjese të tyre)	Mbrojtja nga përmytjet, Ndryshimet klimatike	Shtretër lumenjsh të thatë etj.

Ka disa aktivitete antropogjene që shkaktojnë presione hidromorfologjike, p.sh., drejtimi i lumenjve (presioni 4.1), ndërtimi i barrierave ose digave (presioni 4.2), ndryshimet hidrologjike (presioni 4.3) dhe humbja fizike e pjesëve të trupit uJOR për shkak të gërmimit (presioni 4.4). Presionet hidro-morfologjike janë presionet më të përhapura në trupat uJORë sipërfaqësorë, raportuar sipas DKU (referenca: <https://water.europa.eu/>).

Presionet mbi hidromorfologjinë u shërbejnë aktiviteteve të ndryshme të rëndësishme njerëzore si gjenerimi i energjisë elektrike nga hidrocentralet, akumulimi i ujit për bujqësi, furnizimi me ujë për amvisëritë dhe industrinë, si dhe mbrojtja e tokës nga përmytjet. Hidroenergjia, gërmimi (nxjerrja e zhavorrit dhe rërës) dhe mbrojtja nga përmytjet janë shtytësit kryesorë në Kosovë.

Hidrocentralet (HC) në pellgun e Lumit Ibër janë renditur në tabelën e mëposhtme. Ato ndryshojnë habitatet dhe ekosistemet uJore për shkak të fragmentimit dhe humbjes së habitateve, ndryshimeve në regjimin e rrjedhës së ujit dhe ndryshimeve në dinamikën natyrore të transportit të sedimentit. Më shumë detaje dhe informacion historik mund të gjenden në **Shtojcën 3**.

Tabela 29: Regjistri i shtytësve dhe presioneve: Hidrocentralet në Pellgun e Lumit Ibër.

#	Instalacioni/O peratori	Lloji i aktivitetit	Lumi në kuadër të Pellgut të lbrit	Komuna	Leja	Kapaciteti	Burimi
1	HEC Ujmani	Hidroenergji	lbr	Mitrovicë	Nuk ka të dhëna	35 MW; 2 turbina 18 m <sup>3</sup> /sec secila	Raporti i Sigurisë së Ujit për KS Qendrore
2	HEC Hidroline-Albaniku I	Hidroenergji	Bistrica	Mitrovicë	Pëlqim mjedisor	1.9 MW	ARRSHU 2021
3	HEC Hidroline-Albaniku II	Hidroenergji	Bistrica	Mitrovicë	Pëlqim mjedisor	3.6 MW	ARRSHU 2021
4	HEC Hidroline-Albaniku III	Hidroenergji	Bistrica	Mitrovicë	Leje uJore	4.3 MW	ARRSHU 2021

5	HEC Hidroline-Albaniku IV	Hidroenergji	Bistrica	Mitrovicë	Leje ujore	1.1 MW	ARRSHU 2021
6	HEC Kaqandoll	Hidroenergji	Kaqandolli	Podujevë	Pëlqim i ujit	2.6 MW	ARPL
7	HEC Llapi 1	Hidroenergji	Llapi	Podujevë	Pëlqim i ujit	0.79 MW	ARPL
8	HEC Llapi 2	Hidroenergji	Llapi	Podujevë	Pëlqim i ujit	0,802	ARPL

### 3.5.3 Vizioni dhe objektivat e menaxhimit për ÇRMU 4

#### Vizioni

Lumenjtë dhe burimet e tyre natyrore shfrytëzohen në mënyrë të qëndrueshme për të siguruar zhvillimin e një ekosistemi të vetëqëndrueshëm dhe një dinamike sa më natyrore të rrjedhës së ujit.

#### Objektivat e menaxhimit

- Zhvillimi dhe zbatimi i politikave përkatëse shtetërore;
- Përmirësimi i menaxhimit, sigurisë dhe monitorimit të digave;
- Zbatimi i një strategjie për menaxhimin e erozionit dhe pyllëzimin e zonave kritike;
- Identifikimi i pikave të nxehta që lidhen me ndryshimet në sasinë e ujit, veçanërisht në lidhje me dinamikën e pamjaftueshme të rrjedhës natyrore (identifikimi i pikave kritike të Rrjedhës-M);
- Zbatimi i politikës së Rrjedhës-M në pellgun e lumit;
- Prezantimi i zgjidhjeve të bazuara në natyrë për të rivendosur ndryshimet hidromorfologjike në lumenj;
- Krijimi i një strategjie për nxjerrjen e qëndrueshme të rërës në lumenj.

### 3.6 ÇRMU 5: Presione tjera në ujërat sipërfaqësore (presione tjera: akuakultura)

#### 3.6.1 Përshkrimi i problemit<sup>33</sup>

Akuakultura i referohet kultivimit të peshkut për konsum njerëzor (bujqësia e peshkut). Një nga dallimet kryesore në akuakulturë janë sistemet e mbyllura kundrejt atyre të hapura. Sistemet e hapura të akuakulturës përbëhen nga 'pellgjet e peshqve' në rrjedhën natyrore të lumit ku peshqit rriten, ushqehen dhe më pas kapen për përdorim. Sistemet e mbyllura të akuakulturës janë sisteme që përdorin sistemet e filtrimit dhe riqarkullimit, duke hequr kështu rrezikun e ndotjes nga derdhja e efluentit në rrugët ujore natyrore.

Eutrofikimi është një çështje e zakonshme që vjen së bashku me akuakulturën. Eutrofikimi i referohet pasurimit të tepërt të azotit dhe fosforit në ekosistem. Akuakultura shkakton eutrofikim në mënyra të shumta. Në sistemet e hapura të akuakulturës, të ushqyerit e tepërt të peshqve fut azot dhe fosfor shtesë direkt në ujë. Sistemet e mbyllura kontribuojnë gjithashtu në eutrofikim, pasi ato tentojnë të shkarkojnë efluentin direkt në rrugët ujore natyrore.

Një tjetër ndikim negativ që ka akuakultura në mjedis është shkarkimi. Ashtu si çdo sistem tjetër i prodhimit të kafshëve, akuakultura gjeneron mbetje gjatë gjithë procesit. Mbetjet e akuakulturës mund të ndahen në mbetje të ngurta dhe të tretshme, veçanërisht karbon, azot dhe fosfor.

<sup>33</sup> B. Healey et al., Aquaculture and its impact on the environment, University of Massachusetts Amherst, April 2012.

### 3.6.2 Shtytës të rëndësishëm dhe presione të ndërlidhura në ujërat sipërfaqësore (presione tjera: akuakultura)

Tabela 30: Shtytës të rëndësishëm dhe presione të ndërlidhura në ujërat sipërfaqësore (presione tjera: akuakultura).

Presionet	Shtytësit kryesorë	Përshkrimi
5.1 Speciet dhe sëmundjet e introduktuara	Transporti, peshkimi dhe akuakultura, Turizmi dhe rekreacioni.	Përfshin specie aliene invazive.
5.2 Shfrytëzimi/largimi i kafshëve/bimëve	Rekreacioni, peshkimi dhe akuakultura	Peshkimi komercial ose peshkimi rekreativ/sportiv, përdorimi komercial i bimëve ose algave nga trupat ujorë.

Lokacionet e akuakulturës (fermat e peshkut) në Pellgun e Lumit Ibër janë renditur në Tabela 31 më poshtë.

Tabela 31: Regjistri i shtytësve dhe presioneve: Akuakultura në Pellgun e Lumit Ibër.

#	Operatori	Lloji i aktivitetit	Lumi në kuadër të Pellgut të Ibrit	Komuna	Burimi
1	Amazona	Fermë peshku	Llapi	Obiliq	MMPHI dhe studim literature
2	Krapi	Fermë peshku	Llapi	Obiliq	MMPHI dhe studim literature
3	Radeve/Henci	Fermë peshku	Sitnica	Lipjan	MMPHI dhe studim literature
4	River Fish	Fermë peshku	Tërrstena	Vushtrri	ARPL
4	Baicë	Fermë peshku	Drenica	Lipjan	MESPI & Desk Study
5	Koshtovë/Rest.Ibër	Fermë peshku	Ibri	Mitrovicë	MESPI & Desk Study
6	Koshtovë/Rest.Vigu	Fermë peshku	Ibri	Mitrovicë	MMPHI dhe studim literature
7	Socanica	Fermë peshku	Moshnica	Leposaviq	MMPHI dhe studim literature
8	Gradina	Fermë peshku	Kozareva	Zubin Potok	MMPHI dhe studim literature
9	River Fish Sh.p.k	Fermë peshku	Gojbula	Vushtrri	ARPL

### 3.6.3 Vizioni dhe objektivat e menaxhimit për ÇRMU 5

#### Vizioni

Menaxhimi i qëndrueshëm i peshkimit në lumenj dhe liqene.

#### Objektivat e menaxhimit

- Zhvillimi i politikave dhe zbatimi i tyre në përputhje me legjislacionin e BE për akuakulturën;
- Menaxhimi, monitorimi dhe kontrollimi i fermave të peshkut nëpërmjet studimeve dhe vlerësimeve periodike;
- Krijimi dhe inkorporimi i organizatave të peshkimit në dhënien e lejeve dhe inspektimin e këtyre aktiviteteve.

### 3.7 ÇRMU 6: Presionet në sasinë dhe cilësinë e ujërave nëntokësore

#### 3.7.1 Përshkrimi i problemit

Ujërat nëntokësore janë resursi kryesor për ujin e pijshëm (si nga KRU ashtu edhe nga pusët private) dhe një burim i rëndësishëm uji për bujqësinë. Nëse vëllimi i ujërave nëntokësore të

nxjerra tejkalon rimbushjen e ujërave nëntokësore në bazë strukturore, atëherë ato nuk janë më të balancuara dhe kjo shkakton rënien e niveleve të ujërave nëntokësore. Një situatë e tillë do të çojë në situata kritike të furnizimit gjatë periudhave të thatësisë. Përveç kësaj, mungesa e furnizimit me ujë mund të shkaktojë konflikte midis grupeve të përdoruesve, duke rrezikuar furnizimin me ujë të pijshëm dhe prodhimin bujqësor.

Mungesa e monitorimit dhe rregullimit gjithëpërfshirës të vëllimeve të nxjerra të ujërave nëntokësore për përdoruesit e pengon menaxhimin aktiv të burimeve të disponueshme ujore nëntokësore. Kjo është me rëndësi të madhe pasi që nxjerrja e ujërave nëntokësore veçse është jashtëzakonisht e lartë dhe nivelet e ujërave nëntokësore janë në rënie.

Ndotja e ujërave nëntokësore shkaktohet kryesisht nga agrokimikatet si plehrat dhe pesticidet, nga substanca organike që rezultojnë nga grumbullimi dhe trajtimi joadekuat i ujërave të zeza dhe nga substanca të rrezikshme që vijnë nga aktivitete industriale dhe të tjera ekonomike. Një ndotje e tillë kimike përbën një rrezik serioz për shëndetin e popullatës kur merret përmes ujit të pijshëm të patrajtuar ose të trajtuar në mënyrë joadekuate. Ndotja gjithashtu mund të rrezikojë ekosistemet që lidhen ose varen nga ujërat nëntokësore.

### **Vlerësimi i rrezikut të sasisë së ujërave nëntokësore**

Vlerësimi për sasinë e trupave ujorë nëntokësorë bazohet në vlerësimin e ekspertëve dhe rezultatet e takimeve teknike dhe të palëve të interesit.

### **Vlerësimi i rrezikut kimik të ujërave nëntokësore për trupat ujorë nëntokësorë në Kosovë**

Së fundi u vunë në dispozicion të dhënat e para nga Programi Pilot i Monitorimit (shih gjithashtu **Kapitullin 4**). Për analizën, ne kemi përdorur gjithashtu *presionet nga ÇRMU 1 dhe 2*, dhe kemi përdorur informacionin e mbulueshmërisë të tokës për të nxjerrë rrezikun nga presionet e aktiviteteve në terren bazuar në informacionin CORINE për mbulueshmërinë e tokës (2018). Ky informacion përfshin lokacionet e minierave dhe deponive, zonat urbane, zonat bujqësore, pyjet, kullosat dhe mjedise të tjera natyrore. Bazuar në këtë analizë, u vlerësuan rreziqet e mundshme të ndotjes së ujërave nëntokësore.

### **3.7.2 Shtytësit kryesorë dhe presionet e ndërlidhura në sasinë dhe cilësinë e ujrëve nëntokësore**

Rritja e kërkesës për ujë në bujqësi, rritja e popullsisë dhe aktivitetet industriale janë shtytës të rëndësishëm që shkaktojnë ndryshime në sasinë e ujërave nëntokësore. Ndotja e ujërave nëntokësore shkaktohet kryesisht nga aktivitetet bujqësore, por mund të rezultojë edhe nga aktivitetet urbane dhe industriale.

#### **Presionet e lidhura me resurset ujore janë:**

- Nxjerrja e ujërave nëntokësore për ujitje paraqet presion mbi sasinë e ujërave nëntokësore. Për më tepër, rritja e popullsisë urbane mbështetet në mënyrë të konsiderueshme në ujërat nëntokësore për të plotësuar kërkesën për ujë të pijshëm, dhe nxjerrjet e ujërave nëntokësore gjithashtu përbushin kërkesën për ujë në prodhimtarinë industriale.
- Ndotja difuzive e ujërave nëntokësore shkaktohet kryesisht nga përdorimi i gjerë i plehrave dhe pesticideve në prodhimtarinë bujqësore. Kjo ndotje shkaktohet gjithashtu nga depozitimi i llumit të ujërave të zeza industriale dhe nga amvisëritë në tokë ose shkarkimi në trupat ujorë sipërfaqësorë, nga mungesa ose rrjedhja e sistemeve të

grumbullimit të kanalizimeve, nga vërshimi i ujërave të stuhisë gjatë reshjeve të mëdha dhe nga trajtimi joadekuat i ujërave të zeza.

- Ndotja nga burimet e palëvizshme shkaktohet kryesisht nga ujërat e zeza komunale, ujërat e zeza industriale dhe rrjedhjet nga vendet e deponimit të mbeturinave dhe depot e plehut organik.

### 3.7.3 Vizioni dhe objektivat e menaxhimit për ÇRMU 6

#### **Vizioni për cilësinë e ujërave nëntokësore**

Për të ruajtur *cilësinë e ujërave nëntokësore*, pra për ti mbajtur ato të përshtatshme për përdorime të ndryshme dhe pa rrezik për shëndetin e njeriut. Aty ku ujërat nëntokësore tashmë janë prekur për shkak të aktiviteteve antropogjene, ato duhet të rikthehen në statusin 'cilësi e mirë'.

#### **Objektivat e menaxhimit – cilësia e ujërave nëntokësore**

- Zhvillimi dhe zbatimi i politikave përkatëse shtetërore;
- Të ndalohet çdo shkarkim i drejtpërdrejtë i substancave ndotëse në ujërat nëntokësore;
- Parandalimi i shkarkimeve indirekte të substancave të rrezikshme në ujërat nëntokësore;
- Kufizimi i çdo shkarkimi indirekt të substancave jo të rrezikshme në ujërat nëntokësore;
- Parandalimi i humbjeve të konsiderueshme të ndotësve nga instalimet teknike dhe zvogëlimi i ndikimit të incidenteve aksidentale të ndotjes duke zbatuar masat e duhura të sigurisë;
- Promovimi i praktikave më të mira bujqësore për të minimizuar infiltrimin e plehrave dhe pesticideve në ujërat nëntokësore;
- Ngritja e kapaciteteve për ruajtjen, menaxhimin dhe asgjësimin e pesticideve në mënyrë që të parandalohet ndotja nga burime të palëvizshme;
- Përmirësimi i sistemit të monitorimit të cilësisë së ujërave nëntokësore për të vlerësuar me saktësi statusin e cilësisë së ujërave nëntokësore.

#### **Vizioni për sasinë e ujërave nëntokësore**

Të sigurohet *sasia e ujërave nëntokësore*, pra përdorimi i qëndrueshëm i tyre afatgjatë (nxjerrja dhe rimbushja në ekuilibër), duke marrë parasysh ndikimet e ndryshimeve klimatike. Nxjerrja e ujërave nëntokësore nuk duhet të çojë në ndonjë ndërhyrje të substancave që shkaktojnë përkeqësimin e cilësisë së ujërave nëntokësore.


#### **Objektivat e menaxhimit – sasia e ujërave nëntokësore**

- Zhvillimi dhe zbatimi i politikave përkatëse shtetërore;
- Krijimi i mekanizmave për rregullimin dhe kontrollimin e nxjerrjes së ujërave nëntokësore;
- Krijimi i një regjistri të nxjerrjes së ujërave nëntokësore;
- Vlerësimi i ndikimeve të procesit të pompimit diellor në nxjerrjet e ujërave nëntokësore;
- Ndërhyrje në nivel politikash për të plotësuar kërkesat e ardhshme për ujërat nëntokësore dhe ndikimet e ndryshimeve klimatike;

- Vëzhgim nga afër i ndikimeve të legjislacionit në zhvillimin e shfrytëzimit të ujërave nëntokësore;
- Të kuptuarit më të mirë të sistemeve të ujërave nëntokësore dhe koordinimi i duhur kur bëhet fjalë për sisteme ndërkufitare të ujërave nëntokësore;
- Promovimi i intervenimeve menaxheriale nga ana e përdoruesve në zonat e prekura nga thatësira ose ku ujërat nëntokësore tashmë janë tejnxjerrur ose janë afër kufirit të tejnxjerrjes;
- Promovimi i përdorimit të përbashkët të ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore;
- Promovimi i rimbushjes së ujërave nëntokësore.

### 3.8 Pasqyrë e presioneve në sistemin e ujit në Pellgun e Lumit Ibër

Harta 21: Pasqyrë e presioneve në sistemin e ujit në Pellgun e Lumit Ibër



## Kapitulli 4

### Monitorimi dhe Vlerësimi i Statusit

#### 4.1 Hyrje

Me implementimin e DKU, u krijuan programe të gjera monitorimi nga të gjitha vendet anëtare të BE, si për trupat ujqorë sipërfaqësorë ashtu edhe për ata nëntokësorë. Programet bazohen në të dhënat historike në dispozicion, në lokacionet e reja të monitorimit, si dhe vlerësimet e rrezikut për të gjithë trupat ujqorë në të gjithë Evropën. Bazuar në udhëzimet e DKU, programet e monitorimit janë të nevojshme për të mbuluar tri lloje të monitorimit:

**Monitorimi Mbikëqyrës** ka për qëllim krijimin e informacionit:

- për të plotësuar dhe validuar procedurat e vlerësimit të ndikimit.
- për të mundësuar përgatitjen adekuate të programeve të ardhshme të monitorimit; dhe,
- për të vlerësuar ndryshimet afatgjata në kushtet natyrore ose ato që ndodhin si rezultat i aktivitetit antropogjen.

**Monitorimi Operacional** synon të ofrojë informacion që do të përdoret për të klasifikuar statusin e trupave ujqorë të identifikuar si 'në rrezik të përmbushjes së objektivave të tyre mjedisore'. Nëse merren masa për të përmirësuar cilësinë e një trupi ujqor, monitorimi operacional mund të përdoret gjithashtu për të vlerësuar çdo ndryshim që rezulton nga këto veprime.

Së fundi, **Monitorimi Hetimor** mund të ndërmerret kur monitorimi mbikëqyrës tregon se objektivat mjedisore për një trup të caktuar ujqor nuk ka gjasa të përmbushen dhe për të kuptuar shkaqet e një dështimi të tillë. Përveç kësaj, monitorimi hetimor është projektuar gjithashtu për të vlerësuar shkallën e ndikimit të ndotjeve aksidentale.

Përderisa monitorimi obligohet të përfshijë disa "elemente cilësore", si parametrat kimikë, biologjikë dhe hidromorfologjikë, DKU nuk specifikon teknikat dhe metodat që do të përdoren. Monitorimi kimik do të fokusohet kryesisht në matjen e ndotësve prioritarë, por edhe të çdo ndotësi potencial që identifikohet si i rëndësishëm.

#### 4.2 Metodologjia

##### 4.2.1 Ujërat sipërfaqësore

Të dhënat e monitorimit janë të nevojshme për të përcaktuar statusin e trupave ujqorë sipërfaqësorë. Këto të dhëna janë poashtu të domosdoshme për të përcaktuar se ku janë të nevojshme masat dhe çfarë masash duhet të ndërmerren. Në Kosovë nuk ekziston monitorim i gjerë i ujërave sipërfaqësore. Prandaj janë shfrytëzuar të dhënat historike nga Instituti Hidrometeorologjik dhe Universiteti i Prishtinës. Gjithashtu, janë përdorur të dhënat nga cikli i parë i Pilot Programit të Monitorimit, realizuar në kuadër të projektit MIRU-K. Meqenëse të dhënat në dispozicion janë të pamjaftueshme për të përcaktuar zhvillimet afatgjata, rezultatet janë përdorur vetëm për të vlerësuar gjendjen aktuale.

**Të dhënat e mëposhtme janë përdorur për vlerësimin e trupave ujqorë sipërfaqësorë në Pellgun e Lumit Ibër:**

- Të dhëna historike për cilësinë e ujit nga IHMK për periudhën 2015-2020. **Error! Reference source not found.** 22 tregon pikat monitoruese të rrjetit monitorues të


IHMK. Mostrat u mblodhën nga 15 trupa ujqorë sipërfaqësorë dhe u analizuan në laboratorin e IHMK për parametrat e përgjithshëm, si dhe për disa metale të rënda.

- Rezultatet e ciklit të parë (pranverë 2023) të matjeve të kryera në kuadër të Pilot Programit të Monitorimit. Parametrat e përgjithshëm janë përcaktuar nga IHMK. Metalet e rënda, pesticidet dhe hidrokarburet policiklike aromatike janë matur nga një laborator i jashtëm (Qendra LCC për Kërkime Ekotoksikologjike në Podgoricë). Analizat biologjike, duke përfshirë makroinvertebrorët, diatometë dhe peshqit, janë kryer nga Universiteti i Prishtinës.

Nuk janë monitoruar të gjithë trupat ujqorë. Informacion shtesë u mor nga studimi i modelimit të cilësisë së ujit, realizuar nga PointPro (PointPro, 2023). Janë përdorur rezultatet e modelimit për azotin dhe fosforin total, si dhe SHBO.

Të dhënat e përdorura për të vlerësuar gjendjen hidrologjike janë rezultatet nga modelimet hidrologjike të Vlerësimit të Bilancit Ujqor realizuar në kuadër të MIRU-K. Modelimi është kryer duke përdorur të dhënat e viteve 1982-2020.

Harta 22: Monitorimi aktual i ujërave sipërfaqësore në Pellgun e Lumit Ibër



## 4.2.2 Ujërat nëntokësore

Për ujërat nëntokësore ka të dhëna të kufizuara historike mbi sasinë dhe cilësinë. Vetëm kohët e fundit, në vitin 2022, është krijuar një rrjet monitorimi i ujërave nëntokësore. Rrjeti drejtohet nga IHMK dhe financohet nga Programi Mjedisor për Kosovën i SIDA-s. Në kohën e vlerësimit, nuk kishte të dhëna të mjaftueshme për cilësinë e ujërave nëntokësore. Prandaj, është bërë një vlerësim i bazuar në risk/rrezik që merr parasysh mënyrat e përdorimit të tokës. Kjo metodë është përshtatur nga çasja e përdorur për Lumin Vardar. Rezultatet e ciklit të parë të monitorimit (pranverë 2023) në kuadër të Pilot Programit të Monitorimit janë përdorur për të verifikuar rezultatet e vlerësimit të bazuar në risk/rrezik.

## 4.3 Vlerësimi i statusit të Ujërave Sipërfaqësore

### 4.3.1 Çasje e përgjithshme

Trupat ujqorë sipërfaqësorë vlerësohen për statusin e tyre kimik dhe ekologjik. Figura 3 paraqet procedurën e vlerësimit sipas DKU. Parimi 'një-jashtë- të gjithë-jashtë' zbatohet për vlerësimin e përgjithshëm të statusit. Statusi kimik është 'i mirë' nëse të gjitha substancat vlerësohen si të mira dhe 'jo i mirë' nëse një ose më shumë substanca nuk përmbushin standardin. Statusi ekologjik përcaktohet nga vlerësimi më i keq i elementeve të cilësisë biologjike. Nëse biologjia është në rregull, por një parametër i përgjithshëm fiziko-kimik ose një ndotës specifik nuk e arrin objektivin, vlerësimi i përgjithshëm ekologjik ulet në 'cilësinë mesatare'. Një vlerësim nuk është gjithmonë në dispozicion për çdo substancë ose parametër. Vlerësimi më pas bazohet në rezultatin më të keq të substancave ose parametrave që janë matur.

Vlerësimi 'një-jashtë- të gjithë-jashtë' tregon nëse një problem mbetet në një trup ujqor. Megjithatë, rezultati i kësaj metode nuk jep një ide për numrin e parametrave që nuk përputhen. Për shembull, nuk është e qartë nëse vetëm 1 substancë kimike nuk i përmbush objektivat, ose të gjitha substancat nuk i përmbushin objektivat. Prandaj, në këtë PMPL janë paraqitur rezultatet e parametrave individualë dhe elementeve të cilësisë.

Sugjerohet që programi i monitorimit të përfshijë edhe ngarkesën e sedimenteve në trupat ujqorë sipërfaqësorë, sidomos në degët kryesore të Ibrit si Sitnica dhe Drenica.




Figura 3: Procedura e përgjithshme për përcaktimin e statusit të trupit uhor sipërfaqësor (L- i lartë; MR – i mirë; M – mesatar; D – i dobët; K – i keq; nd – nuk ka të dhëna; DSH - dështon).

### 4.3.2 Statusi ekologjik

Statusi ekologjik bazohet në të ashtuquajturat elemente të cilësisë biologjike. Këto elemente janë organizmat si makrofitet, fitoplanktoni, peshqit dhe flora e fauna bentike. Për më tepër, kimia reflektohet duke marrë parasysh elementet e përgjithshme kimike dhe fiziko-kimike, si dhe ndotësit specifikë të pellgjeve lumore. Elementet e përgjithshme e mbështesin ekologjinë dhe përfshijnë ndotës organikë dhe lëndë ushqyese të degradueshme, duke reflektuar statusin e oksigjenimit dhe eutrofikimit. Ndotësit specifikë janë substanca që janë shqetësuese në një pellg. Parametrat hidromorfologjikë kanë rol vetëm në vlerësimin në dy klasë: në statusin ekologjik "i mirë" dhe atë "shumë i mirë", si dhe potencialin ekologjik "i mirë-maksimum". Statusi ekologjik vlerësohet në 5 klasa siç tregohet në Figura 4.

	Statusi i lartë - Nuk ka ndryshime ose ka ndryshime shumë të vogla antropogjene në cilësinë biologjike, elementet fiziko-kimike dhe hidromorfologjike të trupit uhor.
	Statusi i mirë - Nivele të lehta të devijimit të përbërjes dhe dendësisë së elementeve cilësore biologjike, me kushte fiziko-kimike dhe hidromorfologjike në përputhje me arritjen e një cilësie të mirë biologjik.
	Statusi mesatar - Devijim mesatar i elementeve të cilësisë biologjike në raport me statusin e lartë, me kushte fiziko-kimike dhe hidromorfologjike në përputhje me arritjen e cilësisë mesatare biologjike.
	Statusi i dobët - Ujërat që tregojnë dëshmi të ndryshimeve të mëdha në vlerat e elementeve të cilësisë biologjike (ECB).

	Statusi i keq - Ujërat që tregojnë dëshmi të ndryshimeve të rënda të vlerave të ECB.
--	--

**Figura 4: Klasifikimi i statusit ekologjik.**

### **Elementet e Cilësisë Biologjike**

Në pranverën e vitit 2023 në Pellgun e Ibrit u zhvillua një aktivitet monitorues. Në 18 lokacione u krye mostrimi për makroinvertebrorët bentikë, peshqit dhe diatometë. Për secilin prej këtyre elementeve cilësore, janë përdorur indeksat biotikë për të klasifikuar statusin e një trupi ujqor.

Tabela 32 përmbledh klasifikimin e elementeve të cilësisë biologjike. Është vlerësuar statusi për secilin element, dhe elementi i klasës më të ulët përcakton statusin e përgjithshëm të cilësisë biologjike. Ekziston vetëm një trup ujqor sipërfaqësor (Llapi) që klasifikohet si 'i mirë'. Dy kanë status 'mesatar' dhe tjerët klasifikohet në grupin 'i dobët' ose 'i keq'. Gjendja e keqe në Prishtinë – Bresje mund të shpjegohet me ngarkesën e lartë me substanca organike që kanë origjinë nga ujërat e zeza nga amvisëritë, gjë që rezulton në varfërim të oksigjenit gjatë verës.

**Tabela 32: Klasifikimi i elementeve të cilësisë biologjike (L- i lartë; MR – i mire; M – mesatar; D – i dobët; K – i keq; nd – nuk ka të dhëna).**

TUS	Kodi i TUS	Lokacioni i monitorimit	Makroinvertebrorët bentikë	Peshqit	Diatometë	Statusi i bazuar në elementin e klasës më të ulët
Ibër - 02	XK-02-16-02	Ibër-Koshtovë	M	nd	MR	M
Ibër - 03	XK-02-16-04	Ibër Mitrovicë	D	K	M	K
Ibër - 04	XK-02-16-05	Ibër -Kelmend	D	nd	D	P
Lumi i Gadimes	XK-02-02-01	Sitnicë - Bablak	D	K	D	K
Sitnicë – 04	XK-02-01-06	Sitnica - Plemetin	K	K	D	K
Sitnicë – 05	XK-02-01-07	Sitnicë - Nedakovc	D	nd	M	D
Sitnicë - 06	XK-02-01-08	Sitnicë - Mitrovicë	D	nd	D	D
Llapi– 01	XK-02-10-01	Llap - Murgullë	MR	MR	MR	MR
Llap – 03	XK-02-10-03	Llap - Milloshevë	D	M	M	D
Sitnicë – 04	XK-02-01-06	Prishtinë - Bresje	K	K	K	K
Gracankë – 02	XK-02-04-03	Gracankë - Vragoli	K	K	K	K
Drenicë - 01	XK-02-07-01	Drenica - Pjetërshticë	M	nd	MR	M
Sitnicë – 03	XK-02-01-05	Drenicë - Vragoli	D	D	M	D
Shtimje – 01	XK-02-01-01	Shtime - Devetak	M	nd	M	M
Shtimje – 02	XK-02-01-02	Shtime - Muzeqinë	D	nd	D	D
Rezervuar	XK-02-08-03	Batllavë	M	M	M	M
Rezervuar	XK-02-16-01	Ujman	M	nd	MR	M
I pacaktuar në TUS		Drenicë - Krojmir	P	K	MR	K

### **Elementet e përgjithshme të cilësisë kimike dhe fiziko-kimike**

Janë testuar parametrat e përgjithshëm që mbështesin statusin ekologjik, të cilët përfshijnë kushtet e oksigjenimit (oksigjeni i tretur dhe Shpenzimi Biokimik i Oksigjenit) dhe lëndët nutritive (përbërjet e azotit dhe fosforit). Për të vlerësuar gjendjen e atyre trupave ujqorë për të cilët nuk ka të dhëna monitorimi, janë përdorur rezultatet e studimit të modelimit të cilësisë së ujit. Modelimi gjeneroi produktin për SHBO, P dhe N total. Rezultatet janë përfshirë për ata trupa ujqorë për të cilët nuk ka të dhëna monitorimi. Ruzultatet e modelimit janë paraqitur në tabelë me qelizë të hijezuar.

Duke përdorur parimin 'një-jashtë-të gjithë-jashtë', është përcaktuar statusi i përgjithshëm i trupave ujqorë. Elementi i klasës më të ulët jepet në kolonën e fundit, duke treguar nëse trupi ujqor nuk ka status të mirë. Rezultatet janë paraqitur në Tabela 33.

Vetëm 4 trupa ujqorë sipërfqësorë plotësojnë statusin " e mirë". Për shkak të niveleve të larta të SHBO dhe lëndëve ushqyese, të tjerët nuk arrijnë të përmbushin statusin " e mirë". Në veçanti, pranë zonave urbane statusi është 'i keq'. Lëndët e larta ushqyese, në veçanti fosfori, tregojnë gjithashtu ndikimin e bujqësisë intensive.

Tabela 33: Klasifikimi i elementeve të përgjithshme kimike (L- i lartë; MR – i mire; M – mesatar; D – i dobët; K – i keq; nd – nuk ka të dhëna).

TUS	Kodi i TUS	Lloji i TUS	Stacioni i monitorimit	Oksigjeni i tretur (OT) mg/l	Shpenzimi Biokimik i Oksigjenit (SHBO <sub>5</sub> ) mg/l	Amonium (NH <sub>4</sub> ) mg N/l	Nitrate (NO <sub>3</sub> ) mg N/l	Azot total mg N/l	Orto fosfate (PO <sub>4</sub> ) mg P/l	Fosfortotal us mg P/l	Konduktiviteti (EC) µS/cm	Status i bazuar në elementin e klasës më të ulët
Shtimje-01	XK-02-01-01	Natyrall	Devetak	8.05	3.45	0.24	0.10	0,55	0.07	0,16	309	M
Shtimje-02	XK-02-01-02	Natyrall	Muzeqine	7.35	16.29	0.92	0.73	2,89	0.18	0,9	460	D
Sitnica-01	XK-02-01-03	Natyrall	Sitnica Lipjan	nd	161,44	nd	nd	18,59	nd	4,84	nd	K
Sitnica-02	XK-02-01-04	TUMR	Sitnica Vragoli	8.77	15.96	0.29	0.43	5,34	0.40	1,36	710	K
Sitnica-03	XK-02-01-05	Natyrall	Drenica Vragoli	6.87	28.54	0.75	2,46	5,09	0.38	1,37	741	K
Sitnica-04	XK-02-01-06	TUMR	Sitnica Nedakoc	6.05	29.63	2.22	1.38	5,44	0.53	1,41	733	K
			Sitnica Mitrovice	nd	20,25	nd	nd	5,57	nd	1,46	nd	K
Sitnica-05	XK-02-01-07	Natyrall	Bablak	6.13	23.23	1.96	1.46	5,18	0.37	1,17	645	K
Sitnica-06	XK-02-01-08	TUMR		nd	23,33	nd	nd	5,35	nd	1,29	nd	K
Lumi i Gadimes	XK-02-02-01	Natyrall			0,28			0,7		0,14		MR
Vershec	XK-02-03-01	Natyrall			0,23			0,07		0,02		L
Klisura	XK-02-04-01	Natyrall			0,2			0,9		0,11		MR
Gracanka 01	XK-02-04-02	TUMR	GraqankaVragoli	5.98	30.31	3.40	0.53	6,4	0.69	1,80	1435	K
Gracanka-02	XK-02-04-03	Natyrall			29,33			6,33		1,76		K
Lumi i Magures	XK-02-05-01	Natyrall	Bresje	4.37	73.72	5.07	0.44	10,51	0.97	3,77	733	K
Prishtevka	XK-02-06-01	Natyrall	Pjetershtice	7.00	4.34	0.11	0.12	0,59	0.03	0,10	370	MR
Drenica-01	XK-02-07-01	Natyrall			88,3			6,45		1,5		K
Drenica-02	XK-02-07-02	Natyrall			27,97			5,06		1,28		K

TUS	Kodi i TUS	Lloji i TUS	Stacioni i monitorimit	Oksigjeni i tretur (OT) mg/l	Shpenzimi Biokimik i Oksigjenit (SHBO <sub>5</sub> ) mg/l	Amonium (NH <sub>4</sub> ) mg N/l	Nitrate (NO <sub>3</sub> ) mg N/l	Azot total mg N/l	Orto fosfate (PO <sub>4</sub> ) mg P/l	Fosfortotal us mg P/l	Konduktiviteti (EC) µS/cm	Status i bazuar në elementin e klasës më të ulët
Keçekollë	XK-02-08-01	Natyral			0,11			0,47		0,08		K
Lumi Kalatica	XK-02-08-02	Natyral			0,12			0,62		0,08		K
Batllava	XK-02-08-03	TUMR			0,08			0,02		0		K
Lumi i Dumnicës	XK-02-09-02	Natyral	Murgulle	7.35	3.98	0.21	0.15	0,71	0.06	0,33	341	MR
Llapi-01	XK-02-10-01	Natyral	Podujeve	6.72	22.98	1.53	0.90	4,43	0.22	1,19	512	K
Llapi-02	XK-02-10-02	Natyral	Llapi Millosheve	6.63	19.08	1.27	2.01	4,90	0.22	0,23	514	D
Llapi-03	XK-02-10-03	Natyral			18,47			4,88		1,02		K
Lushta	XK-02-11-01	Natyral			0,75			2,03		0,26		M
Lumi i Brosovackës	XK-02-12-01	Natyral			0			0,03		0		L
Lumi i Kozareves	XK-02-13-01	Natyral			0,05			0,03		0,01		L
Lumi i Banjes	XK-02-14-01	Natyral			0,05			0,03		0,01		L
Bistrica	XK-02-15-01	Natyral			1,64			0,2		0,04		L
Ibër-01	XK-02-16-01	TUMR	Koshtove	8.47	2.98	0.65	0.25	1,11	0.05	0,16	298	M
Ibër-02	XK-02-16-02	Natyral	Mitrovicë	9.14	17.46	0.90	0.40	2,62	0.11	0,70	341	D
Ibër-03	XK-02-16-04	TUMR	Kelmend	7.87	19.59	1.56	1.28	4,67	0.20	0,81	478	K
Ibër-04	XK-02-16-05	Natyral			3,94			4,36		0,75		D

## **Ndotësit Specifikë të Pellgut Lumor (NSPL)**

Statusi për ndotës specifikë bazohet vetëm në disa metale për arsye se për këto substanca kishte informacion të mjaftueshëm. Duhet të theksohet se mund të ketë substanca të tjera problematike. Këtu përfshihen materiet farmaceutike, pesticidet, substanca per- dhe polifluoroalkile (PFAS) dhe ndotës të tjerë në zhvillim e sipër. Hulumtimet e mëtejshme mund të përcaktojnë se cilat substanca janë të rëndësishme.

Përqendrimit mesatare të metaleve të rënda si kromi (Cr), mangani (Mn), zinku (Zn), bakri (Cu) dhe hekuri (Fe) për një periudhë tre vjeçare nga 2015-2017 janë paraqitur në Tabela 34. Niveli i kromit në trupat ujqorë sipërfaqësorë Sitnica 03, 04 dhe Graçanka 02 është i lartë dhe prandaj këtu kemi statusin 'e dobët'. Në trupat e tjerë ujqorë gjendja është 'e lartë deri në mesatare'. Për zinkun, bakrin dhe hekurin statusi është 'i lartë' drejt 'i mirë'. Për manganin koncentrimet të larta janë gjetur për dy trupa ujqorë (Sitnica – 06 dhe Graçanka 02).


**Tabela 34: Klasifikimi i ndotësve specifikë të pellgut lumor (metalet)**

TUS	Kodi i TUS	Forma e TUS	Stacioni i monitorimit	Nënpellgu	Kromi (Cr) µg/l	Zinku (Zn) µg/l	Mangani (Mn) µg/l	Bakri (Cu) µg/l	Hekuri (Fe) µg/l	Status i bazuar në elementin e klasës më të ulët
Shtimje-01	XK-02-01-01	Natyrall	Devetak	XK-02-01	6	3	43	8	36	L
Shtimje-02	XK-02-01-02	Natyrall	Muzeqine		28	5	80	10	134	MR
Sitnica-01	XK-02-01-03	Natyrall	Sitnica Lipjan							
Sitnica-02	XK-02-01-04	TUMR	Sitnica Vragoli		71	40	251	22	110	M
Sitnica-03	XK-02-01-05	Natyrall	Drenica Vragoli		154	25	92	14	219	D
Sitnica-04	XK-02-01-06	TUMR	Bresje Sitnica Plemetin		177	43	296	37	224	D
Sitnica-05	XK-02-01-07	Natyrall	Sitnica Nedakoc							
Sitnica-06	XK-02-01-08	TUMR	Sitnica Mitrovicë		68	1337	493	76	339	D
Lumi i Gadimes	XK-02-02-01	Natyrall	Bablak	XK-02-02						
Vershec	XK-02-03-01	Natyrall		XK-02-03						
Klisura	XK-02-04-01	Natyrall								
Gracanka-01	XK-02-04-02	TUMR		XK-02-04						
Gracanka-02	XK-02-04-03	Natyrall	Graçanka Vragoli		172	895	4492	9	826	K
Lumi i Magures	XK-02-05-01	Natyrall		XK-02-05						
Prishtevka	XK-02-06-01	Natyrall		XK-02-06						
Drenica-01	XK-02-07-01	Natyrall	Pjetershticë	XK-02-07	7	13	55	9	42	L
Drenica-02	XK-02-07-02	Natyrall								
Keçekolla	XK-02-08-01	Natyrall		XK-02-08						
Lumi Kalatica	XK-02-08-02	Natyrall								
Batllava	XK-02-08-03	TUMR								
Lumi i Dumnicës	XK-02-09-02	Natyrall		XK-02-09						
Llapi-01	XK-02-10-01	Natyrall	Murgull	XK-02-10	9	46	382	32	358	D

TUS	Kodi i TUS	Forma e TUS	Stacioni i monitorimit	Nënpellgu	Kromi (Cr) µg/l	Zinku (Zn) µg/l	Mangani (MN) µg/l	Bakri (Cu) µg/l	Hekuri (Fe) µg/l	Status i bazuar në elementin e klasës më të ulët
Llapi-02	XK-02-10-02	Natyrall	Podujevë		9	35	167	19	399	M
Llapi-03	XK-02-10-03	Natyrall	Llapi Milloshevë		9	79	168	29	298	M
Lushta	XK-02-11-01	Natyrall		XK-02-11						
Lumi i Brosovaçkës	XK-02-12-01	Natyrall		XK-02-12						
Lumi i Kozarevës	XK-02-13-01	Natyrall		XK-02-13						
Lumi i Banjës	XK-02-14-01	Natyrall		XK-02-14						
Bistrica	XK-02-15-01	Natyrall		XK-02-15						
Ibër-01	XK-02-16-01	TUMR								
Ibër-02	XK-02-16-02	Natyrall	Koshtovë	XK-02-16	25	7	74	17	71	MR
Ibër-03	XK-02-16-04	TUMR	Mitrovicë		58	13	77	10	80	M
Ibër-04	XK-02-16-05	Natyrall	Kelmend		66	387	276	181	126	M
Kanali Ibër-Lepenec	XK-02-17-01	TUA								

### Vlerësimi i përgjithshëm i statusit ekologjik

Duke përdorur parimin 'një-jashtë-të gjithë-jashtë', **Error! Reference source not found.** tregon vlerësimin e përgjithshëm të statusit ekologjik bazuar në të gjithë elementët e cilësisë së vëzhguar.



**Figura 5: Vlerësimi i përgjithshëm i statusit ekologjik.**

Për 17 trupa ujqorë ka të dhëna të pamjaftueshme. Të gjithë trupat ujqorë sipërfaqësorë të monitoruar nuk arrijnë të përmbushin statusin 'e mirë' ekologjik. 9 prej tyre e kanë statusin 'e keq', 4 e kanë statusin 'e varfër' dhe 3 statusin 'mesatar'. Shkaku kryesor i gjendjes së keqe

janë shkarkimet e ujërave të zeza të patrajuara nga amvisëritë dhe shkarkimet industriale. Në disa trupa ujqorë, bujqësia intensive krijon gjithashtu probleme në cilësinë e ujit.

### 4.3.3 Statusi kimik

Statusi kimik bazohet në substancat prioritare. Për substancat prioritare, një trup ujqor ose është në përputhje ose nuk është, pra nuk ka klasifikim në klasa. "E kuqe" do të thotë që dështon të përmbushet standardi i cilësisë mjedisore dhe "e kaltër" do të thotë që përmbushet. Ekziston një listë e substancave prioritare në mbarë BE. Nga kjo listë disponohen të dhëna vetëm për metalet e rënda kadmium (Cd), nikel (Ni) dhe plumb (Pb). Është përdorur përqendrimi mesatar për një periudhë tre vjeçare 2015-2017. Tabela 34 tregon rezultatet.

**Tabela 35: Klasifikimi i substancave prioritare (Cd, Ni dhe Pb) (Dsh – Dështon).**

TUS	Kodi i TUS	Forma e TUS	Stacioni i monitorimit	Kodi EU	Kadmium (Cd) µg/l	Nikel (Ni) µg/l	Plumb (Pb) µg/l	Status i bazuar në elementin e klasës më të ulët
Shtimje-01	XK-02-01-01	Natyrall	Devetak	5	9.42	20	34.0	Dsh
Shtimje-02	XK-02-01-02	Natyrall	Muzeqine	5	16.67	25	32.2	Dsh
Sitnica-01	XK-02-01-03	Natyrall	Sitnica Lipjan	5				
Sitnica-02	XK-02-01-04	TUMR	Sitnica Vragoli	5	14.25	43	9.0	Dsh
Sitnica-03	XK-02-01-05	Natyrall	Drenica Vragoli	5	18.83	54	21.1	Dsh
Sitnica-04	XK-02-01-06	TUMR	Bresje	5	20.17	20	83.3	Dsh
			Sitnica Plemetin		12.09	64	6.8	Dsh
Sitnica-05	XK-02-01-07	Natyrall	Sitnica Nedakoc	5				
Sitnica-06	XK-02-01-08	TUMR	Sitnica Mitrovicë	5	7.73	75	63.8	Dsh
Lumi i Gadimes	XK-02-02-01	Natyrall	Bablak	5				
Vershec	XK-02-03-01	Natyrall		5				
Klisura	XK-02-04-01	Natyrall		5				
Gracanka-01	XK-02-04-02	TUMR		5				
Gracanka-02	XK-02-04-03	Natyrall	Graqanka Vragoli	5	39.21	411	142.4	Dsh
Lumi i Magures	XK-02-05-01	Natyrall		5				
Prishtevka	XK-02-06-01	Natyrall		5				
Drenica-01	XK-02-07-01	Natyrall	Pjetershticë	5	3.57	17	3.2	Dsh
Drenica-02	XK-02-07-02	Natyrall		5				
Keçekollë	XK-02-08-01	Natyrall		5				
Kalatica	XK-02-08-02	Natyrall		5				
Batllava	XK-02-08-03	TUMR		5				

TUS	Kodi i TUS	Forma e TUS	Stacioni i monitorimit	Kodi EU	Kadmiu m (Cd) µg/l	Nikel (Ni) µg/l	Plumb (Pb) µg/l	Status i bazuar në elementin e klasës më të ulët
Lumi i Dumnicës	XK-02-09-02	Natyral		5				
Llapi-01	XK-02-10-01	Natyral	Murgull	5	15.51	23	241.8	Dsh
Llapi-02	XK-02-10-02	Natyral	Podujevë	5	22.53	62	38.6	Dsh
Llapi-03	XK-02-10-03	Natyral	Llapi Milloshevë	5	14.05	78	77.9	Dsh
Lushta	XK-02-11-01	Natyral		5				
Lumi i Brosovaçkës	XK-02-12-01	Natyral		5				
Lumi i Kozarevës	XK-02-13-01	Natyral		5				
Lumi i Banjës	XK-02-14-01	Natyral		5				
Bistrica	XK-02-15-01	Natyral		5				
Ibër-01	XK-02-16-01	TUMR		5				
Ibër-02	XK-02-16-02	Natyral	Kushtove	5	15.01	44	2.3	Dsh
Ibër-03	XK-02-16-04	TUMR	Mitrovice	5	19.39	68	4.1	Dsh
Ibër-04	XK-02-16-05	Natyral	Kelmend	5	9.51	82	209.4	Dsh
Kanali Ibër-Lepenec	XK-02-17-01	TUA		5				

Të gjithë TUS dështojnë të përmbushin statusin 'e mirë'. Në shumicën e trupave ujqorë, nivelet për Ni dhe Pb nuk përmbushin standardin. Në të gjithë trupat ujqorë, përqendrimi i Cd e ka tejkaluar vlerën standarde. Figura 6 përmbledhë të dhënat për statusin kimik. Statusi i 14 TUS është i keq dhe për 19 TUS nuk ka të dhëna.




Figura 6: Vlerësimi i përgjithshëm i statusit kimik TUS.

Gjatë monitorimit në stinën e pranverës (2023) të zhvilluar gjatë pilot programit të monitorimit, mostrat u analizuan edhe për pesticidet organoklorine dhe hidrokarburet aromatike policiklike (HAP). Shumë prej këtyre ndotësve janë përfshirë edhe në listën e BE të substancave prioritare. Mostrat janë analizuar nga Qendra për Kërkime Ekotoksikologjike në Podgoricë. Për të gjitha mostrat e marra, nivelet e pesticideve ishin nën nivelin e detektimit. Për shumicën e HAP përqendrimet ishin gjithashtu nën nivelin e detektimit (NND). Në lokacionet ku u gjetën këta ndotës, nivelet ishin shumë më poshtë sesa përqendrimet maksimale të lejuara të për standardet e cilësisë mjedisore. Megjithatë, duhet theksuar se mostrimi është bërë vetëm një herë. Prandaj, për shkak të ndryshueshmërisë sezonale në përqendrim, kjo mund të mos japë një pasqyrë reprezentative.

#### 4.3.4 Statusi hidromorfologjik

Nuk është bërë vlerësimi i plotë për ndikimet hidromorfologjike në Pellgun e Ibrit pasi që aktualisht nuk ka të dhëna për një kuantifikim objektiv të ndikimit hidrologjik dhe/ose morfologjik sipas Standardit Teknik Evropian.

Megjithatë, si një tregues shumë të përafërt, praktikat më të mira ndërkombëtare pranojnë gjerësisht Indeks Bazik të Rrjedhjes (IBRR). Ky indeks i natyralizuar i lumenjve është një tregues i mirë i shkarkimit vjetor të ujërave nëntokësore në sistemin e ujërave sipërfaqësore. IBRR përcaktohet nga kurba e kohëzgjatjes së rrjedhës (KKRR) si raporti Q90/Q50. Në terma afatgjatë, duke supozuar se pellgu i lumit është në ekuilibër hidrodinamik, shkarkimi i ujërave nëntokësore duhet të jetë i barabartë me rimbushjen e ujërave nëntokësore. Përqindjet Q10/Q50 dhe Q90 janë nxjerrë nga modelimet hidrologjike të Vlerësimit të Bilancit Ujor realizuar në kuadër të MIRU-K. Llogaritjet janë bërë duke përdorur seritë e të dhënave të rrjedhës për periudhën 1982-2020. Rezultatet janë paraqitur në **Error! Reference source not found.** Bazuar në IBRR, statusi i të gjithë trupave ujorë është vlerësuar si 'i mirë'. Një IBRR më e madhe se 0.3 është përdorur si prag.

**Tabela 36: Vlerësimi i statusit hidromorfologjik bazuar në regjimin e rrjedhjes.**

TUS	Kodi i TUS	Forma e lumit	Nënpellgu lokal	Regjimi aktual i rrjedhjes				Statusi i sasisë së ujit sipërfaqësor
				Q10	Q50	Q90	BFI	
Shtimje – 01	XK-02-01-01	Natyral	Shtime	0.71	0.27	0.1	0.37	I Mirë
Shtimje – 02	XK-02-01-02	Natyral	Shtime	2.27	0.68	0.27	0.39	I Mirë
Sitnica – 01	XK-02-01-03	Natyral	Sitnica	6.22	2.04	0.68	0.33	I Mirë
Sitnica – 03	XK-02-01-05	Natyral	Sitnica	10.28	4.29	2.01	0.47	I Mirë
Sitnica – 05	XK-02-01-07	Natyral	Sitnica	29.09	9.97	4.62	0.46	I Mirë
Lumi i Gadimes	XK-02-02-01	Natyral	Gadima	0.66	0.08	0.03	0.37	I Mirë
Vershec	XK-02-03-01	Natyral	Vershec	0.77	0.23	0.08	0.32	I Mirë
Klisura	XK-02-04-01	Natyral	Klisura	0.87	0.13	0.05	0.36	I Mirë
Gracanka – 02	XK-02-04-03	Natyral	Gracanka	3.41	1.3	0.39	0.3	I Mirë
Lumi i Magures	XK-02-05-01	Natyral	Magura	0.42	0.16	0.06	0.36	I Mirë
Prishevka	XK-02-06-01	Natyral	Prishevka	1.19	0.43	0.18	0.42	I Mirë
Drenica - 01	XK-02-07-01	Natyral	Drenica	4.82	1.25	0.43	0.34	I Mirë
Drenica – 02	XK-02-07-02	Natyral	Drenica	5.66	1.49	0.49	0.33	I Mirë
Keçekolla	XK-02-08-01	Natyral	Keçekollë	1.05	0.14	0.04	0.3	I Mirë
Lumi Kalatica	XK-02-08-02	Natyral	Kalaticë	1.03	0.15	0.06	0.36	I Mirë
Lumi i Dumnicës	XK-02-09-02	Natyral	Dumnicë	4.3	1.29	0.43	0.33	I Mirë
Llapi – 01	XK-02-10-01	Natyral	Llapi	0.98	0.25	0.1	0.4	I Mirë
Llapi - 02	XK-02-10-02	Natyral	Llapi	3.16	0.95	0.33	0.35	I Mirë
Llapi – 03	XK-02-10-03	Natyral	Llapi	8.6	2.89	1.4	0.48	I Mirë
Lushta	XK-02-11-01	Natyral	Lushta	0.56	0.08	0.03	0.37	I Mirë
Lumi i Brosovaçkës	XK-02-12-01	Natyral	Brosovaçka	0.57	0.13	0.04	0.3	I Mirë
Lumi i Kozarevës	XK-02-13-01	Natyral	Kozareva	0.36	0.08	0.04	0.47	I Mirë
Lumi i Banjës	XK-02-14-01	Natyral	Banja	0.98	0.21	0.09	0.43	I Mirë

TUS	Kodi i TUS	Forma e lumit	Nënpellgu lokal	Regjimi aktual i rrjedhjes				Statusi i sasisë së ujit sipërfaqësor
				Q10	Q50	Q90	BFI	
Bistrica	XK-02-15-01	Natyrat	Bistrica	2.32	0.72	0.28	0.39	I Mirë
Ibër - 02	XK-02-16-02	Natyrat	Ibër	38.25	8.99	3.2	0.36	I Mirë
Ibër – 04	XK-02-16-05	Natyrat	Ibër	58.85	19.21	7.53	0.39	I Mirë

#### 4.4 Vlerësimi i statusit të ujërave nëntokësore

##### Vlerësimi i rrezikut për sasinë e ujërave nëntokësore

Nëse nxjerrjet nga trupat ujqorë nëntokësore nuk balanohen nga rimbushja në akuiferë, gjendja sasore e trupave ujqorë nëntokësore nuk do të jetë e mirë. Aktualisht, nuk ka stacione monitorimi të ujërave nëntokësore në pellg që kryejnë monitorimin e nivelit të ujërave nëntokësore. Për të vlerësuar statusin sasior, të dhënat për nxjerrjet e ujërave nëntokësore duhet të vihen në dispozicion nëpërmjet kompanive të furnizimit me ujë të pijshëm. Informatat nga kërkesat për leje për nxjerrjet e ujërave nëntokësore gjithashtu duhet të jenë në dispozicion. Rezultati nga rrjeti i sapokrijuar i monitorimit të ujërave nëntokësore mund të plotësojë mangësitë e të dhënave në mënyrë që të bëhet një vlerësim i duhur i rrezikut për sasinë e ujërave nëntokësore. Përveç kësaj, këshillohet të përdoret modeli i ujërave nëntokësore për të vlerësuar rimbushjen e ujërave nëntokësore. Modelimet mund të përdoren gjithashtu për të kontrolluar nëse resurset ujore nëntokësore po përdoren në mënyrë të qëndrueshme.

##### Vlerësimi i rrezikut për cilësinë e ujërave nëntokësore

Për shkak se nuk ka fare të dhëna ose ka të dhëna të kufizuara për cilësinë e ujërave nëntokësore, nuk mund të kryhet një vlerësim i plotë i statusit. Informacioni për mbulueshmërinë e tokës është përdorur për të vlerësuar rrezikun nga presionet e aktiviteteve në sipërfaqen e tokës. Supozohet se këto aktivitete prekin edhe akuiferët nën sipërfaqe. Duke përdorur informacionin CORINE për mbulueshmërinë e tokës (2018) duke përfshirë vendet e minierave dhe deponive, zonat urbane, zonat bujqësore, pyjet, kullotat dhe mjediset e tjera natyrore, u vlerësua rreziku i mundshëm i kontaminimit të trupave ujqorë nëntokësore. Është përcjellë metodologjia dhe supozimet që janë përdorur në Planin e Menaxhimit të Pellgut të Lumit Vardar për vlerësimin e rrezikut kimik të ujërave nëntokësore (Raporti Teknik, Projekti i Binjakëzimit, 2019). Një përshkrim i detajuar i metodologjisë është paraqitur në raportin për Vlerësimin e Statusit dhe Analizën Preliminare të Mangësive për Pellgun e Ibrit (Raporti Teknik, Projekti i Binjakëzimit, 2019, Shtojca IV). Janë marrë në konsideratë katër klasë rreziqesh siç janë paraqitur në Tabela 37. Për çdo lloj përdorimi të tokës, është përcaktuar klasa e rrezikut.


**Tabela 37: Klasët e rrezikut të përdorura për tipin e përdorimit të tokës.**

Përdorimi i tokës	Burimi i palëvizshëm ose i lëvizshëm	Rrezik i Lartë, Mesatar ose i Ulët	Klasa e rrezikut
MINIERA, INDUSTRI, MBETURINA	I palëvizshëm	I lartë	1
Urbane	Difuziv ose i palëvizshëm	I lartë	1
Bujqësi intensive	Difuziv	Mesatarisht i Lartë	2
Bujqësi ekstensive	Difuziv	Mesatar	3
Zona natyrore	Asnjë	I Ulët	4
Ujë	Asnjë	I Ulët	4

Bazuar në këto klasë rreziku dhe sipërfaqet e përdorimit të tokës për secilin prej trupave ujqorë nëntokësore, është llogaritur një vlerë relative rreziku. Rezultatet janë paraqitur në Harta 23.


Vlerat më afër 1 tregojnë zonat me rrezik 'të lartë' dhe vlerat më afër 4 tregojnë zonat me 'rrezik të ulët'. Tabela 38 paraqet vlerësimin e trupave ujorë nëntokësorë në Pellgun e Ibrit.

**Harta 23: Nota e vlerësimit të rrezikut kimik për trupat nëntokësorë.**



**Tabela 38: Vlerësimi i statusit për trupat ujorë nëntokësorë në Pellgun e Ibrit.**

Kodi i trupit ujor nëntokësor	Trupi nëntokësor, Lumi	Vlerësimi i parë i statusit të cilësisë së ujërave nëntokësore
XKUN0018	Drenicë, Ibër	Rrezik relativisht i lartë
XKUN0022	Reqicë, Ibër	Rrezik relativisht mesatar/i ulët
XKUN0023	Qyqavicë, Ibër	Rrezik relativisht mesatar/i ulët
XKUN0024	Vicianum, Ibër	Rrezik relativisht i lartë
XKUN0025a	Trepçë, Ibër	Rrezik relativisht mesatar/i ulët
XKUN0025b	Badovc, Ibër	Rrezik relativisht mesatar/i ulët



**Figura 7: Vlerësimi i përgjithshëm i statusit kimik TUN.**

### **Pilot Programi i Monitorimit**

Në pranverën e vitit 2023, është kryer cikli i parë i mostrimit të ujërave nëntokësore si pjesë e Pilot Programit të Monitorimit. Rezultatet janë përdorur si një verifikim fillestar i vlerësimit të rrezikut. Mostrat janë analizuar për disa parametra të përgjithshëm, metale, pesticide organoklorine dhe HAP. Rezultatet janë testuar rreth përputhjes me standardet e përgjithshme të BE për ujërat nëntokësore (Tabela 39). Këto përfshijnë nitratet dhe pesticidet. Për parametrat e tjerë, rezultatet duhet të testohen kundrejt vlerave të pragut (VP) që mbetet të caktohen.

**Tabela 39: Përputhshmëria e rezultateve të nitrateve dhe pesticideve me standardet e përgjithshme të BE për ujërat nëntokësore.**

Kodi i TUN	XKUN0024								XKUN0025a	
	Vicianum								Trepça	
Emri i TUN	P1	P2	P101	PZ128	P 4 (P1-8)	P5	P 6 (P56)	P7	Standardi i BE	
Lokaliteti i mostrimit										
Nitrate (mg/l)	19,4	3	15	27,4	140	38,6	310	23,6	50	
Pesticide (µg/l)	Të gjitha poshtë LoQ <0,00005								0,1	

Shumica e pikave të monitorimit janë në trupin ujor nëntokësor XKUN0024 (Vicianum). Bazuar në analizën e rrezikut, ky trup ujor nëntokësor tregon një rrezik relativisht të lartë dhe këtë e konfirmojnë edhe rezultatet e monitorimit. Në dy lokacione (P4 dhe P6), vërehet një tejkalim i konsiderueshëm i standardit të nitrateve. Nivele të ngritura të nitrateve vërehen edhe në disa lokalitete tjera. Një përqendrim i shtuar i nitrateve vërehet edhe në trupin ujor nëntokësor XKUN0024a (Trepça). Ky trup ujor u vlerësua në kategorinë e rrezikut 'mesatar drejt nivelit të ulët'.

Pesticidet e matura në të gjitha mostrat ishin nën nivelin e kuantifikimit dhe si të tilla nivelet e vëzhguara nuk e kalonin standardin e BE. Megjithatë, duhet theksuar se janë matur vetëm pesticidet organoklorine, të tilla si Aldrini, Dieldrini, Endosulfani, Heksaklorobenzeni dhe DDT. Shumica e këtyre pesticideve janë ndaluar të përdoren nga BE për mbrojtjen e bimëve. Pasi që Kosova zyrtarisht ndjek rregulloren e BE për praninë e pesticideve, është e pasigurtë nëse këto komponime ende përdoren në sasi të mëdha. Kjo mund të shpjegojë pse këto substanca nuk u gjetën. Rekomandohet një rivlerësim i substancave të matura.

#### 4.5 Zonat e mbrojtura

Duke qenë se nuk ka monitorim specifik për zonat e mbrojtura, statusi nuk është vlerësuar. Rekomandimet për monitorim janë paraqitur më poshtë.

#### 4.6 Rekomandimet për monitorim

Duhet kuptuar se ky është vlerësimi i parë i statusit për trupat ujorë sipërfaqësorë dhe nëntokësorë në Pellgun e Ibrit. Vlerësimi u bazua në të dhënat historike në dispozicion dhe në rezultatet e para të programit pilot të monitorimit. Megjithëse të dhënat në dispozicion janë të kufizuara, mund të konkludohet se shumë trupa ujorë nuk arrijnë të përmbushin statusin e mirë.

Monitorimi duhet të vazhdojë dhe të avansohet për të përditësuar më tej vlerësimin në ciklin e ardhshëm të Planit të Menaxhimit të Pellgut Lumor. Kjo duhet të rezultojë në një përditësim dhe kuptim më të mirë të statusit. Përveç kësaj, DKU kërkon gjithashtu monitorim mbikqyrës për të vlerësuar ndryshimet afatgjata në kushtet natyrore ose ato që vijnë si rezultat i aktivitetit antropogjen. Në planin afatgjatë, monitorimi duhet të ndihmojë gjithashtu në përcaktimin e efikasitetit të masave për përmirësimin e statusit.

Duke pasur parasysh burimet dhe kapacitetet e kufizuara financiare, gjithçka nuk mund të bëhet menjëherë. Është e nevojshme të caktohen prioritetet në bazë të resurseve në dispozicion. Kjo do të thotë se një rrjet i plotë monitorimi sipas DKU duhet të implementohet hap pas hapi.


##### 4.6.1 Ujërat sipërfaqësore

Nuk janë monitoruar të gjithë trupat ujorë sipërfaqësorë. Kjo do të thotë se statusi ekologjik i 19 TUS dhe statusi kimik i 17 TUS nuk mund të përcaktohet. Është propozuar një rrjet prej 35 lokalitetesh monitorimi (shih hartën). Duke pasur parasysh burimet e kufizuara, është vendosur një prioritet. Gjithashtu, sa i përket frekuencave të rekomanduara të monitorimit propozohen frekuenca mesatare dhe minimale. Kjo lejon zbatimin hap pas hapi të rrjetit të plotë të monitorimit, në përputhje me kërkesat e BE (shih **Shtojcën V**).

DKU kërkon krahasimin e statusit me kushtet referente. Kjo nuk është bërë në analizën aktuale të statusit, sepse nuk kishte të dhëna të mjaftueshme për të përcaktuar kushtet referente. Propozohet të kryhet një monitorim hetimor shtesë për të përcaktuar kushtet referente.

Gjithashtu, duhet të kryhet monitorim shtesë hetimor për statusin kimik. Bazuar në nivelet e kadmiumit (Cd), nikelit (Ni) dhe plumbit (Pb), të gjithë trupat ujorë sipërfaqësorë janë në rrezik. Arsyeja e përqendrimeve të larta të këtyre metaleve të rënda nuk dihet. Burimet e mundshme janë aktivitetet minerare, shkarkimet industriale, ujërat e zeza nga amvisëritë dhe deponitë. Përqendrimit e ngritura mund të shkaktohen edhe nga gjeologjia. Përcaktimi i një vlere krahasuese përqëndrimi është i nevojshëm për të dhënë një përgjigje përfundimtare.

Harta 24: Monitorimi i propozuar për ujërat sipërfaqësore.



#### 4.6.2 Ujërat nëntokësore

Për të vlerësuar gjendjen sasiore të ujërave nëntokësore, kërkohet kuantifikim i mëtejshëm i ujit të përdorur për pije dhe industri. Këto të dhëna duhet të vihen në dispozicion të ARPL. Për të vlerësuar nëse nxjerrja e ujit është në ekuilibër me rimbushjen e trupave ujqorë nëntokësore, mund të merret parasysh modelimi i ujërave nëntokësore. Të dhënat që rezultojnë nga rrjeti i monitorimit të nivelit të ujërave nëntokësore të krijuar së fundmi mund të përdoren për të përcaktuar nëse ujërat nëntokësore përdoren në mënyrë të qëndrueshme.

Për monitorimin e cilësisë së ujërave nëntokësore janë marrë mostra nga pusët ekzistuese në pellg. Një stacion monitorimi duhet të shtohet në pjesën veriore të Vicianum-it. Drenica nuk ka pika në kuadër të pilot monitorimit të ujërave nëntokësore, prandaj rrjeti duhet të zgjerohet në këtë pellg lumor. Grupi i trupave ujqorë nëntokësore Qyqavicë/Trepçë/Badovc ka vetëm një pikë në kuadër të pilot monitorimit, prandaj rrjeti monitorues duhet të zgjerohet edhe këtu. Gjithashtu, duhet të shtohen pikat e monitorimit në Reqicë. Për këtë rajon karstik, burimet mund të përdoren edhe për monitorimin e ujërave nëntokësore.

Në rrjetin e pilot monitorimit që ka nisur në vitin 2023, mostrat janë analizuar për disa parametra. Grupi i parametrave përfshinë nitratat, metalet e rënda dhe parametrat e përgjithshëm për të vlerësuar trupat ujqorë nëntokësore. Janë analizuar gjithashtu pesticidet organoklorine dhe hidrokarburet aromatike policiklike. Cikli i parë i mostrimit tregoi se për këto dy grupe ndotësish, vlerat e gjetura janë nën nivelin e kuantifikimit, që është shumë më poshtë standardeve të BE. Prandaj, lista e parametrave për monitorimin e ujërave nëntokësore duhet të rishqyrtohet.

Në programin aktual të monitorimit maten vetëm pesticidet organoklorine. Duke qenë se shumë nga këto substance nuk përdoren më, rekomandohet një rivlerësim i rrjetit të monitorimit. Komponentet më të përdorura si Alfa-cipermetrin Karbofuran, Klorpirifos, Malation dhe Pirimikarb duhet të përfshihen. Përzgjedhja e substancave mund të bazohet në ndikimin e sektorit dominues bujqësor dhe llojin e të mbjellave dhe mund të ndryshojë sipas rajonit. Rekomandohet krijimi i një Rrjeti Kombëtar të Veçantë të Monitorimit për pesticidet.

Rezultati i monitorimit të vazhdueshëm duhet të përdoret gjithashtu për të përcaktuar më tej kufijtë dhe nivelet natyrore (NN) (të parametrave të caktuar) siç përshkruhet në **Shtojcën 4**.

#### 4.6.3 Zonat e mbrojtura

Zonat e mbrojtura janë ato zona për të cilat rregulloret specifikojnë kërkesa shtesë për mbrojtjen e ujit. Këtu përfshihen zonat e mbrojtjes së ujit, zonat ujqore të larjes, zonat e ndjeshme dhe të cenueshme sipas Rregulloreve për Mbrojtjen e Mjedisit dhe zonat e mbrojtura sipas Rregulloreve të Mbrojtjes së Natyrës, për të cilat ka regjim dhe cilësi specifike të ujit. Monitorimi shtesë kryhet vetëm në zona të veçanta të mbrojtura, të cilat duhet të plotësojnë jo vetëm kriteret për status të mirë ekologjik dhe kimik, por gjithashtu duhet të respektojnë standardet shtesë të cilësisë së ujit. Monitorimi mbikëqyrës dhe/ose operacional kryhet me një frekuencë minimale dhe programi përfshin ato elemente cilësore që nxjerrin në pah në mënyrë efektive faktorët stresues specifike në trupin ujqor.

Ministria e Mjedisit me akt nënligjor, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Shëndetësisë, në të ardhmen do të përcaktojë kriteret për zonat e mbrojtura për qëllime strategjike, ndërsa zonat e mbrojtura ujqore ekologjike do të përcaktohen me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës.

Nuk ka zona specifike të mbrojtura të përcaktuara ende në pellg për: (i) Speciet ujore me rëndësi ekonomike; (ii) Ujë për rekreacion dhe larje dhe (iii) Zonat e ndjeshme ndaj lëndëve nutritive. Megjithatë, janë bërë përpjekje për përcaktimin e këtyre zonave specifike të mbrojtura. Ka projektvendime të Qeverisë së Kosovës të pamiratuara ende që përcaktojnë zona të veçanta të mbrojtura brenda pellgut.

Aktualisht, Kosova ka vetëm një zonë të caktuar për mbrojtjen e habitateve dhe specieve. Kjo zonë është Ligatina e Hencit, dhe gjendet në Pellgun e Lumit Ibër, në nënpellgun e Sitnicës. Kjo zonë është caktuar si zonë e mbrojtur në vitin 2014 sipas Ligjit Nr. 03/L-233 “Për Mbrojtjen e Natyrës” dhe statusi i saj është “Zonë e Veçantë e Mbrojtur e Zogjve”.

#### 4.6.4 Implementimi

Për të arritur një rrjet monitorimi që plotëson tërësisht kërkesat e DKU, duhet të bëhen investime si në infrastrukturën laboratorike, ashtu edhe në ngritjen e kapaciteteve dhe stafit.

##### Investimi në pajisje

Investime nevojiten edhe për pajisje laboratorike, të cilat janë thelbësore për analizimin e substancave prioritare, elementeve cilësore biologjike dhe elementeve fiziko-kimike. Kjo përfshin kromatografinë e gazit-spektrometrinë e masës (GC/MS) për analizën e pesticideve dhe mikro-ndotësve të tjerë organikë prioritarë. Përdorimi i metodave të reja analitike do të rrisë edhe koston operacionale të laboratorit të IHMK. Rinovimi dhe modernizimi i laboratorit (dhomave) është i nevojshëm si pjesë e zbatimit të metodave të avancuara analitike.

##### Akreditimi

Duhet të kryhet një akreditim në nivel shtetëror dhe EN/ISO 17025. Kjo kërkon aplikimin e procedurave gjithëpërfshirëse të Sigurimit të Cilësisë dhe Kontrollit.

##### Orari për implementim

Një orar i propozuar për implementimin e monitorimit është prezantuar në Tabela 40.

**Tabela 40: Orari për implementim.**

Ndërhyrja	Viti	2025		2026		2027		2028		2029		2030	
		Kuartali (Q)	Q1,2	Q3,4	Q1,2	Q3,4	Q1,2	Q3,4	Q1,2	Q3,4	Q1,2	Q3,4	Q1,2
Prokurimi (pajisje, reagjensë, materiale harxhuese, etj.)	Përgatitja e tenderit		X										
	Përfundimi i tenderit		X										
	Vendosja e pajisjeve në laboratorë			X	X								
	Pajisjet funksionale					X							
Akreditimi kombëtar							X	X	X	X	X		
Akreditimi EN/ISO 17025								X	X	X	X		
Rritja e nr të stafit; trajnimi		X	X										

#### 4.7 Sistemi informativ ujq

Është zhvilluar një sistem i standardizuar i informacionit gjeografik në të cilin të dhënat ruhen vazhdimisht për pellgun përkatës të lumit. Mbledhja e të dhënave është bërë në bazë të rishikimit të dokumenteve ekzistuese (historike), vizitave në terren dhe ekspeditave shtesë monitoruese. Tabela 41 paraqet burimet e të dhënave dhe llojin e të dhënave të mbledhura nga secili burim.

**Tabela 41: Burimi dhe lloji i të dhënave.**

Burimi	Lloji i të dhënave
IHMK	Stacionet meteorologjike dhe hidro
	Klima dhe Hidrometeorologjia,
	Pikat e monitorimit të cilësisë së ujërave sipërfaqësore (koordinatat, kodet dhe të dhënat e monitorimit kimik)
	Pikat e monitorimit të cilësisë së ujërave nëntokësore (koordinatat, kodet, por nuk është ndërmarrë asnjë monitorim i cilësisë së ujit)
WISE 5	Infrastruktura e Përdorimit të Ujit - Infrastruktura që ndërlidhet me nxjerrjen e ujit të pijshëm TUN
	Programi i Monitorimit - Sasia e Ujit Sipërfaqësor
	TUS
	Rrjeti lumor, Liqenet
Nga Studimi I Bilancit uJOR	Pellgu
	Nënpellgu
	LC
	Reshjet mujore
	Informacion rreth nxjerrjes dhe rimbushjes së ujit, përcaktimit të trupave uJorë dhe analizave ekonomike
ARPL dhe AMMK	Parametrat fiziko-kimikë
	Të dhënat e sasisë së ujit
	Presionet
	HEC ekzistuese dhe të planifikuara
	Bujqësia
	Ujitja
	Përmbytjet
	Reshjet e shiut
	Kufijtë e pellgut
	Kufijtë e komunës
	Vendndodhjet e vendbanimeve
Projekti i Binjakëzimit	Trupat uJore nëntokësore
	Vendet e mostrimit të ujërave nëntokësore
Agjencia e Statistikave	Të dhënat socio-ekonomike
	Të dhënat demografike

Informacioni u mor në formate të ndryshme dhe formate pjesërisht të kompletuara, si dhe versione të ndryshme për të njëjtat të dhëna. Prandaj, një pjesë e grupeve të të dhënave është dashtë të vlerësohen, riformatohen dhe plotësohen me informacione shtesë. Të dhënat origjinale ishin në tre formate të ndryshme: Shapefile, Excel dhe Raporte.

Duke pasur parasysh se sistemi i menaxhimit të ujit për pellgjet e lumenjve është një sistem integral i bazave të të dhënave, GIS përdoret si teknologji e rëndësishme për (i) ruajtjen, integrimin dhe menaxhimin e një sasive të madhe të dhënash dhe (ii) mbështetjen e dhënies së informacionit palëve të interesit dhe vendimmarrësve. Prandaj, në kuadër të projektit u krijua një gjeodatabazë si grumbull i të dhënave të mbledhura. Kjo gjeodatabazë do të ofrojë të dhëna bazike për studime dhe analiza të ardhshme edhe për institucionet përkatëse.

## Kapitulli 5

### Analiza Ekonomike e Përdorimeve të Ujit, Analiza e të Ardhurave dhe Kthimi i Kostos

#### 5.1 Hyrje rreth çasjes së përdorur

Analiza ekonomike e përdorimit të ujit dhe vlerësimi i kthimit të kostos (cost recovery) në sistemin e ujit i përmbahet Udhëzuesit të Strategjisë së Përbashkët të Zbatimit (SPZ) të DKU, përpiluar nga Grupi i Punës për Ekonominë e Ujit (WATECO). Në këtë kontekst, duhet të ndiqen hapat e mëposhtëm:

- Vlerësimi i rëndësisë ekonomike të përdorimit të ujit.
- Identifikimi i përdorimeve dhe shërbimeve socio-ekonomike të ujit.
- Analiza ekonomike e përdorimit të ujit.
- Projektioni i trendeve të përdorimit të ujit.
- Identifikimi i mekanizmave në fuqi që kanë të bëjnë me çmimin e ujit.
- Zhvillimi i analizës së kthimit të kostos.
- Rekomandime për masat e mundshme për të përmirësuar sistemin e ujit dhe për të siguruar përputhshmërinë me DKU.

Një përshkrim i detajuar i metodologjisë dhe rezultateve jepet në Shtojcën 6, që është raporti teknik mbi analizën ekonomike.

Fatkeqësisht, kuantifikimi i kostos mjedisore dhe kostos së resurseve nuk ishte i mundur në këtë raport dhe ky kuantifikim duhet të zhvillohet në hapat e ardhshëm. Janë të nevojshme studime të mëtejshme për të përcaktuar këta parametra. Për shkak të mungesës së të dhënave, analiza e kthimit të kostos (cost recovery) nuk mori parasysh kostot mjedisore dhe të resurseve. Prandaj, u zhvillua dhe u vlerësua një analizë financiare e kthimit të kostos për përdoruesit e ujit.

Për më tepër, përdoruesit e ujit u identifikuan sipas sektorëve ekonomikë. Këta sektorë janë përdorimi në amvisëri, për ujë të pijshëm, përdorimi për ujitje, industri dhe prodhim të energjisë. Kategorizimi i sektorit socio-ekonomik bazohet në kërkesat e DKU dhe të dhënat aktuale në dispozicion në Kosovë. Kjo ndarje është tashmë në fuqi nga Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe për këtë arsye e njëjta është përdorur në këtë raport.

Së fundi, rekomandimet se si të llogariten kostot mjedisore dhe të resurseve janë zhvilluar në kapitullin e fundit të analizës ekonomike ku janë dhënë rekomandime të tjera se si të përmirësohet menaxhimi i ujit brenda pellgjeve.

#### 5.2 Analiza ekonomike e përdoruesve të ujit

Analiza socio-ekonomike fokusohet në një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve që kanë të bëjnë me ujin në të tre pellgjet lumore: Ibër, Lepenc dhe Moravë e Binçës. Konsumi vjetor i ujërave të ëmbla në vitin 2021 në të tre pellgjet e lumenjve ishte 173.32 milionë m<sup>3</sup>, nga të cilat 55% për përdorim në amvisëri, institucione dhe biznese, 28% për ujitje dhe 17% për industri.

Amvisëritë furnizohen me ujë nga 7 Kompani Rajonale të Ujësjellësve. Mbulimi i furnizimit të Kosovës me ujë ndryshon nga pellgu në pellg. Pellgjet e lumenjve Ibër dhe Lepenc ofrojnë

shërbime të furnizimit me ujë për rreth 81% të popullsisë që mbulojnë, ndërsa Morava e Binçës vetëm për 61%. Zhvillimet e popullsisë në Kosovë janë ndikuar nga faktorë të rëndësishëm demografikë, si migrimi i brendshëm apo i jashtëm dhe numri i lindjeve. Uebfaqja e ASK ofron projeksione për rritjen e popullsisë deri në vitin 2061. Popullata që furnizohet nga shërbimet e KRU pritet të rritet nga 1,052,997 milion banorë në 1,127,383 milion në vitin 2026. Më poshtë është paraqitur rritja popullore për pellg lumor, duke ndjekur trendin e vendit. Pellgu i Ibrit e ka numrin më të madh të popullatës.

**Tabela 42: Rritja e popullsisë për pellg lumor: viti 2021 krahasuar me vitin 2026.**

Pellgu lumor	Kompanitë e shërbimeve të ujësjellësit	Popullata (2021)	Popullata (2026)
Pellgu i Lumit Ibër	KRU "Prishtina" & KRU "Mitrovica"	733,748	785,582
Pellgu i Lumit Lepenc	KRU Bifurkacioni	156,944	168,031
Pellgu i Lumit Morava e Binçës	KRU Hidromorava	162,305	173,770
<b>Totali</b>	-	<b>1,052,997</b>	<b>1,127,383</b>

Sektori i bujqësisë në të tri pellgjet është përdoruesi i madh i ujit dhe e ka një ndikim të rëndësishëm në sigurinë e ujit në vend, duke marrë parasysh modernizimin e ngadaltë dhe mungesën e investimeve në infrastrukturë (Banka Botërore, 2018). Në sektorin e ujitjes, marrja e ujit dhe produktiviteti janë më të larta. Megjithatë, bujqësia është një nga sektorët kryesorë ekonomikë me pjesëmarrje të lartë në GDP e Kosovës (Banka Botërore, 2018) (PointPro, 2022).

Në sektorin e energjisë, uji përdoret për të prodhuar energji elektrike nëpërmjet hidrocentraleve. Edhe pse ky ujë nuk konsumohet, për këtë veprimtari kërkohen prurje të mëdha të ujërave të ëmbla dhe vëllime të mëdha për t'u rezervuar. Uji përdoret gjithashtu për ftohje në termocentrale. Në sektorë të tjerë të industrisë, uji përdoret në procesin e prodhimit dhe ftohje të pajisjeve (Banka Botërore, 2018).

### 5.3 Përdorimet dhe shkarkimet aktuale dhe ato të ardhshme të ujit

Analiza e shfrytëzimit aktual të ujit i merr parasysh të gjeturat e Vlerësimit Ekonomik të Menaxhimit të Resurseve Ujore dhe Gjurmës Ujore të Kosovës. Prandaj, kjo analizë merr në konsideratë tri kategori të konsumatorëve, i) amvisëritë dhe ujin e pijshëm, ii) industrinë (përfshirë sektorin e energjisë) dhe iii) bujqësinë. Këta janë sektorët më të rëndësishëm ekonomikë të varur nga uji. Kjo analizë vlerëson projeksionet e ardhshme për zhvillimin e aktiviteteve (industri, bujqësi dhe rritje e popullsisë), duke marrë parasysh Strategjinë Kombëtare të Ujërave dhe dokumente tjera zyrtare që ndërlidhen me sektorin e ujit.

Në Ibër ekzistojnë dy Kompani Rajonale të Ujësllësit: KRU "Prishtina" dhe KRU "Mitrovica". Përveç kësaj, në Ibër gjendet edhe Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër-Lepenci". KRU publikojnë një raport vjetor të performancës me sasinë e përdorimit të ujit, të hyrat dhe ujin e pafuturuar (humbjet e ujit). Kompanitë e ujitjes janë private dhe nuk ofrojnë të dhëna në lidhje me përdorimin e ujit në pikëpamje të vëllimit, humbjeve ose të ardhurave dhe kostos.

#### 5.3.1 Nxjerrjet aktuale të ujit për furnizim të amvisërive dhe shkarkimet

Nga raportet e KRU, informacionet më të fundit për popullatën e furnizuar, ujin e prodhuar (të nxjerrë), ujin neto të përdorur në vit dhe ujin e pafaturuar të përdorur në vit (humbja e ujit) janë analizuar dhe grupuar sipas pellgjeve lumore. Popullata e përgjithshme brenda secilit pellg dhe uji i nxjerrë nga KRU janë paraqitur në Tabela 43. Ndërmarrjet publike të ujësjellësve mbështeten kryesisht në resurset sipërfaqësore për nxjerrjen e ujit për furnizim të amvisërive.

**Tabela 43: Nxjerrjet aktuale të ujit për pellg – KRU.**

Pellgu lumor	Popullata aktuale	Prodhimi i ujit nga KRU (mil/m <sup>3</sup> )
Pellgu i Lumit Ibër	733,748	82.6

**Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës**

Prodhimi i ujit në këtë raport nënkupton ujin e nxjerrë për qëllime të konsumit të amvisërive. Prandaj, këtu përfshihet uji i humbur (uji i pafaturuar). Duke marrë parasysh ujin e humbur para se të arrijë tek konsumatorët, mesatarisht vetëm 44% e ujit të prodhuar përdoret dhe paguhet nga konsumatorët me një humbje prej 56% të ujit të prodhuar. Nivelet e larta të ujit të pafaturuar janë të dëmshme për mirëqenien financiare dhe funksionimin e kompanive të ujësjellësve. Prandaj, është e domosdoshme të përmirësohet infrastruktura për të reduktuar ndjeshëm humbjen neto të ujit në mënyrë që jo vetëm të plotësohet kërkesa në rritje për ujë në të ardhmen, por gjithashtu të kontribuohet në uljen e kostove të prodhimit të ujit dhe presioneve në resurset ujore.

Dy KRU janë pjesë e pellgut të lumit Ibër, KRU “Prishtina” dhe KRU “Mitrovica”. E para ofron shërbime të kanalizimit për 78% të popullsisë, që në të njëjtën kohë është përçindja më e lartë e të gjitha KRU në Kosovë, ndërsa e dyta mbulon 60% të popullsisë. Në nivelin e pellgut të lumit, 72% e popullsisë së Pellgut të Lumit Ibër ka çasje në sistemin e kanalizimit. Aktualisht, ekzistojnë pesë impiante funksionale të trajtimit të ujërave të zeza në pellgun e Ibrit. ITUZ në Skenderaj menaxhohet nga KRU “Mitrovica” me kapacitet mesatar vjetor prej 735,000 m<sup>3</sup> dhe është projektuar për 10,000 banorë. KRU “Prishtina” menaxhon katër impiante të vogla për trajtimin e ujërave të zeza: ITUZ “Harilaq” i cili pas grumbullimit të ujërave të zeza nga KRU “Prishtina” i shkarkon ato në Lumin Drenica, ITUZ “Badovc” (ose Mramor) i cili shkarkon ujërat e zeza në Lumin Graçanka, ITUZ “Medvec-Vrelle” që më tej shkarkon ujërat e zeza në Lumin Klinë, dhe ITUZ “Orllan” që derdh efluentin e saj në Lumin Sitnicë. Në Pellgun e Ibrit ka gjithsej 126 pika shkarkimi të ujërave të zeza. Bazuar në vlerësimin e ekspertëve, shkarkimet nga amvisëritë në Kosovë janë llogaritur si 80% e prodhimit të ujit nga KRU.

Bazuar në vlerësimin e ekspertëve, shkarkimet nga amvisëritë në Kosovë janë llogaritur si 80% e prodhimit të ujit nga KRU.

**Tabela 44: Shkarkimet e amvisërive në trupat ujorë.**

Pellgu Lumor	Shkarkimi nga amvisëritë (mil m <sup>3</sup> )
Pellgu i Lumit Ibër	63.12

**Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës**

### 5.3.2 Nxjerrjet e ardhshme të ujit për furnizimin të amvisërive dhe shkarkimet

Projeksionet e ardhshme të përdorimit të ujit e marrin parasysh vitin 2026. Për më tepër, sipas analizës së ujit të pafaturuar të prodhuar në Kosovë në vitin 2020, kompanitë kanë zhvilluar një qasje strategjike për menaxhimin e ujit të pafaturuar (UPA), me objektivi zvogëlimin e humbjeve të ujit me një normë prej 2% për vit. Strategjia e fundit Zhvillimore e Kosovës (2016-2021) gjithashtu e kishte përcaktuar atë si prioritet strategjik, ndërsa ARRU ka përcaktuar një nivel të UPA nën 25%, si më të pranueshëm. Pas vitit 2021, nuk u publikua asnjë përditësim i strategjisë zhvillimore. Prandaj, konsiderohet se nivelet e humbjes së ujit do të arrijnë nivelin e pranueshëm prej 25% deri në vitin 2026.

Prandaj, janë shqyrtuar tre skenarë të ndryshëm që kanë të bëjnë me përmirësimet që do të zbatohen në sistemin e ujit. Një skenar pesimist konsideron se humbjet e ujit mbeten në të njëjtat nivele, ndërsa një skenar realist supozon një ulje vjetore prej 2%. Së fundi, një skenar i

tretë konsideron se UPA do të arrijë 25% deri në vitin 2026. Rezultatet për nxjerrjen e ujit nga KRU duke marrë parasysh rritjen e popullsisë deri në vitin 2026 janë paraqitur më poshtë:

**Tabela 45: Skenarët e ardhshëm të nxjerrjes së ujit.**

Pellgu Lumor	Popullata (2026)	Nxjerrja e ujit nga KRU (mil m <sup>3</sup> ) 2026 (skenari optimist)	Nxjerrja e ujit nga KRU (mil m <sup>3</sup> ) 2026 (skenari realist)	Nxjerrja e ujit nga KRU (mil m <sup>3</sup> ) 2026 (skenari pesimist)
Pellgu i Lumit Ibër	785,582	57.4	74.3	84.5

Duke marrë parasysh tre skenarët e zhvilluar për nxjerrjen e ujit për amvisëri, gjithashtu tre skenarë të ndryshëm u krijuan për shkarkimet e amvisërive në vitin 2026, ku u konsiderua se 80% e ujit të nxjerrur shkarkohet.

**Tabela 46: Skenarët e ardhshëm të shkarkimit nga amvisëritë.**

Pellgu Lumor	Shkarkimi nga amvisëritë 2026 (mil m <sup>3</sup> ) (skenari optimist)	Shkarkimi nga amvisëritë 2026 (mil m <sup>3</sup> ) (skenari realist)	Shkarkimi nga amvisëritë 2026 (mil m <sup>3</sup> ) (skenari pesimist)
Pellgu i Lumit Ibër	26.4	59.4	67.6

### 5.3.3 Nxjerrjet aktuale të ujit për përdorim të ujit të pijshëm (të ambalazhuar)

Nxjerrja e ujit për përdorim të ujit të pijshëm të ambalazhuar sigurohet nga dy kompani në Pellgun e Ibrit. Sasia totale e ujit të nxjerrë për përdorim si ujë i pijes jepet në tabelën më poshtë. Në Pellgun e Ibrit nxirret 15% e totalit.

**Tabela 47: Nxjerrja vjetore për ujë të pijshëm.**

Pellgu lumor	Nxjerrja vjetore (m <sup>3</sup> )
Pellgu i Lumit Ibër	5,783.01
Pellgu i Lumit Lepenc	10,415.24
Pellgu i Lumit Morava e Binçës	23,013.83
<b>Total</b>	<b>39,212.08</b>

**Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës**

### 5.3.4 Nxjerrjet e ardhshme të ujit për përdorim si ujë i pijshëm

Sa i përket nxjerrjeve të ardhshme, në Pellgun e Ibrit, në vitin 2026 është paraparë një rritje prej 7%. Rezultatet janë paraqitur më poshtë:

**Tabela 48: Nxjerrjet e ardhshme të ujit për përdorim si ujë i pijshëm i ambalazhuar.**

Pellgu lumor	Marrja vjetore 2026 (m <sup>3</sup> )
Ibri	6,192
Lepenci	11,151
Morava e Binçës	24,639
<b>Total</b>	<b>41,982</b>

### 5.3.5 Nxjerrjet aktuale të ujit për ujitje

Nuk ka të dhëna në nivel pellgu lumor sa i përket përdorimit të ujit në sektorin e bujqësisë. Prandaj, të dhënat nga uebfaqja e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), bashkë me ato nga Master Plani i Ujitjes së Tokave Bujqësore në Kosovë (MPUK) rreth të mbjellave dhe modeleve të të mbjellave, si dhe të dhënat klimatike nga Qendra e Përbashkët Kërkimore e Komisionit të BE janë marrë dhe grupuar sipas pellgjeve lumore.

Uji i prodhuar për ujitje në pellgjet e lumenjve Ibër dhe Moravë e Binçës është më i vogël se sasia e prodhuar për konsum të amvisërive, që do të thotë se sektori i bujqësisë ushtron më pak presion mbi resurset përkatëse ujore, sipas burimeve të përmendura më sipër. Në Pellgun e Lumit Lepenc prodhohet më shumë ujë për ujitje, prandaj ky faktor është një shtytës i

rëndësishëm i nxjerrjes dhe konsumit të ujit. Për më tepër, sasia e sipërfaqes (ha) e përdorur për bujqësi është rritur me kalimin e viteve. Megjithatë, sipërfaqet e ujitura janë zvogëluar në pellgjet e lumenjve Ibër dhe Moravë e Binçës pasi janë aplikuar teknika më efikase të përdorimit të tokës dhe ujitjes.

**Tabela 49: Mesatarja vjetore e ujit të nxjerrë për ujitje për pellg lumi.**

Pellgu lumor	Totali i ujit të prodhuar për ujitje (mil m <sup>3</sup> /vjetor)	Uji i prodhuar për ujitje nga ujërat sipërfaqësore (mil m <sup>3</sup> /vit)	Uji i prodhuar për ujitje nga ujërat nëntokësore (mil m <sup>3</sup> /vit)
Pellgu i Lumit Ibër	27.4	24.7	2.7

**Burimi:** Uebfaqja e Agjencisë së Statistikave të Kosovës

**Tabela 50: Përmbledhje e ujit të përdorur për ujitje nga ujërat sipërfaqësore dhe ato nëntokësore (mil m<sup>3</sup>/vit).**

Pellgu lumor	Resursi	2018	2019	2020	2021
Pellgu i Lumit Ibër	Ujëra sipërfaqësore	23.9	22.8	23.3	23.8
	Ujëra nëntokësore	2.7	2.5	2.6	2.6

**Burimi:** Masterplani i Ujitjes në Kosovë

MPUK (Master Plani i Ujitjes në Kosovë) pohon se nevojat vjetore të konsumit të ujit për hektar (ha) variojnë midis 3500 m<sup>3</sup>/ha dhe 5500 m<sup>3</sup>/ha. Prandaj, konsumi mesatar i ujit për pellg lumi sillet ndërmjet 3500 m<sup>3</sup>/ha dhe 4500 m<sup>3</sup>/ha.

### 5.3.6 Nxjerrjet e ardhshme të ujit për ujitje

Master Plani i Ujitjes i vitit 2020 thekson se objektivat afatshkurtra (5 deri në 8 vjet) përfshijnë zgjerimin e tokës së ujitur, afërsisht duke e dyfishuar atë. Bazuar në këtë strategji, nxjerrja e vlerësuar e ujit për ujitje për vitin 2026 është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 51: Nxjerrjet e ardhshme të ujit për ujitje.**

Pellgu lumor	Totali i ujit të prodhuar për ujitje (mil m <sup>3</sup> ) (2026)	Prodhimi i ujit për ujitje nga ujërat sipërfaqësore (mil m <sup>3</sup> ) (2026)	Prodhimi i ujit për ujitje nga ujërat nëntokësore (mil m <sup>3</sup> ) (2026)
Pellgu i Lumit Ibër	53	47.7	5.3

Për të projektuar konsumin neto të ujit për ujitje, përqindja e ujit të pafaturuar në pellgun përkatës lumor është zbritur nga konsumi total i vlerësuar i ujit për ujitje në vitin 2026. Megjithatë, në përlogaritje ishte parashikuar që uji i pafaturuar do të ulet me 2% secilin vit. Kjo vlerë është përcaktuar në bazë të trendit të ujit të pafaturuar për periudhën 2018-2021 dhe vlerësimit të ekspertëve.

**Tabela 52: Konsumi i ardhshëm neto i ujit për përdorim në ujitje.**

Pellgu lumor	Konsumi neto i ujit për ujitje (milion m <sup>3</sup> ) (2026)	Prodhimi neto i ujit për ujitje nga ujërat sipërfaqësore (mil m <sup>3</sup> ) (2026)	Prodhimi neto i ujit për ujitje nga ujërat nëntokësore (milion m <sup>3</sup> ) (2026)
Pellgu i Lumit Ibër	30.2	27.2	3

### 5.3.7 Nxjerrjet aktuale të ujit për sektorin e industrisë dhe prodhimin e energjisë dhe shkarkimet e ujit

Sipas raportit të Gjendjes së Ujit të vitit 2020 të publikuar nga AMMK, industritë përdorin 30% të ujit të prodhuar nga KRU. Konsumatorët më të mëdhenj industrialë të ujit në Kosovë janë kompanitë. Shumica furnizohen me ujë nga liqenet sipërfaqësore të akumuluar (Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, 2020). Çdo vit, përdorimi i ujit në industri nga pellgjet e

lumenjve Ibër, Lepenc dhe Moravë e Binçes arrinë deri në 28.6 milionë m<sup>3</sup> ujë. Pellgu i Ibrit e arrinë vlerën prej 90% të totalit të ujit të përdorur për sektorin e industrisë.

**Tabela 53: Sasia mesatare vjetore e ujit të nxjerrë për përdorim në industri.**

Pellgu lumor	Përdorimi industrial i ujit (milion m <sup>3</sup> /vit)
Pellgu i Lumit Ibër	23.7

**Burimi:** Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe projeksioni i autorëve

Një nga përdoruesit kryesorë të ujit në industri janë termocentralet, të cilat e përdorin ujin për ftohjen e pajisjeve të tyre. Termocentrali Kosova A furnizohet me ujë nga Lumi Llap, Ibër-Lepenci dhe Liqeni i Batllavës kur është e nevojshme. Kosova B furnizohet me ujë nga Ibër-Lepenci. Sipas të dhënave të ofruara nga ASK, Kosova B ka përdorur rreth 16.3 milionë m<sup>3</sup> ujë për prodhimin e energjisë gjatë vitit 2021, ndërsa Kosova A ka përdorur 3.5 milionë. Kompani të tjera, si Kompania NewCoFeronikel, gjithashtu kanë një përdorim të lartë të ujit që vjen nga pellgjet e lumenjve Ibër dhe Lepenc.

**Tabela 54: Shkarkimet industriale.**

Pellgu lumor	Shkarkimi i ujit industrial (mil m <sup>3</sup> )
Pellgu i Lumit Ibër	17.7

### 5.3.8 Nxjerrjet e ardhshme të ujit për sektorin e industrisë dhe prodhimin e energjisë dhe shkarkimet e ujit

Nxjerrja e ujit për industrinë ka ndjekur të njëjtën përqindje të konsideruar aktualisht, ku 30% e ujit nxirret nga KRU. Kjo ndodh sepse deri më tani nuk është zhvilluar një strategji e qartë në lidhje me zhvillimet industriale për vendin.

**Tabela 55: Nxjerrjet e ardhshme të ujit për përdorim industrial.**

Pellgu lumor	Përdorimi i ujit industrial për v. 2026 (mil m <sup>3</sup> /vit)
Pellgu i Lumit Ibër	34.1

Shkarkimet e ardhshme nga industria kanë ndjekur të njëjtat përqindje të konsideruara aktualisht, me 30% të ujit që nxirret nga KRU dhe me përmirësime në humbjet e ujit.

**Tabela 56: Shkarkime të ardhshme industriale.**

Pellgu lumor	Shkarkimi i ujit industrial 2026 (mil m <sup>3</sup> )
Pellgu i Lumit Ibër	10.6

## 5.4 Analiza e kostos dhe e të ardhurave

Sipas Strategjisë Kombëtare të Kosovës për Ujërat, kostot e zbatimit të legjislacionit të BE për ujërat rezultojnë nga investimet në infrastrukturën e nevojshme për të përmbushur *acquis* (SHPEK – shpenzimet kapitale), kostot e operimit dhe mirëmbajtjes (SHPOP – shpenzimet operative) dhe barrën administrative të monitorimit dhe mirëmbajtjes së legjislacionit (Qeveria e Republika e Kosovës, 2017).

### 5.4.1 Mekanizmat e kostos së ujit

Furnizimi me ujë të pijshëm në Kosovë organizohet përmes shtatë kompanive të licencuara të ujësjellësit (KRU), ndërsa furnizimi me ujë për ujitje bëhet përmes tri kompanive të ujitjes. Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit i paguajnë taksa Ministrisë së Mjedisit për nxjerrjen e ujit dhe shfrytëzimin e tij nga rezervuarët artificialë. Kompanitë furnizojnë me ujë amvisëritë, bizneset dhe institucionet dhe mbledhin dhe trajtojnë ujërat e zeza aty ku ekzistojnë sistemet

e grumbullimit dhe impiantet e trajtimit. Banorët paguajnë për këto shërbime, të cilat supozohet se mbulojnë kostot operative dhe disa kosto investimi.

Marrja e ujit tarifohet në bazë vëllimore (për m<sup>3</sup>), në varësi të përdorimit të ujit, me përjashtim të rastit të ujitjes, ku shuma e tarifuar varet nga sipërfaqja (hektarë) që ujitet.

Prodhimi i hidrocentraleve është i tarifueshëm në bazë të energjisë (kWh) së prodhuar. Pagesa për shkarkimin e ujërave të ndotura (ujërave të zeza) është vëllimore (për m<sup>3</sup>) dhe varion në varësi të parametrevë në vijim:

- Burimi i ujërave të zeza (industriale, urbane)
- Shkalla e trajtimit para shkarkimit
- Klasifikimi (cilësia e ujit) i ujit në të cilin bëhet shkarkimi

Faturat dhe pagesat realizohen çdo muaj.

#### 5.4.2 Të ardhurat nga tarifat e furnizimit me ujë dhe tarifat për ujërat e zeza

KRU publikojnë të dhëna vjetore teknike dhe financiare për performancën e tyre. Të dhënat nga tarifat e përdorimit të ujit për furnizim publik dhe pasqyra e tarifave të KRU janë në tabelën e mëposhtme.

**Tabela 57: Tarifat e përdorimit të ujit nga KRU.**

Tarifat e përdorimit të ujit për furnizim publik						
Përdorimi i ujërave sipërfaqësore nga rrjedhat ujore për furnizim publik me ujë						0.003 (EUR/m <sup>3</sup> )
Përdorimi i ujërave nëntokësore për furnizim publik me ujë						0.001 (EUR/m <sup>3</sup> )
Përdorimi i ujit nga rezervuarët për furnizim publik me ujë						0.002 (EUR/m <sup>3</sup> )
Pasqyrat tarifore për periudhën 2022 - 2024						
Pellgu i Lumit Ibër	Amvisëritë			Komerçiale dhe industriale		
	Tarifa fikse (EUR/muaj)	Furnizimi vëllimor me ujë (EUR/m <sup>3</sup> )	Ujërat e zeza (EUR/m <sup>3</sup> )	Tarifa fikse (EUR/muaj)	Furnizimi vëllimor me ujë (EUR/m <sup>3</sup> )	Ujërat e zeza (EUR/m <sup>3</sup> )
KRU Prishtina	1	0.44	0.06	2.00	0.67	0.13
KRU Mitrovica	1	0.36	0.09	2.00	0.52	0.2

Të hyrat nga shërbimet e ujit dhe kanalizimit janë mbi 23,5 milionë Euro. Tabela e mëposhtme përmban informacione vetëm për KRU që ofrojnë shërbime të ujit dhe kanalizimit për rajonet në kuadër të tre pellgjeve lumore. Të dhënat vijnë nga grupet e të dhënave të publikuara nga raportet e performancës së KRU.

**Tabela 58: Të hyrat e KRU për periudhën 2020-2021.**

Të ardhurat nga shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza (milion €)							
Kompania Rajonale e Ujësullësit (KRU)	Pellgu Lumor	2020			2021		
		Të ardhurat Furnizimi me ujë	Të ardhurat e shërbimeve të ujërave të zeza	Total	Të ardhurat Furnizimi me ujë	Të ardhurat e shërbimeve të ujërave të zeza	Total
Prishtinë	<i>Ibër</i>	12,980	1,482	14,462	12,926	1,544	14,470
Mitrovicë	<i>Ibër/Drini i Bardhë</i>	3,265	1,335	4,600	3,325	1,383	4,708

#### 5.4.3 Tarifat e ujit për shërbimet e ujitjes

Sa i përket shërbimeve të ujitjes, tarifat e ujit vendosen nga kompanitë e ujitjes. Çmimet nuk bazohen në kostot e rimbursueshme, por në përfitimet marxhinale të ujit të përdorur në ujitje

dhe parimin e "aftësisë për të paguar" të kapacitetit për shlyerje. Këtu nuk merret parasysh elementi i "kthimit të kapitalit". Përdoret çmimi jo vëllimor. Metodrat jo vëllimore tarifojnë ujin e ujitjes në bazë të njësisë së tokës (hektar).

Në Kosovë, tri tarifa të ndryshme aplikohen për qëllime të ujitjes nga kompanitë e ujitjes. Për ujin që vjen nga rrjedhat ujore, rezervuarët ose resurset e ujërave nëntokësore, aplikohen tarifa shtesë. Kompanitë e ujitjes nuk bëjnë të ditur tarifat e fundit të ujit për ujitje. Gjithashtu, nuk ka asnjë informacion lidhur me të hyrat e vlerësuar nga tarifat e ujit dhe nuk ka të dhëna publike për numrin e fondeve të mbledhura nga këto tarifa. Prandaj, potenciali për rritjen e të ardhurave nga menaxhimi i ujit përmes tarifave të ujit u realizua përmes një modelimi bazuar në të dhënat statistikore në dispozicion për përdorimin e ujit sipas kategorive të ndryshme të përdorimeve dhe bazës së llogaritjes së tarifave siç përcaktohet nga Ligji për Ujërat (PointPro, 2022).

Mund të aplikohen tri tarifa të ndryshme në varësi të resurseve ujore: i) uji i përdorur nga rrjedhat ujore, ii) uji nga rezervuarët që përdoren për ujitje dhe iii) uji që nxirret nga resurset e ujërave nëntokësore që përdoren për ujitje. Prandaj, përdoruesit paguajnë për numrin e hektarëve të ujitur, jo për totalin e ujit të konsumuar dhe llojin e resursit ujor.

**Tabela 59: Tarifat e ujit për përdorimin e ujit për ujitje varësisht nga resursi ujor.**

Përdorimi i ujërave sipërfaqësore nga rrjedhat ujore për ujitje	5 €/ha në vit
Përdorimi i ujërave sipërfaqësor nga rezervuarët për ujitje	10 €/ha në vit
Përdorimi i ujërave nëntokësore për ujitje	2.5 €/ha në vit

Sipas MPUK (Master Planit të Ujitjes në Kosovë), nevojat për ujë për hektar variojnë midis 3500 m<sup>3</sup>/ha dhe 5500 m<sup>3</sup>/ha. Prandaj, janë zhvilluar tre skenarë në lidhje me nevojat për ujë për hektar nga resurset ujore sipërfaqësore dhe ato nëntokësore. Më pas, janë tre skenarë të mundshëm të të ardhurave nga uji që përdoret për ujitje. Tabelat me llogaritjet e skenarëve gjenden në **Shtojcën 6**.

Skenari 2 është skenari më i mundshëm i aplikueshëm në Kosovë. Ai konsideron se 4500 m<sup>3</sup> ujë përdoret për të ujitur 1 hektar tokë. Gjithashtu, ai konsideron se toka e ujitur nga ujërat sipërfaqësore mund të përdorë 100% të ujit nga rrjedhat ujore ose rezervuarët. Totali i të ardhurave për ujitje në Pellgun e Lumit Ibër është 83,796 Euro.

**Tabela 60: Vlerësimi i të ardhurave nga uji sipërfaqësor dhe nëntokësor i përdorur për ujitje, skenari 2, Ibër.**

Skenari 2 4500 m <sup>3</sup> /ha	Toka që përdor ujërat sipërfaqësore (ha)	Të ardhurat nga rrjedhat ujore të përdorura për ujitje (€)	Të ardhurat e ujit nga rezervuarët e përdorur për ujitje (€)
Ibri	5,484	27,424	54,849
Skenari 2 4500 m <sup>3</sup> /ha	Toka që përdor ujërat nëntokësore (ha)	Të ardhurat nga ujërat nëntokësore të përdorura për ujitje (€)	
Ibri	609	1,523	

#### 5.4.4 Tarifat e ujit për industrinë dhe prodhuesit e energjisë

Tarifat e ujit për konsumatorët industrialë të furnizuar nga kompanitë e ujit me shumicë caktohen nga furnizuesit ndërsa tarifat për bizneset e vogla caktohen nga ARRSHU. Këto tarifa bazohen në mbulimin e kostove për shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes, si dhe nevojat për investime kapitale për prodhimin dhe shpërndarjen e ujit. Tarifat dhe të ardhurat sipas pellgjeve lumore janë paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 61: Tarifatat e ujit dhe ujërave të zeza si dhe të ardhurat e vlerësuara nga përdorimi dhe shkarkimet e ujit në sektorin e industrisë.**

Pellgu lumor	KRU	Tarifa fikse (€ /muaj)	Furnizimi me ujë vëllimor (€ /m <sup>3</sup> )	Ujërat e zeza (€ /m <sup>3</sup> )
Ibër	RWC Prishtina	€ 2.00	€ 0.69	€ 0.11
	RWC Mitrovica	€ 2.00	€ 0.55	€ 0.20
Pellgu Lumor	Përdorimi i ujit industrial (mil m <sup>3</sup> )	Të ardhurat nga përdorimi i ujit në industri (milion €)	Të ardhurat nga shkarkimi i sektorit të industrisë (milion €)	
Ibër	23.67	0.47	2.84	

Të ardhurat e sektorit industrial kontribuojnë me më shumë se 20 milionë Euro për furnizuesit e ujit. Pellgu i Lumit Ibër është ai me më shumë industri që kontribuojnë në të hyrat e KRU.

Prodhuesit e energjisë paguajnë për përdorimin e ujit në varshmëri të sasisë së energjisë elektrike të prodhuar. Në rastin e energjisë, uji mund të përdoret për pajisjet ftohëse të termocentraleve dhe për digat. Kompensimi për prodhimin e hidrocentraleve është i tarifueshëm në bazë të sasisë së energjisë (kWh) të prodhuar.

**Tabela 62: Tarifatat e ujit për sektorin e energjisë në vitin 2021.**

<b>Prodhuesit e energjisë elektrike</b>	2.5% e çmimit të shitjes për çdo kilovat orë të prodhuar
<b>Ujë për ftohje në termocentrale me sistem ftohjeje të hapur</b>	1.7 për kWh të prodhuar në termocentrale

Kryesisht, në Kosovë ekzistojnë dy burime të energjisë I) hidrocentralet dhe II) burimet tjera, ku përfshihen termocentralet dhe panelet diellore. Në vitin 2021, hidrocentralet kanë prodhuar sasinë e mëposhtme të energjisë për pellg lumi dhe kanë gjeneruar këto të ardhura:

**Tabela 63: Të ardhurat e parashikuara nga hidrocentralet.**

Pellgu lumor	Prodhimi (MWh)	Të ardhurat nga energjia e shitur (milion €)	Të ardhurat nga energjia e prodhuar (milion €)
Pellgu i Lumit Ibër	128,388	216,558	2,183

Në vitin 2021, uji i përdorur për ftohjen në termocentralet me linjit arriti në 14 milionë metër kub, ndërsa në vitet e mëparshme përdorej më shumë ujë për ftohjen e pajisjeve. Të hyrat totale nga termocentralet arritën në 216,750 euro.

## 5.5 Kthimi i kostos

Sipas Strategjisë së Përbashkët të Zbatimit të DKU dhe WATECO, llogaritjet e kthimit të kostos duhet të përfshijnë kostot mjedisore dhe kostot e resurseve ujore. Fatkeqësisht, kuantifikimi i kostove mjedisore dhe kostove të resurseve nuk ishte i mundur në këtë raport dhe duhet të zhvillohet në hapat e ardhshëm. Studime të mëtejshme janë të nevojshme për të përcaktuar sasinë e kostove mjedisore dhe të resurseve. Duke marrë parasysh mungesën e të dhënave, nuk ishte e mundur të zhvillohej një kthim total i kostos për pellg lumi; prandaj u zhvillua vetëm një kthim financiar i kostos.

Raportet e performancës nga KRU japin të dhëna rreth të ardhurave dhe kostos. Për dy KRU që gjenden në Pellgun e Lumit Ibër të dhënat e tilla janë paraqitur në tabelën në vijim.

**Tabela 64: Kthimi i kostos në Pellgun e Lumit Ibër.**

Shkalla e kthimit të kostos – Pellgu i Lumit Ibër			
KRU "Prishtina"	2019	2020	2021
Të ardhurat totale	14,581,009	13,006,996	13,074,944
Shpenzimet kapitale			519,128
Kostot operative	11,919,986	10,099,459	10,254,012

Kostot e mirëmbajtjes	1,438,625	634,113	678,841
Raporti kosto-rikthim	109%	121%	114%
<b>KRU "Mitrovica"</b>	<b>2019</b>	<b>2020</b>	<b>2021</b>
Të ardhurat totale	3,333,601	3,711,884	2,889,570
Shpenzimet kapitale			249,284
Kostot operative	2,690,801	3,535,423	3,363,491
Kostot e mirëmbajtjes	82,816	21,183	24,819
Raporti kosto-rikthim	120%	104%	79%

Për sa i përket kthimit të kostos, me kalimin e kohës shihet një rënie në kostot operative, duke supozuar se operacionet po bëhen më efikase. Kostot e mirëmbajtjes përfshijnë shpenzimet kapitale dhe kostot e amortizimit.

Është thelbësore të përmendet se në vitin 2019 ka pasur një kosto masive të shpenzimeve kapitale, të përfshira në kostot e mirëmbajtjes në KRU Prishtina, për shkak të punimeve në sistemin e ujit (WSRA, 2021). Për më tepër, ka pasur një rritje të lehtë në kostot e përgjithshme operative, megjithëse ka pasur një rënie të ujit të pafaturuar me optimizim të prodhimit të ujit në krahasim me vitet e mëparshme. Një faktor i mundshëm vendimtar që i kontribuon sfidës së uljes së kostove operative dhe të mirëmbajtjes janë subvencionet e larta të ofruara nga Qeveria e Kosovës për KRU Mitrovica, gjë që ka ndikim në të gjithë Pellgun e Lumit Ibër.

Kur bëhet fjalë për kthimin e kostos për sektorë, një vlerësim është dhënë në tabelën në vijim

**Tabela 65: Kthimi financiar i kostos për sektor.**

<b>Financial cost-recovery rate – Ibrri River Basin</b>	
<b>KRU "Prishtina" &amp; KRU Mitrovica</b>	<b>2021</b>
Të ardhurat totale - amvisëritë	19,178,000
Kostot totale - amvisëritë	13,059,149
Raporti i kthimit të kostos financiare në amvisëri	<b>146.85%</b>
Të ardhurat totale - industria	17,540,000
Kostot totale - industria	9,112,950
Raporti i kthimit të kostos financiare në industri	<b>192.47%</b>
Të ardhurat totale të ujitjes	83,797.08
Kostot totale të ujitjes	9,324,325
Raporti i kthimit të kostos financiare për ujitjen	<b>0.90%</b>

## 5.6 Rekomandime

Megjithëse sistemi i ujit është financiarisht i qëndrueshëm, ai nuk i përmbush të gjitha objektivat e DKU. DKU nuk llogarit vetëm të ardhurat dhe kostot e sistemeve. Për shembull, fakti që nuk ka impiante për trajtimin e ujërave të ndotura brenda pellgjeve të lumenjve shton kostot mjedisore që nuk janë përcaktuar në aspektin sasior në këtë studim. Këto kosto mjedisore për shkak të dëmeve të shkaktuara nga shkarkimi i mbetjeve të patrajuara dhe nivelet e larta të ujit të pafaturuar përbëjnë rreziqe jofinanciare për sistemin e ujit.

Sipas Direktivës Kornizë të Ujërave, politikat e çmimit të ujit janë të rëndësishme për ngritjen e sistemeve të ujit dhe promovimin e një sistemi të qëndrueshëm dhe efikas të ujit. Megjithatë, shmangia e dëmit mjedisor duhet të merret parasysh edhe gjatë funksionimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve të ujit.

Shumica e hapave të analizës ekonomike të zhvilluara deri më tani do të duhet të përsëriten në fazat e mëvonshme pasi ciklet e mëtejshme të menaxhimit kërkohen dhe propozohen nga DKU. Për më tepër, kostot e para mjedisore që do të llogariten duhet të bazohen në koston e Programit të parë të Masave (PM).

Në përputhje me DKU, kostot e resurseve që lidhen me vlerën ekonomike të mundësive që nuk janë marrë parasysh gjatë shpërndarjes së resursit për një përdorim të caktuar, (dhe kështu ato mund të trajtohen bazuar në metoda alternative të vlerësimit të ujit (p.sh., vlera e mbetur) ose çmimet e tregut), duhet të realizohen duke e nxjerrë dhe lëvizur ujin nga një përdorim në destinacionin përfundimtar. Kjo qasje duhet të përfshihet nga autoritetet e ujit për një llogaritje të ardhshme të kthimit të koston të sistemit të ujit.

Prandaj, kostot mjedisore dhe të resurseve lindin nëse një ndryshim në një trup ujur prek një ose më shumë nga këto funksione nga të cilat shoqëria përfiton. Prandaj, ekziston një varësi e madhe e kostove mjedisore nga gjendja fizike e sistemit të ujit dhe nga njohuritë e informacionet rreth këtij statusi fizik. Kjo përfshin dëmtimin e shkaktuar në sistemin e ujit si rezultat i presioneve të ushtruara në sistemin e ujit, siç është shkalla e dëmtimit të nivelit natyror të rimbushjes ose rikuperimit të sistemit nga një përdorim specifik i ujit. Kategoritë e tjera të dëmeve përfshijnë: eutrofikimin, kripëzimin, tharjen, humbjen e diversitetit biologjik dhe ndryshimet morfologjike në një sistem ujur. Ky lloj informacioni është thelbësor për vlerësimin e mëvonshëm të kostove mjedisore. Statusi fizik i një trupi ujur ose sistemi ujur ofron bazën për vlerësimin e kostove mjedisore në terma ekonomikë. Nëse ky informacion nuk është i disponueshëm, kostot mjedisore (dhe më pas kostot e mundshme të resurseve) nuk mund të vlerësohen. Është e rëndësishme të dihet shkalla e dëmit të shkaktuar dhe nga kush është shkaktuar, por edhe në çfarë mase dëmi kompensohet (ose jo) nga ndotësi ose përfituesi i një përdorimi ose shërbimi të veçantë të ujit.

Më shumë rekomandime janë në dispozicion në **Shtojcën 6**, raporti i Analizës Ekonomike.

## Kapitulli 6

### Programi i Masave

#### 6.1 Hyrje

Programi i Masave (PM) për Pellgun e Lumit Ibër bazohet në Analizën e Presionit/Ndikimit dhe Vlerësimin e Rrezikut (Riskut) (**Shtojca 3**, përmbledhur në **Kapitujt 3** dhe **4**). Lidhur me ndikimet e mundshme që janë analizuar për ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, PM propozon masa që do të mbështesin përmirësimin e situatës në të gjithë pellgun. Në përgjithësi, PM i lbrit synon të arrijë qëllimin e përgjithshëm të Pellgut të lbrit dhe objektivat përkatëse të menaxhimit (**Kapitulli 3**).

PM i Planit të Menaxhimit të Pellgut të Lumit Ibër u zhvillua bashkërisht në bazë të Punëtorive Teknike të realizuara në mars, maj dhe shtator 2023, me pjesëmarrjen e autoriteteve përgjegjëse të ujit dhe palëve kryesore të interesit. Raportet e punëtorive teknike janë bashkangjitur si **Shtojca 7**. Bazuar në Analizën e Presionit/Ndikimit dhe rezultatet e Punëtorive Teknike, është detajuar prioritizimi i masave për 6 ÇRMU.

Ky kapitull përshkruan strukturën bazë të PM të lbrit dhe përmban masat konkrete për secilën ÇRMU për zbatimin në të ardhmen.

#### 6.2 Arsyetimi për zhvillimin e Programit të Masave (PM)

Programi i masave (PM) i targeton problemet individuale të identifikuar për secilën nga gjashtë ÇRMU. Gjetjet kryesore janë përmbledhur në Tabela 66.

Tabela 66: Gjetjet kryesore për gjashtë ÇRMU.

ÇRMU	Reflektim mbi të gjeturat kyçe
<b>ÇRMU 1: Ndotja nga vendbanimet urbane dhe industrinë (burimet e palëvizshme)</b>	Mungesa e trajtimit adekuat të ujërave të zeza nga amvisëritë dhe industria rrezikon shëndetin e popullatës dhe ndikon në përshtatshmërinë e ujërave për pije, larje, peshkim dhe aktivitete të tjera. Ndotja nga burimet e palëvizshme nga aktivitetet industriale, deponitë e mbetjeve, aktivitetet minerare dhe guroret, si dhe nga fermat e peshkut po shkakton kërcënime direkte dhe indirekte si për ujërat sipërfaqësore ashtu edhe ato nëntokësore. Shkarkimet e ndotura e dëmtojnë cilësinë e ekosistemeve ujore.
<b>ÇRMU 2: Ndotja nga burime të lëvizshme nga bujqësia dhe burime të tjera (ndotje nga burime difuzive)</b>	Ndotja nga lëndët nutritive nga bujqësia, veçanërisht azoti dhe/ose fosfori, mund të kontribuojë në eutrofikimin e ujërave. Eutrofikimi e shkakton rritjen e tepërt të algave që si pasojë mund të ndikojë ndjeshëm në cilësinë e ujit. Gjithashtu, këtu bën pjesë përdorimi i gjerë i pesticideve që shkarkohen në ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore, duke i përkeqësuar resurset e ujit të pijshëm dhe rrezikuar shëndetin e njeriut, ekosistemet dhe aktivitetet prodhuese. Shtytës tjerë të rëndësishëm të ndotjes nga burime difuzive që janë marrë në konsideratë në analizën e riskut/rrezikut janë rrjedhjet e pakontrolluara dhe të shpërndara urbane në sistemin ujor, ndotja difuzive nga transporti dhe reshjet atmosferike që përmbajnë azot dhe squfur.
<b>ÇRMU 3: Presionet në sasinë e ujërave sipërfaqësore</b>	Ekzistojnë kërkesa në rritje për ujë për furnizim të amvisërive, industrisë dhe bujqësisë që duhet të plotësohen gjatë gjithë vitit dhe kërkojnë depozitimin dhe/ose devijimin e sasive të mëdha të ujit nga Lumi Ibër në infrastrukturën e shumta të lidhura me ujin si digat dhe rezervuarët. Ndryshimet klimatike mund të shtojnë sfidat në pellgun e Lumit Ibër në të ardhmen dhe do të rrisin përmbytjet dhe thatësitat.
<b>ÇRMU 4: Presionet mbi hidro-morfologjinë e ujërave sipërfaqësore</b>	Veçoritë fizike të ekosistemeve ujore janë ndryshuar, duke shkaktuar ndryshimin e formës së trupave ujorë dhe rrjedhës së lumenjve për qëllime bujqësore, rritjen e depozitimit të ujërave sipërfaqësore për përdorim të shumëfishtë, funksionimin e hidrocentraleve dhe mbrojtjen e vendbanimeve dhe tokës bujqësore nga përmbytjet. Për këto qëllime, disa lumenj u drejtuan, u kanalizuan dhe u shkëputën nga fushat e tyre përmbytëse; toka është drenazhuar, janë ndërtuar diga dhe penda, brigjet e lumenjve janë përforcuar dhe nivelet e ujërave nëntokësore kanë ndryshuar. Këto aktivitete kanë rezultuar në ndryshimin e habitateve, ndryshimin e rrjedhave,

ÇRMU	Reflektim mbi të gjeturat kyçe
	ndërprerjet e vazhdimësisë së lumenjve dhe humbjen e lidhjes me fushat përmbytëse.
<b>ÇRMU 5: Presione tjera në ujërat sipërfaqësore (akuakulturë)</b>	Eutrofikimi është një çështje e zakonshme që vjen së bashku me akuakulturën. Akuakultura shkaktoneutrofikim në mënyra të shumta. Në sistemet e akuakulturës me ujë të hapur, ushqimi i tepërt i peshkut fut azot dhe fosfor shtesë direkt në ujë. Sistemet e mbyllura kontribuojnë gjithashtu nëeutrofikim, pasi ato shkarkojnë direkt efluentin në rrugët ujore natyrore.
<b>ÇRMU 6: Presionet në sasinë dhe cilësinë e ujërave nëntokësore</b>	Nëse vëllimi i ujërave nëntokësore të nxjerra e tejkalon rimbushjen e ujërave nëntokësore në bazë strukturore, atëherë ujërat nëntokësore nuk janë më të balancuara, duke çuar në rënien e niveleve të ujërave nëntokësore. Ndotja e ujërave nëntokësore shkaktohet kryesisht nga agrokimikatet si plehrat dhe pesticidet, nga substancat organike nga grumbullimi dhe trajtimi i pamjaftueshëm i ujërave të zeza, si dhe nga substancat e rrezikshme nga aktivitetet industriale dhe të tjera ekonomike (shih gjithashtu ÇRMU 1 dhe 2).

Përderisa programi specifik i masave për zgjidhjen e problemeve individuale është i rëndësishëm, 'efektet e ndërvarura' janë gjithashtu jashtëzakonisht të rëndësishme në menaxhimin e pellgjeve lumore. Në nivel pellgu, masat e miratuara për të zgjidhur një lloj problemi mund të kenë implikime në një problem tjetër, i cili ndikim mund të jetë ose negativ ose pozitiv. Për shembull, çdo aktivitet për të reduktuar ndotjen difuzive nga bujqësia që përfshin praktika të përmirësuar bujqësore si përdorimi efikas i plehrave, do të ndikojë drejtpërdrejt pozitivisht në cilësinë e ujërave nëntokësore lokale. Mund të ndikojë gjithashtu në cilësinë e ujit në përrenj dhe lumenj, nëse rrjedhjet nga fushat bujqësore përfundojnë në to, duke ndikuar kështu në cilësinë e ujit të lumenjve në pjesët e poshtme të tyre. Rritja e prurjeve në lumenj nëpërmjet lëshimit të ujit nga rezervuarët rregullues në rrjedhën e epërme mund të ndikojë pozitivisht në regjimin e ujërave nëntokësore, për shkak të infiltrimit më të madh të ujit përmes shtratit të lumenjve, në varësi të karakteristikave të tokës. Nga ana tjetër, zvogëlimi i lëshimit të ujit nga rezervuarët mund të ndikojë negativisht në kushtet e ujërave nëntokësore në rrjedhën e poshtme për shkak të reduktimit të flukseve të kthimit në akuiferët e cekët. Ndryshimet në funksionimin e rezervuarëve shumëqëllimësh për rritjen e kapacitetit të tyre për të ofruar mbrojtje kundër përmbytjeve mund të ndikojnë negativisht në aftësinë e tyre kundër thatësirës dhe potencialin gjenerues të hidrocentraleve, pasi uji duhet të lirohet nga rezervuarë të tillë përpara fillimit të sezonit gjatë të cilit ndodhin përmbytjet. Më tej, mund të ketë mënyra të shumta për të adresuar një lloj problemi, ku secili prej tyre ka një efekt të ndryshëm në resurset ujore të pellgut (për sa i përket sasisë dhe cilësisë) dhe përdoruesit e ujit në zona të ndryshme.

Për shkak të ndërlidhjes së komponentëve të ndryshëm të sistemit fizik ose hidrologjik (që ndikon në disponueshmërinë e ujit) dhe sistemit socio-ekonomik (që ndikon në përdorimin e ujit) dhe ndërveprimin midis të dyve, analiza e problemeve, procesi i identifikimit të programit kryesor të masave për zgjidhjen e tyre dhe përcaktimi i shkallës në të cilën duhet të zbatohen duhet të kryhet në mënyrë të integruar në shkallë hapësinore dhe kohore. Kjo siguron efektivitet në kuptimin fizik dhe ekonomik.

### 6.3 Afati kohor për PM të lbrit dhe prioritizimi i masave

Zbatimi i Planit të Menaxhimit të Pellgut të Lumit Ibër është në përputhje me hapat dhe afatin kohor të Ciklit të Menaxhimit të Pellgut Lumor (**Kapitulli 1**). Zhvillimi dhe konsultimi i raundit të parë të PMPL Ibër do të finalizohet deri në fund të vitit 2023. Sikli i parë gjashtëvjeçar i MPL do të fillojë në vitin 2024 dhe parashikon detajimin dhe zbatimin e PM të tij. Pas vitit 2023, ciklet e njëpasnjëshme të MPL do të vazhdojnë zbatimin e masave deri në arritjen e qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara për Pellgun e lbrit.

- Për të siguruar planifikim dhe zbatim efektiv, prioritizimi i masave e ka një rol të rëndësishëm. Në këtë kontekst, janë marrë parasysh të gjitha masat e mundshme për Pellgun e Lumit Ibër dhe prioriteti i tyre është paraqitur në 3 klasë (prioritet i lartë / i mesëm / i ulët). PM në paragrafin 6.6 dhe 6.7 paraqet masat e identifikuara të kategorisë 1 (prioritet i lartë zbatim).

#### Prioritizimi i mëposhtëm është zbatuar në kuadër të PM të Ibrit:

Prioriteti i zbatimit	Kriteret për caktimin në klasën prioritare të zbatimit
1. (Prioriteti i lartë i zbatimit: fillimi i zbatimit para vitit 2030)	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zbatimi i masave për trupat ujorë sipërfaqësore dhe nëntokësore që rrezikojnë përmbushjen e qëllimeve dhe objektivave të Ibrit në vitin 2023;</li> <li>• Zbatimi i programeve të vazhdueshme shtetërore/rajonale;</li> <li>• Masat lidhur me kuadrin ligjor, politik dhe rregullator.</li> </ul>
2. (Prioriteti i mesëm i zbatimit: fillimi i zbatimit para vitit 2035)	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zbatimi i masave për trupat ujorë sipërfaqësore dhe nëntokësore që mund të rrezikojnë përmbushjen e qëllimeve dhe objektivave të Ibrit në vitin 2023.</li> </ul>
3. (Prioriteti i ulët i zbatimit: fillimi i zbatimit më vonë se 2035)	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zbatimi i masave për trupat ujorë sipërfaqësore dhe nëntokësore që nuk rrezikojnë përmbushjen e qëllimeve dhe objektivave të Ibrit në vitin 2023.</li> </ul>

### 6.4 Zbatimi i planit të veprimit dhe monitorimi


Hapi tjetër në zbatimin e PM është formulimi i një Plani të Veprimit për Zbatimin, ku masat e prioritizuara kuantifikohen për sa i përket vëllimit dhe vlerësimeve të Kostos, si dhe planifikohen në një plan (program) zbatimi operacional për secilin pellg.

Pasi PM do të zbatohet gradualisht në pellg, ai ka të ngjarë të prodhojë ndikime pozitive në performancën e pellgut, veçanërisht në aspektin e cilësisë dhe sasisë së ujërave sipërfaqësore, regjimit të ujërave nëntokësore dhe aftësisë së përgjithshme të pellgut për të përmbushur kërkesat e ndryshme për ujë. Megjithatë, është e rëndësishme që të ketë monitorim të vazhdueshëm të rezultateve në mënyrë që të shmangen ose minimizohen ndikimet e paqëllimshme që mund të ndodhin në rast se konceptimi i programit të masave nuk është i qëndrueshëm ose nuk ka marrë parasysh situatën specifike lokale. Duhet të ketë tregues të qartë për monitorimin e këtyre rezultateve.

Si Plani i Veprimit për Zbatimin, ashtu edhe Treguesit për Monitorim janë përtej fushëveprimit të PMPL Ibër dhe duhet të zhvillohen sapo të miratohet plani. Kjo nuk do të thotë që programet në vazhdim dhe masat themelore dhe plotësuese që mund të zbatohen menjëherë nuk duhet të realizohen.

### 6.5 Struktura e programit të masave

PM lidhet me gjashtë çështjet e rëndësishme të menaxhimit të ujit që janë identifikuar për Pellgun e Lumit Ibër, duke përfshirë ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore. Ai merr në konsideratë plotësisht objektivat e ndërlidhura të menaxhimit në mënyrë që të arrijë *Qëllimin e Përgjithshëm të Pellgut të Lumit Ibër* dhe objektivat përkatëse të menaxhimit (**Kapitulli 3**). Figura 8 ilustron strukturën e PM të Ibrit si bazë për zbatim.



**Figura 8: Struktura e Programit të Masave (PM) për Pellgun e Lumit Ibër**

Si strukturë bazë, PM ka dy kategori masash, të cilat janë:

- Masat themelore, dhe
- Masat plotësuese

Masat themelore përfshijnë zbatimin e akteve ligjore dhe politikave në nivel shtetëror dhe lokal, të cilat mbështesin arritjen e qëllimit të përgjithshëm të pellgut lumor dhe objektivave të menaxhimit. Nëse është e nevojshme, këto duhet të plotësohen me masa plotësuese për të përmbushur qëllimet dhe objektivat.

### 6.6 Masat themelore për Pellgun e Lumit Ibër

Zbatimi i akteve ligjore, politikave dhe programeve kryesore ekzistuese të nivelit shtetëror dhe rajonal janë në *Klasën 1 të Prioritetit*, pra implementimi i tyre duhet të fillojë para vitit 2030.

Republika e Kosovës ka miratuar standardet mjedisore të BE dhe është bërë përparim thelbësor në zhvillimin e legjislacionit të përgjithshëm lidhur me mbrojtjen e mjedisit, duke përfshirë mbrojtjen e ujit. Harmonizimi i legjislacionit të Kosovës me BE vlerësohet duke monitoruar progresin e transpozimit dhe zbatimit të legjislacionit. Një numër i konsiderueshëm i ligjeve mjedisore janë shqyrtuar dhe miratuar nga Kuvendi i Kosovës gjatë viteve të fundit. Vendi ka bërë gjithashtu progres të dukshëm në miratimin e legjislacionit dytësor (udhëzime administrative, rregullore, vendime, etj.). Kosova gjithashtu ka miratuar Strategjinë Kombëtare për Ujërat, e cila do të ndikojë në zhvillimin e resurseve ujore.

Viteve të fundit, qeveria ka hartuar disa ligje, udhëzime administrative dhe strategjinë e ujit. Ligjet dhe vendimet (legjislacioni primar dhe sekondar) në sektorin e ujit përbëjnë bazën ligjore që rregullon sektorin e menaxhimit të ujërave në Kosovë. Pasqyra e akteve dhe politikave kryesore ligjore ekzistuese, të cilat do të mbështesin zbatimin e PM dhe arritjen e qëllimit të përgjithshëm të pellgut lumor dhe objektivave të menaxhimit është dhënë në **Kapitullin 9**, seksioni 9.3.

Bazuar në punëtoritë teknike të zhvilluara gjatë marsit, majit dhe shtatorit të vitit 2023, u propozuan dhe u konfirmuan nga anëtarët e grupeve punuese rekomandimet e mëposhtme në lidhje me politikën, strategjinë dhe masat rregullatore. Këto janë të gjitha veprimet që janë të nevojshme për përfshirjen e PMPL në ligj dhe rregullore dhe janë kushte të rëndësishme që duhet të plotësohen për të realizuar PM:

- Rishikimi i Ligjit për Ujërat (Nr. 04/L-147) për të adresuar: (i) pjesët e mbetura të patranspozuar të legjislacionit përkatës të BE, (ii) rregullimin e paqartësive (duke përfshirë përmirësimin e termave dhe përkufizimeve në të dyja gjuhët: Shqip dhe Anglisht, (iii) riformulimin e Shtojcës 1 bazuar në DKU, (iv) qartësimin e roleve dhe mandatit midis departamenteve/njësive që kanë të bëjnë me ujin në MMPHI por edhe ndërmjet ministrisë dhe komunave, (v) realizimin e ligjit në praktikë dhe duke parashikuar derogime kur është e mundur;
- Rishikimi i Udhëzimeve Administrative ekzistuese që reflektojnë ndryshimet në Ligjin e rishikuar të Ujërave;
- Hartimi dhe zbatimi i Udhëzimit Administrativ për Pjesëmarrjen e Publikut në menaxhimin e ujërave
- Hartimi i një Strategjie të re Kombëtare për Ujërat e Kosovës për të integruar Programin e konsoliduar të Masave për të 4 pellgjet në Kosovë;
- Rishikimi i Ligjit për Ujitjen (Nr. 02/L-9) për të zbatuar masat e propozuara në Master Planin për Ujitjen lidhur me përdorimin efikas të ujit;
- Zhvillimi i një mekanizmi për zbatimin e Ligjit për Ndryshimet Klimatike për të lehtësuar veprimet e përshtatjes, duke përfshirë përshtatjen e masave që kanë të bëjnë me ujin;
- Hartimi i ligjit të ri për financimin e menaxhimit të resurseve ujore dhe miratimi i një politike të re për kapacitetet njerëzore;
- Zbatimi i Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës (Nr. 03/L-233) dhe kryerja e një vlerësimi të ndikimit në sistemin ujor;
- Rishikimi i Ligjit për Ujërat, Ujitjen dhe Natyrën - sa relevante dhe të përditësuara janë këto ligje për zbatimin e PMPL.

## 6.7 Masa plotësuese për Pellgun e Lumit Ibër

### 6.7.1 Hyrje

Masat plotësuese si pjesë e këtij PM plotësojnë masat themelore. Ato janë identifikuar për zbatim në Pellgun e Lumit Ibër në rast se masat themelore nuk mund të sigurojnë arritjen e qëllimit të përgjithshëm të Ibrit dhe objektivave të menaxhimit. Ato përfshijnë në mënyrë të rëndësishme zbatimin e programeve shtetërore dhe rajonale si dhe masat që parashikojnë zbatimin e projekteve, teknologjive inovative, studimeve dhe nismave të tjera të natyrës teknike ose ekonomike për të arritur qëllimin e përgjithshëm. Më tej, masat përfshijnë veprime për të plotësuar kuadrin ligjor, politik dhe institucional ekzistues me qëllim përmirësimin e menaxhimit të pellgjeve lumore dhe zbatimin e masave.

Masat plotësuese janë ndarë në 7 nënkategori që përmbajnë masa konkrete për çdo ÇRMU.

## 6.7.2 Lista e prioritizuar e masave plotësuese për Pellgun e Lumit Ibër

Bazuar në rezultatet e vlerësimit të statusit për ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe pjesëmarrjen aktive të palëve kryesore të interesit gjatë disa takimeve dhe punëtorive teknike (**Shtojca 7**) është zhvilluar lista e mëposhtme e prioritizuar e masave plotësuese. Këto masa janë kyçe për të filluar në Pellgun e Ibër. Paragrafi në vijim paraqet tërësinë e PM.

Ne perditesimin e planeve Sugjerohet të përfshihen projekte të drejtpërdrejta për restaurimin ekologjik të zonave të eroduara përmes pyllëzimit, stabilizimit të brigjeve dhe masave të bazuara në natyrë

**Tabela 67: Lista prioritare e masave plotësuese për Pellgun e Lumit Ibër.**

#	Masat plotësuese Klasa 1 (fillimi i zbatimit para vitit 2030)	Vendndodhja (shtet, pellg, komunë, trup uhor sipërfaqësor / trup uhor nëntokësor, lokacion)	Pjesë e projektit/programit në vazhdim
1.1	Grumbullimi dhe trajtimi më i avancuar (trajtimi terciar ose më shumë) i ujërave të zeza në vendbanimet me më shumë se 10,000 banorë në ujëmbledhës me ujëra sipërfaqësore "në rrezik".	<i>Përmirësimi i ITUZ ekzistuese ose ndërtimi i ITUZ të reja.</i>  Komunat: Mitrovicë, Prishtinë, Obiliq, Fushë Kosovë, Graçanicë, Podujevë	Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017-2036
1.2	Grumbullimi dhe trajtimi dytësor i ujërave të zeza në vendbanimet me më shumë se 2,000 banorë në ujëmbledhës me ujëra sipërfaqësore "në rrezik".	<i>Përmirësimi i ITUZ ekzistuese ose ndërtimi i ITUZ të reja.</i>  Lokacionet: Skenderaj, Harilaq, Orllan, Mramor.	Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017-2036
1.3	Grumbullimi dhe trajtimi më i avancuar (trajtimi terciar ose më shumë) i ujërave të zeza industriale në ujëmbledhës me ujëra sipërfaqësore "në rrezik".	<i>Përmirësimi i ITUZ ekzistuese ose ndërtimi i ITUZ të reja.</i>  Impiantet industriale: KEK, Trepça, Llamkos, Kishnica.	Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017-2036
1.5	Ndërtimi/rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit nga komunat dhe KRU.	<i>Përmirësimi i rrjetit ekzistues të furnizimit të ujësjellësit dhe atij të kanalizimit.</i>  Komunat: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq dhe Graçanicë.	Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017-2036
1.7	Zbatimi i një rrjeti gjithëpërfshirës monitorimi dhe programi monitorues për ujërat sipërfaqësore (shih gjithashtu rekomandimet në <b>Shtojcat 2 dhe 5</b> ).	Nivel pellgu.	Masë e re e propozuar
1.8	Zbatimi i një rrjeti gjithëpërfshirës monitorimi dhe programi monitorues për ujërat nëntokësore (shih gjithashtu rekomandimet në <b>Shtojcat 2 dhe 5</b> ).	Nivel pellgu.	Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017-2036
1.10	Ndërtimi i digave të reja shumëqëllimëshe për kontrollimin e përmbytjeve, depozitimin e ujit dhe hidrocentralet, sigurinë e ujit, thatësitat, rekreacionin dhe prodhimin e energjisë së bazuar në zero karbon.	Nivel pellgu.	Masë e re e propozuar
1.14	Rehabilitimi i kanalit ujitës Ibër-Lepenc.	Kanali ujitës Ibër-Lepenc (të gjithë trupat uhorë sipërfaqësorë që janë pjesë e sistemit Ibër-Lepenc).	Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017-2036
1.15	Masat strukturore të bazuara në një studim të menaxhimit të përmbytjeve, për të reduktuar përmbytjet në zonat e prirura nga përmbytjet në pellg.	Komunat Skënderaj dhe Mitrovicë.	Masë e re e propozuar

#	Masat plotësuese Klasa 1 (fillimi i zbatimit para vitit 2030)	Vendndodhja (shtet, pellg, komunë, trup uhor sipërfaqësor / trup uhor nëntokësor, lokacion)	Pjesë e projektit/programit në vazhdim
1.16	Instalimi i pajisjeve moderne dhe sistemeve të monitorimit në diga për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave të mëposhtme: matjet gjeodezike, hidrometeorologjike, seizmike, gjeologjike, hidrogjeologjike, hidroteknike dhe bathimetrike.	Batllavë, Badovc dhe Ujman.	Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017-2036
1.18	Siguria e ujit për liqenin e Badovcit.	Badovc / Ujman.	Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017-2036
3.1	Avansimi institucional i kuadrove në planifikimin e MIRU dhe PML në kuadër të departamenteve/njësive përkatëse të MMPHI, ARPL, IHMK, AMMK, Inspektorati.	Nivel shteti dhe pellgu	Masë e re e propozuar
4.3	Ruajtja dhe mbrojtja e liqeneve për qëllime rekreative.	Nivel shteti dhe pellgu	Masat janë duke u zhvilluar dhe implementuar
6.1	Rritja e ndërgjegjësimit për të gjithë akterët dhe qytetarët rreth efikasitetit dhe mbrojtjes së cilësisë së ujit.	Nivel shteti dhe pellgu	Masë e re e propozuar
6.4	Rritja e ndërgjegjësimit për të gjithë akterët mbi rëndësinë dhe përfitimet nga planifikimi i MIRU dhe MPL.	Nivel shteti dhe pellgu	Masë e re e propozuar
7.3	Plani i Menaxhimit të Riskut/Rrezikut nga Përmbytjet për zonat/TUS që janë në rrezik dhe kanë pasur përmbytje në vitet e fundit.	Nivel i pellgu	Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017-2036

### 6.7.3 Masat plotësuese të klasës 1 të prioritetit për Pellgun e Lumit Ibër

Në tabelën e mëposhtme janë përmbledhur të gjitha masat plotësuese si pjesë e zbatimit të klasës 1 të Prioritetit, d.m.th. masa për trupat ujorë sipërfaqësorë dhe nëntokësorë që janë në rrezik të përmbushjes së qëllimit dhe objektivave të Ibrit në vitin 2023.

**Tabela 68: Masat plotësuese të klasës 1 të prioritetit për Pellgun e Lumit Ibër.**

#	Masat plotësuese Klasa 1 (fillimi i zbatimit para vitit 2030)	ÇRMU	Vendndodhja (shtet, pellg, komunë, trup uJOR sipërfaqësor / trup uJOR nëntokësor, lokacion)	Pjesë e projektit/programit në vazhdim	Detajet
1	<b>Masat teknike duke përfshirë teknologjitë inovative</b>				
1.1	Grumbullimi dhe trajtimi më i avancuar (trajtimi terciar ose më shumë) i ujërave të zeza në vendbanimet me më shumë se 10,000 banorë në ujëmbledhës me ujëra sipërfaqësore "në rrezik".	1	<i>Përmirësimi i ITUZ ekzistuese ose ndërtimi i ITUZ të reja.</i>  Komunat: Mitrovicë, Prishtinë, Obiliq, Fushë Kosovë, Graçanicë, Podujevë.	Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017-2036.  ITUZ në Mitrovicë – ekziston një projekt në vazhdim i financuar nga BERZH dhe EIB i cili planifikon të ofrojë shërbime të ujërave të zeza për 200,000 banorë (duke përfshirë komunat më të vogla dhe fshatrat përreth Mitrovicës).  Ekziston një projekt i pezulluar në lidhje me ITUZ në Prishtinë i financuar nga BE (Gjermania dhe Franca).	ITUZ në Prishtinë – ka dy të vogla në Mramor dhe Harilaq. Kapacitetet e tyre janë të vogla në krahasim me shkarkimin e ujërave të zeza dhe duhet të përmirësohen. Në Orllan (pjesë e komunës së Podujevës) ekziston një ITUZ i vogël. Që të trija operohen nga KRU Prishtina dhe bëjnë vetëm trajtim dytësor.  Rritja e efikasitetit të KRU Prishtinë dhe Mitrovicë, si dhe zhvillimi i kapaciteteve financiare të nevojshme për rritjen e investimeve në mirëmbajtjen dhe zgjerimin e aseteve për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit.
1.2	Grumbullimi dhe trajtimi sekondar i ujërave të zeza në vendbanimet me më shumë se 2,000 banorë në ujëmbledhës me ujëra sipërfaqësore "në rrezik".	1	<i>Përmirësimi i ITUZ ekzistuese ose ndërtimi i ITUZ të reja.</i>  Komunat: Skenderaj, Harilaq, Orllan, Mramor.	Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017-2036.	Për vendbanimet e caktuara rurale, sigurimi i një trajtimi dytësor të decentralizuar të ujërave të zeza (nëse është e mundur bazuar në parimet e zgjidhjeve të bazuara në natyrë si tokat e lagështa, filtrat helofitë, etj.).
1.3	Grumbullimi dhe trajtimi më i avancuar (trajtimi terciar ose më shumë) i ujërave të zeza industriale në ujëmbledhës me ujëra sipërfaqësore "në rrezik".	1	<i>Përmirësimi i ITUZ ekzistuese ose ndërtimi i ITUZ të reja.</i>  Impiantet industriale: KEK, Trepça, Llamkos, Kishnica.	Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017-2036.	

#	Masat plotësuese Klasa 1 (fillimi i zbatimit para vitit 2030)	ÇRMU	Vendndodhja (shtet, pellg, komunë, trup uhor sipërfaqësor / trup uhor nëntokësor, lokacion)	Pjesë e projektit/programit në vazhdim	Detajet
1.4	Trajtimi, ripërdorimi / asgjësimi i llumit të ITUZ (zbatimi, monitorimi dhe inspektimi).	1	Komunat në të cilat ITUZ duhet të ndërtohen: Mitrovicë, Prishtinë, Obiliq, FUSHË Kosovë, Graçanicë, Podujevë.  Komunat dhe fshatrat ku veçse ka ITUZ: Skënderaj, Harilaq, Orllan, Mramor.	Masë e re e propozuar	Që kjo të zbatohet, fillimisht duhet të zhvillohet një "Kornizë Kombëtare e Menaxhimit të Llumit".
1.5	Ndërtimi/rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit nga komunat dhe KRU.	1	<i>Përmirësimi i sistemit ekzistues të ujësjellësit dhe kanalizimit.</i>  Komunat: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq dhe Graçanicë.	Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017-2036	
1.6	Përditësimi i Sistemit ekzistues të Informacionit të Ujit me një bazë të dhënash/kadastër të gjeo-referencuar dhe regjistër të lejeve të ndotësve të burimeve të palëvizshme (ndotje urbane, industri, deponi, miniera, etj.).	1	Nivel pellgu	Masë e re e propozuar	
1.7	Zbatimi i një rrjeti gjithëpërfshirës monitorimi dhe programi monitorues për ujërat sipërfaqësore (shih gjithashtu rekomandimet në <b>Shtojcat 2 dhe 5</b> ).	1, 2, 3	Nivel pellgu	Masë e re e propozuar	Zbatimi i një rrjeti monitorimi dhe programi monitorues gjithëpërfshirës dhe ligjërish të detyrueshëm për cilësinë (ndotjen nga burime difuzive) dhe sasinë e ujërave sipërfaqësore, që do të shtrihet në faza bazuar në kapacitetin dhe burimet e disponueshme në IHMK.  Zgjerimi i rrjetit të monitorimit të sasisë së ujit për përrrenjtë dhe degët e lumenjve dhe kryerja e matjeve të vazhdueshme të rrjedhjes së ujit në lokacione strategjike në pellg.  Përfshirja e institutit bujqësor të Pejës në zhvillimin e programit kombëtar të monitorimit.

#	Masat plotësuese Klasa 1 (fillimi i zbatimit para vitit 2030)	ÇRMU	Vendndodhja (shtet, pellg, komunë, trup ujour sipërfaqësor / trup ujour nëntokësor, lokacion)	Pjesë e projektit/programit në vazhdim	Detajet
1.8	Zbatimi i një rrjeti gjithëpërfshirës monitorimi dhe programi monitorimi për ujërat nëntokësore (shih gjithashtu rekomandimet në Shtojcat 2 dhe 5).	6	Nivel pellgu	Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë pohon se ekziston një program i financuar nga Qeveria Suedeze për monitorimin e 6 puseve nëntokësore dhe se do të duhej të përfundonte në fund të vitit 2022.	Zbatimi i një rrjeti monitorimi dhe programi monitorues gjithëpërfshirës dhe ligjërish të detyrueshëm për cilësinë (ndotjen nga burimet e palëvizshme dhe të lëvizshme) dhe sasinë e ujërave nëntokësore, që do të realizohet në disa faza bazuar në kapacitetin dhe burimet e disponueshme në IHMK.  Monitorim më i mirë i niveleve dhe cilësisë së ujërave nëntokësore në zonat e identifikuar si në rrezik nga mbishfrytëzimi dhe/ose përkeqësimi i cilësisë së ujit, duke përfshirë përmirësimin e kapaciteteve përkatëse.  Përfshirja e Institutit Bujqësor të Pejës në zhvillimin e programit kombëtar të monitorimit.
1.9	Përmirësimi i grumbullimit, trajtimit, përpunimit dhe ripërdorimit të mbetjeve të ngurta për të gjitha vendbanimet urbane me mbi 2000 banorë dhe si dhe për zonat kryesore industriale në pellg.	1, 2, 6	Nivel pellgu	Masë e re e propozuar	Zhvillimi dhe zbatimi i planeve të menaxhimit të mbetjeve nga amvisëritë dhe zbatimi i masave, si grumbullimi dhe asgjësimi i duhur i mbetjeve të ngurta për fshatrat/zonat rurale.
1.10	Ndërtimi i digave të reja shumëqëllimëshe për kontrollimin e përmytjeve, depozitimin e ujit dhe hidrocentralet me qëllim të sigurisë së ujit, mbrojtjes nga thatësitat, për qëllime rekreative dhe prodhim të energjisë me zero karbon.	3	Nivel pellgu	Masë e re e propozuar	Është në proces studimi i fizibilitetit për ndërtimin e digës së Pollatës në komunën e Podujevës.
1.11	Masa adekuate për Rimbushjen e Menaxhuar të Akuiferit (RMA) për të lehtësuar rimbushjen e ujërave nëntokësore (me infiltrim, injektim ose filtrim) aty ku sasia e ujërave nëntokësore është "në rrezik".	6	Trupat ujourë nëntokësorë: Drenica, Vicianumi dhe Badovci janë në rrezik të lartë.	Masë e re e propozuar	

#	Masat plotësuese Klasa 1 (fillimi i zbatimit para vitit 2030)	ÇRMU	Vendndodhja (shtet, pellg, komunë, trup uhor sipërfaqësor / trup uhor nëntokësor, lokacion)	Pjesë e projektit/programit në vazhdim	Detajet
1.12	Zgjidhje e bazuar në natyrë për parandalimin e erozionit dhe rrezikut nga rrëshqitjet e tokës aty ku ujërat sipërfaqësore janë 'në rrezik'.	4	Nivel pellgu	Masë e re e propozuar	Duhet të konsiderohen dhe vlerësohen strategji të ndryshme të menaxhimit të pellgut ujëmbledhës në shkallën e pellgut ujëmbledhës (p.sh. pyllëzimi dhe reduktimi i pjerrësisë etj.) si dhe programet e ruajtjes së ujit që zbatohen nga agjencitë qendrore dhe shtetërore lidhur me ndikimet e tyre në ngarkesat e sedimentit.
1.13	Kufizimi i transferit të pesticideve / lëndëve nutritive nëpërmjet rrjedhjes ose shpërlarjes aty ku ujërat sipërfaqësore dhe cilësia e ujërave nëntokësore janë 'në rrezik'.	2, 6	Nivel pellgu	Masë e re e propozuar	Ndërmarrja e masave parandaluese për të ndaluar rrjedhjen dhe lëvizjen e pesticideve të tretura në ujë ose në tokat erozive. Kjo është e detyrueshme në zonat përreth puseve të ujit të pijshëm ose afër rrjedhave ujore.
1.14	Rehabilitimi i kanalit ujitës Ibër-Lepenc.	3	Kanali Ujitës "Ibër-Lepenci" (të gjitha TUS që janë pjesë e sistemit uhor Ibër-Lepenc)	Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017-2036	Modernizimi i sistemeve të ujitjes për kontrollin e ujit, duke përfshirë drejtimin e kanaleve dhe instalimin e strukturave të kontrollit të ujit dhe pajisjeve matëse.
1.15	Masa strukturore të bazuara në një studim të menaxhimit të përmytjeve për të reduktuar përmytjet në zonat e prirura nga përmytjet në pellg.	3, 5	Komuna e Skenderajt dhe Mitrovicës	Masë e re e propozuar	Rihabilitimi i pjesëve të caktuara të shtretërve të lumenjve.
1.16	Instalimi i pajisjeve moderne dhe sistemeve të monitorimit në diga për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave të mëposhtme: matjet gjeodezike, hidrometeorologjike, seizmike, gjeologjike, hidrogjeologjike, hidroteknike dhe bathimetrike.	3, 4	Digat e Batllavës, Badovcit dhe Ujmanit	Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017-2036	
1.17	Punimet e nevojshme rehabilituese në diga.	3, 4	Digat e Batllavës, Badovcit dhe Ujmanit	Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017-2036	
1.18	Siguria e ujit për liqenin e Badovcit.	3, 4	Badovc / Ujman	Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017-2036	Investim në rehabilitimin dhe instalimin e tubacionit i cili mund të sigurojë ujë për Badovcin nga Liqeni i Ujmanit përmes kanalit të Ibër-Lepencit në rast të situatave emergjente.
2	<b>Masat ekonomike</b>				

#	Masat plotësuese Klasa 1 (fillimi i zbatimit para vitit 2030)	ÇRMU	Vendndodhja (shtet, pellg, komunë, trup uhor sipërfaqësor / trup uhor nëntokësor, lokacion)	Pjesë e projektit/programit në vazhdim	Detajet
2.1	Masat rreth çmimeve të ujit për zbatimin e kthimit të kostos për shërbimet e trajtimit të ujërave të zeza nga amvisëritë dhe industria (parimi ndotësit paguajnë përmes taksave dhe tarifave).	1	Nivel pellgu	Masë e re e propozuar	Zbatimi i parimit ndotësi paguan, për shembull në formën e një sistemi tarifimi për amvisëritë dhe industrinë për ujërat e zeza. Hartimi i një skeme operacionale financimi, kombinuar me instrumente për kthimin e kostove të investimit dhe eksplotimit, si dhe kostove që lidhen me kontrollin dhe monitorimin e cilësisë së ujit. Kuadri ekonomiko-financiar duhet të qartësojë përgjegjësitë, shpërndarjen e barrës financiare dhe të vendosë një regjim sanksionimi që inkurajon përdorimin e teknologjive të përshtatshme të trajtimit.
2.2	Masat që kanë të bëjnë me politikat e çmimeve të ujit për zbatimin e kthimit të kostos për shërbimet e ujit për industrinë, bujqësinë dhe amvisëritë (parimi përdoruesit paguajnë përmes taksave dhe tarifave).	3	Nivel pellgu	Masë e re e propozuar	Realizimi i një strukture tarifore vëllimore të ujit për ujin e ujitjes nga sistemet sipërfaqësore të ujitjes.
3	<b>Masat institucionale dhe të ngritjes së kapaciteteve</b>				
3.1	Përforcimi institucional dhe i stafit në planifikimin e MIRU dhe MPL në kuadër të departamenteve/njësive përkatëse të MMPHI, ARPL, IHMK, AMMK, Inspektorat.	Të gjitha ÇRMU	Nivel shtetëror dhe pellgu	Masë e re e propozuar	
3.2	Përforcimi institucional dhe i stafit në planifikimin e MIRU dhe MPL brenda një numri të përzgjedhur komunash.	Të gjitha ÇRMU	Nivel pellgu	Masë e re e propozuar	

#	Masat plotësuese Klasa 1 (fillimi i zbatimit para vitit 2030)	ÇRMU	Vendndodhja (shtet, pellg, komunë, trup uhor sipërfaqësor / trup uhor nëntokësor, lokacion)	Pjesë e projektit/programit në vazhdim	Detajet
3.3	Ngritja e kapaciteteve në monitorimin në terren, marrjen e mostrave, analizat, modelimin dhe menaxhimin e të dhënave në lidhje me sasinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, si dhe ndotjen nga burimet e palëvizshme dhe të lëvizshme.	1, 2, 3, 6	Nivel shtetëror dhe pellgu	Masë e re e propozuar	Zhvillimi dhe ekzekutimi i një plani për ngritjen e kapaciteteve, zgjerimin dhe shpërndarjen e bazës së njohurive dhe shkëmbimin e përvojave, duke përfshirë: përcaktimin e prioriteteve hulumtuese për trajtimin dhe monitorimin e ujit, si dhe indikatorëve të cilësisë së ujit. Trajnimi i planifikuesve të MPL rreth cilësisë së ujit dhe ekosistemeve të lumenjve. Inicimi i një Paneli të Kualitetit të Ujit për të shfaqur histori suksesi dhe për të promovuar shkëmbimin midis palëve të interesit. Plani i ngritjes së kapaciteteve duhet të fokusohet gjithashtu në trajnimin profesional lidhur me aspektet teknike të monitorimit në terren të ujërave sipërfaqësore dhe atyre nëntokësore (matja e rrjedhës, marrja e mostrave, analizat).
3.4	Modernizimi i laboratorëve të cilësisë së ujit, duke përfshirë aftësitë për të monitoruar pesticidet, ndotësit organikë dhe izotopet.	1, 2 & 6	Nivel shtetëror dhe pellgu	Masë e re e propozuar	Kjo do të kërkojë investime në laboratorë dhe pajisje të përshtatshme dhe ngritjen e kapaciteteve përkatëse në monitorimin e ndotësve në zonat e saturuara dhe të pasaturuara, duke përfshirë marrjen e mostrave, analizën, interpretimin dhe modelimin e të dhënave. Kromatograf i gazit, spektrometrat e masës, GC/MS. Pajisjet për përgatitjen e mostrës, aparatet e nxjerrjes, reagjentët dhe standardet, etj.
3.5	Rritja e numrit të stafit të kualifikuar në planifikimin e MIRU dhe MPL brenda departamenteve/njësive përkatëse të MMPHI, ARPL, IHMK, AMMK, Inspektorati.	Të gjitha ÇRMU	Nivel shtetëror dhe pellgu	Masë e re e propozuar	
3.6	Rritja e bashkëpunimit dhe shkëmbimi i të dhënave të monitorimit të ujit midis të gjitha institucioneve relevante në Kosovë.	Të gjitha ÇRMU	Nivel shtetëror dhe pellgu	Masë e re e propozuar	

#	Masat plotësuese Klasa 1 (fillimi i zbatimit para vitit 2030)	ÇRMU	Vendndodhja (shtet, pellg, komunë, trup ujour sipërfaqësor / trup ujour nëntokësor, lokacion)	Pjesë e projektit/programit në vazhdim	Detajet
3.7	Caktimi i një eksperti kyç në MMPHI/ARPL për të lehtësuar koordinimin ndërmjet institucioneve përkatëse në Kosovë.	<b>Të gjitha ÇRMU</b>	Nivel shtetëror dhe pellgu	Masë e re e propozuar	
3.8	Forcimi institucional dhe rritja e kapaciteteve të stafit të ARPL të përfshirë në Leje dhe Licensim.	<b>1</b>	Nivel shtetëror dhe pellgu	Masë e re e propozuar	
<b>4</b>	<b>Masat ligjore, politike dhe rregullatore</b>				
4.1	Përditësimi i Planeve të Menaxhimit të Pyjeve në koordinim me akterët e sektorit të ujit për të gjitha pellgjet e lumenjve.	<b>3, 4</b>	Nivel shtetëror dhe pellgu	Masat janë duke u zhvilluar dhe implementuar.	
4.2	Rishikimi i legjislacionit për të përmirësuar ndërtimin e hidrocentraleve.	<b>3</b>	Nivel shtetëror dhe pellgu	Masat janë duke u zhvilluar dhe implementuar.	
4.3	Ruajtja dhe mbrojtja e liqeneve për qëllime rekreative.	<b>4</b>	Nivel shtetëror dhe pellgu	Masat janë duke u zhvilluar dhe implementuar.	
4.4	Promovimi i qasjes së ekosistemit dhe zgjidhjet e bazuara në natyrë (ZBN).	<b>3, 4</b>	Nivel shtetëror dhe pellgu	Masat janë duke u zhvilluar dhe implementuar.	
4.5	Zonat e mbrojtura në afërsi të trupave ujourë, të caktuara për prodhimin e ujit të pijshëm (si resurset ujore sipërfaqësore ashtu edhe nëntokësore).	<b>3, 6</b>	Nivel shtetëror dhe pellgu	Masat janë duke u zhvilluar dhe implementuar.	
4.6	Regjistrimi dhe politikat ndaj substancave/kimikateve për industrinë duke përfshirë vlerësimin për potencialin e tyre toksik dhe strategjitë për të parandaluar ose reduktuar këta ndotës. Zhvillimi i kufijve të cilësisë së ujit lidhur me mikro-ndotësit dhe substancat e reja 'të ardhshme'.	<b>1</b>	Nivel shtetëror dhe pellgu		Zhvillimi i politikave që mundësojnë mbledhjen e të dhënave dhe ndërgjegjësimin e industrive për efektet e përdorimit të substancave.

#	Masat plotësuese Klasa 1 (fillimi i zbatimit para vitit 2030)	ÇRMU	Vendndodhja (shtet, pellg, komunë, trup uhor sipërfaqësor / trup uhor nëntokësor, lokacion)	Pjesë e projektit/programit në vazhdim	Detajet
4.7	Përforcimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për të përmirësuar përputhshmërinë me objektivat e Planit MPL Ibër, veçanërisht: Përmirësimi i rregullores për përcaktimin e objektivave të cilësisë së ujit. Përmirësimi i rregullores për mbrojtjen e ujit të pijshëm. Përmirësimi i rregullores për ripërdorimet e ujit (standardet e cilësisë, lejet dhe përgjegjësitë e akterëve të ndryshëm). Përmirësimi i zbatimit të rregulloreve (cilësia e shkarkimeve të efluentëve urbanë dhe industrialë). Inicimi/rishikimi i sistemit të lejeve mjedisore dhe sistemit të licencimit.	<b>Të gjitha ÇRMU</b>	Nivel shtetëror dhe pellgu	Masat janë duke u zhvilluar dhe implementuar.	
4.8	Zhvillimi i një kodi të praktikave të mira bujqësore, trajnimi i fermerëve për këtë qëllim dhe krijimi i një skeme subvencionimi për të inkurajuar fermerët që të zbatojnë këtë kod.	<b>2</b>	Nivel pellgu	Masat janë duke u zhvilluar dhe implementuar.	Inicimi i Menaxhimit të Integruar të Dëmtuesve (MID), lehtësimi i praktikave bujqësore efikente dhe të pastra në nivel ferme, lehtësimi i teknikave të ujitjes me efikasitet të ujit, parandalimi i sifonimit dhe shkarkimet e ndotjes difuzive në sistemin e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore.
4.9	Zbatimi strikt i normave të kontrollit të ndotjes për industritë e mëdha dhe qendrat urbane, për të siguruar shkarkimin afër zeros të rrjedhjeve të patrajuara në lumenj.	<b>1, 2, 3, 6</b>	Nivel shtetëror dhe pellgu	Masat janë duke u zhvilluar dhe implementuar.	
4.10	Krijimi i një regjistri për të gjitha llojet e nxjerrjeve nga ujërat nëntokësore (të përdoren informatat në dispozicion).	<b>6</b>	Nivel pellgu		
<b>5</b>	<b>Studime dhe vlerësime për zhvillimin dhe zbatimin e masave</b>				
5.1	Hartimi i një udhëzuesi për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis lidhur me hidrocentralet e reja.	<b>3</b>	Nivel shtetëror dhe pellgu	Masë e re e propozuar	

#	Masat plotësuese Klasa 1 (fillimi i zbatimit para vitit 2030)	ÇRMU	Vendndodhja (shtet, pellg, komunë, trup ujq sipërfaqësor / trup ujq nëntokësor, lokacion)	Pjesë e projektit/programit në vazhdim	Detajet
5.2	Hartimi i një strategjie për iniciimin e masave të efijencës së ujit në pellg.	3, 6	Nivel shtetëror dhe pellgu	Masë e re e propozuar	
5.3	Zbatimi i një strategjie të ujitjes në nivel pellgu për të përmirësuar disponueshmërinë e ujit për bujqësinë.	3	Nivel pellgu	Masë e re e propozuar	
5.4	Vlerësimi i remediacionit për deponitë e kontaminuara.	1, 6	Nivel shtetëror dhe pellgu	Masë e re e propozuar	
5.5	Vlerësimi në nivel pellgu mbi potencialet e ripërdorimit të ujërave të zeza të trajtuara.	1	Nivel shtetëror dhe pellgu	Masë e re e propozuar	Ripërdorimi mund të fokusohet në grupet e mëposhtme: industri, bujqësi, hortikulturë, përdorim të ujit jo të pijshëm. Iniciimi i masave të ripërdorimit të ujit për ujërat e zeza të amvisërive dhe ato industriale të trajtuara në rrethanat e mëposhtme: përdorime urbane që kërkojnë ujë me cilësi të dobët, riciklim brenda objekteve industriale; dhe ripërdorim në industri i ujërave të zeza urbane të trajtuara.
5.6	Rishikimi i teknologjive në dispozicion për trajtimin e ujërave të zeza industriale dhe vlerësimi i aplikimit të mundshëm, duke përfshirë përzgjedhjen e rasteve studimore reprezentative.	1	Nivel shtetëror dhe pellgu	Masë e re e propozuar	
5.7	Parandalimi i emetimeve në hotspotet urbane dhe industriale / përditësimi i raportit të AMMK rreth hotspotëve.	1	Nivel pellgu	Masë e re e propozuar	Zhvillimi i një qasje të integruar për të ulur ndotjen nga hotspotet urbane dhe industriale. Theksi duhet të kushtohet ndikimit të emetimeve të ndryshme, përcaktimit të përqendrimeve dhe ngarkesave, ndikimit të imisionit në lumë / habitat / njerëz.  Përmirësimi i inkuadrimit në sistemet e kanalizimeve dhe ITUZ (trajtimi në fund të tubit) dhe integrimi i potencialit për parandalimin, riciklimin/ripërdorimin e ujërave të zeza për të mbrojtur disponueshmërinë e ujit. Pasi të jetë i disponueshëm një shembull, ai mund të kopjohet në zona (hot spote) të tjera.

#	Masat plotësuese Klasa 1 (fillimi i zbatimit para vitit 2030)	ÇRMU	Vendndodhja (shtet, pellg, komunë, trup uhor sipërfaqësor / trup uhor nëntokësor, lokacion)	Pjesë e projektit/programit në vazhdim	Detajet
<b>6</b>	<b>Masat vetëdijësuese</b>				
<b>6.1</b>	Rritja e ndërgjegjësimit për të gjithë akterët dhe qytetarët për efikasitetin e ujit dhe mbrojtjen e cilësisë së ujit.	<b>Të gjitha ÇRMU</b>	Nivel shtetëror dhe pellgu	Masë e re e propozuar	Fushata sensibilizuese për cilësinë e ujit dhe përdorimin e ujit, si dhe ndikimin në shëndetin e njeriu. Fushata specifike për të inkurajuar përgjegjësinë individuale (p.sh. defekimi i hapur), kolektive dhe korporative.  Programet e administrimit të ujit për sektorët ndotës dhe nxitja e vullnetarizmit mjedisor. Vullnetarët mund të caktohen për të ndihmuar në komunikim me komunitetet e vogla.
<b>6.2</b>	Nxitja e aktiviteteve industriale që investojnë në përmirësimin e proceseve teknologjike dhe trajtimin e ujërave të zeza.	<b>1</b>	Nivel pellgu	Masë e re e propozuar	
<b>6.3</b>	Promovimi i punës në sektorin e ujit në Kosovë për të rritur numrin e njerëzve të kualifikuar dhe rritjen e resurseve njerëzore në sektorin e ujit.	<b>Të gjitha ÇRMU</b>	Nivel shtetëror dhe pellgu	Masë e re e propozuar	
<b>6.4</b>	Rritja e ndërgjegjësimit për të gjithë akterët rreth rëndësisë dhe përfitimeve që vijnë nga planifikimi i MIRU dhe PML.	<b>Të gjitha ÇRMU</b>	Nivel shtetëror dhe pellgu	Masë e re e propozuar	
<b>6.5</b>	Krijimi i një Sistemi Këshillimor Bujqësor (SKB) për të mbështetur fermerët për të kuptuar dhe përmbushur më mirë rregullat dhe standardet e Kosovës për mjedisin, shëndetin publik dhe të kafshëve.	<b>2</b>	Nivel shtetëror dhe pellgu	Masë e re e propozuar	Sistemi mund të jetë vullnetar ose i detyrueshëm. SKB u ofron fermerëve informacion rreth: <ul style="list-style-type: none"> <li>• obligimeve në nivel ferme që rrjedhin nga çështjet ligjore dhe kodi i presioneve të mira bujqësore;</li> <li>• praktikave bujqësore të dobishme për klimën dhe mjedisin;</li> <li>• kërkesave për mbrojtjen e ujit, përdorimin efikas dhe të qëndrueshëm të ujit;</li> <li>• përdorimin e plehrave;</li> <li>• përdorimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve;</li> <li>• Menaxhimin e integruar të dëmtuesve.</li> </ul>

#	Masat plotësuese Klasa 1 (fillimi i zbatimit para vitit 2030)	ÇRMU	Vendndodhja (shtet, pellg, komunë, trup uhor sipërfaqësor / trup uhor nëntokësor, lokacion)	Pjesë e projektit/programit në vazhdim	Detajet
7	<b>Masat tjera</b>				
7.1	Studim mbi potencialet e kapacitetit termik për të prodhuar energji.	-	Nivel shtetëror dhe pellgu	Masë e re e propozuar	
7.2	Mbështetja e fermerëve me panele diellore për pompim/ujitje.	-	Nivel komunal	Masë e re e propozuar	
7.3	Plani i Menaxhimit të Rrezikut (Riskut) nga Përmbytjet për zonat/TUS që janë në rrezik dhe kanë pasur përmbytje në vitet e fundit.	-	Nivel pellgu	Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017-2036	Vlerësimi i nivelit të përmbytjeve për skenarë të ndryshëm përmbytjesh për të kuptuar më mirë se cilat zona janë në rrezik të ulët, të mesëm ose të lartë nga përmbytjet.

## 6.8 Vlerësimi paraprak i kostos së masave shtesë me prioritet

#	Masat shtesë Klasa 1 (fillimi i zbatimit para vitit 2030)	Vendndodhja (shtet, pellgu, bashkia, TUS/ TUN, lokacion)	Pjesë e projektit/programit në vazhdim	Vlerësimi i kostos
1.1	Grumbullimi dhe trajtimi më i avancuar (trajtimi terciar ose më shumë) i ujërave të zeza në vendbanimet me më shumë se 10,000 banorë në ujëmbledhës me ujëra sipërfaqësore në rrezik	Përmirësimi i ITUZ ekzistuese ose ndërtimi i ITUZ të reja në komunat: Mitrovicë, Prishtinë, Obiliq, Fushë Kosovë, Graçanicë, Podujevë.	Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017-2036	Ndërtimi i ITUZ të reja. ITUZ Mitrovicë: 50 milion Euro; ITUZ Prishtinë: 100 milion Euro; ITUZ Obiliq: 20 milion Euro; ITUZ Fushë Kosovë: 40 milionë Euro; ITUZ Graçanicë: 10 milionë Euro; ITUZ Podujevë: 40 milionë Euro.
1.2	Grumbullimi dhe trajtimi dytësor i ujërave të zeza në vendbanimet me më shumë se 2,000 banorë në ujëmbledhës me ujëra sipërfaqësore në rrezik	Përmirësimi i ITUZ ekzistuese ose ndërtimi i ITUZ të reja në komunat: Skenderaj, Harilaq, Orlan, Mramor.	Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017-2036	Përafërsisht 1 deri në 5 milion në varësi të numrit të banorëve për të ndërtuar një ITUZ të ri
1.3	Grumbullimi dhe trajtimi më i avancuar (trajtimi terciar ose më shumë) i ujërave të zeza industriale në ujëmbledhësit me ujëra sipërfaqësore në rrezik	Përmirësimi i ITUZ ekzistuese apo ndërtimi i ITUZ të reja industriale: KEK, Trepça, Llamkos, Kishnica.	Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017-2036	Rehabilitimi: 50 milionë Euro për çdo impiant të madh industrial
1.4	Ndërtimi/rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit nga komunat dhe KRU.	Përmirësimi i rrjetit ekzistues të furnizimit me ujë dhe rrjetit të kanalizimit në komunat: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq dhe Graçanicë.	Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017-2036	5 milionë euro në vit për shpenzimet e mirëmbajtjes 5 milionë për zgjerim/ndërtim të rrjetit të ujit për komunë
1.5	Zbatimi i një rrjeti gjithëpërfshirës monitorimi dhe programi monitorues për ujërat sipërfaqësore (shih gjithashtu rekomandimet në Shtojcat 2 dhe 5).	Nivel pellgu	Masë e re e propozuar	1 milion për lumë 2 milionë për rrjetin e ujërave të stuhisë për komunë
1.6	Zbatimi i një rrjeti gjithëpërfshirës monitorimi dhe programi monitorues për ujërat nëntokësore (shih gjithashtu rekomandimet në Shtojcat 2 dhe 5).	Nivel pellgu	Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017-2036	Të përcaktohet
1.7	Ndërtimi i digave të reja shumëqëllimëshe për kontrollin e përmytjeve, depozitimin e ujit dhe për hidrocentralet në dobi të sigurisë së ujit, menaxhimit të thatësirave, për qëllime rekreative dhe prodhim energjie me nivel zero të karbonit.	Nivel pellgu	Masë e re e propozuar	20 deri në 70 milionë Euro për digë
1.8	Rehabilitimi i kanalit ujitës Ibër-Lepenc.	Kanali Ujitës "Ibër-Lepenci" (të gjitha TUS që janë pjesë e sistemit uhor Ibër-Lepenc)	Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017-2036	1.5 milionë euro për kilometër
1.9	Masat strukturore të bazuara në një studim të menaxhimit të përmytjeve për të reduktuar përmytjet në zonat e prirura nga përmytjet në pellg.	Komuna e Skenderajt dhe Mitrovicës	Masë e re e propozuar	0.2 milionë euro për komunë
1.10	Instalimi i pajisjeve moderne dhe sistemeve të monitorimit në diga për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave të mëposhtme: matjet gjeodezike, hidrometeorologjike, seizmike, gjeologjike, hidrogeologjike, hidroteknike dhe bathimetrike.	Digat e Batllavës, Badovcit dhe Ujmanit	Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017-2036	0.1 – 0.2 milionë Euro për digë

1.11	Siguria e ujit për liqenin e Badovcit.	Badovc / Ujman	Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017-2036	2 milionë Euro për kilometër
1.12	Përmirësimi institucional dhe i stafit në planifikimin e MIRU dhe MPL në kuadër të departamenteve/njësive përkatëse të MMPHI, ARPL, IHMK, AMMK dhe Inspektorat.	Nivel shtetëror dhe pellgu	Masë e re e propozuar	0.5 - 1 milion Euro në vit
1.13	Ruajtja dhe mbrojtja e liqeneve për qëllime rekreative.	Nivel shtetëror dhe pellgu	Masat janë duke u zhvilluar dhe implementuar.	0,5 milion për liqen
1.14	Rritja e ndërgjegjësimit për të gjithë akterët dhe qytetarët për efikasitetin e ujit dhe mbrojtjen e cilësisë së ujit.	Nivel shtetëror dhe pellgu	Masë e re e propozuar	1 milion Euro
1.15	Rritja e ndërgjegjësimit për të gjithë akterët mbi rëndësinë dhe përfitimet nga planifikimi i MIRU dhe MPL.	Nivel shtetëror dhe pellgu	Masë e re e propozuar	1 milion Euro
1.16	Plani i Menaxhimit të Riskut/Rrezikut nga Përmbytjet për zonat/TUS që janë në rrezik dhe kanë pasur përmbytje në vitet e fundit.	Nivel pellgu	Strategjia Shtetërore e Ujërave në Kosovë 2017-2036	1 milion Euro

**Shënim:** vlerësimet e kostos janë paraprake dhe mund të përdoren për studime fizibiliteti dhe buxhetim të hershëm dhe marzhi i saktësisë është +/- 30%. Vlerësimet e kostos janë bazuar në projekte të ngjashme të realizuara gjatë viteve të fundit të korigjuara me një ngritje të indeksit të inflacionit për Kosovën gjatë dy viteve të fundit (mbi 20%).

## Kapitulli 7

### Regjistri i Zonave të Mbrojtura në Pellgun e Lumit Ibër

#### 7.1 Hyrje<sup>34</sup>

Sipas nenit 6 dhe **Shtojcës IV** të DKU, Shtetet Anëtare duhet të krijojnë regjistra të të gjitha zonave që ndodhen brenda çdo pellgu lumor, të cilat kërkojnë mbrojtje të veçantë sipas legjislacionit specifik për mbrojtjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, ose për ruajtjen e habitateve dhe specieve që varen drejtpërdrejt nga uji, duke përfshirë mbrojtjen e zonave të Natura 2000 dhe specieve ujore me rëndësi ekonomike (p.sh. pakurizorët ujorë me ekzoskelet).

Një përmbledhje e regjistrit të zonave të mbrojtura duhet të jetë pjesë e PMPL, duke përfshirë hartat që tregojnë vendndodhjen e secilës zonë të mbrojtur dhe një përshkrim të legjislacionit kombëtar ose lokal sipas të cilit janë përcaktuar zonat e mbrojtura.

Zonat që duhet të përfshihen në *Regjistrin e Zonave të Mbrojtura* dhe gjendja aktuale e *Zonave të Mbrojtura* në Kosovë janë dhënë në Tabela 69.

**Tabela 69: Krahasimi ndërmjet kërkesave të DKU për krijimin e zonave të mbrojtura dhe gjendjes aktuale me zonat e mbrojtura në Kosovë.**

Përmbajtja e Regjistrit të zonave të mbrojtura sipas nenit 6 të DKU dhe Shtojcës IV	Zonat e mbrojtura ligjërisht të shpallura në Kosovë
Zonat e mbrojtura të ujit për pije (Neni 7 DKU) - Agjencia përkatëse duhet të identifikojë çdo trup të ujërave nëntokësore dhe/ose sipërfaqësore (një "zonë e mbrojtur e ujit për pije") brenda çdo pellgu lumi që përdoret për nxjerrjen e ujit të destinuar për konsum njerëzor. Për çdo zonë të mbrojtur të ujit për pije, programi i masave për pellgun e lumit brenda të cilit ndodhet duhet të përfshijë masa me qëllim shmangien e përkeqësimit të cilësisë së ujit në atë zonë, për të ulur nivelin e trajtimit të pastrimit të kërkuar në prodhimin e ujit të pijshëm të nxjerrë prej tij.	Pjesërisht ekuivalente me kërkesat e DKU.
Zonat e përcaktuara për mbrojtjen e specieve ujore me rëndësi ekonomike (peshqit e ujërave të ëmbla dhe pakurizorët e ujërave me ekzoskelet).	-
Zonat e mbrojtura për larje - Direktiva e ujërave për larje (2006/7/EC) është instrument ligjor në menaxhimin e mjedisit dhe reduktimin e rrezikut shëndetësor gjatë larjes në ujërat natyrore. Qëllimi i kësaj direktive është të mbrojë shëndetin e njeriut dhe të ruajë, mbrojë dhe përmirësojë cilësinë e mjedisit.	-
Zonat e ndjeshme ndaj nutrientëve të ujërave të zeza urbane - Zonat e ndjeshme ndaj nutrientëve të ujërave të zeza urbane janë zona që preken nga ndotja me nutrientë si azoti dhe fosfori. Këto zona zakonisht ndodhen pranë trupave ujorë si lumenjtë, liqenet dhe ujërat bregdetare. Direktiva për trajtimin e ujërave të ndotura urbane (DTUNU, Direktiva 91/271/EEC) kërkon grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të zeza në të gjitha zonat urbane me më shumë se 2000 banorë.	-
Zonat e ndjeshme ndaj nitrateve (Direktiva 91/676/KE kërkon që shtetet anëtare të përcaktojnë zonat e ndjeshme ndaj nitrateve, ZNN) - Direktiva e nitrateve kërkon që shtetet anëtare të monitorojnë cilësinë e ujërave dhe të identifikojnë zonat që kullojnë në ujërat e ndotura ose janë në rrezik ndotjeje. Këto	-

<sup>34</sup> Based on a clarification note in relation to the reporting of spatial data for Water Framework Directive (WFD) protected areas, in the context of the March 2022 reporting of the third River Basin Management Plans (RBMPs), 28 April 2022.

Përmbajtja e Regjistrit të zonave të mbrojtura sipas nenit 6 të DKU dhe Shtojcës IV	Zonat e mbrojtura ligjërisht të shpallura në Kosovë
<p>kanë të bëjnë me ujërat që për shkak të aktiviteteve bujqësore janë eutrofike ose mund të përmbajnë një përqendrim prej më shumë se 50 mg/l nitrate. Këto zona përcaktohen si Zona të Ndjeshme ndaj Nitrateve (ZNN). Direktiva e nitrateve është pjesë integrale e DKU dhe është një nga ligjet kryesore që mbrojnë ujërat nga presionet bujqësore.</p>	
<p>Zonat e mbrojtura të Direktivave për Habitatet dhe Zogjtë (lokacionet Natura 2000) - Direktivat e Zogjve dhe Habitateteve përbëjnë themelet e politikës së BE për biodiversitetin. Ato ofrojnë një kornizë të sigurt ligjore për të gjitha vendet e BE në mbrojtjen e biodiversitetit më të vlefshëm dhe më të kërcënuar. Direktiva e Zogjve synon të mbrojë të gjitha llojet e shpendëve të egër që ndodhen në natyrë në BE dhe habitatet e tyre më të rëndësishme. Përveç ndalimit të rënies ose zhdukjes së llojeve të shpendëve, Direktiva synon të lejojë që speciet e shpendëve të rimëkëmben dhe të zhvillohen për një kohë të gjatë. Për të arritur këto synime, vendeve të BE iu kërkohet të marrin masat e nevojshme për të ruajtur ose rivendosur popullatat e shpendëve. Direktiva e Habitateteve synon të mbrojë habitatet natyrore dhe faunën dhe florën e egër në Evropë. Kjo direktivë siguron një kornizë për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të specieve të egra të florës dhe faunës që janë në rrezik zhdukjeje. Zonat e mbrojtura të përcaktuara sipas këtyre direktivave formojnë rrjetin Natura 2000, i cili është rrjeti më i madh i koordinuar i zonave të mbrojtura në botë, i shtrirë në të 27 Shtetet Anëtare të BE, si në tokë ashtu edhe në det.</p>	<p>Pjesërisht ekuivalente me kërkesat e DKU.</p>

## 7.2 Qasja dhe statusi i regjistrimit të zonave të mbrojtura në Pellgun e Lumit Ibër

Qeveria e Republikës së Kosovës vendos të shpallë zona të mbrojtura ujore në bazë të legjislacionit shtetëror, pas sugjerimit të Ministrisë së Mjedisit. Neni 66 i Ligjit për Ujërat e Kosovës specifikon tri lloje të zonave të mbrojtura ujore në Kosovë:

1. Zonat e mbrojtura sanitare (Zonat e përcaktuara për ujë të pijshëm për konsum njerëzor);
2. Zonat e mbrojtura për qëllime strategjike (Zonat e përcaktuara për speciet ujore me rëndësi ekonomike, zonat e përcaktuara për ujë rekreativ dhe për larje, dhe zona të përcaktuara si zona të ndjeshme ndaj lëndëve ushqyese);
3. Zonat e mbrojtura ekologjike (Natura 2000).

### Zonat e mbrojtura sanitare

Kriteret për caktimin e zonave të mbrojtura sanitare, si dhe baza ligjore e përdorur për shpalljen e çdo zone të mbrojtur në Kosovë gjenden në **Kapitullin 2** të këtij plani.

**Tabela 70: Regjistri i zonave të mbrojtura – Kategoria Zonat e Mbrojtura Sanitare (ZMS) në Pellgun e Lumit Ibër.**

Emri i zones së mbrojtur	Nënpellgu	Funksioni	Data e caktimit	Legjislacioni i vendor	Legjislacioni i BE	Trupat ujorë kryesorë	Statusi aktual	Kufinitë e publikuar
Rezervuari (Liqeni) "BADOVCI".	Graçanica	ZMUPN	24.04.2013	Ligji nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës	Direktiva 2000/60/EC	XK-02-04-01	Aktive	I, II, III
						XK-02-04-02		
						XK-02-04-03		
Rezervuari (Liqeni) "BATLLAVA".	Batllava	ZMUPN	24.04.2013	Ligji nr. 04/L-147 për ujërat e Kosovës		XK-02-08-01	Aktive	I, II, III
						XK-02-08-02		
						XK-02-08-03		
Pellgjet në Komunën e Lipjanit- ish Fabrika për prodhimin e letrës	Sitnica	ZMUPN	28.08.2015	Ligji nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës		XK-02-04-01	Aktive	I, II, III
						XK-02-04-02		

#### **Zonat e mbrojtura për qëllime strategjike**

Kosovës aktualisht i mungon ndonjë zonë e përcaktuar për qëllime strategjike. Megjithatë, janë ndërmarrë iniciativa për përcaktimin e zonave të tilla specifike të mbrojtura. Zona specifike të mbrojtura shtesë janë krijuar brenda pellgut në projekt-vendimet e Qeverisë së Kosovës që ende nuk kanë marrë miratimin.

#### **Zonat e përcaktuara për mbrojtjen e habitateve dhe specieve**


Këto zona dhe karakteristikat e tyre janë renditur në Tabela 71.

Tabela 71: Zonat e mbrojtura natyrore në Pellgun e Lumit Ibër.

Kodi	Emri	Komuna / Zona	Zona (ha)	Përshkrimi
RN_001	Kamilja	Leposaviq	228	Rezervat i veçantë natyre me karakteristika paleontologjike
MN_003	Plepi ( <i>Populus tremula</i> ) in Bajçincë	Podujevë	0,05	Monument natyre me karakteristika botanike
MN_006	Shpella e Gadimes	Lipjan	39	Monument natyre me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik
MN_007	Mineralet – Kristalet	Mitrovicë	0,05	Monument natyre me natyrë gjeomorfologjike dhe gjeologjike
MN_017	Shpella e Baicës	Drenas/Gllogoc	0,11	Monument natyre me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik
MN_018	Shpella e Gillanasellës	Drenas/Gllogoc	0,5	Monument natyre me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik
MN_019	Burimi termomineral në Vuqë	Leposaviq	16,6	Monument natyre me natyrë hidrologjike
MN_020	Burimi i ujit mineral ne Sallabajë	Podujevë	0,31	Monument natyre me natyrë hidrologjike
MN_021	Burimi i ujit ne Shajkovc	Podujevë	1,41	Monument natyre me natyrë hidrologjike
MN_022	Trungu i qarrit ( <i>Quercus cerris</i> ) ne Pollatë	Podujevë	0,44	Monument natyre me karakteristika botanike
MN_023	Trungu i qarrit ( <i>Quercus cerris</i> ) ne Dobratin	Podujevë	0,07	Monument natyre me karakteristika botanike
MN_024	Trungjet e rrënjës ( <i>Quercus robur</i> ) në Nekovc	Drenas/Gllogoc	0,05	Monument natyre me karakteristika botanike
MN_025	Kompleksi i trungjeve të rrënjës ( <i>Quercus robur</i> ) në Negroc	Drenas/Gllogoc	0,05	Monument natyre me karakteristika botanike
MN_026	Trungjet e shpërdhit në Negroc	Drenas/Gllogoc	0,05	Monument natyre me karakteristika botanike
MN_027	Shpella e Kishnarekës	Drenas/Gllogoc	2	Monument natyre me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik
MN_028	Trungu i qarrit ( <i>Quercus cerris</i> ) në Krajkovë	Drenas/Gllogoc	0,05	Monument natyre me karakteristika botanike
MN_029	Guri i Gradinës në Llapushnik	Drenas/Gllogoc	2	Monument natyre me karakter gjeomorfologjik
MN_030	Burimi i ujit mineral në Poklek	Drenas/Gllogoc	0,05	Monument natyre me natyrë hidrologjike
MN_031	Trungjet e Dushkut – Gjashtë lisat ( <i>Quercus sp.</i> ) në Likoshan	Drenas/Gllogoc	0,05	Monument natyre me karakteristika botanike
MN_032	Trungjet e dushkut ( <i>Quercus sp.</i> ) në Tërstenik	Drenas/Gllogoc	0,05	Monument natyre me karakteristika botanike
MN_033	Trungu i dushkut ( <i>Quercus sp.</i> ) në Likoshan	Drenas/Gllogoc	0,05	Monument natyre me karakteristika botanike
MN_034	Guri i plakës në Dobroshec	Drenas/Gllogoc	0,05	Monument natyre me karakteristika botanike
MN_036	Trungjet e dushkut ( <i>Quercus sp.</i> ) në Polac	Skenderaj	0,05	Monument natyre me karakteristika botanike
MN_037	Trungu i dushkut ( <i>Quercus sp.</i> ) në Likoc	Skenderaj	0,05	Monument natyre me karakteristika botanike
MN_038	Burimi i ujit termal në Banjë	Skenderaj	0,1	Monument natyre me natyrë hidrologjike
MN_039	Trungu i dushkut ( <i>Quercus sp.</i> ) në Prellovc	Skenderaj	0,05	Monument natyre me karakteristika botanike
MN_040	Kompleksi i trungjeve të dushkut ( <i>Quercus sp.</i> ) në Rrezallë	Skenderaj	0,02	Monument natyre me karakteristika botanike
MN_041	Kompleksi i trungjeve të bungbutës ( <i>Quercus pubescens Willd.</i> ) në Klladernicë	Skenderaj	0,1	Monument natyre me karakteristika botanike
MN_113	Vrella e Zezë, në Petrovë	Shtime	2	Monument natyre me karakteristika hidrologjike
MN_114	Shpella e Imer Devetakut, në Devatak	Shtime	2	Monument natyre me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik
MN_115	Trungjet e dushkut, në Mollopolc	Shtime	0,05	Monument natyre me karakteristika botanike
MN_116	Lisi i Sahitit, në Godanc i Epërm	Shtime	0,05	Monument natyre me karakteristika botanike

Kodi	Emri	Komuna / Zona	Zona (ha)	Përshkrimi
MN_117	Lisi i Alushit, në Rashincë	Shtime	0,05	Monument natyre me karakteristika botanike
MN_118	Shpella e Pjetershticës, në Pjetershticë	Shtime	0,05	Monument natyre me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik
MN_119	Lisat Binjak, në Gadanc i Epërm	Shtime	0,05	Monument natyre me karakteristika botanike
MN_120	Gështenjat e Shtimës, në Shtime	Shtime	0,50	Monument natyre me karakteristika botanike
MN_121	Shpella e Devetakut dhe Burimi, në Devetak	Shtime	2	Monument natyre me karakteristika gjeomorfologjike, hidrologjike dhe speleologjike
MN_122	Trungu i shpardhit ( <i>Quercus frainetto</i> ) në Dyz	Podujevë	0,50	Monument natyre me karakteristika botanike
MN_123	Trungjet e dushkut ( <i>Quercus sp.</i> ) në Llapashticë e Epërme	Podujevë	0,10	Monument natyre me karakteristika botanike
MN_124	Trungu i dushkut ( <i>Quercus sp.</i> ) në Llapashticë e Epërme	Podujevë	0,50	Monument natyre me karakteristika botanike
MN_125	Vrella dhe trungu i ahut, në Dobratin	Podujeva	0,10	Monument natyre me natyrë hidrologjike dhe botanike
MN_126	Trungu i plepit ( <i>Populus tremula</i> ) në Murgullë	Podujeva	0,50	Monument natyre me karakteristika botanike
MN_127	Trungu i Plepit ( <i>Populus tremula</i> ) në Gerdoc	Podujeva	0,50	Monument natyre me karakteristika botanike
MN_128	Trungu i plepit ( <i>Populus tremula</i> ) në Orllan	Podujeva	0,50	Monument natyre me karakteristika botanike
MN_129	Trungjet e Shpardhit Dushkut, ( <i>Quercus frainetto</i> ), në Zhilivodë	Vushtri	0,10	Monument natyre me karakteristika botanike
MN_130	Trungjet e Dushkut, në Druar	Vushtri	0,10	Monument natyre me karakteristika botanike
MN_131	Kompleksi i Trungjeve ( <i>Quercus sp.</i> ) të Dushkut, në Galicë	Vushtri	0,15	Monument natyre me karakteristika botanike
MN_132	Trungu i Bungut, ( <i>Quercus petraea</i> ) në Shitaricë	Vushtri	0,5	Monument natyre me karakteristika botanike
MN_133	Trungu i Rrënjës, ( <i>Quercus robur</i> ) në Dumnicë e LLuges	Vushtri	0,5	Monument natyre me karakteristika botanike
MN_134	Burimi i ujit termomineral, në Gjelbishtë	Vushtri	0,10	Monument natyre me natyrë hidrologjike
MN_135	Trungu i Qarrit, ( <i>Quercus cerris</i> ) në Ceceli	Vushtri	0,50	Monument natyre me karakteristika botanike
ZVM_001	Zone e veçante e mbrojtur e zogjve	Fushë Kosova, Graçanica, Lipjan	109,5	Vlerat dhe karakteristikat si ornitologjike, ihtiologjike, hidrogeologjike, botanike dhe peizazhore.

Harta 25: Pasqyrë e të gjitha zonave të mbrojtura – Pellgu i Lumit Ibër.



## Kapitulli 8

### Procesi i përfshirjes së palëve të interesit dhe konsultimi publik

#### 8.1 Hyrje

Programi i përgjithshëm MIRU-K mbështet krijimin e mekanizmave të pjesëmarrjes së palëve të interesit në MIRU. Si palët zyrtare të interesit, ashtu edhe OSHC/OJQ që përfaqësojnë interesa të ndryshme shoqërore kanë qenë veçanërisht në fokus. Pas ekspertizës së ofruar për zhvillimin e kapaciteteve, OSHC/OJQ të përzgjedhura kanë kontribuar në zhvillimin e PMLP Ibër.

Programi MIRU-K do të mbështesë një sërë aktiviteteve komunikimi dhe vetëdijësi që lehtësojnë përfshirjen e qasjes së MIRU në mesin e palëve kryesore të interesit dhe popullatës së Kosovës.

Për zhvillimin e Planit të Menaxhimit të Pellgut të Lumit Ibër:

- u ofrua mbështetje për ARPL në kuadër të misioneve teknike dhe prezantimeve duke ofruar raporte të misionit dhe dokumente përmbledhëse;
- janë mbajtur dy takime me palët e interesit: në shtator 2023 për presionet dhe vlerësimin e statusit dhe në nëntor 2023 për PMPL dhe PM. Janë përgatitur raportet e takimeve;
- për zhvillimin e PMLP dhe PM janë zhvilluar tri seminare teknike. Rezultatet janë përmbledhur në Shtojcën 7 dhe janë përfshirë në PMLP Ibër.
- është përshkruar një proces për pjesëmarrjen e publikut dhe janë duke u eksploruar opsionet për zyrtarizimin dhe zbatimin e tij.

#### 8.2 Kërkesat e DKU për përfshirjen e palëve të interesit dhe pjesëmarrjen e publikut

Neni 14 i DKU kërkon që Shtetet Anëtare të inkurajojnë përfshirjen aktive të të gjitha palëve të interesit në zbatimin e direktivës, duke përfshirë procesin e planifikimit. Kërkesat për përfshirjen e palëve të interesit dhe pjesëmarrjen e publikut janë të përshkruara në dokumentin udhëzues të DKU nr. 8 mbi pjesëmarrjen e publikut. Dokumenti ofron udhëzime jo-detyruese bazuar në "praktika të mira" dhe mjete shpesh për të ndihmuar Shtetet Anëtare të zbatojnë pjesëmarrjen e publikut në çështje që ndërlidhen me DKU.

Dokumentin udhëzues thekson se pjesëmarrja e publikut është një mjet për të përmirësuar vendimmarrjen dhe jo një objektiv në vetvete. Ai ndihmon në përcaktimin e arsyesimit, kornizës, rezultateve dhe vlefshmërisë së proceseve të vendimmarrjes. Dokumenti përshkruan gjithashtu tri forma kryesore të pjesëmarrjes së publikut: përfshirje aktive në të gjitha aspektet e zbatimit të direktivës, konsultim në tre hapat e procesit të planifikimit dhe qasje në informacionin bazë.

#### 8.3 Identifikimi i palëve të interesit

Për të nxitur një pjesëmarrje aktive të të gjitha palëve të interesit në hartimin e Planit të Menaxhimit të Pellgut të Lumit Ibër, ato u identifikuan dhe u listuan. Lista e mëposhtme përmbledh të gjitha palët e interesit që ishin pjesë e hartimit të planit përmes takimeve, konsultimeve dhe seminareve:

- Institucionet qeveritare
  - o Këshilli Ndërmintor për Ujërat
- Përfaqësues nga institucionet qendrore
  - o MMPHI që përfshin ARPL, AMMK dhe IHMK
  - o Instituti për Shëndetësi Publike në Kosovë
  - o Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
  - o Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
- Përfaqësues nga institucionet vendore
  - o Përfaqësues nga secila komunë
- Kompanitë Rajonale të Ujit
  - o KRU Prishtinë
  - o KRU Mitrovicë

## Kapitulli 9

### Konteksti institucional në menaxhimin e resurseve ujore

#### 9.1 Hyrje

Ky kapitull përmban një përmbledhje të kontekstit ekzistues institucional dhe kornizës së akteve dhe politikave ligjore, të cilat janë relevante për zbatimin e menaxhimit të resurseve ujore në Pellgun e Lumit Ibër. Së bashku me financimin dhe programet ekzistuese të zbatimit, kuadri qeverisës dhe ligjor kontribuon në zbatimin e Planit të Menaxhimit të Pellgut të Lumit Ibër. Në këtë kontekst, Programi i Masave i këtij Plani i referohet këtyre akteve ligjore në masat themelore për çdo Çështje të Rëndësishme të Menaxhimit të Ujit, me qëllim që të kontribuojë në arritjen e synimeve të përgjithshme të dakorduara të Pellgut të Lumit Ibër.

#### 9.2 Autoritetet përgjegjëse të ujit dhe palët kryesore të interesit në menaxhimin e resurseve ujore në Kosovë

Ka një sërë institucionesh të nivelit qendror dhe lokal, si dhe ndërmarrje publike që merren me mbrojtjen dhe administrimin e ujërave. **Error! Reference source not found.** skematizon kornizën institucionale për menaxhimin e resurseve ujore në Kosovë.




Figura 9: Korniza e organizatave institucionale për menaxhimin e resurseve ujore në Kosovë

Sipas Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, *Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës* (MMPHI) dhe *Autoriteti i saj Rajonal i Pellgjeve Lumore* (ARPL) ka këto përgjegjësi:

- Hartimi i ligjeve dhe akteve nënligjore, strategjive, planeve dhe politikave lidhur me të gjitha çështjet e resurseve ujore në Republikën e Kosovës;
- Zbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e resurseve ujore, duke përfshirë ligjet e tjera mjedisore;
- Administrimi dhe menaxhimi i të gjitha resurseve ujore në territorin e Republikës së Kosovës;
- Kryerja e të gjitha detyrave dhe aktiviteteve administrative, profesionale, organizative dhe zhvillimore të obligueshme me këtë ligj;
- Bashkëpunim i ngushtë me ministritë e tjera në Republikën e Kosovës në lidhje me resurset ujore dhe mjedisin jetësor; dhe
- Bashkëpunimi ndërkufitar me vendet fqinje dhe më gjerë në fushën e ujit

***Këshilli Ndërmintor për Ujërat (KNU)*** është organ koordinues dhe vendimmarrës që shqyrton çështjet sistematike të ujit, harmonizimin e nevojave dhe interesave të ndryshme dhe propozon masa për zhvillimin, shfrytëzimin dhe mbrojtjen e resurseve dhe sistemit ujor të Kosovës. Në përgjithësi jep mendime dhe rekomandime për çështjet e ujit në vend, bën propozime për ligje dhe akte të tjera nënligjore që kanë të bëjnë me rregullimin e çështjeve në fushën e ujit në përgjithësi etj.

***Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK)*** është një tjetër institucion publik i themeluar nga Ministria e Mjedisit në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit dhe ka këto përgjegjësi kryesore:

- të siguroj informacionin e duhur për administratën, Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës për zbatimin e politikave në mbrojtjen e mjedisit;
- të zhvilloj dhe koordinoj sistemin unik të informimit për mbrojtjen e mjedisit lidhur me sistemin e përcjelljes së gjendjes së mjedisit në Kosovë si dhe të mbledhë të dhënat për mjedisin;
- ti vendosë dhe ti mbajë qendrat referente me bazat e të dhënave për përcjelljen e mjedisit (të dhënat socio-ekonomike, presionet në mjedis, gjendjen dhe kualitetin e mjedisit);
- të zhvillojë procedurat për përpunimin e të dhënave të grumbulluara për mjedisin dhe vlerësimin e tyre (modelimin, prezantimin dhe paraqitjen vizuale);
- të kryej punët profesionale gjatë përcaktimit të përmbajtjes, metodologjisë dhe mënyrës së përcjelljes të gjendjes së mjedisit

***Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK)***, në bazë të Ligjit për Ujërat e Kosovës, është përgjegjës për zbatimin e Programit të Monitorimit i cili hartohet nga Ministria dhe miratohet nga Qeveria për një periudhë dyzet (40) vjeçare me mundësi rishikimi, duke ndryshuar dhe plotësuar, bazuar në të dhënat e monitorimit. Gjithashtu, ky institut është përgjegjës për monitorimin e sasisë dhe cilësisë së ujërave sipërfaqësore, nëntokësore dhe rezervuarëve. Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK) përfaqëson shtetin në fushën e meteorologjisë

dhe hidrologjisë dhe kryen funksionet e institucionit shtetëror Hidrometeorologjik në organizatat ndërkombëtare të Meteorologjisë dhe Hidrologjisë.

**Ministria e Ekonomisë (ME)** - Njësia e Politikave dhe Monitorimit të Ndërmarrjeve Publike është përgjegjëse për Ligjin për Ndërmarrjet Publike (Nr. 03/L-087). Ky ligj i kategorizon ndërmarrjet publike të përfshira në menaxhimin e ujit për pije dhe ujitje në tre grupe: ndërmarrje publike qendrore, ndërmarrje publike rajonale dhe ndërmarrje publike lokale. Janë shtatë kompani rajonale të ujit për rajone të ndryshme në Kosovë.

**Ministria e Shëndetësisë (MSH)- Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKSHP)** është institucioni shëndetësor profesional dhe shkencor në Kosovë. Në fushën e ujit, IKSHP është përgjegjës për propozimin dhe vendosjen e standardeve të ujit të pijshëm që distribuohet nga kompanitë e ujësjellësit, si dhe për monitorimin e zbatimit të këtyre standardeve. Baza ligjore për autoritetin dhe përgjegjësitë e IKSHP përbëhet nga Udhëzimi Administrativ Nr. 2/99 i cili rregullon çështjen e cilësisë së ujit të pijes. Misioni i IKSHP qëndron në mbrojtjen dhe përmirësimin e shëndetit të popullatës duke monitoruar treguesit, parandalimin e sëmundjeve dhe promovimin e shëndetit publik.

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR)**- Në fushën e ujitjes dhe kullimit të tokës bujqësore, MBPZHR ka këto përgjegjësi:

- Zhvillimi i politikave të ujitjes dhe kullimit;
- Përcaktimin e kriterëve dhe limiteve të propozuara për tarifat e ujitjes;
- Si anëtar i Bordit Mbikëqyrës, vlerëson planet e biznesit për të siguruar zbatimin e politikave të miratuara;
- Jep pëlqim për transferimin e përgjegjësive për menaxhimin e kanaleve dytësore dhe terciare dhe objekteve përkatëse nga shoqëria te shoqata, brenda kufijve të duhur;
- Përcakton përgjegjësitë dhe kufijtë ndërmjet kompanive dhe shoqatave, si dhe vetëm ndërmjet shoqatave.

Uji për ujitje ofrohet nëpërmjet infrastrukturave kryesore të operuara nga kompani të regjistruara dhe të licencuara që ofrojnë shërbime. Kompanitë operojnë sipas kushteve të kontratave të tyre, në përputhje me detyrat e dhëna nga MBPZHR. Në Kosovë ekzistojnë tri Kompani Rajonale të Ujitjes.

**Ministria e Financave (MF)**- MF është përgjegjëse për ndarjen e fondeve për të gjithë akterët e lartpërmendur.

**Komunat**- Bazuar në Ligjin për Ujërat, komuna ka këto detyra dhe përgjegjësi sa i përket menaxhimit të ujërave:

- Lëshon leje ujore në bazë të aktit nënligjor për lejet ujore dhe sipas autorizimit nga Ministria e Mjedisit;
- Ndërtimi i objekteve dhe pajisjeve ujore për mbrojtje nga efektet e dëmshme të ujit ose qëllime të tjera;
- Mbrojtja nga dëmtimet e ujit, erozioni dhe nga aktivitete tjera të dëmshme në zonat urbane dhe periferike, si dhe financimi i veprimeve të tilla;
- Hartimi i programit të mbrojtjes për efektet e dëmshme të ujit në bashkëpunim me autoritetet përkatëse qeveritare;

- Përcaktimi i pikave të erozionit brenda zonave urbane dhe financimi i mirëmbajtjes dhe rregullimit të flukseve dhe aktiviteteve për mbrojtjen nga erozioni në këto zona;
- Menaxhimi i objekteve të rregullimit të flukseve në zonat urbane dhe ndërmarrja e të gjitha masave të nevojshme për rregullimin e flukseve në këto zona;
- Informimi i MMPHI sa më shpejt që të jetë e mundur në rastet e rrezikut nga erozioni dhe përmbytjet.

**Autoriteti Rregullativ për Shërbimet e Ujit (ARRU)**- Rregullator i pavarur ekonomik për shërbimet e ujit dhe ujërave të zeza në Kosovë. Roli i ARRU është të sigurojë ofrimin e shërbimeve cilësore, efikase dhe të sigurta në baza jodiskriminuese për të gjithë konsumatorët kosovarë, duke marrë parasysh mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik. Detyrat dhe përgjegjësitë e ARRU në sektorin e ujit përfshijnë:

- Licencon ndërmarrjet publike që ofrojnë: (1) shërbime të furnizimit me ujë dhe ujërave të zeza, (2) shërbime të furnizimit me ujë me shumicë të kompanive të ujësjellësit;
- Vendos dhe miraton tarifat e shërbimeve për shërbimet e rregulluara, duke siguruar që tarifat të jenë të drejta dhe të arsyeshme dhe të mundësojnë qëndrueshmëri financiare të ofruesve të shërbimeve;
- Kryen monitorimin dhe implementimin e përputhshmërisë me standardet e shërbimit për ofruesit e licencuar të shërbimeve;
- Mbikëqyrë dhe zbaton Kartën e Konsumatorëve e cila përmban të gjitha të drejtat dhe detyrimet si për ofruesit e shërbimeve ashtu edhe për klientët;
- Mbikëqyrë dhe zbaton regjimin e shkyçjes dhe lidhjet e paligjshme;
- Themelon dhe mbështetë Komitetet Konsultative të Konsumatorëve në secilën zonë të shërbimit - shtatë rajone të Kosovës

## Kapitulli 10

### MIRU në nivelin e pellgut lumor: mësimet e nxjerra nga zbatimi i DKU në Evropë

Një çështje e rëndësishme është se si institucionet qeveritare në të gjitha nivelet përkatëse i përkushtohen punës drejt zhvillimit të një vizioni dhe qëllimi të përbashkët për pellgun e lumit dhe zbatimin e tyre? Duke u mbështetur në mësimet e nxjerra në Evropë dhe në kontekstualizimin e aplikuar gjatë punës në Planet e MPL në Kosovë, mund të bëhen 10 rekomandimet/mësimet si në vijim:

1. Menaxhimi i pellgjeve lumore është çështje kyçe për të përmirësuar cilësinë e ujit dhe disponueshmërinë e ujit: uji nuk ndjek kufijtë administrativë, të vendeve ose shteteve, rajoneve ose fshatrave. Bashkëpunimi në nivel pellgu për të arritur marrëveshje të ndërsjella brenda pellgut është jetik për zhvillimin e një vizioni të përbashkët për pellgun dhe përmirësimin gradualisht të resurseve ujore të pellgut dhe sistemeve ujore.
2. Transparenca është jetike për menaxhimin e pellgjeve lumore: ÇRMU të përcaktuara qartë me vizion dhe objektiva, standarde mjedisore transparente, marrëveshje të orientuara drejt rezultateve, transparencë në proces (afati kohor i zbatimit ciklik) dhe transparencë në ndarjen e të dhënave të marra nga monitorimi janë kritere jetike për menaxhimin e pellgut lumor. Në këtë mënyrë, vendimmarrësit dhe zyrtarët e menaxhimit të ujit përgjegjës për kapacitetin, buxhetin dhe planifikimin, janë në gjendje të justifikojnë investimet. Hartimi i kësaj që u tha më lartë për të gjitha autoritetet publike ofron një ndjenjë besimi dhe i motivon ata për përpjekje të përbashkëta për të realizuar objektivat e vendosura. Rrjedhimisht, politika ujore e pellgjeve lumore është gjithashtu transparente për autoritetet publike, organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarët.
3. Synimi për një vizion ambicioz me synime realiste të ndërmjetme: zbatimi i vizionit të përbashkët, qëllimeve dhe objektivave për pellgun lumor nuk mund të realizohet brenda një cikli 6-vjeçar. Në vend të kësaj, ndarja në faza e implementimit dhe ndjekja e një qasjeje ciklike të zbatimit me një vlerësim të përditësuar të rrezikut në çdo periudhë pasuese është thelbësore. Vizioni dhe objektivat afatgjata mund të jenë ambicioze, por qëllimet e ndërmjetme duhet të jenë realiste. Kjo gjithashtu do t'i mbajë akterët përkatës të motivuar dhe të përfshirë.
4. Bashkëpunimi brenda një Autoriteti të Pellgjeve Lumore mbështet zbatimin e MIRU brenda një pellgu lumor: edhe në pellgjet e mëdha si lumenjtë Rhine dhe Danub në Evropë, bashkëpunimi brenda Komiteteve ndërkombëtare të Pellgjeve Lumore dhe në shkallë kombëtare në Autoritetin e nënpellgut rezultoi në pako të realizueshme dhe të përbalueshme masash për të punuar në vizionin, qëllimet dhe objektivat e pellgut të lumit. Suksesi i bashkëpunimit në nivelin e pellgut qëndron në verifikimin e përbashkët gjatë vlerësimit të rrezikut për ÇRMU të identifikuar. Duhet të ketë angazhim të përbashkët në një PMPL të pellgut, duke përfshirë edhe një PM të detajuar. KPL janë nivele thelbësore bashkëpunimi për të drejtuar dhe koordinuar zbatimin e planit të MPL dhe për të lehtësuar pjesëmarrjen e të gjithë palëve të interesit (qeveritare dhe joqeveritare). KPL duhet të takohen rregullisht (3-4 herë në vit) dhe axhenda duhet të përgatitet së bashku me përfshirjen e të gjithë anëtarëve të autoritetit.
5. Ndërgjegjësimi për vlerat e ujit të pastër dhe të shëndetshëm: zbatimi i parimeve të MIRU në nivelin e pellgut dhe puna e përbashkët në një plan MPL rezulton në një kuptim më të mirë të ÇRMU dhe ndërhyrjeve të mundshme për t'i adresuar ato. Tani po pranohet gjithnjë e më shumë se siguria e ujit që nënkupton ujë të pastër dhe

ekosistem ujq të shëndetshëm është thelbësore për zhvillimin shoqëror dhe rritjen ekonomike. Palët e interesit të pellgut tani ndajnë këtë këndvështrim ndaj menaxhimit të ujit.

6. Qasja nga lart poshtë dhe nga poshtë-lart: DKU e definojnë kuadrin për përcaktimin e standardeve të cilësisë mjedisore dhe kushteve referente për objektivat ekologjike (nga lart poshtë), por detajimi i objektivave ekologjike përcaktohet në nivel rajonal (për çdo trup ujq sipërfaqësor dhe nëntokësor). Prandaj, vetë autoritetet rajonale të ujit janë më të lidhura dhe të përkushtuara ndaj grupit të objektivave për cilësinë e ujit dhe ekologjinë. Sigurisht, kushtet referente të cilësisë kimike të ujit janë të përcaktuara në nivel shtetëror dhe duhet të zbatohen për të gjithë trupat ujqorë.
7. Efekti i një 'obligimi/detyrimi për rezultat': zbatimi i masave të DKU për të arritur objektivat i nënshtrohet një obligimi ndaj rezultatit, me dënimine nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë si mjeti i fundit i parandalimit. Ky presion "nga lart-poshtë" nga Komisioni Evropian po funksionon mjaft efektshëm brenda BE dhe i mban të gjitha palët në përgjegjësitë e tyre.

Një çështje e dytë e rëndësishme është se si të nxiten akterë të ndryshëm, sektorë dhe përdorues të ujit që të bashkëpunojnë dhe të kontribuojnë në menaxhimin e cilësisë së ujit dhe parandalimin e ndotjes?

8. Licencimi, zbatimi dhe mbikëqyrja: një nxitje e rëndësishme për sektorë të ndryshëm është legjislacioni i duhur për cilësinë e ujit dhe shëndetin e ekosistemit. Qasja e DKU është një shembull se si një legjislacion i lidhur me ujin është inkorporuar brenda një Bashkimi të shteteve të pavarura, social me legjislacionin e vet. Vetëm me një legjislacion, sistemi i ujit nuk do të përmirësohet. Prandaj, është e rëndësishme të krijohet një sistem transparent dhe funksional i licencimit, zbatimit dhe mbikëqyrjes nga autoritetet përgjegjëse dhe përkatëse.
9. Bashkëpunimi me Autoritetin e Pellgjeve Lumore: bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve publike dhe përfaqësuesve të sektorëve të ndryshëm në shoqëri rezultoi në të kuptuar më të mirë të vizionit, qëllimit dhe objektivave të përbashkëta për pellgun e lumit. Bindja për rëndësinë e një sistemi ujqor të shëndetshëm për konsum njerëzor, bujqësi, industri, blegtori, turizëm, etj., është një nxitje e madhe për këta sektorë për të mbështetur punën për MIRU. Nëse vetë sektorët nuk janë të bindur, do të jetë shumë e vështirë të zbatohen masat për përmirësimin e cilësisë së ujit.
10. Pjesëmarrja rriti komunikimin për cilësinë e ujit: brenda BE nevoja për të komunikuar në lidhje me aktivitetet dhe produktet e DKU ka rritur njohuritë dhe ndërgjegjësimin për cilësinë e ujit dhe ekologjinë. Pjesëmarrja nuk është thjesht një detyrim sipas DKU. Në vend të kësaj, synohet gjenerimi i njohurive lokale dhe ofrimi i mundësisë banorëve, bizneseve dhe organizatave për të shprehur interesat dhe shqetësimet e tyre dhe për t'u përfshirë në politikëbërjen e ujit. Në fund, kjo forcon mbështetjen për zbatimin dhe ekzekutimin e masave.

## Kapitulli 11

### Referencat

1. Anketa e Ekonomive Bujqësore 2021. <https://ask.rks-gov.net/media/7436/agricultural-holdings-survey-2021.pdf>
2. Të gjitha ligjet dhe udhëzimet administrative mund të gjenden në <https://gzk.rks-gov.net/default.aspx?index=1>
3. Raporti Vjetor i Performancës për Ofruesit e Shërbimeve të Ujit në Kosovë 2021 [http://www.arrurks.org/assets/cms/uploads/files/Monitorimi%20i%20Performances/Raporti%20Vjetor%20i%20Performances%20se%20Ofruesve%20te%20Sherbimit\\_%20ENG\\_05.09.2022.pdf](http://www.arrurks.org/assets/cms/uploads/files/Monitorimi%20i%20Performances/Raporti%20Vjetor%20i%20Performances%20se%20Ofruesve%20te%20Sherbimit_%20ENG_05.09.2022.pdf)
4. B. Healey et al., Aquaculture and its impact on the environment, University of Massachusetts Amherst, April 2012
5. Biodiversity and Forestry Indefinite Quantity Contract, USAID, Kosovo, May 2003
6. Common Implementation Strategy for the Water Framework Directive (2000/60/EC), Guidance document No. 10, River and lakes – Typology, reference conditions and classification systems, page 21
7. Common Implementation Strategy for the Water Framework Directive (2000/60/EC) - Guidance Document No. 18 – Guidance on Groundwater Status and Trend Assessment
8. Deltares and Abkons, Proposal for the Establishment of Pilot Monitoring for Surface Water and Groundwater in Three River Basins, July 2022
9. Directive (EU) 2020/2184 of the European Parliament and of the Council of 16 December 2020 on the quality of water intended for human consumption (recast) (Text with EEA relevance), **Annex 1**
10. Draft Vardar River Basin Management Plan (VRBMP). Technical Report. Twinning Project MK 13 IPA EN 01 16. 2019.
11. EBRD, & WorldBank. (2012). Feasibility study for protection of Ibër-Lepenc canal Kosovo: Environmental and Social Impact Assessment Framework.
12. Raportin për Hotspotet Mjedisore në Kosovë 2011. [https://ammkrks.net/assets/cms/uploads/files/Publikime-  
raporte/raporti\\_i\\_hotospoteve\\_shqip\\_18122012\\_final.pdf](https://ammkrks.net/assets/cms/uploads/files/Publikime-raporte/raporti_i_hotospoteve_shqip_18122012_final.pdf)
13. Epitar, Study on assessment of pressures and risks from diffuse pollution, IWRM-K, 2023
14. ERO Annual Report 2021. <http://www.eroks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Raportet%20Vjetor/Annual%20Report%202021.pdf>
15. EU Twinning Project KS 09 IB EN 01-Draft Report on Groundwater Monitoring “Support to the Environment Sector” in Kosovo, 2011
16. [EUR-Lex - 02008L0105-20130913 - EN - EUR-Lex \(europa.eu\)](#)
17. [EUR-Lex - 32000L0060 - EN - EUR-Lex \(europa.eu\)](#)
18. [EUR-Lex - 32006L0118 - EN - EUR-Lex \(europa.eu\)](#)
19. European Commission – CIS Guidance 13 - Overall approach to the classification of ecological status and ecological potential
20. European Commission – CIS Guidance Document 18 - Guidance on Groundwater Status and Trend Assessment

21. European Commission – CIS Guidance No 31 – Ecological Flows in the Implementation of the WFD
22. European Commission – Directive 2000/60/EC – **Annex II**
23. European Commission – Directive 2000/60/EC - establishing a framework for Community action in the field of water policy
24. European Commission – Directive 2006/118/EC - on the protection of groundwater against pollution and deterioration
25. European Commission – Directive 2008/105/EC – The Environmental Quality Standards Directive
26. European Commission – Directive 91/676/EEC - concerning the protection of waters against pollution caused by nitrates from agricultural sources
27. European Commission – Water Framework Directive, **Annex II, 1.3**
28. European Commission – Water Framework Directive, **Annex V, 1.4.1**
29. European Commission – Water Framework Directive, Article **16**, and **Annex X** replaced by EQSD, **Annex II**
30. European Commission- Environmental Flows as a Tool to Achieve WFD Objectives - Discussion Paper, 2012
31. European Environmental Agency (2020). European Significant Water Management Issues
32. European Standard EN 15843 - Water quality - Guidance standard on determining the degree of modification of river hydro-morphology
33. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës së Kosovës. <https://auvk.rks-gov.net/>
34. Green Report 2022. [https://www.mbpzhrks.net/repository/docs/Raporti\\_i\\_Gjelber\\_20221.pdf](https://www.mbpzhrks.net/repository/docs/Raporti_i_Gjelber_20221.pdf)
35. [Groundwater \(europa.eu\)](http://Groundwater.europa.eu)
36. <https://ammk-rks.net/en/publikime/25/arkivi/p4>
37. <https://ask.rks-gov.net/media/6390/vjetari-statistikor-2021f.pdf>
38. <https://ask.rks-gov.net/media/6390/vjetari-statistikor-2021f.pdf>
39. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15796>
40. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2631>
41. [https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Biodiversiteti%20IK/Zonat%20e%20mbrojtura/Zonat\\_e\\_Mbrojtura.pdf](https://www.ammk-rks.net/assets/cms/uploads/files/Biodiversiteti%20IK/Zonat%20e%20mbrojtura/Zonat_e_Mbrojtura.pdf)
42. Uebfaqja e Kompanisë Ibër-Lepenci <https://Ibër-lepenc.org/>
43. ICMM (Independent Commission for Mines and Minerals). <https://kosovo-mining.org/?lang=en>
44. IEWP & SGR, India EU-Water Partnership (IEWP) and Support to Ganga Rejuvenation (SGR): the India-EU Water Partnership aims to facilitate cooperation between India and a flexible coalition of EU Member States on water related issues. The IEWP Action is co-financed by the European Union and the German Federal Ministry for Economic Cooperation and Development (BMZ). The IEWP Action is implemented by GIZ. Website: [www.iewp.eu](http://www.iewp.eu)
45. Installation of sensors for monitoring wells, by AGS Corporation SH.P.K, for Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure (MESPI), Regional Authority of River Basins
46. INTEGRATED WATER RESOURCES MANAGEMENT IN KOSOVO (IWRM-K). Phase 1- May 2020 – April 2024. Technical Support to Agriculture in Kosovo in the Context of

Integrated Water Resources Management. STUDY ON ASSESSMENT OF PRESSURES AND RISKS FROM DIFFUSE POLLUTION

47. [IWRM Website \(iwrm-k.com\)](http://www.iwrm-k.com)
48. IWRM-K. (2022). Economic Assessment of Water Resources Management.
49. AMMK (2020). Raporti për gjendjen e ujërave në Kosovë.
50. AMMK. (2020). Raporti për gjendjen e mjedisit
51. Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, 2020
52. Master Plani i Ujitjes 2020. [https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Master Plani kombetar i Ujitjes i perkthyer ne gjuhen shqip 2021.pdf](https://www.mbpzhr-ks.net/repository/docs/Master_Plani_kombetar_i_Ujitjes_i_perkthyer_ne_gjuhen_shqip_2021.pdf)
53. Ligji Nr. 04/L-147 Ligji i Ujërave të Kosovës
54. Planet menaxhuese (PMPL) 2Prill 2022
55. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. <https://www.mbpzhr-ks.net/>
56. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI). <https://mmphi.rks-gov.net/>
57. Strategjia për Ndryshimet Klimatike 2018- 2017/ Plan ii Veprimit për Ndryshimet Klimatike 2018- 2020
58. PointPro (2023). Integrated Water Resources Management in Kosovo (IWRM-K), phase 1, May 2020-April 2024.
59. PointPro (2023). Water Balance Study for Kosovo & Support to Upgrade of Hydro-meteorological Monitoring System Kosovo Surface Water Quality.
60. KRU "Mitrovica". <http://www.kru-mitrovica.com/>
61. KRU "Prishtina". <https://kru-prishtina.com/rz/>
62. SAFEGE-EpTisa-Seureca-Beoinzenjering 2000-Safege Doo. MPS for Sewerage & Wastewater in the West Morava River Basin, R3: Environmental Impact Assessment, 2012)
63. Scheidleder, A., 2012. Groundwater threshold values – In-depth assessment of the differences in groundwater threshold values established by Member States. Environment Agency Austria (EAA)
64. Vjetari Statistikor i Kosovës 2021. <https://ask.rksgov.net/media/6968/statistical-yearbook-2021.pdf>
65. Studimi mbi ndryshimet klimatike në rajonin e Ballkanit Perëndimor, 2018
66. [Surface water \(europa.eu\)](http://europa.eu)
67. [THE 17 GOALS | Sustainable Development \(un.org\)](http://un.org)
68. [The Natura 2000 protected areas network — European Environment Agency \(europa.eu\)](http://europa.eu)
69. The Sida Framework Environmental Programme for Kosovo, December 2022
70. UNEP partnership, Mining an environment in the Western Balkans, 2010
71. UNMIK. (2016). UNMIK Waste Management Plan
72. Water Polluters Cadastre. [https://www.ammkrks.net/assets/cms/uploads/files/Publikime-raporte/Water Polluters Cadastre eng.pdf](https://www.ammkrks.net/assets/cms/uploads/files/Publikime-raporte/Water_Polluters_Cadastre_eng.pdf)
73. Water Security for Central Kosovo 2012 <https://elibrary.worldbank.org/doi/abs/10.1596/27116>
74. Water Security for Central Kosovo 2018 <https://documents1.worldbank.org/curated/en/496071548849630510/Water-Security-Outlook-for-Kosovo.pdf>

75. Water Supply Server in Rural Areas, Kosovo, 2000/01 Premiere Urgence, Aide Humanitarian Internationale
76. [wfd — Bibliotheek \(europa.eu\)](#)
77. [wfd — Bibliotheek \(europa.eu\)](#)
78. Banka Botërore, 2014. Feasibility Study for Protection of Iber-Canal
79. [www.waterconsultant.com](http://www.waterconsultant.com)